



HALIL RAMA

 UETPRESS

MAGJIA E FJALËS

Profile krijuesish, kritikë letrare, analiza të veprave studimore

Me parathënie nga Preç Zogaj

63 - ESSE / *ide & debate*

MAGJIA E FJALËS

Një libër për librat...

*Profile krijuesish, kritikë letrare,
analiza të veprave studimore*

HALIL RAMA

Me parathënie nga Preç Zogaj

 UET PRESS

Tiranë, prill 2022

Titulli i librit: **MAGJIA E FJALËS**
Një libër për librat...

Autor: Halil **RAMA**
Redaktor: Aristir **LUMEZI**
Recensent: Dr. Hajri **MANDRI**

Libri është pjesë e kolanës “**MONOGRAFI, ESSE, STUDIME**”.

© 2022 UET Press. Të gjitha të drejtat të rezervuara.

Asnjë pjesë e këtij botimi, mbrojtur nga ligji nr. 9380, dt. 28.04.2005 i Shtetit Shqiptar “Për të drejtat e autorit dhe të drejta të tjera lidhur me të”, nuk mund të riprodhohet, ruhet, transmetohet a përdoret me asnjë formë a mjet grafik, elektronik apo mekanik, përfshirë por jo kufizuar fotokopje, skanime, digjitalizim, rrjet web apo sisteme të tjerë, pa lejen me shkrim të botuesit.

Universiteti European i Tiranës
Shtëpia Botuese Universitare “UET Press”
Adresa: Rr. “Xhanfize Keko”, Nd.56, Godina B, Tirana, Albania
uetpress@uet.edu.al
www.uet.edu.al/uetpress

Botimet UET Press certifikohen pranë Zyrës Shqiptare
për Mbrojtjen e të Drejtave të Autorit.

International Standard Book Number (ISBN) 978-9928-320-88-9

Libri është kataloguar në datën e publikimit pranë Bibliotekës Kombëtare të Shqipërisë
dhe Bibliotekës së Universitetit European të Tiranës.



Shtëpia Botuese Universitare
“UET Press” është pjesë e
Universitetit European të Tiranës.

Tiranë, prill 2022

PËRMBAJTJA

...Në shërbim të librit në gjuhë shqipe.....	1
<i>Parathënie nga Preç Zogaj</i>	

I. PROFILE & KRITIKË LETRARE

Presidenti Reagan ose ëndrra amerikane e jetësuar	7
Teodor Laço, njeriu i letrave, politikës dhe diplomacisë.....	15
ADN-ja e pandryshuar e Shefki Karadakut.....	24
Magjia e fjalës në prozën e Zija Çelës.....	34
“Një e tretë dashuria”, një kulm në poezinë e Preç Zogajt.....	40
Një palë “opinga” për Hrushovin?!	46
Trilli artistik befasues i Bashkim Hoxhës në romanin “Një shaka e vogël me vdekjen”	54
Romani “Anja” i jep Ahmet Prençit çmimin letrar të karrierës “Gjergj Fishta”... ..	58
“Saga përtej Atlantikut”, një rrëfim ndryshe	68
“5 skenarë...” të Bujar Kapexhiut	76
Për poetin e këngës, Naim Plaku	82
Hazis Ndreu, ikonë e artit dhe kulturës kombëtare.....	87
Berishët e Muhurrit, si rast unikal në historinë Skënderbegiane	94
Shpendi Topollaj, shkrimtari produktiv me krijimtari shumëplanëshe	102
Romani “Polakja” i Xhevat Mustafës, radiografi e diktaturës, prognozë e së ardhmes	105
Hysni Bruçi, si model i poetit kombëtar	114
“Martesa e dytë”, romani i ripërtëritjes së familjes.....	121
“Njeriu me maskë”, si skaner i një realiteti tronditës	127

“E puthura”, libri që e identifikon Andon Andonin si një mjeshtër të prozës së shkurtër	132
Veptra krijuese e Dr.Hajri Mandrit në tri dimensione.....	136
Për librin “Musai – Portret i njeriut fisnik”	141
Poezia e dhimbjes njerëzore në pesë libra të Demir Rusit.....	146
Fatos Daci, 51 libra në harkun kohor të 20 viteve	150
Mirënjohje Çamërie për Dibrën e dibranët	155
Mevlud Buci - mësues, publicist dhe poet i talentuar	161

II. NGA LETËRSIA DOKUMENTARE

Libri i gjeneral Parllakut “Një shekull në memorie”	169
Fadil Hoxha - arkitekt i Kosovës së lirë	185
Ligjërimi diplomatik i Shaban Muratit	193
“Koha kur po shkriheshin akujt” në librin e Kamber Farukut.....	198
Shatku - plejada e burrave të shquar dibranë në historinë e Tiranës	205
Fisi Bruçi i Lukanit të Dibrës	210

III. PËR DISA LIBRA STUDIMORË-SHKENCORË

Prof. dr. Eshref Ymeri, shtigjeve të fjalës artistike	219
Një libër, sa intrigues aq edhe mbresëlënëse	224
Vepër shkencore me vlera të jashtëzakonshme etnokulturore	228
“Nga ishin Kastriotët” ku lindi Skënderbeu?”	237
42 Kryetarët e Tiranës në një album fotografik dhe biografik	243
“Toponimia e Çidhnës”, një botim me vlera të rralla shkencore	247
Pedagogjika e Peshkopisë, tempull i dijes	250
Filozofia popullore dibrane në rrëfimet e Sakip Camit	255
“Laseri në Oftalmologji”, vepër me vlera shkencore	259
Kur Adem Kormaku debatonte me Manush Myftiun për 15 – katëshin.....	265
Dr. Hajri Mandri: Halil Rama – profili i publicistit dhe shkrimtarit të mirënjohur	272

...NË SHËRBIM TË LIBRIT NË GJUHË SHQIPE

Parathënie nga Preç Zogaj

Një libër me shkrime për disa libra është më pak se secili prej tyre veç e veç dhe më shumë se të gjithë bashkë në kuptimin e informacionit përmbledhës që përcjell. Shkrime të tilla, kur shkruhen bukur, të mësojnë, të japin kanaqësi, të shtyjnë t'ia besosh fatin letërsisë së mirë, domethënë të jesh njeri, siç thotë kritiku franko gjerman Alen Finkielkraut. I cili, me që ra fjala, është një nga mjeshtrit më të mëdhenj të kësaj fushe. Në librin me titull *Një zemër inteligjente*, përshembull, ai ka përmbledhur nëntë “lexime” për nëntë romane, ku çdo “lexim” të jep çelësin e një thellimi gratis në brendinë, domethënëien dhe vlerat e veprës. Mund të sillen plot shembuj të tjerë kësajsoj. “Magjia e fjalës” bën pjesë në këtë familje.

Autori Halil Rama, i mirënjohur si gazetar dhe esesist, është prej atyre që e kanë librin një ushqim të përditshëm shpirtëror e mendor; një lexues i paepur, siç do thoshte Borhes, i cili, duke folur për veten e tij, e çmonte të qenit lexues si një meritë më të madhe se të qenit krijues.

Të lexuarit për Halilin nuk mbetet në kuadrin e nevojave dhe kënaqësi individuale. Duke hedhur në letër e botuar rregullisht vështrimet e tij për librat që pëlqen, ai vihet në rolin e ndërmjetësit special mes Librit dhe lexuesve. Merr kështu rolin e një shërbyesi publik, që ndërsa nuk ekziston në nomenklaturën zyrtare të funksioneve, i përgjigjet një kredoje më të lartë që përcakton vendin e intelektulit në shoqëri.

Leximet e shumëllojshme - në prozë, poezi, monografi, historiografi, diplomaci, gjeopolitikë, folklor, etnokulturorë e tjerë - dëshmojnë spektrin e gjerë të kërshtërisë, interesave, shijeve dhe kërkesave kulturore dhe intelektuale të autorit.

Te “*Magjia e fjalës*” lexuesi do të gjejë dyzetinjë shkrime. Shumica janë reçenca për libra artistikë apo monografikë. Pjesa tjetër janë kryesisht profile letrare dhe paraqitje botimesh nga etnokultura. Reçensave u prin nga radha dhe cilësia ajo për monografinë “*Kur mbretëron karakteri - Ronald Regan*” të autores Peggy Noonan, për të vijuar me ato për për vëllimin me tregime “*Thikat pa gjak*” të Zija Çelës, romanet “*Dëmtuar gjatë rrugës*” të Besnik Mustafajt, “*Një shaka e vogël me vdekjen*” të Bashkim Hoxhës, “*Saga përtej Atlantikut*” të Shefqet Mekos, “*Anja*” të Ahmet Prençit, etj.

Galeria e profileve letrare vjen si një lloj Wikipedia me informacione pothuajse shterruese për jetën dhe veprën e shkrimtarëve Teodor Laço e Shefki Karadaku, të shkrimtarit e studiuesit, Hajri Mandri, të artistit të mirënjohur dibran, Hazis Ndreu dhe bardit Naim Plaku.

Një kategori tjetër shkrimesh kanë në fokus libra monografikë dhe studimorë për historinë dhe etnokulturën e arealit dibran e më gjerë. Ato kthejnë vëmendjen e merituar nga një kategori hulumtuesish të përkushtuar, siç janë Fatmir Terziu me “*Toponimia e Gollobordës: Diskursi i dygjuhësisë dhe derivati i origjinës*”, Besnik Këbej me “*Origjina dibrane e Skënderbeut*”, Naim Berisha me “*Berishët e Muhurrit*”, Faik Bruçi me “*Fisi Bruçi i Lukanit të Dibrës*”, Haki Përnezha dhe Ruzhdi Bitri me “*Toponimia e Çidhnës*”, e tjerë.

Në tërësi, autori ka ndaj librave që merr në shqyrtim një qasje përbashkuese që do ta quaja “protoniste”. Ky është një term i përdorur nga shkrimtari dhe doktori i shkencave humane, Gjekë Marinaj. Termi në fjalë, siç kuptohet lehtë, është një metaforë që rrjedh nga fizika me referencë atomin: kritiku protonist kujdeset për protonin e qëndrueshëm me peshë dhe pozitiv. Thënë ndryshe fokusohet te ana e mirë e veprës. Protonizimi është zhvilluar nga Marinaj dhe është pranuar si teori letrare filimisht nga Universiteti i Dallazit në SHBA dhe pastaj më gjerë. Teoria sugjeron që një kritik protonist, kur përballet me një tekst, duhet të kërkojë sëpari atë që ka vlerë estetike, intelektuale dhe morale në vepër. Kritiku që gjen pak vlerë në një vepër, thjesht duhet ta lerë mënjanë dhe të përmbahet tërësisht nga diskutimi i tij, duke e lënë atë në errësirë në vend që të bëjë një shfaqje të retorikës përçmuese.

Halil Rama mund ta ketë lexuar por mund edhe të mos ketë dëgjuar për teorinë protoniste. Atë e çon te praktikimi i saj pozitivizmi i tij si njeri dhe si intelektual, dhuntia e tij për të parë të bukurën dhe të mirën në veprat për të cilat shkruan, për t'i dashur e promovuar më gjithë shpirt ato.

Kjo dhunti e karakterit do të ishte krejt e pamjaftueshme pa një set cilësish të tjera, ku spikat profesionalizmi, njohja e termave dhe nocioneve bazë të kritikës letrare, aftësia për të përkufizuar me fjalë të kursyera subjektin e veprës, ndërtimi i një parashprese jo skematike mbi tekstin që përcjell e analizon, duke ndërthurur referimet nga të tjerët me pohimet e veta autentike.

Romani “*Dëmtuar gjatë rrugës*” i Besnik Mustafajt është për Halil Ramën zberthimi i “*lëmshit torturues të lotëve që ia kishin zënë lëfytin e hollë të grykës një nënë*”. Në fakt unë nuk kisha lexuar për këtë vepër një frazë kaq lakonike që në pikpamjen strukturore shëmbëllen kolonën vertebrale të subjektit dhe e paralajmëron lexuesin në formën e joshjes se do të lexojë “anantominë” e një lëmshi lotësh.

Reçensa për ish - Presidentin Ronald Regan vjen si një koleksion sentencash që japin saktë identikitin e një personazhi të jashtëzakonshëm, që erdhi në skenën e madhe nga “*ëndrra amerikane e lirisë dhe mundësive të pashterrshme*”. Reçensuesi fokusohet jo pa qëllim te prejardhja e Reganit nga një familje e thjeshtë amerikane. Ai kërkon të nënvizojë faktin se konservatorizmi politik nuk derivon vetëm nga pasuria apo dinastitë, por vjen gjithashtu nga një traditë e ngulitur vlerash të familjes, besimit, lidhjes me vendin apo oikos-in.

Përmenda këtu vetëm dy shembuj që ilustrojnë pohimin se aftësia për të shkuar në thelbin e veprave që merr për të analizuar është një karakteristikë e shkrimeve të Halil Ramës.


Thuhet me të drejtë se është shija që përzgjedh çfarë të lexojë e promovojë dhe janë citimet ato që pasqyrojnë shijet. “*Po zemra e kërkon nudon e bukur, / e të jetë ajo si mbretëreshë, /që nëpër gjoksin e saj malli i shkurtër /si tajfun Floride të përqeshë...*”. Këto vargje të Shefki Karadakut janë cituar nga Rama në shkrimin për profilin letrar të një shkrimtari dhe poeti që ndoshta nuk i ka marrë vlerësimet e merituar. Janë vargje shumë të bukura që e shtyjnë lexuesin drejt krijimtarisë së autorit.

“*Magjia e fjalës*”, përveçse një adresar titujsh për t’u lexuar dhe një koleksion citimesh që në lidhjen e tyre krijojnë një buqetë perlash për njohjen dhe kujtesën, është një shërbesë e madhe letrare dhe intelektuale në këto kohë të vështira për artin dhe kulturën. Nëse do të përfytyronim një “Urdhër” për mbrojtjen dhe promovimin e kulturës si pasuri e shoqërisë dhe njerëzimit, Halil Rama është aty në shërbim të librit në gjuhën shqipe.

I.
PROFILE
& KRITIKË LETRARE

PRESIDENTI REAGAN OSE ËNDRRA AMERIKANE E JETËSUAR

*Rreth monografisë së Peggy Noonan
“Kur mbretëron karakteri – Renald Reagan”
Gazeta “Panorama” - Feb 5, 2022*



Njëzet vjet më parë (në shkurt të vitit 2001), një sondazh i opinionit publik i kryer nga CNN, “USA Today” dhe “Gallup”, i pyeste amerikanët për emrin e njeriut, të cilin ata e mendonin si Presidentin më të madh të SHBA-së dhe në krye të tij u rendit Ronald Reagan-i me 18 për qind. (Më pas, vinte Xhon F.Kenedi me 16 për qind dhe pas tij Abraham Linkoln me 14 për qind). Katërmbëdhjetë vjet pas atij sondazhi (2015), profili i Ronald Reagan-it vjen i plotë në shqip nëpërmjet monografisë së Peggy Noonan (“Kur mbretëron karakteri – Renald Reagan” ndër bestseller-at botërorë më të shitur e të kërkuar të viteve të fundit), të përkthyer nga Dr. Arian Starova, ish-ministër i Jashtëm i Qeverinë së Pajtitimit Kombëtar të vitit 1997.

Siç shprehet vetë z. Starova, nxitja për këtë përkthim ka qenë vetëm rrugëtimi krejt i veçantë i jetës së Ronald Reaganit, ku vështirësitë, mungesat dhe sukseset kanë qenë ndërthurur më shumë se sa ato të çdo Presidenti tjetër të 100 viteve të kaluara. Presidenti Reagan lindi në 6 shkurt të vitit 1911, në Illinois, në një qytet të quajtur Tampiko, në një shtëpi me qira me një dhomë që ndodhej mbi ndërtesën e një banke.

Qoftë dhe vetëm nga kapitulli i dytë i librit “Të gjithë presidentët kanë prejardhjen e tyre”, sështë e vështirë të kuptojmë se “Regan është i papërsëritshëm, në kuptimin se familja e tij nuk kishte asnjë përkatësi shoqërore të caktuar ose arritje, nuk kishte as prejardhje prej fisnikërisë vendore ose shtresës së mesme, nuk kishte asnjë profesion të trashëguar të tillë si infermier ose doktor dhe nuk kishte asnjë pronë, asnjë fermë, ose dyqan të vogël”.

Nga ky libër, ndër të tjera, marrim mesazhin se Reagan-i ishte dhe mbeti një politikan romantik i magjepsur nga lëvizja e historisë, nga besimi i thellë te Zoti dhe nga rëndësia e të qenit të njeriut gjithnjë i drejtë dhe i ndershëm, nga ideja se është diçka e mirë që të bëhesh pjesë e një gjëje të madhe që bëhet për mirë. Ai i shfaqti këto cilësi gjatë gjithë kohë së tij si drejtues, nga Sindikata e artistëve të Hollivudit deri te Presidenca e tij.

Mesazhi tjetër i qartë që përcillet nga ky libër është ai i dashurisë së pamatë të ish-gubernatorit të Kalifornisë dhe Presidentit të 40-të të SHBA-së për Zotin, Amerikën dhe vlerat morale të njeriut. “Ai e donte Amerikën, jo vetëm sepse ai ishte mësuar për këtë nga familja e tij dhe nga kultura e asaj kohe për ta dashur Amerikën, jo vetëm sepse besonte tërësisht në vërtetësinë mahnitëse dhe vlerën e pohimeve të etërve të saj themelues. Ishte edhe fakti konkret dhe vetjak se ai e donte Amerikën meqenëse liria që ajo ofronte (kushdo mund të hapte një radiostacion, edhe ndonjë mjek me ide të çmendura) i jepte atij mundësinë (kushdo mund të fliste në radio, edhe një dikush që nuk dinte asgjë) jo vetëm për të

hyrë në moshën e rritur mbi një themel të mirë, por edhe për të shpëtuar familjen e tij gjatë Krizës së Madhe.

Ai ishte provë e gjallë e ëndrrës amerikane. Ai nuk mendonte se ajo ishte një ëndërr e përsosur, nuk mendonte se çdo njeri kishte marrë një përfitim të barabartë, sepse ai mendonte se jeta ishte e vështirë dhe fati plot me padrejtësi. Megjithatë, ai mendonte se, ndërsa sistemet njerëzore përparojnë, ai i Amerikës ishte i mrekullueshëm dhe i përshtatshëm për një premtim të arritshëm.

Gjithsesi, rëndësia e këtij libri mbi Presidentin Reagan mund të lidhet me faktin se para lexuesit shqiptar vjen trashëgimia politike, letrare e artistike e Ronald Reagan-it, e cila vazhdon të jetë e fuqishme, veçanërisht për republikanët që shqyrtojnë mundësinë e kandidimit dhe të fitores në zgjedhjet presidenciale të vitit 2023.

Ata që kanë qenë të pranishëm në ditën e vrenjtur kur ai u betua si guvernator i Kalifornisë, betohen se ndërkohë që ai po bënte betimin, dielli doli pak prej reve dhe ndriçoi mbi të. Edhe ata që kanë qenë atje në ditën me re kur ai po përurohej si President në vitin 1980, thonë se dielli doli prej reve, ndërkohë që ai vuri dorën për të bërë betimin ... Kjo nuk duket si e vërtetë, por e tillë është.

REAGAN ISHTE EDHE NJË SHKRIMTAR I MIRË

Për lexuesin është interesant kapitulli i tretë “Ylli i kinemasë”, nga ku del qartë se si Regani kënaqej me aktrimin, dashuronte pikturën dhe praktikisht donte të bëhej aktor, një yll kinemaje, por e kishte të vështirë të shprehte këtë gjë. Ai arriti që ta shndërrojë talentin e tij për të shkruar në talent për komunikim. Reagan-i e ktheu artin e tij në shërbim të ideve, te të cilat ai besonte. Proza e tij nuk përmban kurrë zhvillime të papritura, nuk bën ndalime të paparashikuara, nuk befason. Ajo ka butësinë e një rrjedhe të thjeshtë.

Duke u përpjekur të japë të plotë arsenalin krijues të ish-Presidentit Reagan, autorja e librit, Peggy Noonan, evidenton vlerat e tij si prozator i talentuar. Sipas saj, ajo çka shquhet në tregimet e Ronald Reagan është rrjedhshmëria shumë e madhe. Ai ka një fjalor të gjerë..., korrigjon rrallë ato çka duket se janë kopje të para. Si adoleshent dhe i ri 20- vjeçar, ai shkroi për burrat në frontin e luftës. Reagan-i shkruante ndonjëherë edhe për teatrin, për shfaqjet vendore të teatrit dhe për futbollin amerikan. Megjithatë, në shkrimet e tij gjeje kurdoherë njerëz shumë të zemëruar që kthehen prej luftës në shtëpi, të rënë shpirtërisht, të hidhëruar prej asaj çka kishin parë. Heronjtë e tij të rinj janë të mavijosur, të rënduar nga kujtimet e llogoreve.

Reagan-i shkruante ku të mundej, në tryezën e tij të punë në shtëpi s, në zyrë, ndonjëherë në avion, kur shkonte nga një fjalim në tjetrin, gjatë viteve ndërmjet fundit të mandatit të tij si guvernator dhe fillimit të Presidencës. Ai nuk u sundua kurrë nga shkrimet e tij, merrte përsipër të përkufizonte lirinë, të përcaktonte synimet e etërve themelues, të përforconte kuptimin e pjesës përkatëse të Kushtetutës.

Ai ishte një shkrimtar i mirë dhe karrierën e tij politike e kishte bërë në të vërtetë duke u mbështetur te fjalimet që kishte shkruar dhe rishkruar vetë – mbi skeda, të cilave, siç dihet mirë, ai ua ndryshonte vendin që t'i mbante gjërat të freskëta.

Reagan-i ishte shumë ambicioz, por ai nuk i ndante gjithnjë me njerëzit ambiciet e tij të veçanta. Kudo që ai shkonte, prej shkolle në kolegji dhe në radio, ai ia arrinte që të konkurronte, të fitonte dhe të ngrihej gjithnjë më lart.

VEPRIMTARINË E REAGAN-IT E SUNDOI PËRBALLJA ME SFIDAT

Nuk ishin vetëm ekzistenca e komunizmit dhe synimi keqdashës i komunistëve ato çka e shtynë Reagan-in të pranonte të kandidonte për President, por edhe fakti se

komunistët po luftonin për të marrë nën kontroll Hollivudin, qytetin e tij të profesionit, prodhuesin e madh të historive që shpjegojnë Amerikën e Amerikanëve... Duke rrezikuar emrin dhe jetën e tij në periudhën e një kohe të errët dhe të ngarkuar të historisë së Hollivudit dhe të amerikanëve, ai u shndërrua në njeriun e ndershmërisë heroike që nuk e lejoi komunizmin të pushtonte Hollivudin.

Autorja Noonan shkruan: “Reagan-i filloi si ‘i pari’ dhe përfundoi si ‘i fundit’. Ai ishte i pari guvernatori i Kalifornisë, i pari aktor, i pari i divorcuar, i pari konservator modern me ide serioze për t’u bërë president ... Por dhe ‘i fundit’ prej më të mëdhenjve, i fundit që e ka pasur praninë e tij më të madhe, si atë të një anijeje ... Ai udhëhoqi në një mënyrë të tillë që pjesa më e madhe e njerëzve të zakonshëm dhe e të mëdhenjve të Amerikës – heronjtë e përpjekjeve të palodhura të ‘fluturimeve luftarake’ – e besuan instinktivisht sepse ata e dinin se ai do të përpiqej të bënte atë që ishte e drejtë ...”

Mendimi filozofik dhe jeta e tij ishte mbizotëruar nga sfida e bashkuar me përpjekje, të cilat shpërbleheshin: “Kërko diçka dhe do të të jepet. Kërko dhe do të gjesh”. Ai kishte kërkuar dhe pyetur, kishte punuar fort, kishte ëndërruar gjëra të mëdha dhe përfundonte duke bërë punën që dashuronte, e cila i jepte pasuri, kënaqësi dhe respekt.

Nëse i referohemi jetës dhe veprës së tij, nga ky libër del qartë se Ronald Reagan-i nuk krijoi asnjëherë mendim të mirë për pesimistët dhe për humbjet që ata dukej sikur i kërkonin vetë. Përkundrazi, ai inkurajoi dhe mbështeti “ata që luftojnë për liri dhe kundër komunizmit kudo që ata të jenë”, siç bëri me fjalimin që mbajti në 8 qershor të vitit 1982, në Parlamentin e Britanisë. Po ashtu, siç është shprehur Natan Sharanski, hapi më i rëndësishëm në Luftën e Ftohtë dhe shkatërrimi i perandorisë sovjetike kanë qenë fjalët dhe veprimet e Reganit në fillim të detyrës si president.

Do të mbeten përherë profetike dhe si thirrje për shndërrim fjalët e Reganit drejtuar Presidentit Gorbaçov: “Rrëzoheni këtë

mur, Zoti President”, duke pasur pa rasysh murin simbolik ndarës të Gjermanisë Perëndimore dhe Lindore. Pas atyre fjalëve filloi shpërbërja e Bashkimit Sovjetik komunist”.

VLERAT QË SOLLI REAGANI NË SJELLJEN E AMERIKËS NË BOTË

Ajo çka e formoi Reagan-in ishte diçka më shumë sesa të qenit spiker në radio, diçka më shumë sesa të qenit aktor, diçka më shumë sesa të arriturit e suksesit. Të gjitha këto janë thënë nga personalitete të politikës amerikane edhe ditën e përrurimit të Aeroplanmbajtëses RONALD REAGAN, CVN 76, në 3 marsin e vitit 2001.

Admirali Vern Klark është shprehur se Shtetet e Bashkuara kanë emërtuar një numër aeroplanmbajtësesh me emrat e ish-presidentëve – Xhorxh Uashington, Abraham Lincoln, Tedor Rusvlet, Harri S.Truman, Duajt Ajzenauer, Xhon F.Kenedi. Por, sipas tij, emri i Ronald Reaganit nënkupton lirinë. Klark ka thënë se ashtu siç ndodhi me emrin e tij, ashtu do të ndodhë dhe me këtë anije ... Ndërsa senatori Xhon Verner i Virxhinias e ka quajtur anijen “një ishull të demokracisë që lundron nëpër dete”.

Ish-Presidenti Bush, krenar që ndodhej i pranishëm në pagëzim të anijes më të re të forcave detare më të mëdha të botës, ka shprehur bindjen se “Anija Reagan do të lundrojë gjigante dhe e fortë, ashtu si burri që ne kemi njohur ... Ne jetojmë në një botë, e cila në aq shumë mënyra është formësuar nga vullneti dhe zemra e tij. “Ajo çka ne deshëm, ajo për çka ne luftuam, ishte një komb më i fortë në një botë më paqësore ... Vlerat që solli Ronald Reagan-i në sjelljen e Amerikës në botë nuk do të ndryshojnë...”.

Si President, Ronald Reagani besonte në mënyrë të padyshimtë se tirania është e përkohshme dhe se shpresa e lirisë është e përgjithshme dhe e përhershme, se kombi

amerikan ka mirësi të papërsëritshme dhe duhet të mbetet në mënyrë të papërsëritshme i fortë, se Zoti mban anën e drejtësisë, sepse të gjitha të drejtat tona janë dhurata të vetë Atij. Disa arritje zbehen me kalimin e kohës. Arritjet e Ronald Reagan-it zmadhohen bashkë me kalimin e kohës.

Kur Reagan u zgjodh President në vitin 1980, konservatorët iu referuan kësaj fitoreje si “Revolucioni Reagan”, që nënkuptonte një qeveri më të vogël, ulje taksash dhe rikthimi i krenarisë së Amerikës në botë.

Kur u largua nga detyra në janar të vitit 1989, Presidenti Reagan e përmendi këtë në fjalimin e lamtumirës, që mbajti nga zyra ova le. “Fitorja ime u quajt ‘Revolucioni Reagan’, dhe unë e pranoj këtë.

Por për mua ka qenë gjithnjë si një zbulim i madh, një rizbulim i vlerave dhe logjikës sonë”.

Por nuk janë vetëm republikanët që duan të përmendin emrin e Presidentit të 40-të amerikan. Presidenti Obama i referohet herë-herë Ronald Reagan-it dhe trashëgimisë së tij, madje bëri këto komente gjatë fushatës së vitit 2008: “Unë mendoj se Ronald Reagani ndryshoi trajektoren e Amerikës në një formë që nuk e bënë as Richard Niksoni dhe as Bill Clintoni. Ai inkurajoi atë që njerëzit ndjenin dhe që kërkonin: qartësi dhe optimizëm”.

Ronald Reagan-i është popullor jo vetëm për konservatorët, por për shumë amerikanë të të gjitha bindjeve politike.

Shumë prej mbështetësve të tij të paepur thonë se ai do të mbahet mend më shumë për ringjalljen e frymës kombëtare dhe të optimizmit, në një kohë të vështirë për ekonominë, ndërsa amerikanët vinin në pikëpyetje vendin e tyre në botë. Pikërisht këtu konsiston edhe rëndësia e këtij libri të autores Peggy Noonan, e cila ka qenë ndihmëse e posaçme e Presidentit Ronald Reagan, prej vitit 1984 deri në vitin 1986.

Ky libër i shqipëruar nga Dr. Arian Starova, botim i “Tirana Times”, na jep thujse një profil të plotë të Presidentit Reagan, i cili mbetet një ikonë për shumë republikanë në arenën kombëtare, përfshirë edhe ata që mund të kandidojnë në zgjedhjet e ardhshme presidenciale.

<http://www.panorama.com.al/111-vjetori-i-lindjes.../>

TEODOR LAÇO, NJERIU I LETRAVE, POLITIKËS DHE DIPLOMACISË

*Vepra shumëpërmasore e shkrimtarit,
politikanit dhe diplomatit të urtë e vizionar
Gazeta “Panorama”, Oct 16, 2021*



Njeriu i letrave, politikës dhe diplomacisë Teodor Laço zë vend nderi në historinë e letrave shqipe, si një prej shkrimtarëve më të shquar dhe përfaqësues i letërsisë bashkëkohore shqiptare, që përveç përvijimit të një profili modern në krijimtarinë letrare, nuk u tregua indiferent edhe ndaj zhvillimeve demokratike, duke u kthyer në një nga zërat kryesore në jetën parlamentare shqiptare.

Prej vitesh botës së mendimit i mungon ky intelektual i shquar, vizionar dhe kurajoz, i cili së bashku me kolegët e tij do ta shndërronin Kinostudion në verën e vitit '90 në djepin e mendimit liberal për kohën. Pesë vjet që politikës i mungon ministri i aftë dhe kompetent i kulturës, njëri ndër themeluesit e Partisë Socialdemokrate, ish-themeluesi dhe

kryetari i Partisë Bashkimi Social Demokrat (sot Bashkimi Liberal Demokrat).

Laço ishte dhe mbetet simbol i politikanit të arsyes, luajal ndaj vlerave dhe parimeve që besonte... Ai ka lënë pas një trashëgimi të vyer në të gjitha fushat ku kontribuoi. Kontributet e tij kanë qenë të spikatura që nga periudha kur hyri në kulturën dhe letërsinë tonë, por edhe në nxitjen e proceseve demokratike.

JETA...

Teodor Laço lindi më 29 shtator 1936, në Dardhë. Në atë fshat që ai e konsideronte se nuk ka të dytë; “ku netëve të verës, qielli është një magji që mund të mrekullojë edhe shpirtrat e thatë; me yjet e mëdhenj që vezullojnë dritë shkëlqyese, me yjet e vegjël që regëtojnë në të venitur, me yjet që bien e digjen, duke ndjellë trishtim për jetët që shuhen”.

Djali i një mërgimtari, si një nga të shumtët emigrantë dardharë të Amerikës, të atin, Pandi Laço, do ta takonte për herë të parë dhe të fundit kur ishte vetëm 20 vjeç, duke e jetuar rininë e tij të hershme larg dashurisë së babait, duke pritur letrat e përmallshme që vinin përtej Atlantikut.

U diplomua për agronomi, por talenti i tij spikati sidomos në fushën e letrave. Jetoi me nënën pranë, e cila do të bëhej shëmbëlltyra e shkrimtarit të ardhshëm; e ëmbël, fjalëpakë, e dashur dhe e papërtuar si një nënë. Shtëpia e tij në Dardhë ka mbetur deri në ditët e sotme shenja e pelegrinazhit më të dashur të Teodor Laços.

Babai i dy djemve të talentuar në fushën e kulturës dhe spektaklit televiziv, Pandit dhe Bledit, bashkëshort i aktorese Mirjana, ai u ndje ngrohtë brenda shtëpisë se tij të letërsisë dhe kulturës deri në ditët e fundit të jetës si pakkush tjetër.

Ai nuk e tradhtoi asnjë çast vendlindjen, Dardhën. Shkoi dhe u kthye si Anteu. Ajo strëhëz u bë frymëzimi i sa e sa



veprave letrare të Laços. “Shtëpi e vjetër e fëmijërisë/ hapet porta e vjetruar/ porta që për mua është ankuar/ kur vija rrallë i ftohtë e i vonuar? – Porta nga e cila Ai u përcoll për në botën e përtejme para pesë vitesh. (Vdiq më 15 tetor dhe iu dha lamtumira e fundit nga personalitete të shumta të politikës, letërsisë, artit e kulturës më 16 tetor 2016).

VEPRA LETRARE SHUMËPËRMASORE E LAÇOS

Si rrallëkush në fushën e letrave, Teodor Laço krijoi një trashëgimi letrare shumëpërmasore. Krijimtaria e tij është shumë e gjerë. Janë rreth 55 vepra të botuara, qoftë në letërsi apo dhe në publicistikë. Kësisoj, me korpusin e tij letrar me shumëllojshmëri tituj romanësh, vëllimesh me tregime, dramash, komedish e kujtimesh, Laço zë vend të veçantë në historinë e letërsisë shqipe. Ka filluar të botojë që prej viteve ‘60. Është autor i disa skenarëve të filmave artistikë dhe dokumentarë.


Disa prej librave të tij janë vlerësuar me çmimet më të larta që jepen në Shqipëri. Si romancier, tregimtar, dramaturg, komedian, eseist, skenarist, komentator, opinionist e politolog, Ai, padyshim, njihet nga lexuesi shqiptar, por dhe

ai i huaj ku është përkthyer, si një nga kolosët e letrave shqipe. Janë të njohur për lexuesin romanet e Laços: “Tokë e Ashpër” (1971), “Përballimi” (1975), “Lëndina e Lotëve” (1980), “Të gjithë lumenjtë rrjedhin” (1985), “Pushimet e Kolonelit” (1990), “Një vit i hidhur” (1995), “Mjegull” (2009), “Vrasja e buzëqeshjes” (2013), “Gropas 67” (2014) etj. Po ashtu proza e tij e shkurtër, si: “Rruga e bardhë”, “Një natë shiu”, “Ajri i ftohtë i mesnatës”, “Portat e dashurisë”, “Pylli në vjeshtë”, “Vdekja e Nëpunësit X” etj., që mbeten modele krahasuese e referuese në tregimin e shkurtër shqiptar.

Pjesë integrale e krijimtarisë letrare të tij janë dramat dhe komeditë e shumta dhe po aq të suksesshme, si: “Shtëpia në rrugicë”, “Një nuse për Stasin”, “Gjëmimi i atij dimri”, “Qyteti i akuzuar”, “Shi në plazh” etj., që kanë lënë gjurmët e tyre në repertorin klasik të spektakleve dramaturgjike shqiptare. Në lëmin e kinematografisë, Teodor Laço cilësohet si një prurës autoritar i disa prej skenarëve artistikë, mbi të cilët u realizuan një sërë filmash me prirje të reja regjisoriale e artistike. Dorën e tij mbajnë filmat “Përballimi”, “Dhe vjen një ditë”, “Flutura në kabinën time”, “Vitet e pritjes”, ku mund të konstatohet se suksesi i tyre në publik u garantua së pari nga skenarët e tyre me vlera potenciale.

Nuk mund ta konsiderosh të ezauruar veprimtarinë krijuese të T. Laços pa përmendur edhe publicistikën e tij kulturore, politike e sociale.

Përveç dhjetëra e dhjetëra artikujve të këtyre gjinive, Laço ka shkruar dhe botuar dy librat “Kohë për të kujtuar, kohë për të harruar” dhe “Bashkëjetesë me kohën”, libra këto, voluminozë me publicistikë reflektive social-politike e diplomatike që cilësojnë atë si një vëzhgues, përjetues dhe analizues të mprehtë të realiteteve historike kombëtare e ndërkombëtare. Po ashtu, libri “Një dritare në Kremlin” është pa dyshim pasqyrë e angazhimit të tij krijues.



Ky libër është një shartim i historisë me fiksionin, një kuturisje karakteristike prej shkrimtari, që vjen në ndihmë për të hapur një dritare në kështjellën që rusët e quajnë Kremlin, me një brendësi plot mistere. Kësisoj, Ai ishte dhe mbetet si model i shkrimtarit të prozës së shkurtër, romanit, dramës e komedisë, skenarit të filmit e publicistikës.

LAÇO SI POLITIKAN

Si një prej intelektualëve antikonformistë, që paraprinë me krijimtarinë e tyre vizionin për nevojën e ndryshimeve politike e shoqërore kah demokratizimit të vendit, Ai u përfshi në proceset e krijimit të pluripartizmit në krahun liberal demokrat, fillimisht si një prej themeluesve e drejtuesve të Partisë Social-Demokrate, duke qenë dhe nënkryetar i saj deri në vitin 1994 dhe më pas si krijues e drejtues për 10 vjet i Partisë Bashkimi Social Demokrat (që më vonë ndryshoi emrin në Bashkimi Liberal Demokrat).

Gjatë kësaj kohe (1992-1996 dhe 1997-2005), ai zgjidhet deputet i Parlamentit shqiptar. Laço do të hynte si pjesë e legjislativit nga zgjedhjet e lira pluraliste më 1992, duke vijuar si deputet edhe për dy legjislatura me radhë (12 vjet deputet

i Kuvendit të Shqipërisë). Si deputet, Teodor Laço do të kujtohet për fjalën e urtë e të mençur, duke ndikuar kështu në çtensionimin e situatave konfliktuale mes maxhorancës dhe opozitës. Ai ishte ndoshta nga të rrallët, që në kompromis me PD-në e aleatët tjerë të qendrës së djathtë, ndonëse me dy deputetë të partisë së tij (Laço dhe Starova) të arrinte krijimin dhe drejtimin e Grupit Parlamentar Liberaldemokrat.

Në ligjërimin e tij politik, për më shumë se një dekadë në legjislativin shqiptar, spikati mençuria dhe vizioni bashkëkohor. Laço e drejtoi BSD-në me moton “Për një moral të ri politik” dhe nën këtë moto gjatë dhjetë viteve (1996-2006) kjo parti që jo vetëm përfaqësuese në legjislativin shqiptar, por pati një përfaqësim konstant edhe në pushtetin vendor (bashki e komuna) me një numër të konsiderueshëm, nga 200-230 këshilltarë bashkiakë e komunalë. Pikërisht për të sjellë një moral të ri politik, moral besimi dhe përgjegjësie, Laço e Starova, si dhe bashkëpunëtorët e tyre në kryesinë e kësaj partie (si: Shaqir Rexhvelaj, Petrit Karabina, Adem Jakllari, Behar Gjoka, Kozeta Mesiti, Myslim Islami, Tonin Deda, Andon Andoni, Gentian Zoto etj.), përballuan me stoicizëm edhe sulmet e paprincipita në vitet 2004-2005 ndaj tyre e partisë që drejtonin, kur u sulmuan egërsisht nga lidershpi demokrat, vetëm e vetëm pse votuan kundër verdiktit të tyre, kandidaturën e Robert Çekut për kryetar të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Dhe po si askush tjetër, pas Sabri Godos, do të ishte Teodor Laço që do të njihete dhe aplikonte institucionin e dorëheqjes, duke ia lënë drejtimin e partisë diplomatit Arian Starova, që nga Kuvendi VI kombëtar i BLD (2006). Në harkun kohor të dy viteve (1994- 1997), Laço ishte ministër i Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.

Qenë pikërisht këta dy vjet kur ky dikaster, ndoshta për herë të parë njohu standardet e përparuara europiane. Bashkëkohësit e kujtojnë Laçon ministër, veç të tjerash për

sjelljen në Tiranë të disa trupave teatrale e muzikore nga vende të ndryshme perëndimore si dhe të artistëve me famë botërore, duke ndikuar kështu drejtpërdrejt në integrimin e kulturës shqiptare në botë.

Qe koha kur nën drejtimin e tij Shqipëria rinisi organizimin e festivaleve kombëtare, si Festivali Folklorik, jo më në Gjirokastrë, por në Berat, kur rinisi funksionimi normal i trupave teatrore (Teatri Kombëtar dhe ai i Operës e Baletit, si dhe trupat teatrore rajonale të qyteteve kryesore) dhe kur iu kushtua vëmendja e duhur shtetërore monumenteve të kulturës, arkeologjisë etj.

Pikërisht në vitet që dikasteri i Kulturës drejtohej nga Laço u përgatitën dosjet për pranimin e Beratit e Gjirokastrës në UNESCO, ndërkohë që Kruja, Butrinti, Apolonia, Kalaja e Rozafës, Voskopoja etj., njohën bum turistësh.

Laço ministër mbahet mend edhe për kalimin e pallateve të kulturës të qyteteve kryesore në varësi të bashkive, kur shumë institucione të tjera, si atëherë edhe sot janë të centralizuara nën administrimin e dikastereve qendrore. Kur ai ushtronte detyrën e ministrit të Kulturës, në vitin 1995, një nga ngjarjet më mbresëlënëse ka qenë sjellja e eshtrave të Faik Konicës në Shqipëri. Fjalët që ka mbajtur për veprimtarinë e Konicës në Nju Jork, në prani të pothuaj të gjithë anëtarëve të Vatrës, si dhe në Katedralen e Shën Gjergjit, në Boston, edhe sot na japin emocione po aq të thella.

NË DIPLOMACI, SI AMBASADOR NË FEDERATË RUSE

Teodor Laço e mbylli karrierën e tij si ambasador i Shqipërisë në Federatën Ruse (2006-2008). Në këtë rast nuk kemi të bëjmë me të ashtuquajturit “diplomatë të karrierës”, promovimi i të cilëve ndjek rrugën e zakonshme të ngritjes nga një gradë diplomatike në tjetrën. Por Laço me meritë e fitoi edhe

këtë titull, duke përfaqësuar denjësisht shtetin shqiptar në Federatën Ruse. Sidomos në këtë shtet të madh ai u angazhua dhe ia arriti të promovojë një nivel të lakmueshëm kulturor.

Ashtu si nobelistët Miguel Anhel Asturias, Octavia Paz etj., që njihen edhe si ish-ambasadorë të Amerikës Latine në Francë, edhe Laço ynë përfaqësoi në Moskë modelin shqiptar të diplomatit Me bindjen se angazhimi i krijuesve në diplomaci, gjithsesi, paraqet sfida të shumta, Laço qe ndoshta nga të rrallët ambasadorë që diti të ndërtojë një raport të drejtë midis pasionit kryesor të tij që ishte krijimtaria dhe detyrës shtetërore.

Për të, një nga rastet kur i është dashur gjithë gjakftohtësia dhe vendosmëria për ta kaluar, ka qenë koha që u shpall Pavarësia e Kosovës, kur në selinë e ambasadës shqiptare në Moskë erdhi një kërcënim për vendosje bombe, i cili u shoqërua me protesta pas bllokut të ambasadës. Këtë moment tejet të vështirë, ish-ambasadori Laço e menaxhoi me përpikërinë maksimale. Gjithsesi, si sukses të tij gjatë atyre dy viteve mund të përmendim diplomacinë kulturore.

Por ato dy vite, pa iu shmangur fushës së letrave, i shërbyen shkrintarit dhe diplomatit Teodor Laço për të skeduar librin “Një dritare në Kremlin – Nga Hrushovi te Putin”, që do ta botonte disa vite pasi kishte dalë në pension, duke i ardhur kështu në ndihmë lexuesit për të hapur një dritare në kështjellën që rusët e quajnë Kremlin, me një brendësi plot mistere. Kështu, dy vitet si ambasador në Moskë Laço iu përkushtua historisë, arkivave, shtypit, librave të botuara, që mëtojnë se kanë zbuluar shumëçka nga ngjarjet që kanë ndodhur brenda mureve të Kremlinit në 50 vitet e fundshekullit të kaluar. Nëse do të jetonte sot Teodor Laço, një prej figurave të shquara intelektuale e krijuese shqiptare, historia e letërsisë shqipe do të pasurohej më tej me veprat e tij, por vdekja më.... ia ndërpreu jetën e veprimtarinë e tij të shumëfishtë.

Sidoqoftë, ne e përjetojmë atë sikur të ishte ende gjallë si një imazh e pasqyrim të aktivitetit të tij të gjatë, i angazhimit të tij të gjerë e poliedrik në disa role e arena të rëndësishme të jetës kulturore, artistike, shoqërore, politike, në kontekst me shoqërinë dhe kohën ku dhe kur ai ka jetuar, por edhe me një rreze largpamësie, vizioni e reflektimi që e bën atë një vegimtar e protagonist të pararojës së shndërrimeve e progresit të jetës e shoqërisë shqiptare. Kontributi dhe trashëgimia e vyer që ai la pas do të jetojnë përgjithmonë.

Panorama.al - <http://www.panorama.com.al/teodor-laco-diplomat-ne-rusi-si-e-kercenuan-me-bombe-ambasaden-shqiptare>

<https://gazeta-nacional.com/teodor-laco-ne-85-vjetorin-e.../>

<http://dritare.info/laco-njeriu-i-letrave-politikes-dhe.../>

ADN-JA E PANDRYSHUAR E SHEFKI KARADAKUT

*Gazeta “Panorama”, 16 mars 2021
& Gazeta “Nacional”, 12 mars 2021
& gazeta “Fjala”, 12 mars 2022*

Nëse Moikom Zeqo e cilëson “një Esenin shqiptar i ndrojtur”, Dr. Lutfi Turkeshi, gazetar & studjues nga Republika e Maqedonisë së Veriut, jo më kot, e vlerëson Shefki Karadaku si “Khajamin e ditëve tona”.



Në një shtëpi karakteristike, të lagjes Spahikorre, të qytetit të Elbasanit, 81 vjet më parë (16 Mars 1941) lindi, mori shkollimin bazë dhe nisi rrugëtimin e jetës Shefki Karadaku, i cili ndër vite do të bënte emër si një nga poetët e prozatorët më të mirë në rang kombëtar.. Këtë lagje, si dhe gjithë Elbasanin ai e konsideronte ADN-në e tij të pandryshuar. Në memorien e tij, sa qe gjallë, ruhej Spahikorrja e fëmijërisë, për të cilën me të drejtë pikëllohej kur e shihte se si është dëmtuar...,

ruheshin banesat e traditës, të mbetura ende tashmë, si një dëshmi që dënon dhe akuzon!

I zhytur në nostalgjinë e kohës, ish - mësuesi dhe shkrimtari i talentuar rrëfente mjeshtërisht: “Ne, në Spahikorre i adhuronim pemët, veçanërisht ullinjtë; unë si poet, ca më shumë dhe, si të isha një druid i vërtetë. I kam kushtuar edhe një vjershë të veçantë njërit prej ullinjve të Spahikorres. Pale pastaj, shelgjeve dhe karaktereve hijerënda, apo shtegtimit magjepsës të shpendëve!”. Mjafton qoftë dhe ky rrëfim i çiltër për të konkluduar se Shefki Karadaku, megjithëse një familjar i rregullt dhe përgjithmonë i obliguar, shpirtin e kishte prej bohemi të çliruar dhe të papërmbajtur.

Siç shkruan bashkëkohësi i tij Enver Kushi, brenda korpusit letrar, Shefki Karadaku ka sendërtuar shtëpinë e shpirtit të tij buzë Shkumbinit, atje ku *“ylberi ka rënë mbi brigjet e trishtuara”*.

Dhe kjo shtëpi e shpirtit të poetit, ka mbledhur brenda stinët dhe qiejt e Elbasanit, shirat zemërak, çeljen e karakaftëve, zërat njerëzor, jehonat e largëta të fëminisë, këngët e Isuf Myzyrit, kuajt e hazdisur, kopshtijet e vendlindjes, nënën dhe babain, Nadiren dhe mallin për Çamërinë, Dorianin dhe Albanën, fëmijët e tij.

SHTËPIA E SHPIRTIT TË TIJ...

Në këtë shtëpi të shpirtit të tij vijnë erërat e vjeshtës *“të m'i krehë flokët kaçurrelë”* apo ulen dhe ngrihen lejlekët. Përqark saj *“qielli plot me re i leckosur vjen”*. Dhe kur heq çatinë e kësaj shtëpie shpirti, poeti sheh *“qiellin plot me re që i leckosur vjen përqark...”*

Dhe, kur hap dritaret e kësaj shtëpie, shpirti, bashkë me valët e Shkumbinit që *“përplas jehonën e planetit”*, vjen Nadirja që i *“sjell erën çame si bukuroshe magjishme”* dhe *“gëzimet misterioze të një atdheu të braktisur”*.

Në laboratorin krijues të Shefki Karadaku gjenden një arsenal veprash krijuese. Nga “Kënga e karrove të drithit” te “TORAKS”, ky krijues brilant prodhon emocione të freskëta, me origjinalitet të këndshëm e të besueshëm që gjelbërojnë humanizëm, me mesazhe befasuese, të ndjeshme e me sens dashurie njerëzore.

Karrierës së tij krijuese prej pesë dekadash, i shtohen gjithashtu edhe disa muaj të paharrueshëm që i kaloi në një fshat të humbur të rrethit të Elbasanit, kur jepte mësim në një shkollë fillore.

Studjuesi dhe analisti i zellshëm i veprës së tij letrare, Bardhyl Ajazi, në monografinë : “Elbasan, i bukur Elbasan” (*me syrin e poetit Shefki Karadaku*), ndër të tjera shkruan: “...Shefki Karadaku i përkiste një familjeje të mirëfilltë intelektuale. Babai i Shefkiut Xhaferr Karadaku ishte një arsimtar, që pasi mbaroi atë të bekuar Normale gjithë jetën ia kushtoi mësuesisë. Nëna e Shefkiut Adile ishte një grua e kulturuar dhe arsimdashëse. Ajo bëri shumë sakrifica për shkollimin e fëmijëve të saj. Vëllai i Shefkiut, Astriti mbaroi studimet për gazetari dhe punoi për shumë vite në organet kryesore të shtypit. Motra e Shefkiut, Natasha, mbaroi studimet për mësuesi dhe punoi për shumë vite në arsim. Pra, Shefkiu, në detyrën e arsimtarit ishte në fushën e vet, ishte në botën e librave. Janë ato vite kur ndjeu shijet e para të kënaqësisë së heshtur krijuese, nga skicat, tregimet, reportazhet, monografitë historiko-letrare, për të vijuar pastaj për 20 vite në revistën prestigjioze “Ylli”, si një nga zërat më të spikatur dhe si mbështetësi real e kurajoz i letrarëve të rinj nga i gjithë vendi.

TË MËDHENJTË E LETRAVE PËR KARADAKUN...

Shefki Karadaku me korpusin e tij letrar, ka hyrë denjësisht në historinë e letërsisë shqipe. Një bilanc më konkret e

gjejmë tek libri “Absurdi Mbretëror” – (*Shënime kritike, ese, këndvështrime për krijimtarinë e Shefki Karadakut*), në të cilin autori i 35 veprave letrare në prozë e në poezi, portretizohet si një nga shkrimtarët e dalluar të kohës së tij. Gjejmë në këtë libër kolosët e letrave shqipe: Dritëro Agolli, Llazar Siliqi, Petro Marko, Adriatik Kallulli, por dhe personalitete të njohura të letrave shqipe, si: Moikom Zeqo, Roland Gjoza, Riza Lahi, Petraq Risto, Agim Cerga, Milianov Kallupi, Dr.Lutfi Turkeshi, Faruk Myrtaj, Sazan Goliku, Halil Rama e Sakip Cami, të cilët vlerësojnë maksimalisht veprën letrare të Shefki Karadakut ndër vite. Në librin “ABSURDI MBRETËROR”, botuar në 75-vjetorin e lindjes së shkrimtarit, Bardhyl Ajazi ka përmbledhur artikuj kritikë- Ese. Këndvështrime për krijimtarinë e Shefki Karadakut.

Dhe nëse patriarku i letrave shqipe, Dritëro Agolli vlerëson konceptimin popullor të realitetit në përmbledhjen “Meloditë e Shkumbinit” të Shefki Karadakut, ku evidenton gjuhën e pasur të vargjeve të tij të ngjashme me motivet popullore, si “*Vajza e mullixhiut*”, “*Nata e fundit e aksionit*” e të tjera....., Kallulli shprehet për pleksjen bukur e me forcë të ngjyrave, e heroikes me tragjiken, të fëlligështisë e dobësisë morale të armiqve të egër. Adriatik Kallulli për një nga poezitë më të njohura shkruan se poezia e Shefki Karadakut është në shumë raste një poezi pikturë, ai e ndien që lexuesit i duhet shprehur në një mënyrë të tillë që të parafytyrojë me kthjelltësi atë që ka parë njëherë poeti. Shembulli tipik për këtë është poezia “Kënga e karrove të drithit”, ku gëzimi për korrjen, për bollëkun e grurit shprehet me një kuadër plot lëvizje:

“Kur të fillojë të bredhë nesër dielli,/Në largësinë e fushës, si lejlek,/Atëherë, pas karrove të drithit,/Udhën e kaltër të arave do ndjek.....”

Po ashtu, poeti ynë Llazar Siliqi do të shprehej se, “kur më 1967 Shefki Karadaku doli me vëllimin e tij të parë, ‘Këngën e

karrove të drithit, ne u gëzuem që radhët e poetëve shqiptarë u shtuan me një poet të ri, me një lirik të qetë e të ambël, me ndjenja të holla, me dorë piktori të akuarelit’.

Ndërsa shkrimtari i madh Petro Marko, pasi ka lexuar novelën e Shefki Karadakut, të titulluar “Rrugët e para” shprehet: “Sikur ta kishte këtë botim në vargje dhe ta kishte pagëzuar po me këtë emër, ne përnjëherësh do të thoshim: poeti, pasi njeh rrugët e para të jetës, ka zbuluar në to fenomene dhe tinguj, ose ngjyra të reja dhe tani po na i dhuron me dashuri...”

Dr.Lutfi Turkeshi, gazetar&studjues nga Republika e Maqedonisë së Veriut, jo më kot, e vlerëson Shefki Karadaku si “*Khajamin e ditëve tona*”. Në këtë konkluzion ai arrin pasi ka lexuar romanet “Puthja e ngrirë”, “Njëmijë vjet dashuri”, “Vila e magjepsur”, “Salamandrat”, “Filantropi”, “Panagjerikus” e të tjerë, dhe vëllimet poetike “Kënga e korrave të drithit”, “Melodi të Shkumbinit”, “Ylberi”. “Lumi me njëqind zemra” e “Feniks” të poetit e shkrimtarit Shefki Karadaku, i cili asnjëherë nuk do t’i nënshtrohej jetës edhe pse e vuante atë...

“Si feniks, shkëlqen me ide kuarci duke ndërtuar “udhë betoni”... I tillë është poeti Shefki Karadaku. Tërë vargjet e poemës ‘Feniks’ janë të harmonizuara estetikisht në të gjitha nivelet e të shprehurit emocional, individual, stilit origjinal dhe figuracionit. Këto poezi janë shprehje e një personaliteti poetik jo të zakonshëm... Ka poeti edhe idilin e vet të vendlindjes që është “... *me çuka, rrape-qiparisa dhe subtropiku mund t’i flasë qershisë, por jo ajsbergë...*”. Por, ka poeti edhe dashurinë e shprehur si Naimi e Çajupi: ‘*Të këndoj ty bukuroshe si alku, unë s’jam poet i vjetër melik, po zemra po aq e lashtë sa dheu, përpara teje rreh si det antik...*’, që pastaj të vijojë: ‘*Po zemra e kërkon nudon e bukur, le të jetë ajo si mbretëreshë, që nëpër gjoksin e saj malli i shkurtër si tajfun Floride të përqeshë...*’. Si të përfundojmë?! Shkurt,



Bashkëshortët Nadire e Shefki Karadaku

poezi e veçantë, e jashtëzakonshme, e bukur... Është e tillë poezia e poetit Shefki Karadaku... Është shumë refleksive, sa më shpesh ta lexosh dhe rilexosh, gjithnjë do të nxjerrësh ndonjë ndriçim nga qielli me plot yje lirike të poetit të madh. Pra, kjo lirikë është identiteti poetik si katarzë”, -shkruan **Dr. Lutfi Turkeshi-Gazetar, studiues (“IDENTITETI SI KATARZË” - Gazeta “Fakti”, 8 mars 2001, Shkup).**

Petraq Risto si redaktor i romanit “Puthja e ngrirë” vlerëson ndërthurjen plot dritë dhe hije, si një afresk bardh e zi nga autori, të lirizmit, heshtjes, frikës, rebelimit, ankthit, jetës, dashurisë....

Edhe Moikom Zeqo nuk e ka të vështirë për të deklaruar se Shefki Karadaku është një poet nga të spikaturit në lirikën shqiptare.

Shefki Karadaku portretizohet si një nga shkrimtarët e dalluar të kohës.

Karadaku është një nga përfaqësuesit më të spikatur për gjininë e lirikës ku absorbohen përvojat e poetikave tradicionale me ato moderne e avangardiste evropiane dhe realizohet kundërvënia ndaj traditës letrare. Tipare të futurizmit, ekspresionizmit, surrelizmit, madje dhe

krepuskolarizmit janë përthithur dhe pasqyruar në poetikat e këtij autori.

KOORPUSI LETRAR I SH.KARADAKUT PËRBËN NJË THESAR TË ÇMUAR...

Teksa lexon veprën e Shefki Karadaku, vetëtimthi të kujtohet krijimtaria letrare mjaft cilësore e këtij poeti dhe prozatori që shkruan prej pesë dekadash, si romanet: “Puthja e ngrirë”, “Njëmijë vjet dashuri”, “Argonautët”, “Vila e magjepsur”, “Salamandrat”, “Gjergj Elez Alia”, si dhe disa novela e vëllime me poezi.

Koorpusi letrar i Sh.Karadaku përbën një thesar të çmuar që rrezaton dritën e artë. Gjetjet metaforike, forca krijuese, gjuha e pasur e shpesh poetike, përdorimi mjeshteror i fakteve, kronikat, përshkrimi i heronjve, legjendat dhe episodet e bëjnë të këndshme prozën e këtij shkrimtari.

Rrallë gjen në historinë e letërsisë shqipe një autor si Shefki Karadaku, të vlerësuar nga pena të spikatura si: Agim Cerga, Perikli Jorgoni, Milianov Kallupi, Riza Lahi, Jusuf Shahini, Leonard Veizi, Faruk Myrtaj, Mujë Buçpapaj, Ramazan Vozga, Namik Selmani, Sazan Goliku, Sakip Cami, Neritan Dragoti, Ahmet Banushi, Ermir Hoxha, Kostandin Dhamo, Tomor Jolldashi, Mihal Disho etj.

Krijimtaria e Shefki Karadaku është botuar edhe në gjuhë të tjera europiane. Revista letrare gjermane “Literatura Nr. 11 ndërmjet 20 autorëve nga Gjermania dhe vendet e tjera të Europës dhe Ballkanit boton edhe fragmente nga krijimtaria e shkrimtarit shqiptar Shefki Karadaku. Revista është botuar nga shoqëria letrare “Marburg” e Universitetit të Marburgut. Kopjet e saj ruhen në bibliotekën gjermane sipas ISSN.

Para pak kohësh, me kontributin e familjes u botua në anglisht romani i Shefki Karadaku “PUTHJA E NGRIRË”, nga një kopje e të cilit ju dhurua selive te huaja diplomatike në

Tiranë. Dhe menjëherë vjen vlerësimi i ambasadorit gjerman Peter ZINGRAF për këtë roman tejet të arrirë që me të drejtë është mirëpritur e vlerësuar në botën letrare të kryeqytetit.

Nuk është rastësi që poeti e prozatori Shefki Karadaku mirëpritej e botohej kudo në trevat shqipfolëse, si në Prishtinë, Dibër të Madhe, Ulqin, Strugë etj. Madje në vitet '73-74 gazeta prestigjioze "RILINDJA" e Prishtinës botoi në 6 numra radhazi novelën e tij "Kur kërcasin boçet e pishave"

Trashëgimia letare që na la Shefki Karadaku me 13 vëllime me poezi dhe 12 romane e 10 libra me tregime e novela, që të gjithë me subjekt të zgjedhur e të arrirë nuk është pak. Ato janë një kontribut i çmuar për të sotmen dhe për të nesërmen që të mos ketë "Puthje të ngrirë", që fjala e lirë të rrjedhë si "Ujëvarë", që "Gjergj Elez Alia" t'u transmetohet brezave si njeri trim dhe i besës, si njeri i zgjuar dhe i ditur, që respekton njerëzit e tij, por edhe vizitorët e huaj të rajonit e të botës, që "Shkumbini" të mos shkatërrojë tokat, por të përmirësojë ekologjinë tonë, që "Elbasani i bukur" të çlirohet nga ndotja dhe të shndërrohet në turizmin tradicional shekullor. Ky është mesazhi që përcjell vepra e Shefki Karadakut.

Ndaj, shkrimtarë të tillë si Ai, që kanë sjellë risi në letërsinë tonë, meritojnë vëmendje nga kritika letrare dhe, në mungesë të Lidhjes së Shkrimtarëve, nga Ministria e Kulturës e nga Presidenti i Republikës. Personalitete si Ai, meritojnë vëmendje, sepse janë truri i kombit.

N'asnjë libër poetik, të cilët ai i krijoi dhe i botoi njeri pas tjetrit, dhe sidomos tek më i fundit me titullin sinjifikativ "TORAKS", nuk mungon Elbasani; Karadaku është ajo kumria që s'është tradhtoi kurrë...Madje siç shkruan Kostandin Dhame:

Ky libër, këtë herë, përveç teksit poetik, ngërthen midis faqesh edhe disa fotografi dhe vizatime, të hedhura gjithë fantazi fine nga vetë Shefki Karadaku. Këto vizatime së bashku me fotografitë, shpërfaqin jetën e tij midis shtëpisë së

lindjes, brigjeve të Shkumbinit, tek kundron kumrien n'ajër, Bezistanin gumëzhitës, Kalanë, Sahatin, shelgun e pikëlluar që shkrehet mbi ujëra, dritaret pas pemëve të redaksisë së Revistës Ylli, Rrugën e Elbasani, e çnuk tjetër...

Shefki Karadaku, nga Elbasani i kumries, kësaj embleme n'ajër, nga Elbasani i Kalasë me çezmat te porta që rrjedhin e rrjedhin si mikpritja, dhe shtëpitë përbrenda me lule dhe vajza të bukura, nga Elbasani i Ditës së Verës, i Ballokumeve të ëmbla, i Shkumbinit shkumëzues, përgjatë brigjeve të të cilit stinët ndërrohen si dekore; nga Elbasani i Kristoforidhit, Isuf Myzyrit, Dhaskal Todrit, Vëllezërve Shpataraku, Bezistanit, Rrapit të Vojvodës, me poezinë dhe prozën e tij me vlera kombëtare, i dhuroi këtij qyteti një identitet të ri, Elbasani i Shefki Karadakut. Bashkëshortja e tij, Nadirja pohon se:

“Shefkiu nuk e programonte kohën kur shkruante. Shkruante në shtëpi, në parqe e lulishte, kudo ku gjelbëronte muza e tij.....Kishte ditë që ulej para tavolinës dhe shkruante për 10 orë rresht. Shpesh çohëj edhe nga gjumi dhe shkruante për disa orë edhe natën... Nuk kishte regjim të caktuar, por pas viteve ‘90 ai shkroi me shumë temp dhe botoi shumë libra, ndërkohë që la në dorëshkrim disa vepra tjera letrare”.

Një vit më parë, më 16 mars 2021, familja Karadaku humbi njeriun e saj të dashur dhe që e bënte të ndjehej krenare. Ndërsa letërsia dhe kultura kombëtare humbën një nga autorët e saj më të shquar, kur mund t'i jepte akoma vepra të tjera, edhe më cilësore artistikisht dhe më të pasura emocionalisht. Shefkiu u shua vetëm fizikisht. Emri, veprat e shumta e me nivel të padiskutueshëm artistik, i kanë dhënë me kohë të drejtën e denjë të pavdekësisë dhe të prehjes në Parajsë! Ndaj dhe do të përkujtohet në 1-vjetorine vdekjes (16 mars 2022) dhe 81-vjetorin e lindjes, me një Akademi Përkujtimore në Akademinë e

Shkencave, jeta dhe veopra letrare e të cilit do të përcillet edhe në një film dokumentar.

<http://www.panorama.com.al/te-kujtonte-nje-esenin-shqiptar-te-ndrojtur-nga-driteroi-te-llazar-siliqi-e-petro-marko-si-e-vleresuan-shefki-karadakun/>


<https://gazeta-nacional.com/poeti-shefki-karadaku-me-16-mars-akademi-perkujtimore-ne-1-vjetorin-e-ndarjes-se-tij-nga-jeta-nga-halil-rama-mjeshter-i-mad/>

<https://alb-spirit.com/2022/03/13/adn-ja-e-pandryshuar-e-shefki-karadaku/>

MAGJIA E FJALËS NË PROZËN E ZIJA ÇELËS

Bregat njerëzore, bukuria e rrëfimit dhe larmia e subjekteve në vëllimin me tregime “Thika pa gjak”

*Gazeta Telegraf - Suplementi Pena Shqiptare/
25 Qershor, 2021*



Shkrimtari i mirënjohur Zija Çela, Nderi i Kombit, për vetë vlerat e krijimtarisë së tij letrare, është padyshim ndër më të preferuarit e lexuesit. Nëse tri vitet e fundit jemi mrekulluar me romanet “Djali komik” e “Lavjerrësi i qytetit”, këtë fillim vere ai na dhuroi “Thika pa gjak”, që sapo është vënë në qarkullim nga “Onufri”. Një vëllim i strukturuar në tri pjesë, secila me nëntitullin e saj, gjithsej 54 tregime që të magjepsin me lëndën e larmishme, bukurinë fjalës dhe forcën tërheqëse të leximit. Pavarësisht nga mjediset apo vendi ku zhvillohen ngjarjet, të gjitha tregimet sjellin tema të aktualitetit dhe janë trajtuar, siç ndodh në krijimtarinë e Çelës, me frymën e universalitetit.


Me të drejtë, në përçjelljen e librit, prozatori e poeti Besnik Mustafaj, ka theksuar kur shkruan: “Sado improvizues e

spontan që është Zija Çela gjatë shkrimit, tipar ky që zbulon poetin brenda tij, ai e ka megjithatë të qartë Itakën ku do të mbërrijë dhe nuk hutohet gjatë rrugës, gjë që i jep rrëfimit të tij një qartësi, një dinamikë dhe një ritëm të lartë.” Pikërisht rrëfimi i qartë, dinamika dhe ritmi i lartë përshkojnë tregimet e Çelës. Lakonizmi spikat edhe në tregimin, i cili i jep titullin këtij libri. Autorit i mjaftojnë pak radhë në tregimin “Thika pa gjak”, për t’u ndalur thekshëm te tradhtia bashkëshortore, kjo plagë e rëndë e shoqërisë njerëzore, që rrëfehët nëpërmjet dialogut mes dy personazheve. Njëri prej tyre është Leli Makulla, që dyshon në tradhtinë e së shoqes. “Dhe që, si burrë pa këllqë për tradhtinë, i kthehet vetes: Jo, jo, nuk është ajo! Se imeshoqelëkokën pas meje e rrenat të tjera, e dokrra pa kokrra.” Pasi rrëfehët fare shkurt, por bindshëm artistikisht, prova e hidhur që kishte kaluar Leli Makulla, kur para Motel Nevadës, nga xhami i makinës, kushëriri kishte parë gruan e tij me një zotëri burrë, teksa zbrisnin shkallëve të fjetores, “zgjidhja” jepet në paragrafin e fundit: “E vrava, pra! I thuaj policisë se nuk jam larguar nga shtëpia.” Ndërsa më tej autori shkruan: “Kishin kaluar tetëmbëdhjetë vjet nga lajmi i kushëririt për Magdën dhe Nevadën. Qysh atëhere e kishte mbajtur dyshimin në zemër si thikë pa gjak.”

Këtë plagë të shoqërisë njerëzore, Zija Çela e trajton mjeshtërisht edhe në tregimin “Deri në fund”, kur dy personazhet, Asllani dhe Bilani, pasi rrëfejnë ëndrrat duke bërë seks me gratë e njëri-tjetrit, e kërkojnë me ngulm të verbër tragjiken, ata vrasin njëri-tjetrin...

“SIKUR JANË ZGJUAR TË PALUMTURIT E BOTËS...”

Mehmet Kraja, që spikat vetë në fushën e letrave, e vlerëson “Thika pa gjak” si “një libër të shkëlqyer, të atillë që dinë të bëjnë mjeshtërit e prozës dhe të shkrimit letrar.” Për shkrimtarin



dhe analistin e mirënjohur Kraja: “Këto tregime, shkruar me synimin e artit sipëror, sjellin shqetësime jetësore, trazime e reflekse meditative të njerëzve, që duan të shprehen për brengat e tyre të thella, plagët metaforike të thikave pa gjak. Të palumturit e botës sikur janë zgjuar, u ka ardhur radha dhe duan të flasin.”

Dhe pesonazhet flasin vërtet, duke zbuluar pengjet e dramat e jetes. Nuk flet vetëm psikologu te “Timoni”, që e ka të vështirë t’i përgjigjet Evelinës për seksin, pasi ndodhet në konflikt interesi, ndërsa për timonin ai i sugjeron të rishqyrtojë vetveten. Por kjo, sipas tij, “nuk do të thotë se jeni

thes me silikon ose kurvë!”

Flet edhe Tone Marashi, pronare e Bar Motra Tone në tregimin “Shuplaka e motrës”. Megjithëse gazetari dëshmitar del pro saj në gjyqin me Sedat Mahollin, i cili përgojonte prostitutat, prapëseprapë ajo do të shpërthejë në fund edhe ndaj tij: “E ç’burrë je ti që nuk ia ngjeshe turinje atij horri, kur e dëgjove të ndynte gojën në prani të Motrës Tone!”

Flet edhe Bushkashi te “Halli i burrit”, kur shprehet se do t’i donte parmakët e ballkonit “të forta e të bardha, si këmbët e zonjushave”.

E kështu, “të palumturit e botës” sikur janë zgjuar dhe flasin, sa të mahnisin me bukurinë e magjinë e fjalës në dhjetra tregime të Zija Çelës.

Ndërkohë, si risi e prozës së shkurtër të autorit, është për t’u vënë re edhe mënyra si u qaset ai emrave të personazheve. Të

tillë janë: Genti Meniku në tregimin “Margarita dhe tollumbace”; Andrea de Roca në Castelново te tregimi “Cili je dhe cila është”; Rudi Strazimiri te “Brezi i shkretëtirës”; Izabela Leonardo Dimikele dhe Rajmond Fransua te “Basti Final”; Anita Bokanini e Bernard Habacia te “Gropa thithëse”; Damian Roshi te “Demi në thes” e shumë e shumë emra të tjerë, që të ngazëlleshin herë me karakterin, herë me profilin e tyre, të ndërtuar mjeshhtërisht nga gjeniu i letrave shqipe Zija Çela.


Këtë ndjenjë provon edhe gjatë leximit të tregimit “Tregtarë të tymit”, ku rrëfëhet historia e Markut, i cili u kthye nga Amerika si Majkëll dhe e Gjinit, që në Amerikë u vetëquajt Xhimi...

NIVELI I LARTË ARTISTIK I NJË MJESHTRI TË DENJË

Shkrimtari i i mirënjohur Lazër Stani, i befasuar nga bukuria e rrëfimit, evidenton te libri “Thika pa gjak” larminë e subjekteve, natyrshmërinë, ritmin, muzikalitetin dhe ngjyrimet e fjalës, trillin dhe lakonizmin, si veçori të pranishme në secilin prej tregimeve. Duke e konsideruar një koleksion rrëfimesh sa shqiptare po aq universale, ngjizur me fantazi të pashtershme kreative dhe të harmonizuara në një libër të strukturuar gjithë origjinalitet, Lazër Stani konkludon: “Thika pa gjak dëshmon sërish nivelin e lartë të këtij mjeshtri të denjë të prozës së shkurtër, që edhe në letërsinë botërore nuk janë shumë.”

Kështu, si rrallëkush, autori trajton plagët sociale te tregimet “Banka e ankesave”, “Koha e qenve”, “Mis luga” etj, ku tek ky i fundit MIS është Ministria e Iluzionit Social. Duke marrë gjithnjë shkas nga jeta, fantazia e autorit nuk ka të sosur, prandaj sjell me elegancë edhe ironinë e sarkazmën.

Si në disa romane, edhe në këtë vëllim me tregime, Zija Çela dëshmohet gjithashtu njohës i jurisprudencës. Kjo reflektohet në disa tregime ku, me trille artistike mbresëlënëse, hasim



njëkohësisht viktimën, hetuesin, prokurorin, dëshmitarët dhe gjykatësin.

Në koherencë me realitetin, Zija Çela trajton me vetëdije të lartë artistike tema nga më të mprehtat. Nëse te “Banka e ankesave” rrëfen zyrtarin burokrat, i cili nuk ngurron t’i thotë qytetarit se ankesës së tij mund t’i vijë radha për t’u shqyrtuar pas dy-tri viteve, te “Tregtarë të tymit” gjejmë të famshmet PPP dhe sipërmarrës të pasuruar përmes tenderave me prokurim të drejtpërdrejtë. Po përmend kalimthi gjithashtu “Blu dhe Mavi Mbretërore”. Duke iu referuar gazetarit të huaj Frenk Uiliams, i cili kishte ardhur në vendin tonë për një reportazh, lexojmë: “Përpara se të përgatiste leksionin për studentët, me gjithë kërkimet e tij intensive, në tërë lëmshin tokësor asgjëkund tjetër nuk kishte mundur ta gjente termin Media kazani”.

Ndërsa te tregimi “Alpinisti”, nga personazhi interesant Flavio Markoni që kishte arritur të ngjitej në Everest, na thuhet në mënyrë metaforike: “Ekziston një mal tjetër, që është rreth gjashtëmijë metra më i ulët se Everesti. Dhe ndonëse e kam provuar dy herë, nuk kam mundur ta pushtoj. Ky mal është Olimpi.”

PERIFRAZIME SI SHPREHJE FILOZOFIKE

Nëse gjatë leximit të librit “Thika pa gjak” ndeshim fjalë e fjali të rralla që na nguliten në memorie, si: *“...vetëm në atë vendin e çuditshëm, ku as shtëpia nuk është e pronarit, por e Zotit dhe e të huajve” (Blu dhe mavi mbretërore); “Njerëzimi njëlloj humbet, si po të harrojë me qeshë, si po të harrojë me qa!” (Mali i jetës); “prapanica e pulës ia dhjeu tërë imazhin romantik” (Hëna në tigan), në tregimet e shkurtra të pjesës së tretë, nëntitulluar HOROSKOP, gjejmë tregimtarin filozof me thënie të atilla proverbiale, që mund të shërbejnë si postulate. Ja disa prej tyre:*

“E ndiej si shkallëve të hierarkisë gjëmon kori servil dhe si njerëzorja nuk ka më vlerë, kur baltë bëhet dinjiteti dhe nderi qenërisht hidhet në erë.”

“Një grua, një grua, për Qiell e për Tokë, edhe Zot të bën kur ta jep në kokë.”

“Qysh se më pate prekur, më ka zënë një hekë, thua se dua me vdekë.”

“Zogjtë që bashkë fluturojnë në vjeshtë, shkojnë drejt rrufesë së dimrit.”

“Megjithëse nuk ke më pak vrulle epshi, ajo mbretëresha tjetër, bilbilesa, të ka zëvendësuar me lodra seksi.”

“Duket sikur hëna e ka shpejtuar lindjen dhe dielli e ka vonuar perëndimin, vetëm e vetëm që të ndodhen ballë për ballë.” Apo: “Poshtë, pak para meje, një fije bari si gjuhë nepërke përqesh pleqërinë time...”

...Lexon Zija Çelën e të vjen të thuash: “Faleminderit, Mjeshtër, letërsia juaj është e paharrueshme.”


<https://telegraf.al/suplement/suplementi-pena-shqiptare-magjia-e-fjales-ne-prozen-e-zija-celes>

“NJË E TRETË DASHURIA”, NJË KULM NË POEZINË E PREÇ ZOGAJT

Libri fitues i çmimit të parë “Gjergj Fishta” në eventin kushtuar 150-vjetorit të lindjes së poetit të madh dhe korifeut të Rilindjes sonë Kombëtare

Gazeta “PANORAMA, Nov 9, 2021

Një e tretë dashuria”, libri fitues i çmimit të parë “Gjergj Fishta” në eventin kushtuar 150-vjetorit të lindjes së poetit të madh dhe korifeut të Rilindjes sonë Kombëtare, përcakton një kulm në ecurinë e botimeve të autorit të mirënjohur Preç Zogaj.




Është një vepër shumëpërmasore që sjell te lexuesi poezinë e dashurisë njerëzore. Ky vlerësim për poezinë e tij nuk vjen thjesht nga pena të rastësishme, por nga poetja e shquar Natasha Lako dhe nga poeti i parë laureat Rudolf Marku.

Kjo u duk fare qartë edhe në spektaklin poetik që UET organizoi në bashkëpunim me Teatrin Kombëtar në Art Turbina për librin më të ri me poezi të Preç Zogajt, “Një e tretë, dashuria”, botim i UET Press.

Në këtë spektakël, Natasha Lako, ndër poetet më të mira shqiptare, do të evidentonte shpagimin që vjen me fytyra të bukura, festën e gjuhës ku çdo fjalë e të gjithëve lulëzon në fjalën e poetit, një marrëdhënie kjo që e zbulon vetëm Preç Zogaj. Lako evidenton shpagimin e vuajtjes nëpërmjet dashurisë njerëzore, që në poezitë e këtij libri vjen si citat për dashurinë, si një shpërthim i brendshëm i gjuhës. Brenda një linje të tërë të letërsisë shqipe, Lako evidenton mjeshtërinë e poetit P. Zogaj, i cili si askush tjetër bën edhe bashkimin e traditës. Për këtë ajo sjell në vëmendjen e lexuesit dy poezitë e ciklit të pestë, “Pjetër Bogdani” dhe “Me Rudolf Markun në kafe “Çokolatino”

Kështu, nëse tek e para: “...Me trastën në shpinë Pjetri – shenjt i zëvendësuar para lindjes/ varet drejt shtegut ku do ta vrasin/ Si lule zjarri shpërthejnë/ shpat më shpat sibilat...”, tek e dyta : “...Rudolfi është më i mirë se Rudolfi/ Unë jam më i mirë se unë”. Mjaftojnë qoftë edhe këto vargje për të kuptuar se si nëpërmjet metaforës, poezia prodhon afrinë mes detajeve jetësore e njerëzore, filozofike e artistike, që kurrë nuk i kemi menduar më parë se ato do të mund të bashkëjetojnë të veshura me artin e fjalës së bukur. Ndaj edhe e madhja poete Natasha Lako çmon pasurinë e gjuhës, që, sipas saj, nën penën e Preçit bëhet e papërsëritshme dhe e pandashme nga ai. Duke e konsideruar këtë libër një vëllim që të befason, ajo thotë se Preçi e di vendin e vet në poezi dhe se me këtë libër ai ka fituar veten. “Ka një lulëzim fjala dhe këto kurora pemësh janë njerëzit. Çdo fjalë lulëzon në mënyrën e vet te Preçi dhe është e papërsëritshme. Fjala zë një vend të çuditshëm që nuk e ke te asnjë poet tjetër. Është një marrëdhënie që e zbulon vetëm Preçi. Për mua kjo është një nga gjërat më të bukura, që tregojnë një pjekuri shumë të madhe artistike”, shprehet poetja Lako.

Ndërsa poeti i parë laureat, Rudolf Marku, i cili ka bërë parathënien e librit, por njëkohësisht gëzon një miqësi të



hershme me autorin, i bëri një interpretim interesant vetë titullit të librit, teksa e cilësoi si librin më të mirë të letërsisë shqipe, por edhe të vetë autorit, i cili e ka sprovuar veten në disa gjini letrare.

“Poetë si Preç Zogaj e konsiderojnë Poezinë – Universin Shpirtëror të Njeriut – dhe misionin e tyre poetik si astrologët, që nuk rreshtin së kërkuari për yllësi dhe galaktika të reja”, – shkruan ndër të tjera Rudolf Marku në parathënien e këtij libri. Ai

vlerëson se “një e tretë dashuria” është një titull që na kthen pas te koncepti i Lasgush Poradecit, te poezia e tij e famshme: “Se s’dashuronja-as un’ as ti/Po dashuronte dashurija”.

Është gjithmonë një e tretë... Te dashuria është gjithmonë një sekret, është një e tretë gjithmonë. Këtë koncept, sipas Rudolf Markut, e merr Preç Zogaj, por merita e tij është kur e merr në mënyrë intuitive, pa i shkuar ndër mend në ato momente që është një koncept i hershëm.

Nën këtë optikë e sheh poezinë e Preç Zogajt edhe aktori i TK dhe pedagogu i UET-së, Dritan Boriçi. Pasi interpretoi mjeshtërisht vargjet: “Ne na njohu një e tretë: Dashuria./ Ajo qëndronte mes heshtjes sonë/ kur shiheshim gjatë si dy të pagojë/ dhe e dinim para tjetrit çfarë ka në mendje tjetri/ dhe flisnim dyshe edhe kur flisnim me vete...”, Boriçi veçoi si tipar animizimin e dashurisë, që sipas tij është pikënisja e këtij vëllimi poetik. Po. Te “Një e tretë, dashuria”, Zogaj, i cilësuar si “poeti i dashurisë”, sublimon gruan.


Duke e parë poezinë e këtij autori jo thjesht një proces

teknik, mund të pranojmë me vetëdije se te “Një e tretë, dashuria” është ditari poetik i Preç Zogajt për një periudhë të caktuar, është perceptimi në një përmbledhje të katër viteve të fundit duke mos përsëritur vetveten, duke ruajtur tiparet e poezisë në raport me poezinë e mëparshme. Ndaj dhe vlerësohet si një libër që përcakton një kulm në ecurinë e botimeve të tij, ndonëse Preç Zogaj gjithnjë gjen maja të reja në raport me poezitë e mëparshme.

Dhe siç pohon vetë Preçi, “autori ka gjithnjë ide, por besoj se ky libër shënon një nivel më të lartë në poezinë time...”. Pikërisht këtë nivel të lartë vlerësuan edhe Drejtoresha e QKLL-së, Alda Bardhyli, dhe drejtoresha e botimeve “UET Press”, Suela Mino, të cilat folën nën dritën e bashkëpunimeve me autorin, prurjet e të cilit kanë qenë të shpeshta nën logon e “UET Press”.

Nëse Besnik Mustafaj vlerëson se: “Si poet, Preç Zogaj është ngjitur tashmë në disa lartësi ku të paktë njerëz të letrave janë ngjitur, atje ku asgjë nuk mund t’i fshihet më shqisës së shtatë të metaforës e ku Engjëlli i thotë “ngadalë vjen njerëzimi tek arti”, për Mimoza Ahmetin, “Poezia e Preçit është dhe mbetet gjithmonë e ndjeshme, veçanërisht në raport me egon e vet, të cilën ai tashmë e ka ndërtuar në formë shkrimi...”

Me këtë libër, Preçi vjen si një prurje e re, nga një proces i imtësisht për të qëmtuar germën, detajin emotiv, instrumente gjuhësore dhe të përjetimit për të komunikuar me fjalën një ngjarje për lexuesin, është një lloj rrugëtimi jete... Poezia e tij është poezi që nderon letërsinë shqipe. Mjafton të citojmë për këtë qoftë dhe vetëm vargjet e poezisë “Njëherë tjetër”: “Njëherë tjetër do flasim gjatë/ për pengun tënd, për pengun tim/ Pres të rikthehet në gjendje të lëngshme/guri që mbaj në gjoks”. Apo dhe vargjet e poezisë “Testament i gjyshes”: “Pastër e mbajtëm shtëpinë gjithë jetën./Gjithë jetën i futëm vaj kandilit/ për kthimin e dytë të mbretit tonë, Jezu Krisht/... Kur të vijë,/qani për ne/o ju fatlumët”



Me 73 poezitë e këtij libri të konturuara në 6 cikle, poeti i mirënjohur Zogaj i prezantohet audiencës së lexuesve dhe botës shqiptare, si një ndër autorët mjaft interesantë e mbresëlënës. Kjo edhe për faktin se poezia e tij, pasi e ke lexuar, të mbetet në mendje. Është poezi që recitohet dhe interpretohet, siç e interpretuan atë me ndjenjë e përjetim artistik në këtë spektakël poetik aktorët e TK Doriana Çaushi e Donald Shehu, si dhe moderuesi i këtij spektakli, Dritan Boriçi, i cili komentet e disa poezive i shoqëroi edhe me interpretime të fuqishme emocionuese. Kjo

ndodh ngaqë poezia e P. Zogajt është një magji që mund të mrekullojë edhe shpirtrat. Më e dukshme kjo dukuri te poezia “Shpagimi po vjen me fytyrën më të bukur”, ku: “Ky diell e ka zanat, s’di të bëjë ndryshe/veç të mrekullojë.../Në hak të diellit mbushet kupa/shpagimi afrohet/me fytyrën më të bukur/ që mund t’imagjinohet”.

Mjafton qoftë edhe kjo përzgjedhje për t’u mrekulluar me poezinë e Preçit, që është poezi përqendrimesh dhe me karakteristika shumë të sakta, për sa i përket formës dhe kompozicionit. Gjen në këtë libër tituj shumë intrigues, si ato të poezive: “Baladë trishtimi për Noçen”, “Kur kujtoj sa të kam dashur ty”, “Të mund të vdesësh pa e marrë vesh bota”, “Pa pushim kërkon të ndalet zemra ime” etj., që të bëjnë për vete që në krye të herës. Mendimin e thellë filozofik të këtij

gjeniu krijues e dallon qoftë dhe në vargjet: “Princi i kaltër atje lart e larg/ thuret e sthuret në një re/ Tetëmbëdhjetë trëndafilat e Noçes shpërthejnë/koralen e gëzimit”. Në tërësinë e tij, libri “Një e tretë, dashuria”, shpalos profilin poetik të një poeti me ndjeshmëri të lartë, me teknika vjershërimi midis tradicionales dhe modernes e postmodernes, me një pasuri të begatë mjetesh dhe teknikash poetike, me struktura vargjesh e strofash të zhdërvjellëta, që e kthejnë formën në një procedim të mesazhit estetik.


Me “Një e tretë, dashuria”, pas romanit të tij të famshëm “Anjeza nuk u zgjua” dhe 101 poezive në librin “In Love”, Preç Zogaj këmbëngul më fort në këtë zhanër letrar, por tashmë më me pjekuri artistike dhe më i afirmuar si poet.

Panorama.al - <http://www.panorama.com.al/nje-e-trete-dashuria-nje-kulm.../>

NJË PALË “OPINGA” PËR HRUSHOVIN?!

*Për romanin “Dëmtuar gjatë rrugës” të Besnik Mustafajt
- fitues të Çmimit të madh të Panairit të Librit 2019, me
të cilin Besnik Mustafaj u shpall “Autori më i mirë i vitit”*

*Botuar në suplementin “MILOSAO”
të “Gazeta Shqiptare”, 15 DHJETOR 2019*



Ditën e fundit të Panairit të Librit 2019, të dielën e 17 Nëntorit, m'u desh të shkoja tri herë në Pallatin e Kongreseve. Dy herët e paradites, mungonte, pasi ishte shitur tri ditët e para, ndërsa në mesditë erdhi i ribotuar romani fitues i këtij panairi “Dëmtuar gjatë rrugës”. U ndjeva me fat që e mora me autografin e autorit Besnik Mustafaj. Por më me fat u ndjeva pasi e lexova këtë roman, vërtetë me fund të lumtur. Personazhi, me fund të lumtur është nëna e autorit. Një fund i lumtur pas një makthi që e kishte pushtuar atë prej tri dekadash se mos një ditë do t'i hapeshin “petët e lakrorit”... Ajo kishte shkelur për herë të parë kur ishte 24-vjeçe në një

zyrë të vërtetë të pushtetit “atje ku ndihet si frikë deri në kockë hija e rëndë e shtetit”. Siç pohon autori që në krye të herës “është një histori, të cilën ajo e ka mbajtur brenda kokës së vet si një tumor (fjalët e saj) për tridhjetë vjet”. Dhe ky “tumor” s’ ishte gjë tjetër veçse brenga që i çelën një palë opinga, që ajo u detyrua atë pranverë të largët të vitit 1959 nga më i madhi i partisë së krahinës, t’i qëndiste si dhuratë për Nikita Hrushovin, në vizitën e tij të parë në Shqipëri. Që nga marrja e porosisë prej ish-sekretarit të parë të PPSH të rrethit për të krijuar një palë opinga artistike, që do të përbënin “sekret shtetëror”, personazhi kryesor i romanit “do të mendonte me bindje të rrënjosur një herë e përgjithmonë se sidomos zyrat e politikanëve të lartë janë të mbushura me mistere djallëzore, ku njeriu i pamësuar zbulon pafuqinë e vet, duke pësuar në shpirt gjymtime të papërfytyrueshme”.

Në thelb, subjekti ka dy pamje: Pamjen gazmore kur pasi iu pëlqyen “opingat artistike” që kasta e atëherëshme ia dhuroi Hrushovit, të cilësuar si “babai i popujve”, nëna u bë “Shoqja S” dhe përzgjidhej si politikane e re “yll në ngjitje” në tribunat e mitingjeve ku brohoritej “Rroftë shoku Hrushov”, dhe pamjen e zyrtë gjatë gjithë viteve të mëpastajme, kur ajo dyshonte se mos shpallej armike, pikërisht pse kishte krijuar “opingat artistike” për Hrushovin që ishte shpallur armik i revolucionit bolshevik nga mbrojtësi i flaktë dhe i vetëm i tij, Enver Hoxha.

PËRSHKRIM BRILANT I LËMSHIT TORTURUES TË LOTËVE TË NJË NËNE

Autori, si rrallëkush tjetër ka ndërtuar profilin e nënës së tij, nëpërmjet dialogesh me të vjehrrin dhe monologjeve me vetveten, gjatë procesit të thurjes së opingave si “sekret shtetëror” dhe në vijim për frikën se mos pas “tradhtisë” së Hrushovit edhe ajo mund të shpallej armike dhe ta pësonin i

biri, vëllezërit dhe gjithë farefisi i saj. Të krijosh një roman kaq të arrirë artistikisht vetëm mbi këtë subjekt është vërtetë një meritë e veçantë e këtij autori, që si askush tjetër përshkruan lëmshin torturues të lotëve që ia kishin zënë lëfytin e hollë të grykës, kësaj nëne fisnike që s'mendote për asgjë tjetër (nëse do ta arrestonin) veçse për të ardhmen e djalit foshnjarak (në djep). Dhe kur u bind se nuk kishte më asnjë rrugë shpëtimi “një zë, që ishte zëri i saj, edhe pse nuk dilte nga goja e saj, zuri të këndonte vajtueshëm: “Nji amanet po jua la:/Kur në mur-o t'më murosni,/Syn' e djathtë t'ma leni jashtë,/Kambn' e djathtë t'ma leni jashtë,/Gjin' e djathtë t'ma leni jashtë:/Se kam lanë djalin e vogël/E kur t'nisi djali gjamën,/Me njan' sy ta shikoj,/Me njan' dorë ta limoj,/Me njan' kambë ta lurtoj,/Me njan' gji ta nergoj”. Amaneti i një nane që “opinga artistike” mendonte se duheshin thurur veç për burrin e saj dhe për asnjë burrë tjetër në botë.

“Mrekullia, që duhej të nxirrte Nëna ime nga duart e veta ‘vetëm me një grep e pe të bardhë’ ishin një palë opinga burrash”. Por për të “Fqinjëria e fjalëve SEKRET dhe SHTETËROR krijonte një bashkim tingullor tepër të frikshëm”. Madje sipas saj “vetëm zyrat mund të bënin sajime të tilla gjuhësore, që t'i përshkonin veshët dhe trurin si turjela”. Pikërisht mbi rrëfime të tilla brilante autori ndërton intrigën për “pyetjet e përsëritura edhe pse të mbetura pa përgjigje si dhe dyshimet e njëpasnjëshme dhe gjithnjë të pasqaruara” që ngadalësojnë tejmas rrjedhën e kohës. Dhe gjithshka “për shkak të atij të mallkuarit, sekretit shtetëror!”. Ishte ajo kohë e kobshme kur mund ta haje po të nxirrje sekretin e thurjes së një palë opinga artistike, pasi përbënte “rrezik të madh të gënjejhet Partia”. Pikërisht në këtë kontekst e paraqet autori marrëdhënien e nënës së tij me Dritën, kushërirën e burrit të saj që vetvetiu “do ta fushnin shoqja shoqen në skutat më të fshehta të shpirtit”. Drita, “e fejuara e damkosur e një armiku të klasës” dhe Selmani, më i arsimuari i zonës që s'pajtohej

me qëndrimet staliniste të PPSH janë dy personazhet, marrëdhënia me të cilët, jo vetëm që nuk e zbehin, por përkundrazi e fisnikërojnë profilin e nënës së B. Mustafajt.

Skani i një partie që ndërhynte edhe në trillet e fshehta dashurore

Me mjeshtri të rrallë artistike, me një guhë të pasur e mjete shprehëse interesante autori ekzaminon atë parti që “kishte për detyrë të ndërhynte edhe në trillet e fshehta dashurore të anëtarëve të saj”, qoftë dhe duke përkruar atë hallakatje të pavullnetshme ndër përhitje të nënës së tij që ruajti në shpirt një gjurmë të re malli për të shoqin komunist që partia e kishte dërguar për studime në Tiranë. Ndaj dhe modeli i opingave artistike që i pari i partisë së krahinës ia kishte porositur si “sekret shtetëror”, do të ishte modeli që i përkiste vetëm një burri, që në këtë roman paraqitet si babai i autorit. Ato do të ishin opinga “më të bukurat e të bukurave”. Ndonëse sipas porositësit, masa e këmbës që do t’i vishte nuk kishte asnjë rëndësi, Nëna ishte zhytur në një makth nga i cili s’po dilte dot.

E mundonte pyetja e tmerrshme për këmbën e burrit të mistershëm, këmba e të cilit futet në çdo këpucë... “I tillë është vetëm djalli e i biri i djallit. Unë s’kam punë me të. Zot i madh m’i ruaj mendtë në kokë!”. Ndaj dhe s’u besoi veshëve kur mësoi se opingat që kishte thurur ishin për Hrushovin që kishte zënë vendin e Stalinit në Moskë... Ndaj dhe i shpërtheu një e qeshur e vrullshme, e papërmbajshme kur mësoi nga i vjehri se “Hrushovi do të vishej me opinga si barinj të Tropojës”. Në fillim ajo “nuk pati ndonjë lëndim në sedër si krijuesja e shpërfillur e dhuratës simbolike për “babanë e popujve”, kur nuk e përfshinë në delegacionin që do të shkonte nga Tropoja në Tiranë për ta takuar atë. Por më pas kuptoi se “brenda saj rridhte pavetëdijshtë një përrua zemërimi, pse krerët e partisë në rreth nuk e kishin marrë me vete në Tiranë”. Ato ditë kur pjesëmarrja në mitingje ishte e detyrueshme,

prodhuesja e opingave artistike për Hrushovin do të shihte vehten dhe të detyrohej të fliste në mitingun e organizuar në qytetin Bajram Curri. Dhe për sa kohë, tanët e patën mirë me “babanë e popujve” nëna, ndonëse e njihte fare pak politikën do të ishte më e preferuara e drejtuesve të saj në rreth. Por rrjedha ndryshoi në të kundërtën, kur pas “tradhtisë” së Hrushovit, shoqja Rushe, si ziliqare që ishte do ta kërcënonte se tani do t’i hapeshin “petët lakrorit”, ç’ka nënkuptonte se nëna (ose shoqja S e romanit) do të ndëshkohej si hrushoviste (ajo do të burgosej ndërsa do ta pësonte i shoqi komunist dhe tre djemtë e saj). Por autori, edhe në këtë rast ka meritën e përshkrimit të një nëne që “krenohej me bukurinë e saj të jashtme, gjë që ishte e papajtueshme me vijën e partisë, sipas së cilës nuk ishte dukja, por thelbi, domethënë bota e brendëshme, shpirti revolucionar që përbënte pasurinë dhe bukurinë e njeriut të ri”.

KOHERENCA ME REALITETIN OBJEKTIV

Nëse ngjarjet i përkasin kohës mënxyrë kur partia porosiste që “lufta e klasave të zhvillohej edhe brenda familjes”, autori i sjell ato në koherencë me realitetin objektiv, qoftë edhe kur pohon “Udhëheqësit kishin një gjuhë të caktuar për të folur me njëri-tjetrin e një tjetër gjuhë për të folur me popullin”. (A nuk ndodh edhe sot kësisoj me klasën tonë politike të dalë bojë!). Apo edhe kur pohon se ka gërmuar gjatë nëpër arkivat e Agjencisë Telegrafike Shqiptare (ATSH) për të gjetur fotografinë e nënës së tij në tribunën e mitingut të organizuar në Tropojë gjatë vizitës së Hrushovit në vendin tonë. Nga ai miting nëna ishte dekoruar me “Urdhrin e Yllit me Pesë Cepa” nga Kryetari i Presidiumit të Kuvendit Popullor, dekoratë kjo që do ta stresonte e mbante nën ankth gjatë gjithë viteve të mëvonshme pas “tradhtisë” së Hrushovit, kur mendonte se do të hapeshin “protokollet e partisë”! “Në të vërtetë - shkruan

autori - ky arsytim në kokën e nënës sime do të sqarohet më vonë, ngadalë, gjatë përplasjeve të vështira që do të kishte ajo me veten për të ndarë sa më mirë nëse ishte viktimë, apo fajtores në këtë histori”. Është një histori e rrallë mbi të cilën autori ndërthur mjeshtërisht ngjarje e personazhe që na bëjmë të kuptojmë më së miri sistemin e kalbur të diktaturës komuniste. Ndonëse e përshkruan si hamendje të nënës së tij, në të vërtetë është koha kur pas ngjarjesh e arrestimesh të bujshme për tradhti imagjinare e kalime të paligjshme kufiri, qyteti Bajram Curri jetonte dita-ditës me një bombë me sahat në gji.

Sthurjen dhe dekadencën e atij sistemi autori na e paraqet mjaftë bukur qoftë dhe me profilizimin e personazhit të Vasilikës, që ndonëse e kishte sjellë partia të përhapte të rene e civilizimin në qytetin verior në zemër të maleve, qytetarët thonin: “Na qelbi vendin ajo bishtpërdredhura e dreqit!”. Dhe kur për këtë “bishtpërdredhurën” shkon fjala deri tek shoku Enver (nëpërmjet një letre anonime) se ajo “shkonte në shtrat jo vetëm me djemtë më të pashëm të qytetit, qofshin ata beqarë apo të martuar, por edhe me kuadrot e partisë e të pushtetit, pa parë moshën e tyre, si dhe me oficerët e sigurimit në rreth”, Udhëheqësi do t’i kërcënonte ato se “puna e madhe dhe delikate e Partisë duhet përqëndruar kësaj here tërësisht tek burrat, për kalitjen e forcës së karakterit të tyre”. Autori që pohon se letrën anonime, bashkë me shënimin e Enver Hoxhës që e ka gjetur në Arkivën Qëndrore të Shtetit gjatë përgatitjeve për shkrimin e këtij romani, argumenton më së miri për këtë “qëndrim krejt të përligjur të Enver Hoxhës që e kishte kuptuar më në fund se nuk kishte mënyrë tjetër veç anonimatis, për t’ua vrarë njerëzve të thjeshtë lepurin e frikës, i cili me ata dhëmbët e tij prerës, po ia hante shpirtin popullit, siç hante lakrat natën në vjeshtë, në kopshtet e fshatarëve. Babai i atij lepurit të tmerrëshëm ishte hija e Stalinit”. Këtë teze e mbron edhe me pohimin e nënës së tij se “hapi që bëri për

t'u përfshirë në politikë, në të vërtetë e kishte hedhur në një greminë ku do të gjente një vetmi të ngulur si tumor i fshehtë, i ngulitur në trurin e saj”.

ENIGMA PËR “KËPUCËN” ME TË CILËN HRUSHOVI GODITI TRIBUNËN E OKB-SË

Dhe si për ta përligjur këtë ngulitje, autori përshkruan më pas me realizëm ngulmimin e nënës që ai të gërmonte në Arkivin e OKB-së për këpucën më të cilën Hrushovi paskësh goditur tribunën e institucionit më të rëndësishëm botëror me pretekstin se nuk i kishin dhënë fjalën për një replikë. Autori nuk arinte ta merrte dot me mend se çfarë lidhje shihte nëna e tij midis opingave, që kishte bërë dikur për Hrushovin, dhe këpucës, me të cilën kishte goditur ai tribunën e sallës plenare të Asamblesë së OKB-së, siç ishte bërë e njohur botërisht dyzetepesë vjet më parë (12 tetor 1960)..., kur flitej për sherret e Hrushovit me kryetarin e asaj Asambleje, Frederick Boland-in, si dhe me kryetarin e delegacionit të Filipineve, një farë Lorenzo Sumulong, i cili kishte thënë se popujt e Europës Lindore, të përpirë nga Bashkimi Sovjetik, nuk gëzonin të drejta civile e as politike.

Pikërisht kjo mungesë lirish të drejtash civile e politike si të drejtat bazë të lirisë njerëzore përshkojnë si fill gjithë romanin “Dëmtuar gjatë rrugës”. Autori tregon mjaft bukur se çfarë e bëri nënën të ketë aq frikë nga zyrat e pushtetit. “Nëna” në romanin tim nuk është një personazh që e bën politikën. Ajo vetëm e pëson politikën. Rrjedhimisht, përjetimet e saj janë ato të një personazhi të pafuqishëm përballë politikës. Vetëdija e pafuqisë është dërrmuese për njeriun. Në këtë roman unë kam synuar ta tregoj ekzistencën e shqiptarit të thjesht nën diktaturë, jo duke e kërkuar dramën në vatrën e dukshme të dhunës e që ishin burgjet apo internimet, por në atë pjesë të skenës që

paraqitej si suksemi i regjimit e ku jetonte shumica absolute e popullsisë”,- shprehet Mustafaj.

Autori pasi arrin ta qartësojë nënën për këtë realitet të trishtë, apo edhe për pakon e ardhur pas shumë vitesh nga Munihu me shënimin e postës së Tiranës “Dëmtuar rrugës”, ky, mund të konsiderohet vërtetë një roman me fund të lumtur. Me këtë roman të llojit e stilit të veçantë, Besnik Mustafaj është në të drejtën e tij ta lëjë mënjanë politikën dhe t’i përkushtohet me gjithë potencialin e talentit të tij prozës. Pasi është vërtetë befasues prezantimi i tij, me këtë roman fitues të Çmimit të madh të Panairit të Librit 2019, me të cilin ai u shpall “Autori më i mirë i vitit”.

TRILLI ARTISTIK BEFASUES I BASHKIM HOXHËS NË ROMANIN “NJË SHAKA E VOGËL ME VDEKJEN”

*Struktura e veçantë e këtij romani, me 13 episode,
duke vendosur në krye të secilit një citat nga autorë të
famshëm botërorë, e bën atë mjaft tërheqës për lexuesin*

*Gazeta Telegraf, 7 Janar, 2022” -
Suplementi “Pena shqiptare”*



Bashkim Hoxha befason sësish lexuesin me romanin e ri “Një shaka e vogël me vdekjen”. Pasi ka befasuar me “Kronikat e mjegullës” (si dhe romanet e mëparshëm “Një ditë si Skënderbeu”, “Heronjtë e viagrës”, “Gruaja e shiut” e “Duartrokotësit”), me dramat e komeditë e inskenuara e të ndjekura nga mijëra shikues, Bashkim Hoxha vjen sërish me romanin me titullin intrigues “Një shaka e vogël me vdekjen”.

Me një trill artistik befases, autori e vendos personazhin kryesor Hektor K. kundra rrymës. Zhdukja e tij e mistershme, pas eksperimenteve bajate me zhguallin e breshkave, për të provuar jetëgjatësinë e njerëzve deri 300 vjet (po aq sa dhe të breshkave), dhe rikthimi i tij po i befshëm, kur shumëkush

e pandehte të vdekur, janë një qasje e veçantë e këtij autori, duke sjellë kështu risi në prozën e sotme shqipe.

Vetë struktura e veçantë e këtij romani, me 13 episode, duke vendosur në krye të secilit një citat nga autorë të famshëm botërorë, e bën atë mjaft tërheqës për lexuesin.

Ky personazh, pra Hektor K, që kur e pyesnin se si i shtynte ditët në vetminë e tij brenda një shtëpize të vjetër në qytetin provincial, përgjigjej me atë batutën pa kuptim: *“Ja të shtyjmë edhe këto treqint vite të tjera, që na kanë mbetur”*, vuri në lëvizje policinë dhe prokurorinë, për ta gjetur dhe hetuar, për eksperimentin e tij me breshkat. Kështu nëse në episodin e parë shtjellohet mjaft bukur hutimi i Akil L për Hektorin, episodi i dytë është befasues që në rreshtat e parë, ku autori shkruan: *“Ditën e dytë mungesa e Hektor K. dhe e një vajze të panjohur bashkë me të do të ishte harruar, po të mos ishte shpërndarë lajmi se ai ishte zhdukur duke marrë me vete një zbulim të rëndësishëm - kishte mundur të gjente formulën se si njerëzit të zgjasnin jetën, të paktën 300 vjet, aq sa jetonin breshkat”*. Pas këtij perifraximi, gjithkush do të mendonte për vajzën e panjohur që “arratiset” me një njeri pothuajse të lajthitur si Hektor K. Dhe fantazia e autorit kulmon në ndërtimin e skenave dashurore mes këtyre dy personazheve, jo në hotele apo motele luksoze, por në shpellën e një mali të lartë, ku pas aktit seksual nuk kanë dushin me ujë të ngrohtë por ju duhet të lahen me ujin e ftohtë të një katarakti (dhe me myshqe në vend të sapunit), të cilin B.Hoxha e sjell për lexuesin me tërë bukurinë dhe madhështinë e tij, nga ku buron ujë gurror dhe ku në vend të sapunit mund të përdoret myshku i drurëve apo gurëve. Pikërisht në atë befasi natyrore i vendos autori dy personazhet e romanit të tij, Hektorin dhe Ritën, të cilët *“në rrotullim e sipër, me ofshama pa fjalë, përfunduan të dy lakuriq, duke u llapashitur në ujin e ftohtë akull të malit”*. Kësisoj, me mjeshtri të rrallë artistike autori e paraqet Rita (Margaritën) si studenten që do të eksplorojë

skena të veçanta dashurore, jo si ato të bashkëmoshatarëve të saj studentë nëpër bare e lulishte, por atje majë maleve e nëpër shpella, duke gënjyer edhe prindërit për këtë “turne” të jashtëzakonshëm , për t’u arratisur atje ku *vetmia e malit duket si titull poezie!*. Dhe e gjitha kjo, ndonëse ishte e vetëdijshme se ia kishte lënë në dorë jetën e saj një të çmënduri.

Brenda kësaj strukture lëvrijnë edhe personazhe të tjerë si mësuesi i kimisë Akili, i cili nuk e kishte vrarë shumë mendjen për gjëra të jetës. Autori e vendos atë në pozitën e një mësuesi të dëshpëruar që qëllimet e jetës i kishte harruar me kohë. Në këtë kontekst shpaloset filozofia e autorit për krizën e shoqërisë së sotme, duke na e paraqitur mësuesin Akil me mentalitetin se “Ata që krijonin lloj lloj krahasimesh për jetën apo dashurinë, apo ata që në Facebook postonin aforizma shkrimtarësh, si për shembull, jeta është një rrugë që fillon në maternitet dhe përfundon në varreza, apo, *jetën dhe lirinë e meriton veç ai që në luftë për to shkon përditë, apo dashuria i jep kuptim ekzistencës*, e të tjera si këto, që i dukeshin sikur mundoheshin kot më tepër për të rënë në sy, se sa për të kuptuar se çfarë është në të vërtetë dashuria apo jeta. Më tej tek episodi “*Janë të bukura marrëzitë*”, ku autori perifrizon Servantesin (Don Kishoti): “*Kam lindur i lirë dhe për të jetuar në liri kam zgjedhur vetminë e fushave, miqtë e mi janë pemët e malit, ujërat e kristalta janë pasqyra ime*” trilli i tij i kapërcen kufijtë e imagjinatës, kur shkruan se “...*midis jetës dhe vdekjes njeriu e ka sofistikuar jetën e tij me rregulla morale, fetare, ligje, shtojnë këtyre edhe teori dhe ideologji nga më të ndryshmet, të gjitha së bashku në emër të përsosjes së jetës, por që shkonin kundër natyrës fillestare të njeriut dhe e bënte atë më të komplikuar*”.(fq.67).

Pikërisht si kapërcim epokal B.Hoxha përcjell nëpërmjet këtij romani mesazhin e thyerjeve të tabuve, ndonëse na çojnë në shturje e degradim moral të shoqërisë së sotme. Më konkretish në episodin “*Pavdekësia dhe trazimet e saj*”,

ku perifrazon Milan Kunderën “Njeriu nuk e di si të bëhet i pavdekshëm”, autori e paraqet personazhin kryesor të romanit të tij në një një tjetër qasje dashurore me artisten Helena, e cila “ u trishtua kur mendoi se sa shumë jetë dashurore të të tjerëve kishte jetuar në skenë dhe jetën e saj shumë pak e kishte shijuar. Kishte vuajtur brengat e tradhtisë së Ana Kareninës, kur ishte fare e re vuajtjet e Ana Frankut, më pas dredhitë e vogla të sekretarëshave dhe dashnoreve të fshehta. I kishte vuajtur seriozisht, kurse ndarjet e saj i kishte pasur pa asnjë shqetësim .”. Dhe më tej tek episodi “PASIONI”, ku sipas Flober (Madam Bovari) “Një pafundësi pasioni mund të ngjishet brenda një minute, si një turmë në një hapësirë të vogël”, i marri Hektor arrin të bëjë dashuri edhe me Helenën. “Ishte ajo e para, që u afrua te Hektori dhe e puthi. Hektori qëndroi për pak çaste pa lëvizur, pastaj e mbështolli të tërën brenda vetes dhe u rrokullisën në qilimin dekorativ me motive të vjetra”. (fq.108). Këto, si dhe varrmihësi Demka tek episodi “Kënga e varrmihësit”, i cili dëshpërohet me eksperimentin e Hektorit për zgjatjen e jetëgjatësisë së njëriut, sepse kështu do të rralloheshin varret e ai do të ngelej pa punë, apo dhe dramaturgu Vili Sh. që detyrohet ta ndryshojë rrjedhën e ngjarjeve në dramën që po shkruan, janë personazhe që të risjellin në mendje heronjtë e letërsisë antike e klasike.

I promovuar bujshëm vetëm para disa ditësh romani “Një shaka e vogël me vdekjen” është ndër më të kërkuarit në libraritë e Tiranës, të Durrësit e pothuajse në gjithë vendin. Kjo për faktin se, gjuha e pasur, mjetet shprehëse dhe përshkrimi brilant i ngjarjeve e personazheve e bëjnë këtë një roman mjaft tërheqës, i cili lexohet me një frymë.

<https://telegraf.al/.../suplementi-pena-shqiptare-halil.../>
<https://alb-spirit.com/.../trilli-artistik-befasues.../>

ROMANI “ANJA” I JEP AHMET PRENÇIT ÇMIMIN LETRAR TË KARRIERËS “GJERGJ FISHTA”...

*“ANJA” vlerësohet nga një juri e përbërë
nga personalitete të letrave shqipe*

Gazeta “Panorama”, Oct 26, 2021



Në eventin kushtuar 150- vjetorit të lindjes së poetit të madh dhe korifeut të Rilindjes sonë Kombëtare, Atë Gjergj Fishta, organizuar nga Bashkia dhe Biblioteka e Lezhës, poeti dhe prozatori Ahmet Prençi u vlerësua me Çmimin e Karrierës “Gjergj Fishta”, për romanin “Anja”.

Natyrisht që autori Prençi do të përjetonte një kënaqësi të jashtëzakonshme. Kjo, edhe për faktin se romani i tij “ANJA” vlerësohet nga një juri e përbërë nga personalitete të letrave shqipe, si poeti laureat Rudolf Marku, shkrimtarja Natasha Lako dhe Bajram Kosumi, shkrimtar, profesor, studiues. Poeti dhe prozatori Prençi mbërrin te ky çmim i madh, pasi romani i tij “Anja”, i botuar para një viti, ka qenë ndër më të preferuarit e lexuesit, jo vetëm në metropolin shqiptar, por edhe në qytetet kryesore të vendit, fakt ky i evidentuar

dukshëm në takimet e poetit me personalitete të letrave e lexues kualitativ, si dhe në studiot e televizioneve kryesore kombëtare e lokale, si në Tiranë dhe në Shkodër, Korçë, Gjirokastër, Vlorë, Durrës etj.

Çmimi letrar i karrierës “Gjergj Fishta” i jepet kështu romanit “ANJA”, që vjen si befasi në botën letrare për sa i përket trajtimit të dashurisë njerëzore dhe plagëve sociale.

Dashuria njerëzore dhe plagët sociale në romanin “Anja”

Nëse, sipas shkrimtarit të mirënjohur Besnik Mustafaj, me vëllimin poetik të vitit 2016, “Udhë në pasqyrë”, poeti Ahmet Prençi” erdhi me një lloj tradite që ka letërsia shqipe, me romanin e tij “ANJA” ai sjell risi në botën letrare, duke befasuar lexuesin e shumtë të tij. Kjo, jo vetëm për subjektin tepër interesant, por dhe për gjuhën e pasur e mjetet shprehëse në karakterizimin e dy personazheve kryesorë të romanit, Anton Hila dhe Anja Steve.

I pari, besnik i parimit për ta ngrysur jetën në vetminë e tij, ndërsa e dyta, një krijesë e magjishme franko-shqiptare që sjell pak Paris në Drinas, nga ku ngjizet dhe trashëgimtari i tyre me emrin e bukur ARBËR. Kësisoj, “Anja” është një risi në prozën e sotme shqipe, qoftë si subjekt dhe për karakterin e ndërthurjen e personazheve. Se në fund të fundit, edhe Antoni, i cili pas disfatës në dashuri në rininë e tij të herëshme, dhe që në mesin e moshës, kërkonte vetmi të përherëshme, më në fund e ka trashëgimtarin e tij. Kështu, mesazhi që përcjell Ahmet Prençi tek lexuesi është ai i ripërtëritjes së jetës. Për këtë ai përdor magjinë dhe forma tjera të mbinatyrshme si element parësor të përmbajtjes, temës dhe vendosjes së personazheve.

NJË DASHURI ME “NEKROLOGJI” TË PARASHKRUAR

Si prolog të ngjarjeve të romanit “ANJA” autori vendos disfatën e inxhinierit të talentuar Anton Hila në dashurinë

për studenten e fizikës, vajzë e një aktori të famshëm, si dhe dy të rinjtë që e kishin përjetuar shumë keq diktatin prindëror të kësaj ndarjeje. Ndonëse Eli mbeti në mendjen e tij, ashtu e re, e bukur, bjondina dhe elegantja simpatike e shkollës, Antoni, kurrë më, pas saj, megjithë disa flirtime rastësore me femra, nuk mendoi të krijonte familje me ndonjërin prej tyre. Autori e profilizon Anton Hilën, si një enigmë njerëzore mes atij pejsazhi të magjishëm, apo si “një tip i mistershëm”, në rrjedhën e ngjarjeve në vitet që kalonin, e kur secili prej tyre (Ai dhe ish - e dashura studente) udhëtonte me pasaportën e vet shpirtërore.

Si djalë i kulturuar dhe bukurosh, aventurat e dashurisë me vajza të bukura ishin një pjesë romantike e jetës së Antonit, ku drama dhe melodrama nuk kuptohen si gjini letrare, por si realitete pagjumësie të bukur...Për ta bërë sa më bindës këtë personazh autori fantazon deri skena për tentativë vetëvrasje pas dështimit me Elin, duke i nxjerrë përpara lokomotivës së trenit, lypësin, që pasi i jep dhjetëlekëshin, i rrëfen dramën e tij të dashurisë..., e megjithatë ai e donte jetën. Kësisoj gjejmë në këtë roman portretizime e përshkrime brilante të ngjarjeve e rrethanave, të përjetimeve të dashurisë së dëlirë, por dhe të përjetimeve dramatike, deri sa tek Anton Hila shfaqet franko-shqiptarja Anja Steve, (me nënë shqiptare e me baba francez).


Të skeduar e përshkruara si rrëfime ngjarjesh e episodesh prej më shumë se tri dekadash, autori Prençi, sjell mjeshtërisht realitetin e qytetit të Drinasit ku po ndërtohej një vepër e rëndësishme hidro-energjitike, drejtues teknik i së cilës ishte inxhinieri Anton Hila (ashtu si edhe peisazhin mahnitës të fshatit ku ai ka ndërtuar vilën e ku po kalonte vitet e fundit të jetës së tij). Duke perifrastuar autorin Prençi: “Ndonjëherë në jetë, një takim krejt i rastësishëm mund të shndërrohet në ngjarje të rëndësishme, në një pikë kthese të jetës tënde, e cila mund të ndryshojë gjithçka...”. Kështu ndodh edhe me

personazhet e këtij romani. Anja që ka ardhur për pushime në qytetin e vendlindjes së nënës së saj “brenda vetes, me instiktet e një princeshe pa oborr mbretëror, ndjente shpalljen e një sfide për princin e panjohur”. Ndërsa Antoni, ndonëse vetmitar i deklaruar, trajtohet në roman si “Mbreti në rretë”.

Nëse për Antonin, dështimi në dashurinë e parë kishte mbyllur shtigjet e një lidhje tjetër afatgjatë, tek Anja, dashuria me Mishelin, të cilit i kishte falur virgjërinë, i përkiste së kaluarës, që nuk duhej bërë pengesë për të ardhmen (Ajo që një ndjenjë e konsumuar dhe e “arkivuar” në muzeun e harresës), për Antonin, ajo erdhi krejt rastësisht si krijesë e magjishme e zbritur nga qielli, enkas për një vetmitar si ai... Pikërisht, Ai që e kishte konsideruar martesën si burgun shpirtëror që kishte krijuar me vullnetin e vet njerëzimi përmes normave, parimeve, moralit, institucioneve, feve deri dhe tek gjykatat...me Anjën “ra brenda”, si i thonë. Dhe në këtë rast, autori fantazon aq bukur saqë sipas tij: “Po të kishte patur rastin Klinton të njihnte bukurinë franko-shqiptare, të ngjizur aq magjishëm tek Anja, ai me siguri do të kishte dhënë dorëheqjen nga posti i lartë, duke divorcuar edhe vetë Hilarin, për t’u martuar me Anjën”... Dhe s’kish si të ndodhte ndryshe, kur autori Prençi na paraqet në portretin e Anjës vajzën ku ishin bërë bashkë të gjitha: intelijenca, pasioni, bukuria dhe sinqeriteti.

Ndërsa Anja kërkonte pak Paris në Drinas..., për Antonin, tashmë në mesin e malit të moshës, (që për më optimistët konsiderohet moshë 50-vjeçare), ndërmarria e një lidhje serioze dhe afatgjatë me një femër, duket si një ftesë për ecje alpine....

Kësisoj, Ahmet Prençi me romanin e tij na afron shumë pranë me personazhet. Ai i përgatit ato për një ngjarje të madhe dhe, sa më pranë saj janë ato, aq më i rreptë është sprovimi i tyre dhe më dramatik përcaktimi. Gjatë atij përjetimi magjik gjatë pesë ditëve në Drinas dhe në plazhin e qytetit bregdetar i ishte shprehur vajzës franko-shqiptare



se: “Ti je një krijesë e magjishme Anja! Të dërgoi Zoti tek unë për të më thënë se unë jetoj, se mund të dashuroj përsëri. Ti më binde se jam në gjendje të dua përsëri...”. Por, largimi i saj për në Francë, pa i thënë “lamtumirë”, do të ishte, siç e shtjellon më tej autori: “Një dashuri me ‘nekrologji’ të parashkruar”. Teksa syrin e brendshëm të mendjes e qarkullonte heraherës në pyllin

e kujtimeve, përfytyrimeve dhe vizioneve për të nesërmen, Anja ia kishte trazuar Antonit psikikën duke prishur krejt ritmin e përditshmërisë së tij...

LETROT E ANJËS, RISI NË PROZËN E AHMET PRENÇIT

Mesazhin e ripërtëritjes së jetës autori Ahmet Prençi e përcjell aq bukur nëpërmjet letrave të Anjës, që vijnë në sintezë me dashurinë e saj të zjarrtë për Anton Hilën. Janë letra që përshkruajnë ndjesinë dhe përbetimin e saj për të rritur e vetme trashëgimtarin e ngjizur në Shqipëri, të pagëzuar me emrin Arbër. Pa patur pranë atë që e konsideronte “vetmitarin e përjetshëm”, që e dashuroi dhe e dashuronte marrëzisht. Dhe në këtë kontekst autori shtjellon mjeshtërisht filozofinë e tij se “Gjithë dramat e kanë në gjenezën e vet dashurinë e verbër”. Siç del në këtë roman befasues, “pa Anjën, inxhinieri Anton Hila, ishte uji apo vepra e betontë...Për aq ditë sa ndenjën bashkë, ajo paskësh kaluar nëpër të, nëpër këtë turbinë njerëzore, si një lëng magjik jete, si një erë me oksigjen përtëritës. Kështu, Ahmet Prençi, si një arkitekt i vërtetë ligjërimesh të këndshme, ndërthur dy linjat që të çojnë tek

një roman shumë i arrirë dhe mjaft tërheqës për lexuesin. Nëpërmjet një procesi të gjatë e të nderlikuar krijues, ai dëshmon aftësinë për të treguar realitete të perceptuara dhe përjetime si realizim artistik në romanin “ANJA”.

RESPEKTI PËR KOHËN, ËSHTË RESPEKT PËR VETEN

Një mesazh tjetër që përcillet në romanin “Anja” është respekti për kohën si respekt për jetën. Për këtë mjafton të perifrazojmë sërish autorin Prençi në rrëfimin e lumturisë pa kufi që përjetuan dy personazhet kryesorë. “Anja gjykoi se vlerën e kohës e japin veprat dhe jo minutat. Me një grusht kohë (aq ishin ditët e marrëdhënies me Antonin) ajo u mbush plot energji dhe pozitivitet, lumturi dhe kënaqësi...Epo, kot nuk paskan thënë, se çfarë sjell minuti nuk e sjell ora. Për herë të parë në Shqipëri ajo kishte provuar dashurinë rrufe, siç ndodh gati në çdo restorant të Nju Jorkut, ku me shikimin e parë zgjedh partneren që të pëlqen, shijon një pije të shpejtë, dhe po aq shpejtë mund të përfundosh duke bërë seks, në kthinat e errta të restorantit, apo në rastet më komode edhe në hotele...E pastaj, secili me vrap në punën e vet, pa ia mësuar as emrin njëri-tjetrit”. Në rrëfimin e këtyre ngjarjeve autori i trajton kohën dhe gjeografinë si dy armiqtë të dashurisë..... Ndërsa aktin e saj final, rritjen pa praninë e Antonit të djalit të tyre me emrin Arbër, autori e lidh aq bukur me faktin që “Në adoleshencën e saj, Anjës ia kishte zgjuar krenarinë për ‘gjenin shqiptar’, një shkrimtar nga Shqipëria, Ismail Kadare...”.

INSTITUCIONI I KULLËS

Një gjetje mjaft interesante e autorit është origjina e personazhit kryesor, nga fshati me emrin Saukull. Ndonëse



kishte lindur, ishte rritur e shkolluar në kryeqytet (si edhe jashtë vendit), Anton Hila ishte i dhënë edhe pas originës. Vetëm një herë në moshën 20-vjeçare ai kishte qenë në këtë fshat, nga “kishte mësuar sa rëndësi ka fjala e dhënë, sa domethënëse janë marrëdhëniet mes vëllezërve në familjen tradicionale, kishte fiksuar (memorizuar) mirë gjërat më të shenjta të të parëve tanë: fjalën e dhënë, nderin, besën, mikpritjen, mirënjohjen, besimin, punën, sakrificën, vetëpërmbytjen, ekuilibrin, respektin etj”. Si njohës gjer në perfeksion i historisë dhe traditës, autori Prenci e paraqet

kullën si simbolin që nuk kishte qenë thjeshtë një vend strehimi apo banimi, por një institucion unik etno-kulturor, një ngrehinë shpirtërore dhe një tempull besimi dhe lirie...

Nisur nga bagazhi jetësor, por veçanërisht në ligjërimin filozofik, autori, sjell një roman që hyn me dinjitet në fondin e artë të letërsisë shqipe. Ligjërime të tilla si: “Spërkatja e themeleve me gjak glorifikonte simbolikën e sakrificës njerëzore për shpirtin hyjnor”, apo se “Kullat ishin parzmoret e gurta të fshatit përballë lufrave qindravjeçare” dëshmojnë për një autor që njeh mirë historinë dhe traditën e vendlindjes së tij. Këto i gjejmë qoftë dhe në përshkrimin e institucionit të “Odës” ku: “...nuk lejoheshin kurrësesi fjalët në vesh ose biseda të ngushta që nuk i dëgjonin të gjithë burrat e pranishëm në dhomë. Flitej me radhë dhe dëgjoheshin të gjithë...” Po ashtu, autori na e paraqet personazhin kryesor, si studjues të vëmendshëm të veprës së At Shtjefën Gjeçovit, i cili përmbledh të gjitha normat e sjelljes në Kanunin që

mban emrin “Kanuni i Lek Dukagjinit”, ku janë të sistemuara një seri dokesh, ligjesh e rregullash të Veriut. Ndërkohë, në kontrast me institucionin e kullës në Malësi, në romanin “Anja” gjejmë arkitekturën e shtëpive në Jug, shtëpi me çati, të tilla që rronin shumë dhe nuk i rrezikonin as rrebeshet e ujit të vjeshtës, as pesha e borës së dimrit, apo e rrasave të gurit.

INTELEKTUALI I VIRTYTSHËM QË NUK PAJTOHET ME TË KEQEN

Në një tjetër këndvështrim, autori Prençi na e paraqet heroin e veprës së tij, si intelektualin e virtytshëm që s’pajtohet me të keqen. Këtë e gjejmë në rastet kur “Antoni kritikonte pa rezerva nisma e qëndrime të të gjitha palëve, që sipas tij ishin populiste dhe jo efektive për shoqërinë...” Me një frazeologji interesante, në ekzaminimin perfekt që iu bën qeveritarëve të korruptuar, ai sjell krahasime me vende me demokraci të zhvilluar, ku kurrësesi nuk mund të depërtojnë në instanca qeverisëse njerëz me të shkuar kriminale. Kjo sipas tij edhe për faktin se “Amerika që është shkalla më e përparuar e lirisë dhe njeriut të lirë, bën kujdes që, para se të zgjedhë Presidentin e vet, kontrollon dhe e bën publike çertifikatën shëndetësore të kandidatëve. Jo si në Shqipëri, që një i çmendur mund të bëhet kryeministër, president, deputet etj...”. Po në këtë optikë e trajton autori zhvillimin e ngjarjeve kriminale që ndodhin në vendin tonë, si dhe këndvështrimin e tij për dinjitetin njerëzor, të shprehura këto mjaft bukur në profilin e shokut të fëmijërisë, prokuror Sandrit, i cili nuk nguron t’i tregojë ligjin edhe ish-prokurorit të përgjithshëm (Alfons Gurrës), të akuzuar për lidhjen e tij me persona të inkriminar, nga të cilët kishte përfituar shuma marramendëse. Plagët e rënda sociale, shtjellohen mjaft artistikisht qoftë dhe vetëm në rrëfimin e Vasilikës, pas krimit makabër të Janit që vret bashkëshorten, grekun dhe vetveten. Autori i jep kështu koherencë veprës

së tij edhe në përshkrimin e marrëdhënieve me shërbyesen e tij, Vasilikën, në shtëpinë ku ishte vendosur përkohësisht në Drinas. Një grua kjo, që ndonëse i ishte përkushtuar familjes, që kishte shërbyer si veterinerë e lartë, kishte përfunduar e braktisur nga djemtë, pas divorcit me të shoqin që e la atë për një vajzë të re. Nëpërmjet Vasilikës ai rrëfen edhe rastin e bashkëshortëve Jani e Margarita në kërkimin domosdoshmërisht të trashëgimitarit që s'po e ngjiznin edhe pas shumë vitesh martesë. Dhe kur Margarita, për të realizuar këtë ëndërr të Janit, tenton një skenë seksi të fshehtë me tregtarin grek, vjen edhe rasti fatal: krimi makabër që kryen Jani duke i vrarë ata të dy si dhe vetveten.

Po në këndvështrimin e ripërtëritjes së jetës gjejmë në roman edhe rrëfimin brilant të rastit të prokuror Sandrit, i cili ndonëse vuante mosngjizjen e një fëmije me bashkëshorten e tij, në adoleshencë kishte lënë shtatzënë bashkëshorten e operativit të sigurimit, e cila e kishte joshur atë në shtëpinë e saj, brenda krevatit bashkëshortor. Janë këto trille magjepsëse që e bëjnë mjaft tërheqës romanin e Ahmet Prençit. Kjo del qoftë dhe në qasjen e autorit për rastet kur: “Jani që vrau Margaritën, por dhe shoku i tij Prokuror Sandri, ishin verbuar nga instituti i trashëgimit dhe i ripërtëritjes gjenetike, që është misioni i çdo çifti dhe finalja e çdo ndërveprimi seksual”.

DILEMA: BURRI APO GRUAJA?!

“ANJA” është ndoshta romani i parë ku Ahmet Prençi ngre në prozë akuzën ndaj Vatikanit, si dhe ndaj klerikëve të mëdhenj, për poshtrimin që i bëjnë femrës. Kanë peshë të rëndë pikëpytjet e tij: Pse nuk doli njëherë tym nga Vatikani që të njoftojë zgjedhjen e një Pape femër?!... Apo, pse nuk pati një imam grua?!... Autori, nëpërmjet fjalës artistike shpjegon se si, “matriarkati kishte vdekur shekuj më parë, ndaj fuqia e burrave shfaqej kudo: në politikë, fe, ushtri”.

Po pse feja?!, -shtron pyetjen autori.

Pse ky poltron ku ulet Zoti dhe mirësia nuk i kishte dhënë femrës atë që meritonte.

Pse kurrë në historinë e Vatikanit nuk u pa një grua përkrah klerikëve me uniformën e zezë?

Pse Vatikani nuk kishte diku në listë një grua në krye!.. Ata peshkopë, ata njerëz me fytyra gipsi që vetëm dinë të shqiptojnë bukur fjalën “Amen”, kurrë nuk menduan se janë aq të barabartë sa murgeshat e shumta që kishin në krah...

Dhe po aq tronditës konkluzioni i autorit se: “Jo vetëm kaq, por edhe shenjtërimin e Nënë Terezës, ata burra me rraso të zezë e bënë pas vdekjes, kur ajo meritonte të shpallej së gjalli shenjtore e mirësisë e paqes njerëzore...”. Edhe në botën myslimane, e njëjta gjë.

Pse asnjëherë në botën islame, imam, nuk ka arritur të jetë një femër?! Në këtë mënyrë, si askush tjetër, Ahmet Prençi guxon t'i konsiderojë teoritë fetare si “limonata” për mendjet e dobëta... Konceptet filozofike të Ahmet Prençit për vazhdimësinë e jetës, për familjen dhe shtetin e së drejtës, të shprehura aq qartë në romanin “Anja”, e bëjnë këtë një vepër letrare që sjell risi në prozën e sotme shqipe.

Ky roman, ndër më të shiturit në libraritë e Tiranës mbart ekspertizën e redaktorit Shefqet Meko e të kritikut të mirënjohur letrar, Behar Gjoka.

<http://www.panorama.com.al/anja-i-jep-ahmet-prencit-cmimin-e-karrieres-gjergj-fishta/>

© Panorama.al-Oct 26, 2021

<https://www.koha.net/kulture/234186/per-romanin-anja-te-ahmet-prencit/>

<https://zanimalsise.com/dashuria-njerezore-dhe-plaget-sociale-ne-romanin-anja-te-ahmet-prencit/>

“SAGA PËRTEJ ATLANTIKUT”, NJË RRËFIM NDRYSHE

*Realitete shqiptaro-amerikane
në romanin e Shefqet Mekos*

Gazeta “Panorama”, Nov 10, 2021



Autori Shefqet Meko, mbas një akumulimi prej dekadash, duket sikur e parashkruan suksesin e romanit të tij të sapobotuar “Saga përtej Atlantikut”. Mjafton të perifrashosh këtë fragment nga faja 244 e këtij romani: “Xhelo e kishte projektuar tashmë librin në kokë, ku përplaseshin shumë rryma, ku kishte kaluar jeta e tij, nga ajo në socializmin e kontrolluar nga lart, ku një gotë raki, pak djathë e dy qepujka të bënin të ndiheshë sikur zotëroje fushën e Devollit, e deri në pangopësinë që shfaq njeriu në kapitalizëm, ku fitimi nuk ka kufi dhe mbetet i vetmi motiv i jetës.... ‘Ky libër do të tronditë botën, por do Zoti jetoj aq gjatë,-thoshte me vete Xhelo Lakrori”.

Po. Me këtë roman pothuajse meditativ (ku vend të dukshëm zë edhe retrospektiva), që ekzaminon saktë e bukur

shoqërinë e dikurshme shqiptare të kohës së socializmit, me të mirat e të këqijat e saj dhe veçanërisht pangopësinë e njeriut në kapitalizëm, të botuar vetëm para dy muajsh dhe të promovuar bujshëm nga botuesi M&B në praninë e dhjetëra personalitete të botës akademike e diplomatike (si prof. Hulusi Hako, Besnik Mustafaj, Arben Çejku, Ahmet Prençi, gazetarë dhe dashamirës të librit) Sh. Meko duket se synon të ketë zërin e vet të veçantë në botën letrare të metropolit shqiptar. Dhe pse jo, edhe në Korçë e Pogradec që është vendlindja e tij, në Shkodër, Vlorë e me disa personalitete të hapësirës mbarëshqiptare në botë, ku ka pasur takime e ka marrë vlerësime mjaft pozitive. Ai i vjen sofrës krijuese shqiptare mbas dekadash përvoja jete dhe eksperience, që shtrihen në dy shekuj, dy vende, dy sisteme dhe kontinente të ndryshme.

Po, shqiptaro-amerikani Xhelo Lakrori që është personazhi kryesor i këtij romani, pasi ka përjetuar suksesin e dëshiruar në tokën e premtuar, më në fund e shkroi librin, me të cilin dëshiron të “tronditë” botën. Kështu pohon autori në gojën e personazhit kryesor të romanit ”Saga përtej Atlantikut”, por në të vërtetë Sh. Meko e ka kaluar sprovën e një autori të suksesshëm edhe me botimin e tre librave të mëparshëm: “Çuditë e Amerikës” (përkthim, shtëpia botuese “Albpaper”, 2008), “Unë ikanaku shqiptar” (Përmbledhje publicistike, shtëpia botuese “Albpaper”, 2011) dhe “I tillë jam” (tregime, skica dhe shënime, shtëpia botuese “Dita Print”, 2019), si dhe me dhjetëra tregimeve mjaft tërheqës për lexuesin të botuar në portalet ”Alb-spirit” e “Fjala e lirë”

Gjithsesi, në prozën e gjatë, ai duket se ka qëlluar në shenjë që me romanin e parë. “Saga përtej atlantikut” është një roman që ndërthur aq këndshëm realitete shqiptaro-amerikane, si intrigë letrare e përjetimeve të personazheve kryesorë, bashkëshortëve Xhelo e Shano Lakrori, të cilët i vendos në dy kohë: kur eksperimentonin të ashtuquajturin “revolucionin

tekniko shkencor” në vendlindjen e tyre, Devollin dhe në Amerikën e mrekullive, ku me punë të ndershme arritën të ndërtojnë biznesin e tyre të suksesshëm. Profili i tyre i skalitur me mjeshtëri të rrallë, me gjuhë të pasur e mjete shprehëse mbresëlënëse gërshetohet aq bukur me filozofimet e autorit për “dogmat katolike që ishin si tela me gjemba ndaj lirisë së individit” dhe “kur besimet fetare përzihen me rrymat politike, duke krijuar përplasje të frikshme dhe të rrezikshme”. Dhe si njohës e perceptues perfekt i realiteteve shqiptaro-amerikane, pasi përshkruan ngjarje e personazhe nga të dyja vendet, të dy kohëve e të profileve të ndryshme, s’ka se si të mos arrijë në përfundimin se “Në fund të fund të fundit, të kërkosh dhe të besosh në ndihmën e Zotit është një kthim te vetvetja. Zoti ka deleguar çdo krijesë të jetë zot i punëve të tij”. (fq.219).

Po. Shefqet Meko që ka përjetuar dhimbshëm edhe kohën kur në Shqipëri diktatura na imponoi deri edhe mohimin e Zotit (pas barbarisë me shembjen e objekteve të kultit”, në romanin e tij “Saga përtej Atlantikut” ua dedikon suksesin biznesmenëve të suksesshëm në Amerikë, në radhë të parë besimit të tyre në Zot.

Këtë ligjërim letrar të tij e ndeshim edhe në rastin kur personazhi kryesor i romanit shpreh besim të patundur në fitoren e mandatit të dytë të ish-Presidentit Tramp, ndërkohë që një kliente e klinikës së tij veterinare do të linte mesazhin më interesant për macen e saj: “Macja ime shkon të bëjë shurrën sa herë fillon kronika e fushatës për President. Deri tani e kam filmuar 55 herë, por saktësisht, sa thuhet ‘fushata për Shtëpinë e Bardhë, direkt dhe te banja’!

Kjo është njëra pamje e subjektit të këtij romani, sepse Sh. Meko, ndoshta si askush tjetër, ngre në pedestal inteligjencën dhe krenarinë shqiptare, të dëshmuar me suksesin e mijëra djemve e vajzave tona edhe në SHBA. Do të mjaftonte për këtë qoftë edhe krenaria që shpreh personazhi kryesor i

romanit të tij, kur ndërsa fermeri Xhon River i pohon se është nga vendlindja e Linkolnit, Xhelo Lakrori shpreh krenarinë e tij si bashkëkombës me Nënë Terezën dhe Ismail Kadarenë (fq.86-87). Dhe po nën këtë optikë ai perifrizon poliglotin dhe eruditin e madh shqiptar, prof. Eshref Ymerin (që sipas tij është “enciklopedi që ec më këmbë), se: “Hiperbolizimi i bujarisë dhe mikpritjes shqiptare ishte varri që ai komb i kishte hapur vetvetes në shekuj”. Lidhur ngushtë me dhjetëra raste të miqësisë që kishte krijuar me amerikanë në Mineapolis, SHBA, ku ka ngritur biznesin dhe jetën e tij, Meko perifrizon sërish studiuesin e njohur shqiptaro-amerikan, që i ka dhënë aq shumë kulturës së popullit më të tkurrur të Ballkanit, se “miku ka vendin e vet të respektuar, por i zoti i shtëpisë është zot shtëpie”.

Ndonëse e konsideron Amerikën kontinentin ku nuk mungon asgjë për atë që ka dollarë, Meko nuk ngurron të shprehetse “Luftapërdollarin në Amerikë është aq e çuditshme, sa që nuk ka imagjinatë përshkruese” dhe se “Pangopësia njerëzore për para nuk njih as parti dhe as ideologji”. Dhe po ashtu, si njohës perfekt i mediave, në romanin e tij ai është denoncues edhe për falsitetin e mediave të mëdha dhe për ata që (si në Amerikë edhe këtu në Shqipëri) bien viktimë e buldozerëve mediatikë... Kësisoj, Meko e mban pezull lexuesin duke ia servirur shqiptaro-amerikanin me emrin Xhelo Lakrori (doktor Lakrori) si rezultante e mutacionit shoqëror e politik të Shqipërisë postkomuniste. “Ai ishte një hero e viktimë që kujtonte, dëshmonte, ballafaqonte fakte, politika momente të jetuara, ëndrra, zhgënjime e shpresa të bukura. Xhelo Lakrori ishte diçka krejt ndryshe, përditë kërkonte të gjente të vërtetat e jetës, kërkonte të gjente se ku ngjasonte dhe ku ishte i ndryshëm socializmi nga shoqëria e lirë kapitaliste, çfarë i bënte të mëdhenj dhe të lavdishëm udhëheqësit në kapitalizëm dhe cili ishte çelësi mashtrues në socializëm... Me ato vëzhgime të kujdesshme që kishte

mundur të bënte Xhelo Lakrori, ai mbetej i tronditur nga fakti se shoqëria shqiptare përherë, në çdo kohë, në çdo regjim kishte mbetur viktimë e burrave pa burrëri”.

Me këtë sy e sheh e vlerëson ai edhe bashkëshorten e tij, Shanon, që ndonëse kur sapo kishte rënë në dashuri me të, ajo i kishte thënë disa herë “më urre” (nisur nga drama e saj me ish-të dashurin e parë, Ben Kapshtica, që e detyroi të abortonte për të mbetur kështu tërë jetën një grua s’do të lindte kurrë fëmijë) ai e dashuroi marrëzisht gjatë gjithë marrëdhënies bashkëshortore, si në Devollin shqiptar dhe në Çikago, SHBA, duke e konsideruar një esencë bukurie dhe frymëzimi që nuk zbehej aspak.

Po nën këtë optikë dallohet lehtë trilli artistik në romanin e Sh. Mekos edhe në marrëdhënien me Anna Parrotin, kur u magjeps pas bukurisë së saj, ndërsa më pas sikur u zbraps kur kujtoi Shanon që dikur i kishte thënë se “...burrat lajthitin kollaj pas bukurisë femërore dhe jo më kot këto të fundit mund të tallen edhe me burrin më të zgjuar”. Gjithkush do të çuditej me përshkrimin brilant nga autori të Anës në rolin e nënës surrugato, e cila e paguar mirë do të lindte fëmijën e çiftit miliarder Miller (që të marrosur pas fitimit u bënë aventurierë e njëherazi viktima të tij).

Si askush tjetër, Sh. Meko filozofon edhe “për psikologjinë ndërvepruese mes kafshëve të vogla dhe njeriut, duke bërë aludimin për ndërlidhjen më gjigande të dy botëve të gjalla, ku njeriu zotëron tërë arsenalin e mundshëm komunikues dhe shprehës, ndërsa qeni dhe macja, në sajë të kufizimeve shprehëse, e mbajnë gjithçka nga brenda dhe shpesh reagojnë me pasione të jashtëzakonshme, që duket në sy dhe veprime ekspresive”. Kjo qasje trilluese e këtij autori e vë në mendime lexuesin kur ai shprehet artistikisht edhe për lajmin e mirë se “qeni i dyshuar me Covid-19 rezultoi negativ”, për të sjellë më pas të dhëna të verifikuara se “qeni dhe macja janë si radarë, ata lexojnë në avancë gjendjen psikologjike të pronarëve

të tyre”, duke besuar kësisoj se shekulli i 21-të do të ishte shekulli i zbulimeve të mëdha në ato “lidhje diplomatike mes njeriut dhe botës tjetër të gjallë” (fq.208-209). Këtë intrigë interesante e gjejmë edhe në letrën imagjinare të gjarpërinjve për njeriun, pasi shqiptaro-amerikani me profesionin e mjekut veterinar kishte arritur të shëronte deri edhe gjarprin johelmues që Anna Parroti e përdorte për t’i bërë masazh barkut që mbante brenda fëmijën e çiftit Millerr. Ai, gjatë një interviste për televizionin lokal që do të bënte jehonë të jashtëzakonshme, si një Tramp i papërmbajtshëm dhe si një pushtues paqësor i kamerave, tha: “Unë kam një mesazh të thellë për të gjithë ata që kanë dashuri për kafshët shtëpiake: duajini dhe respektojini si veten tuaj. Qeni, macja, papagalli, pëllumbat, zogjtë, breshkat, hamsterat, peshqit, kërmijtë etj., janë një përthyerje e shpirtit tonë në një botë gjallesash, që më shumë se me fjalë flasin me sy, mjaullima, lehje, shikime dhe cicërima të bukura... Përfytyroni një përqaftim gjarpri përreth trupit tuaj, një gjarpër që nuk kafshon, nuk helmon, nuk të vdes, por me atë ftohtësi zvarranikësh, pushton trupin tuaj, ju përmbledh brinjë më brinjë si asnjë krijesë tjetër, dhe me atë gjuhë si shigjetë ju puth dhe nuk ju rrezikon...”. A nuk është kjo një intervistë e sajuar bukur (prej gazetari profesionist), duke folur për madhështinë e botës së kafshëve e shpendëve (duke shkundur mendjet e njerëzve kafshëdashës) që e vë autorin e këtij romani në fokusin e një filozofi?! Po. Është pothuajse ashtu siç pohon tërbimin e Enver Hoxhës kur i patën raportuar se miku i vetëm i Lasgush Poradecit ishte një kone e vogël!!! Nën këtë vështrim, autori sjell në vëmendjen e lexuesit edhe poezinë që dikur i kishte lexuar miku i tij Bilal Eshka: ”Lindim hardhuca, pjellim hardhuca/ E zvarrë-zvarrë mbi çdo gjë”. ...Por gjithsesi, në dekadat e jetës së tij në Amerikë, ai shpesh e perifrizonte ndryshe këtë ‘perlë në vargje’ të Bilal Eshkës: ”Lindim kongresmenë, pjellim senatorë/ zvarrë-zvarrë ndaj atij që ka pushtetin në

dorë!” A nuk janë edhe këto vargje, shëmbëlltyrë e realiteteve shqiptaro-amerikane, në koherencë me të sotmen e pashpresë për shumicën e njerëzimit?! Po. Romani i Sh. Mekos ka plot episode që reflektojnë këto realitete, shpesh të ngjashme dhe krejt të ndryshme. Heroi kryesor i romanit, i lodhur dhe zhgënjyer nga premtimet e krahut të majtë, përpigjet të lëvizë djathtas, duke deklaruar votën e vet për një term të dytë të Presidentit Tramp, por që zhgënjehet sërish qysh ditën e votimit kur sheh etjen për pushtet të njeriut më të fuqishëm në pushtet.

Romani i parë i Shefqet Mekos është një arkitekturë krijuese, është fantazi dhe realitet i ballëpërballë, një depërtim psikologjik dhe filozofik në botën e komuniteteve të emigrantëve që shkojnë me shpresa të mëdha por shpejt kuptojnë se Amerikë është liri, por për ta shijuar duhet punë, ku sistemi është sofistikuar dhe nuk mbijeton nëse bën “sikur punon”. Autori ndërthur me mjeshtëri ngjarjet dhe karakteret shqiptare në Amerikë, duke provuar edhe aksiomën popullore “yti mishin ta ha, por kockën ta ruan”.

Shefqet Meko me këtë roman di të hyznizojë mirënjohjen si një pishtar që ndrit rrugën e atyre që dinë ta manifestojnë. (Nata në burg e Xhelo Lakrorit dhe letra falënderuese e shefit të policisë që e përcjell në shtëpi me limuzinën e kunatit...)

Në një këndvështrim të vëmendshëm, “Saga përtej Atlantikut” është një rrëfim ndryshe i jetës së shqiptaro-amerikanëve në kontinentin e madh të lirisë, që shkojnë aty dhe guxojnë, mësojnë, përshtaten, bëhen promotorë të asaj që besojnë dhe krijojnë profilet e karakteret. Romani në fjalë, është saga e njeriut të lirë, por i ndëshkueshëm nga prangat e policit edhe kur ai pa dashje shkel rregullat e qarkullimit rrugor, nga taksat që duhet të paguajë në kohën e duhur për çdo shërbim e punë që bën... si dhe nga kakofonia që të shkakton mashtrimi mediatic dhe mbi të gjitha, jeta si një aventurë e verbër, që të premtën dritën dhe lumturinë...

Shefqet Meko është një nga zërat më të njohur të Radio Tiranës në mesin e viteve '90, gazetar dhe publicisti i mirënjohur i problemeve bujqësore.

Të lexosh romanin e parë të këtij autori, “Saga përtej Atlantikut” bën një “shëtitje letrare” transatlantike që të shijon dhe sikur kërkon të mos mbarojë, sepse është shkruar me një realizëm “social-imperialist”...

<http://www.panorama.com.al/saga-pertej-atlantikut-nje.../>

“5 SKENARË...” TË BUJAR KAPEXHIUT

Libër i llojit e stilit të veçantë në ndihmë të atyre që duan të shkruajnë skenarë të filmave artistikë

Gazeta “Panorama”, Mar 2, 2021



Nga pesë skenarët që Kapexhiu ka përmbledhur në këtë libër të llojit e stilit të veçantë, dy komeditë “Edhe kështu edhe ashtu” (1989) dhe “Dy herë mat” (1986) janë bërë filma, ndërsa tre të tjerët ai i vë në dispozicion të krijuesve që kanë dëshirën, pasionin, shijen dhe aftësinë për krijimet e artit komik

Libri “5 skenarë”, i Prof. Bujar Kapexhiu, erdhi si dhurata më e mirë e fillimvitit 2021 për lexuesin e veçanërisht për autorët e rinj të veprave letrare. Një libër nëpërmjet të cilit autori Kapexhiu, ikonë e artit dhe kulturës kombëtare, u dhuron bujarisht krijuesve të rinj përvojën e tij të suksesshme në shkrimin e skenarëve të filmave artistik.

Botimi i skenarëve letrarë të filmave artistik është një përvojë botërore. Tek ne kjo praktikë ka munguar. Skenari

letrar i filmit artistik është një krijimtari e mirëfilltë letrare, plotëson me dinjitet artistik punën krijuese të autorit dhe, së fundi, justifikon një angazhim dashamirës të çdo lexuesi. Ky libër i Mjeshtrit Kapexhiu, përmban skenarët dhe platformat regjisoriale të filmave “Dy herë mat” (kinokomedi), “Edhe kështu, edhe ashtu” (kinokomedi muzikore), “Bixhoz me dekorata” (kinokomedi), “Mozaiku” (kinokomedi) dhe “Pipiruku këngëtar” (skenar për film artistik për fëmijë), të shkruara me mjeshtëri gjuhësore e mjaft të arrirë artistikisht.

Duke na dhënë me detaje elementet e platformës regjisoriale, për shembull te kinokomedia “Dy herë mat”, si ideja, konflikti, kompozicioni, trajtimi figurativ etj., te loja e aktorëve do të mësojmë se si e bën Mjeshtri Kapexhiu pantelikën e tyre, si të Ilo Pincit, Sazanit, Kopit, Cukut, Rudinës, Besës, Takut, gruas së Kopit (si dhe të grupit të shahistëve), për lexuesin e sidomos për shkrimtarët që mund të pretendojnë t’i shndërrojnë në skenarë filmi romanet apo novelat e tyre, rëndësi ka stili i përdoruar nga Kapexhiu në përshkrimin e ngjarjeve.

Sot formatimi strukturor i skenarit të filmit ka ndryshuar, por Kapexhiu ruan atë formë me nuanca më të dukshme letrare, siç është shkruar skenari i filmit artistik në ato vite.

Duket si një tregim i gjatë apo novelë, ku shtjellohet subjekti me të gjitha nuancat e përshkrimit të mjedisit, të veprimit dhe dialogut të personazheve. Kjo, thotë Kapexhiu, “për të ruajtur dhe si dokumentacion autentik formën dhe stilin e të shkruarit të skenarit. Quhet skenar letrar, por të jemi të sinqertë e objektivë që nuancat letrare në skenarin e filmit janë të kursyera, sepse aty ka rëndësi, veprimi, aksioni, filli i subjektit dhe dialogu. Ekspresioni, psikologjia, meditimi i personazheve mbetet si detyrë e aktorëve në sheshin e xhirimit nën drejtimin e regjisorit dhe kompozimit të figurës nga operatori. Filmi ‘Dy herë mat’ tashmë është parë nga mijëra spektatorë në kinema dhe në ekranin e televizorit dhe

Padyshim nuk është lehtë që edhe të interpretosh edhe të drejtosh. Gjithmonë duhet të kesh një sy tjetër që të shikon dhe të korrigjon. Por kam bashkëpunuar shumë me operatorin Lionel Konomi, i cili më ka ndihmuar në këtë drejtim dhe ka qenë ai që ka bërë syrin korrigjues gjatë filmit.”

KOHERENCA TE “BIXHOZ ME DEKORATA”

Mjaft tërheqës është skenari i kinokomedisë “Bixhoz me dekorata”, përfshirë në librin voluminoz me 544 faqe të Bujar Kapexhiut. Ndonëse titulli mjaft sinjifikativ është në koherencë edhe me realitetin e sotëm të shoqërisë shqiptare, në parashkrimin që i bën skenarit të kësaj kinokomedie autori na njuh me kontradiktën themelore në këtë subjekt, që është përballja e dy koncepteve për moralin: “Ajo e gjeneralit Taho dhe e nipit, i cili me lirinë e të shprehurit që erdhi me vendosjen e demokracisë, merret me një biznes mjaft fitimprurës, me botimin dhe shpërndarjen e një reviste me përmbajtje erotike”. Me mjeshtëri të rrallë autori vë përballë dy personazhe me karakteristika të veçanta e shumë larg nga njëri-tjetri, për sa i përket konceptit se çështë e moralshme e ç’nuk është e tillë.

Linja tjetër që e bën më tërheqës subjektin dhe i jep karakterin komik ngjarjes është linja e kapterit Xhemal, që shkurt e thërrasin Xhemo dhe kur, me miqësinë e ministrit, rritet në përgjegjësi, në takimet me ushtarakët e NATO-s e thërrasin Xhejms. Dy komshinj, gjenerali Taho, që me të padrejtë, sipas reformës, e nxjerrin në pension të parakohshëm dhe kapteri Xhemo që rritet në përgjegjësi, paralelisht kalojnë në situata gazmore që ndërthuren me njëra-tjetrën duke zbuluar situata komike me të papriturat dhe batutat e zgjedhura humoristike.

Për sa i përket anës kompozicionale, Kapexhiu i vendos ngjarjet në mjedise të tilla si: Shtëpia e gjeneralit (dhoma e

gjumit, dhoma e ndenjes, kuzhina, anekse etj.); Hyrja para pallatit, Sheshi i pallatit, Sheshpushim midis apartamenteve, Repart rrobaqepësie, në Librari, Dyqan tapetesh, Shtëpia e kapter Xhemos etj.; mjedise këto ku zhvillohen dialogë tërheqës mes personazheve Sofika, Riku, Yllka, Taho, Piku, Ariani, Qefseri, Viola etj.

Këtu skenaristi përcakton qartë mesazhin dhe qëndrimin ideoemocional që do të jetë i mjaftueshëm vetëm me interpretimin elegant, original e gazmor të aktorëve, si dhe trajtimin regjisorial për gjithçka, ku duhet dora e vëmendja e tij, pa neglizhuar këtu edhe fotografinë dhe këndin e dinamikën e kameras. Këto elemente i gjejmë edhe në skenarët e kinokomedisë muzikore “Edhe kështu, edhe ashtu”, të kinokomedisë “Mozaiku”, si dhe në skenarin për film artistik për fëmijë “Pipiruku këngëtar”, ky i fundit diçka e re, e porealizuar më parë në artin kinematografik tek ne.

“Pipiruku këngëtar” në dukje ngjan film për fëmijë, por subjekti që shtjellohet në të ngjall interes edhe për spektatorin e rritur. Ky skenar ka një teknikë të kombinuar midis filmit me aktorë dhe filmit të animuar. Pra, figura reale e aktorit është përballë figurave të vizatuara. Personazhi i filmit të animuar, Pipiruku, tashmë i njohur me tre seritë e tij, ka dëshirë të bëhet këngëtar dhe me ndihmën e miqve të tij Bleta, Milingona dhe Zogu gushëkuq merr rrugën për të arritur në godinën e Televizionit që po përgatit festivalin e këngës. Dhe pasi kalon në situata të ndryshme plot humor realizon më në fund ëndrrën e tij, pjesëmarrjen në festival.

Botimi i këtyre pesë skenarëve vjen jo vetëm si dëshirë e autorit, për t’i botuar vetëm për vete, për t’i pasur në koleksionin e krijimtarisë letrare, por për të qenë edhe në duart e atyre personave pasionantë, fillestarë që kanë dëshirë të ndjekin rrugën e krijimit të skenarëve për film, siç e quajnë artin e shtatë. Kjo është përvojë dhe një kontribut për të ardhmen e artit kinematografik.

Nga pesë skenarët që Kapexhiu ka përmbledhur në këtë libër, dy komeditë “Edhe kështu edhe ashtu” (1989) dhe “Dy herë mat” (1986) janë bërë filma, ndërsa tre të tjerët ai i vë në dispozicion të krijuesve që kanë dëshirën, pasionin, shijen dhe aftësinë për krijimet e artit komik.

NJË PERSONALITET I ARTIT VIZUAL SHQIPTAR NË TË GJITHA KUPTIMET

Prof. Bujar Kapexhiu, i dekoruar nga Presidenti i Republikës me titujt më të lartë “Mjeshtër i Madh” dhe “Nderi i kombit”, është një personalitet i artit vizual shqiptar në të gjitha kuptimet.


Përmendim këtu filmat “Dy herë mat”, “Edhe kështu edhe ashtu”, “Stola në park”, “Tela për Violinë”, “Duel i heshtur” etj. Karikaturat e Kapexhiut e kanë shoqëruar gjithnjë aktualitetin dhe kanë kritikuar me zgjuarsi fenomenet e forta negative të jetës në Shqipëri.

Së fundmi, ai vjen me librin e tij më të ri “5 skenarë”, me të cilin përcjell përvojën e vet të vyer me filmin artistik, si skenarist dhe regjisor, karikaturist dhe aktor i mirënjohur shqiptar. Ky libër i Kapexhiut është si një “feste mbi sy” i këtij artisti me vlera shumëdimensionale krijuese dhe argëtuese, i cili perherë mbetet në sytë e publikut i ri dhe i qeshur, i dashur dhe i respektuar, i palodhur, këmbëngulës, energjik dhe befasues, që në dekadat e jetës se tij ka gdhendur dhe vetskalitur profilin unik me emrin: Bujar Kapexhiu.

<http://www.panorama.com.al/5-skenare-t-e-bujar-kapexhiut/>

PËR POETIN E KËNGËS, NAIM PLAKU

Katër dekada pas ndarjes nga jeta të autorit të poemës së famshme “Bagëti e Bujqësi”, lindi një tjetër poet i talentuar, me të njejtin emër. Jo në Frashër të Përmetit, por në Sllatinë të Dibrës.



“Data shënonte 14 nëntor 1940. I jati, Shemsiu ishte në punë e vonë, kur u kthye, e mori vesh se ishte shtuar me një djalë.... Emri Naim ishte emër i librave. Nxënësit e shkollave, ato që kishin pak klasë, e njihnin këtë emër. Ishte Naim Frashëri i Rilindjes sonë Kombëtare. Nxënësit e mësonion nëpër shkolla e të rriturit e kishin lexuar. Edhe në shkollën e Sllovës kishin mësuar e recituar poezitë e tij. Shemsiu pothuaj i kishte lexuar të gjitha poezitë e tij të botuara. Djalit që lindi këtë natë nëntori, ia lanë emrin naim. ‘E gëzofte! – u dëguan urimet nëpër kullën që ishte mësuar të priste e të përcillte miq të shumtë, të ftuar e rrugëtarë të ndryshëm...”

E nisëm me këtë perifrachim të autorit të librit “Dritëhijet e një poeti”, të shkrimtarit të njohur Shaqir Skarra, për të bërë

një analogji të dy Naimëve, poetë, që ngjasojnë shumë në jetët dhe veprat e tyre.

Nëse rilindasi i shquar rridhte nga dega e Dakollarëve ose e Dulellarëve e Familjes së shquar Frashëri, edhe Naim Plaku, ishte pinjoll i një fisi emërndritur në Sllatinë, nipi i “gjeneralit me shajak” Elez Isufi. Nëse Naim Frashëri u shqua për lirikën e tij patriotike me temë aktuale (vjershat “Gjuha shqipe”, “Korçës” 1887, etj.), u këndoi me pasion të rrallë mallit dhe bukurive të atdheut (“Bagëti e bujqësia”) dhe bëri thirrje të fuqishme për çlirimin e tij (krijime të ndryshme, “Dëshira e vërtetë e shqiptarëve”), në shekullin që lamë pas, vepra e Naim Plakut, është një testament fjale.

Dhe siç shprehet autori në monografinë “Dritëhijet e një poeti”, Naim Plaku, që e konsideronte poezinë si një “zanë mali, por kryeneçe”, me mjeshtri të rrallë e ledhatoji, e përkëdheli dhe pastaj u dashura pas saj. U dashurua me poezinë që në fëmijërinë e tij, kur qau për “dhinë pikaloshë që ia hëngri ujku” dhe për “mushkën, që ia hodhi ngarkesën të gjithën në tokë, ngaqë nuk e kishte ngarkuar mirë”. Janë këto detaje nga fëmijëria e një nxënësi që shkëlqente në të gjitha lëndët, në gjuhë e lexim, në aritmetikë e gjeometri, në histori e gjeografi, në kimi e biologji. Ngaqë mbante sy e vesh te shpjegimi, si rrallë nxënës, por edhe ngaqë tek kulloste bagëtinë apo dhe kur shkonte për dru në mal, me vehte kishte edhe trajstën me libra. I tillë do të ishte ai edhe në fidanishten e mësuesisë, siç njihej Shkolla e mesme Pedagogjike e Peshkopisë, për përfundimin e së cilës, babait të tij, Shemsi Plakut, iu desh të shesë pothuaj të gjithë bagëtitë. Por edhe në Universitet, tek do të përballej e triumfonte me pedagogun e sintaksës që “dhjetën” e konsideronte pronë të veten. Ishte pikërisht N. Plaku, ndër studentët e paktë që me zotësinë e talentin e tij të rrallë e theu këtë tabu të pedagogut zemërngurtë, ashtu siç sfidoi në vitet e dekadat e jetës së tij të gjithë nihilistët e mediokrit që i shërbyen me zell sistemit të diktaturës.

Këto e të tjera detaje jetësore për këtë poet të këngës, e bëjnë më të dashur për lexuesin këtë vepër dinjitoze të publicistit, studjuesit dhe analistit tashmë të njohur, Shaqir Skarra. Me mjeshtri të rrallë ai ka ditur të “shfrytëzojë” arkivën e pasur që la si trashëgimi, poeti i këngës, Naim Plaku. Nuk është rastësi që nga kritika letrare, emri i Naim Plakut si poet kënge, radhitet përkrah Gjokë Becit e Lefter Çipës. Këtë, përveçse autorit të monografisë “Dritëhijet e një poeti”, e pohojnë edhe emra të spikatur të letrave shqipe, që e kanë studjuar hollësisht veprën e Naim Plakut. Kjo edhe për faktin se tekste të Naim Plakut janë lënda e parë e standardit më të lartë për këngëtarët e mirënjohur Arif Vladi, Shkurte Fejza, Haxhi Maqellara, Skënder Cala, Liri Rasha, Qerim Sula, Ilir Shaqiri, Selami Kolonja, Caje Poleshi, Sherif Dervishi, Vera Laçi, Dritan Jashari etj. Mjafton të kujtojmë se si janë ngritur peshë zemrat e mijëra artdashësve, jo vetëm në Shqipëri, por edhe në skenat më presitigjioze të botës, kur kanë përjetuar zërin e tyre melodioz në interpretimin e teksteve të këngëve të N.Plakut: “O prite Azem Galicën”, “Një gërshet u la me gjak”, “Na knojnë pushkët nëpër kulla”, “O i madhi Skënderbe”, “Përcolla ylberin”, “Mine mori Mine”, “Tinguj krenarie”, “Fluturo shqipe ka kalaja”, etj.

“Naimi u bë gjuhëtar, punoi shumë për të, mblodhi fjalë të rralla jo vetëm të krahinës, por edhe jashtë saj Naimi truppakët, çapitej nga Fushë Alia në Shumbat, nga Cereni në Sllovë e nga Sllova në Gollobordë Ai çliroi shpirtin, duke tjerë zgjuarsinë me fjalët e botës së dijes që mblodhi jo vetëm nga gjuha e mësuar e shkollës, por edhe në odat e kullat dibrane dhe nga valët e fjalës së Drinit e oshëtima e Korabit, duke i shikuar këto nga shpirti i lirisë Pas mësimit, gjatë udhëtimeve do të nxirrte bllokun e do të shkruante toponime e mikrotoponime. Për to pyeste qoftë dhe një çoban që ishte me bagëti .Gjeti ninullat e bukura të djepit e shprehjet frazeologjike, të përdorura aq bukur në këto anë. Përpara se ta hidhte në bllok, këngë qoftë

apo shprehje gjuhësore, kërkonte burimin. Kështu ai ra në gjurmë të ciklit të këngëve të Korabit, mblodhi këngën e Ymer Agë Ulqinit, “Motra me nantë vllazën”, “Balada e Rexhës” e dhjetra të tjera...I mori këto këngë nga goja e popullit, ua hoqi pluhurin dhe i bëri pronë të të gjithëve për të mbetur visare të folklorit shqiptar”.

Mjaftojnë qoftë edhe këto perifrazime të shkëputa nga faqe të ndryshme të veprës së Sh.Skarrës “Dritëhijet e një poeti”, për të konkluduar në punën e mirëfilltë studimore e shkencore që ai ka bërë për të na e sjellë në mënyrë sa më origjinale madhësitinë e profilit krijues e njerëzor të Naim Plakut.

Poeti që përjetoi skajshmërisht përndjekje, ishte vërtetë një poet i përmasave të spikatura. Në monografinë e botuar nga Shtëpia Botuese e mirënjohur tashmë M&B, evidentohen qartazi variacionet poetike në formë mozaiku brenda konstruktit poetik të poezive të tij që shkrihen në kodet nëntekstuale, të shartesave të kumteve dhe përcjelljeve të folkut. Kjo edhe për faktin se në poezinë e tij, Naim Plaku i ngre një kult botës dibrane, nderit, dinjitetit, virtytit, arketipit social, etik dhe filozofik të dibranit që motivohet nga zgjuarsia, matura, etj. Këto, më së miri i gjejmë në veprat poetike të N.Plakut “Fllad e frullizë”, “Kreshtat e Korabit” dhe “Trëndafila mbi mermer”. Por vitet e fundit botimet e tij po lexohen e po pëlqehen nga publiku, sidomos “Krojet e zanave” e “Folklor nga viset e Dibrës”.

Qoftë edhe me një vështrim sporadik të veprës “Dritëhijet e një poeti”, lexuesi do të mrekullohej me “rrefimet nga ditari”, të cilat autori Sh.Skarra ka patur fatin t’i ketë në dorë dhe prej tyre të përveçojë nektarin e veprës shumëdimensionale të Naim Plakut. Dhe jo vetëm kaq, por shkrimtari e studjuesi Skarra, sjell risi në “Raportet e Naimit me veprën”, duke i parë ato në një kontekst të gjerë, në fushën e gjuhësisë e letërsisë, por edhe duke na e paraqitur Naim Plakun si një figurë të

shquar të folkloristikës tonë, si skenarist dhe libretist.

Dhe në vlerësimin e veprës së N.Plakut, autori i mografisë “Dritëhijet e një poeti”, nuk ndalet vetëm tek mendimi i tij analitik, mjaftë i vlefshëm, por sjell referenca të çmuara nga bashkëkohës të mirënjohur. Kështu, akademik Shaban Sinani, përveç shumë punëve të bukura në krijimtari, veçon atë çfarë Naim Plaku i ka kushtuar traditës gojore të popullit të Dibrës, traditës etnozakonore dibrane, studimeve me karakter historiografik dhe etnologjik, krijimtarinë letrare në përgjithësi, sidomos poezinë e tij.

Ndërsa Ali Ahmeti, sjell në kujtesë këngët e mrekullueshme që këndonin Arif Vladi, Liri Rasha, Qerim Sula dhe të tjerë këngëtarë, që atij dhe shokëve të tij, kur luftonin për të drejtat e popullit shqiptar, u jepnin zemër dhe i hidhte në flakën e betejave. Por, lideri i mirënjohur historik i shqiptarëve të Maqedonisë pohon se në atë kohë nuk e dinte që tekstet e tyre aq të fuqishme i kishte bërë Naim Plaku. Dhe nëse për Shkurte Fejzën, poezia e N.Plakut ka shpirt dhe i jep motiv kompozitorit, që të kompozojë, por edhe këngëtarin e frymëzon për të kënduar me shpirt, për Dr.Fejzulla Gjabri, që është edhe redaktori i librit, “Në vëllimet e Naimit ka frymëzim vendlindor, dibran dhe gjithëshqiptar. Aty është lashtësia, aty burojnë mesazhet, aty ngrënë krye hulumtimet .”

http://www.veteraniobvl.org/html/botime/NE_PANTEONIN_E_VLERAVE.pdf

HAZIS NDREU, IKONË E ARTIT DHE KULTURËS KOMBËTARE

*Hazis Ndreu arriti shumë shpejt ta ngrejë
në nivele kombëtare e ndërkombëtare emrin
e artit dhe mençurisë së Dibrës*



DRITËRO AGOLLI:

*“Hazis Ndreu, miku im, mjeshtër i humorit dibran. Sot e
kësaj dite si ai nuk gjen më. I papërsëritshëm, i papërtuar,
modest dhe shpirtmirë”*

MOIKOM ZEÇO:

*“Hazisi është unik. I veçantë, i rrallë në çdo krijimtari
të tij, ku ka tërhequr vëmendjen e shumë shkrimtarëve
me mënyrën e veçantë të të rrëfyerit, duke qenë një nga
pasuritë më të mëdha në rrafshin e ligjërimit, jo vetëm
kombëtar, por ndoshta edhe europian”*

AGRON TUFA:

“Hazis Ndreu ishte ‘magu’, i cili me preken e tij magjike e ngre peshë zemrën e çdo dibrani, pasi arti i tij i flet atij për gjërat më të vyera të pajës më të vyer shpirtërore... Thjesht, Hazis Ndreu arriti shumë shpejt ta ngrejë në nivele kombëtare e ndërkombëtare emrin e artit dhe mençurisë së Dibrës. Ne kemi pasur fatin që jemi përfaqësuar si kulturë përmes një artisti si ai”

HISTORIA E NJË SPEKTAKLI

Në 2008, u realizua një spektakël madhështor në përkujtim të “Artistit të Merituar” Hazis Ndreu – “Mjeshtër i Madh”. Skenarist, regjisor dhe prezantues, prof. Bujar Kapexhiu – “Mjeshtër i Madh”. Një spektakël për një artist dhe njeri të madh, ku interpretuan artistë dhe njerëz të mëdhenj të botës së artit, kulturës e shkencës. Në formë gjysmëharku, në skenën e sallës së madhe të ishSHQUP-it, me sfond portretin e madh të Hazisit, qenë ulur të gjithë pjesëmarrësit e spektaklit.

Artistët, aktorët, këngëtarët, valltarë të radhitur në krah të njëri-tjetrit. Përballë, spektatorët, ashtu siç ulen në formë harku, në shiltetë e Odës Dibrane. Skena me artistët dhe salla me spektatorët, tamam një Odë Dibrane gjigante, e mbushur plot e përplot.... Një kompozim perfekt i një spektakli perfekt, produkt i “Artistit të Merituar” Bujar Kapexhiu, që jo vetëm në aktrim e karikaturë, por edhe si skenarist e moderator, mbetet një Mjeshtër i Madh. Për të arritur deri te ky spektakël-show iu deshën muaj të tërë parapërgatitje...

Dhjetëra takime me studiuesit e Institutit të Folklorit, prof.dr. Ramazan Bogdani, Agron Xhagollin, Skënder Sallakun, Skënder Calën, Inajet Shehun etj. Të gjitha takimet të monitoruara besnikërisht nga Avniu, djali i madh artist i Hazisit, sipas të cilit: “Baba interesohej për të gjithë, të

njohur e të panjohur, që ishin në hall apo që kishin ndonjë problem me zyrtarët. Interesohej për ata që hynin në burg, që i pushonin nga puna, për ata që s'kishin Triskë Fronti, për të futur dikë në shkollë, për vizitë te ndonjë mjek i zoti.... Ishte me një fjalë, derë e hapur për popullin, njoft e panjoft... e dinin që Hazisi të mbaron punë se është i njohur dhe e duan të gjithë... deri në Tiranë... te qeveria”.

Pjesë e skenarit të spektaklit, studiuesi i mirënjohur Moikom Zeqo, i cili rrëfen se i ka bërë përshtypje të veçantë studimi i Hazis Ndreut për Skënderbeun, nëpërmjet toponimeve, legjendave dhe përgjithësisht studimit të terrenit... Me hulumtimin e të gjitha toponimeve që lidhen me Skënderbeun. Sipas tij, “Studimi i Hazis Ndreut në këtë pikë është diçka e re, është diçka serioze...”. Më pas, një tjetër artist i njohur dibran, Dervish Biba, ka zgjedhur të recitojë rapsodinë e Hazis Ndreut, “Dibrës sime”.

Para recitimit, ai shprehet se ka qenë fare i ri kur ka dëgjuar dhe është mrekulluar me këngët, rapsoditë e kërcimet e tij. Hazisi, si kërcimtar, në shumë festivale kombëtare e ndërkombëtare, qe fitues i shumë çmimeve, sidomos në vallen dyshe dibrane me kërcimtarin e mirënjohur Besim Zekthi. Vlerat e tij si koreograf e valltar i evidentoi më së miri prof.dr.Ramazan Bogdani. Studiuesi Agron Xhagolli, veç të tjerash, flet për Odën Dibrane si institucion dhe për burrin e saj, Hazis Ndreu.

“Një universitet që ua kalon shumë universiteteve me emër, për nga forca e riprodhimit të ngjarjeve, interpretimit, për nga mençuria dhe ironia e hollë, aspak fyese për mikun, por shumë favorizuese edhe për t’u formuar në të...”. Këtë e pohon artistikisht edhe “Artisti i Popullit” Reshat Arbana, me fjalë, por edhe me interpretimin e poezisë së Hazisit, të titulluar “Pajtimi”. Më pas, “Artisti i Popullit”, Skënder Sallaku, pohon meritën e padiskutueshme të Hazis Ndreut, i cili duke eksploruar në rrënojat e lashtësisë, si një historian i mirëfilltë,

e futi Historinë e Dibrës në shina të sigurta për të ecur me dinjitet në fushën e madhe të Historisë sonë Kombëtare.

“Kemi qenë shumë miq të afërt me Hazis Ndreun. Një artist i rrallë, por mbi të gjitha një shok e mik i rrallë. I qeshur, fisnik, i mençur, muhabetçi, korrekt, punëtor, i papërtuar, talent. I shoqnisë, por jo i rakisë!”. Pikërisht këtu “ndalon” Skënderi për të interpretuar më pas dy barsoleta, një tiranase dhe një dibrane (nga krijimtaria e Hazisit).

Kështu vijoi spektakli, me interpretime të krijimtarisë së Hazis Ndreut nga Veli Rada, Luftar Paja, Behar Mera, Skënder Cala, Llesh Nikolla si dhe nga këngëtarët Arif Vladi, Lirie Rasha, Qerim Sula, Vera Laçi, Saje Poleshi... Kështu u përkujtua Hazis Ndreu në 80-vjetorin e ditëlindjes së tij, me një spektakël madhështor të ideuar, inskenuar e realizuar nga prof.dr.Bujar Kapexhiu, emri i të cilit, (edhe si kryetar i Shoqatës Bashkësia Dibrane) spikat më së miri, sidomos në tubime intelektualësh dibranë, përvjetorë ngjarjesh e individësh të shquar apo dhe në promovime librash të autorëve dibranë, ku ky korife i mendimit dhe veprimit krijues po i lartëson kaq shumë, Dibrën dhe dibranët.

BURRI I ODËS DIBRANE

Dhjetë vjet më vonë, pikërisht në 90-vjetorin e ditëlindjes së tij, lexuesi ka në dorë profilin e “Burrit të Odës Dibrane” në një libër shumëvlerësh, të stilit dhe llojit të veçantë. Autor, Bujar Kapexhiu – Mjeshtër i Madh, Artist i Merituar, regjisor, skenarist dhe aktor i mirënjohur shqiptar. “Historia e një spektakli”, pas qindra karikaturave të botuara në shtypin e përditshëm që janë përmbledhur në tre libra “Ngërç”, “Për një karrige” dhe “Kthesë”, është libri i B.Kapexhiut, ku “Burri i Odës Dibrane”, përveçse si profil i skalitur mjeshtërisht, të bën për vete edhe me karikaturat tejet miqësore për Hazis Ndreun e miqtë e tij të shumtë. “Historia e një spektakli”

është një spektakël original, në formën e një udhëtimi në vite me krijimtarinë e të madhit Hazis Ndreu, ku gjithçka është e dokumentuar në librat e tij me këngë e rapsodi, tregime alegorike e studime të mirëfillta historike. Gjithçka është e ilustruar me tregimet fantastike të këtij krijuesi e mendimtari të shquar. Gjithçka është e komentuar nga personazhe reale, biografia e të cilëve është historia e vërtetë e



vendit tonë. Në tërësinë e tij, libri sjell Odën Dibrane, që në gjuhën popullore përfaqëson dhomën e pritjes së mikut. E përkufizuar në mënyrë sinjifikative nga Bujar Kapexhiu, “Ajo është simbol i vatrës bujare, besa e burrit, qëndresa e trimit, mençuria e fjalës, kënaqësia e muhabetit, sheshi i përplasjes së opinionëve, urtësia e më të moshuarve, këshilla e prindit, përkrahja e mikut, shpërthimi i këngës, sheshi i kërcimit, jehona e të qeshurit, kuadrati i lodrave, dashuria e respekti midis njerëzve, zanafilla e ngjarjeve, fundi i armiqtësive, tempull për pleqtë, shkollë për të rinjtë, çerdhe e patriotizmit, burim i humorit. Oda është grumbullim njerëzish, miq, të afërm, fafëfis, komshinj, për arsye gëzimi, sepse hidhërimi, mikpritjejeje të të ftuarve apo udhëtarëve nga larg. Këtu lindi dhe u rrit Hazis Ndreu...”.

Autori vjen në këtë përfundim, pasi ka evidentuar vlerësimet e dhjetëra personaliteteve të letrave, artit, kulturës e shkencës për figurën dhe personalitetin e Hazis Ndreut, të cilat i ka përfshirë si kapitull më vete në librin “Burri i Odës

Dibrane”. Mjaftojnë qoftë dhe vetëm disa perifrazime nga Dritëro Agolli, Kol Jakova, Moikom Zeqo, Agron Tufa, Tonin Çobani, Xhezair Abazi, Lutfi Turkeshi, Vasil Tole, Përparim Tomçini, Afërdita Onuzi, etj, për të konkluduar për një libër të bukur e për më tepër, shumë origjinal. Gjer më sot nuk është botuar një libër i tillë, me humor, studime, dialogë, anekdota e të gjitha këto të ilustruara me karikatura. Një libër që nxjerr në pah madhësinë e këtij artisti të rrallë, origjinal, duke e përqendruar këndvështrimin në zhanrin e humorit.

DISERTACION ME VLERA SHKENCORE


Dhe kur gjatë gjithë leximit të këtij libri, je munduar të evidentosh esencien në profilizimin e Mjeshtrit të Madh, Hazis Ndreu, për të shkruar qoftë edhe pak radhë për të, në ndihmë të vjen vetë autori, me kapitullin përmbyllës, “Kanë thënë për Hazis Ndreun”, në faqet 386-393. Dhe nëse për Dritëro Agollin, “Si Hazis Ndreu, mjeshtër i humorit dibran, sot e kësaj dite, si ai nuk gjen më, i papërsëritshëm, i papërtuar, modest dhe shpirtmirë”, për Moikom Zeqon “Hazisi është unik. I veçantë, i rrallë në çdo krijimtari të tij, ku ka tërhequr vëmendjen e shumë shkrimtarëve me mënyrën e veçantë të të rrëfyerit, duke qenë një nga pasuritë më të mëdha në rrafshin e ligjërimit, jo vetëm kombëtar, por ndoshta edhe europian”. Shkrimtari i mirënjohur Agron Tufa vlerëson se: “Hazis Ndreu ishte ‘magu’, i cili me prekjën e tij magjike e ngre peshë zemrën e çdo dibrani, pasi arti i tij i flet atij për gjërat më të vyera të pajës më të vyer shpirtërore...” Thjesht, Hazis Ndreu arriti shumë shpejt ta ngrejë në nivele kombëtare e ndërkombëtare emrin e artit dhe mençurisë së Dibrës. Ne kemi pasur fatin që jemi përfaqësuar si kulturë përmes një artisti si ai”. Me botimet e tij, “Dibra në udhën e historisë”, “Kastriotët dhe Skënderbeu në trojet arbërore”, “Ushtima e Maleve”, “Dibra dhe etnokultura e saj”, “Alegori

dibrane” etj., Hazis Ndreu ka hyrë me dinjitet në fondin e artë të letërsisë shqipe. Le ta kujtojmë, nderojmë e respektojmë si të tillë Hazis Ndreun, si simbolin e Odës Dibrane, gati-gati si një institucion lëvizës ndërshekullor i traditës, të cilin, shumëformësia e qasjes, ribërja letrare e evenimenteve historike, aftësia vrojtuese, kultura e begatë e shkathëtësia përpunuese e lëndës së trevës së vendlindjes, me gjithë gamën përjetuese, e bëjnë të kapërcejë nga Dibra në vizionin e botës shqiptare në përgjithësi. Në këtë këndvështrim, libri i Bujar Kapexhiut, “Burri i Odës Dibrane”, është një ikonë dibrane plot vlera, është disertacion me vlera shkencore.

<http://www.panorama.com.al/hazis-ndreu-ikone-e-artit-dhe-kultures-kombetare/> - Gazeta “Panorama”, Jul 17, 2018

BERISHËT E MUHURRIT, SI RAST UNIKAL NË HISTORINË SKËNDERBEGIANE

*Rreth romanit historik “Të jetosh në paqe” të poetit,
prozatorit e kantautorit Naim Berisha*



Barleti, Franku, Sokoloski, Pall, Stort, Stojanovski dhe shumë të tjerë biografë dhe studiues vendas dhe të huaj të Skënderbeut, evidentojnë Berishët e Muhurrit të Dibrës, si një rast unik në historinë skënderbegiane. Madje Marin Barleti të “Histori e Skënderbeut” - (faqe: 314, 315,) shkruan se “Ndër fisnikët më të mirë të atij vendi (në Dibër,) ka qenë familja e lashtë e Berishëve. Dy vëllezërit, gjeneralë të Skënderbeut dhe, njëherësh, kryetrima të rinisë dibrane, Dhimitri dhe Nikolla, ndihmën e të cilëve Skënderbeu e kishte të dendur dhe të shënuar, kur dëgjuan për fatkeqësinë e ushtrisë sonë dhe për përfundimin e rrethimit të Beratit, kur morën pastaj vesh për rebelimin dhe pabesinë e Moisiut, nuk u vonuan aspak, por vrapuan fluturimthi për tek roja dhe kryeporta e mbretërisë, të trembur se mos roja atje shpërndahej nga frika apo ngaqë

s'kishte kush e frenonte dhe se mos vendi mbetej pa mbrojtës, sidomos kur vinin lajmet se Sebalia ndodhej, ende, në Epir. Dhe kështu Dhimitër dhe Nikollë Berisha me plot arsye, u kujdesuan, së pari, për të kërkuar ushtarë dhe, kështu, e rritën rojën, u dhanë zemër burrave me fjalë dhe me vepra, duke ua shtuar, me çdo mënyrë, dashurinë për Skënderbeun, si dhe duke shfaqur simpatinë e tyre për fatin e tij dhe urrejtjen për pabesinë e Moisiut “.

Duke shkruar për këtë familje, (filloj:”Familja e Lashtë e Berishëve” sepsenëgjithëlibrin voluminoz të tij për Skënderbeun, Barleti, çuditërisht, vetëm këtë familje, në ndryshim nga gjithë të tjerat, e specifikon kështu: “të lashtë”) është e pamundur të mos përmendësh Kastriotët dhe Skënderbeun.

Kjo sepse, këto dy familje, u ngjizën në të njëjtën trevë të origjinës, në Masrekat e Dibrës së Poshtme, për të cilën kanë shkruar jo pak historianë vendas dhe të huaj. Edhe nga burimet arkivore, edhe nga ato gojore vërtetohet se këto dy familje qenë jo vetëm bashkëkohës dhe bashkëfshatarë, por, njëkohësisht, dhe bashkëlufëtare.

Qyshse Kastriotët u shfaqën për herë të parë në skenën luftarake të kohës, Berishët bëjnë krushqi me ta dhe që nga ajo kohë, familja e lashtë e Berishëve, do të mbetet në historinë skënderbegiane si njëra nga familjet bashkëlufëtare më besnike e kauzës së Kastriotëve.

MASREKAT DHE GARDHI, TREVA NË TË CILAT, EKSKLUZIVISHT, IDENTIFIKOHET MUHURRI

Të shkruash për Berishët, më së pari, do të thotë të shkruash për Masrekat, të Epërmet dhe të Poshtmet, si dhe për Gardhin e Poshtëm (të Dibrës së Poshtme), treva në të cilat, ekskluzivisht, identifikohet Muhurri, ky shtrat i rrallë shtrëngatë i origjinës së lashtë të Kastriotëve. Të shkruash për Berishët e kohës së Kastriotëve do të thotë të hedhësh një

dritë të re mbi qytezën e lashtë ilirike të Hurdhë-Muhurrit dhe Mazrekave të Epërme vend ku u ngjizen dhe u formuan në shekuj Kastriotët, të cilët i dhanë kombit shqiptar lavdinë dhe pavdekësinë.

Të shkruash për Berishët e Skënderbeut do të thotë të farkëtosh dhe një të vërtetë më shumë se Gardhi i Poshtëm, (vendlindja e dy gjeneralëve të Skënderbeut, Dhimitër dhe Nikollë Berisha), ishte ashtu siç pohon Gjon Muzaka, njeri prej dy katundeve që pati në zotërim Pal Kastrioti, gjyshi i Skënderbeut.

Së fundi, të shkruash për Berishët e Skënderbeut do të thotë të shkruash për një rast unik në historinë skënderbegiane që dëshmon shumë. Pra, kemi dy vëllezër, njëri më i zoti se tjetri, që të dy gjeneralë të Skënderbeut, luftëtarë të ekselencës, njerëz të elitës ushtarake skënderbegiane, nënkomandantë nga më të rreptët e Skënderbeut dhe, njëherësh, nga më të besuarit e tij, personazhe historike të veprës së madhërisme të Skënderbeut shkruar nga Barleti, vepër e përkthyer në shumë gjuhë evropiane dhe që qarkullon prej më shumë se 500 vitesh në gjithë botën.

Kur shkruhet dhe flitet për Berishët e kohës së Skënderbeut, s'do mend që flitet e shkruhet për Berishët e Muhurrit të Dibrës së Poshtme. Asnjë historian apo kronikan, asnjë burim arkival apo gojor nuk na bën të njohur ekzistencën e ndonjë fisi a familjeje tjetër "Berisha" në gjithë trevën autentike arbërishte të epokës së Kastriotëve.

Nëse ka sot familje Berishësh, gjithkund, në hapësirat etnike shqiptare, ato, dihet, kanë diverguar përgjatë harkut kohor të këtyre pesë shekujve të fundit, pra, fill pas MOTIT TË MADH nga e vetmja pikë: Familja e Lashtë e Berishëve të Masrekave dhe Gardhit të Poshtëm, përndryshe, nga Muhurri i sotëm i Dibrës së Poshtme, pikërisht, aty ku e kanë gjenezën, aty kanë dhe trojet e tyre të vjetra e të pakontestueshme Kastriotët tanë monumentalë.

Referuar këtyre kolosëve të historisë sonë kombëtare, por dhe në të dhëna arkivore e gojore, poeti, romancieri, përkthyesi dhe, njëherësh, kantautori muhurrak Naim Berisha, autori i më shumë se 30 librave artistikë, (vetëm në këta 23 vitet e fundit), ka botuar së fundmi romanin e tij të gjashtë, të cilit i ka vënë titullin e bukur dhe kuptimplotë, “TË JETOSH NË PAQE”. Ndryshe nga pesë të parët, ky i fundit i përket zhanrit historik.

Në këtë libër, ai trajton temën e qëndresës së popullit të arbërit në kohën e Skënderbeut. Duke glorifikuar familjen e lashtë të Berishëve të Mazrekave në Gardh të Poshtëm, dmth, në Muhurrin e sotëm të Dibrës së Poshtme dhe të dy gjeneralëve të Skënderbeut, vëllezërve Dhimitër dhe Nikollë Berisha, djem të Gjergj Berishë Mazrekës dhe Majra Kastriotit) ai, në të njëjtën kohë, glorifikon gjithë qëndresën heroike të Arbërisë nën udhëheqjen e Skënderbeut kundër tiranisë së pashembullt turke.

FRYMA POLEMIZUESE E AUTORIT DHE BESUESHMËRIA NË PËRSHKRIMIN E PERSONAZHEVE

Duke vazhduar me vlerat e romanit, nuk mund të mos nënvizoj frymën polemizuese të autorit me ata që u përpoqën të anashkalojnë qëllimisht Muhurrin dhe Berishët, edhe pas mbledhjes së dëshmimeve të pleqve të urtë muhurrakë, Lam Mziu e Fali Rama. Ndërkohë që ka edhe të tjerë që ndonëse botuan libra rreth gjurmëve të kastriotëve në Sinë e Muhurr, megjithë kontributin studimor nuk arritën të orientohen nga figurat e kryetrimave Nikollë e Dhimitër Berisha, siç bëjnë H.Koltraka, S.Mziu e F.Daci.

Romani historik i N.Berishës bëhet më i besueshëm kur iu referohet studjuesve të mirëfilltë të historisë së Muhurrit, Hilmi Sadikut e Ilvi Shehut, apo edhe Hysni Bruçit e Hysni

Millosehit si promovues të vjershës së tij të parë dhe të studimit për Berishët e Muhurrit të botuar në revistën “10 korriku”.

Një figurë interesante është dhe ajo e Liman Berishës, për bëmat e të cilit në betejat kundra turqve e serbëve, deri në kryengritjet e viteve ‘20-21 unë kam shkruar që para 30 vitesh reportazhin “Muhurri në breg të Drinit”, botuar në gazetën “Ushtima e Maleve”, dhe ku ndoshta për herë të parë sjell referenca nga Barleti e Noli për gjeneralët trima të Skënderbeut, Dhimitër e Nikollë Berisha.

Tërheqës janë edhe profilet e Xhemalit, Osmanit e hallë Miles, që Gjorgu, heroi kryesor i librit, mjeshterisht i viziton, qoftë dhe vetem si inkurajues të krijimtarisë së tij. Po në këtë këndvështrim përfshihen në romanin historik “Të jetosh në paqe” dhe xhaxhallarë e autorit, Ramazani, Haliti e Lika si dhe kushërinjtë, Arbeni, Limani e Bardhyli, si pasardhës të denjë të Dhimitrit e Nikollës. Pikërisht edhe për hedhjen dritë rreth këtyre figurave e personaliteteve të shquara, ky roman i N.Berishës zë vend të veçantë në larminë e botimeve kombëtare.

“TË JETOSH NË PAQE” NJË ROMAN I ZHANRIT HISTORIK

Duke u mbështetur në mendimet e konsulentëve dhe të recenzentëve, emrat e të cilëve janë të shkruar në faqen e parë të librit, kemi mbërritur në një akord se ky libër i veçantë i Naimit, më shumë se një libër monografik për familjen a fisin, është një roman i zhanrit historik, sepse i gjithë libri është nën ndikimin e parimit artistik dhe estetik të historisë.

“Të jetosh në paqe” që i dedikohet familjes së lashtë, të vjetër dhe të re të Berishëve të Muhurrit dhe jo vetëm atyre, është një kontribut i ri si në thesarin e historiografisë skënderbegiane, ashtu dhe për letërsinë që i korrespondon asaj periode legjendare e të papërsëritshme.

Romani në fjalë që është fantazi me baza historike e të vërteta, të tërheq në linjat e veta dhe mbetet disi intrigues, duke ngallur interes dhe kureshtje. Si i tillë, ai lexohet me një frymë. Dhe ne besojmë se do lexohet kështu për shumë e shumë kohë, si brenda, edhe jashtë kufijve të atdheut dhe në bibliotekat personale të shqiptarëve.

NAIM BERISHA, POETI, PROZATORI DHE KANTAUTORI I MIRËNJOHUR NGA MUHURRI QË KA BOTUAR MË SE 35 LIBRA

Poeti, prozatori dhe kantautori i mirënjohur Naim Berisha u lind në Fushë-Muhurr në gjirin e familjes së lashtë të Berishëve, siç cilësohet kjo familje nga humanisti i madh shqiptar Marin Barleti në veprën e tij “Historia e Skënderbeut”. Dy stërgjyshat e tij, Dhimitër dhe Nikollë Berisha, ishin nipa dhe njëherësh, gjeneralë tejet besnikë të Heroit Kombëtar të shqiptarëve Gjergj Kastrioti-Skënderbeu.

Naimi, për këta heronj të ndritshëm dhe të pamohueshëm të Muhurrit dhe jo vetëm, do të shkruante më pas, (që do të thotë: tani vonë), një roman historik të tërë kushtuar këtyre kryetrimave të rinisë dibrane, me të cilët gjithë Muhurri, Dibra dhe mbarë shqiptarët duhet të ndihen krenarë!

Naim Berisha është dalluar si mësues i muzikës dhe i gjuhëletërsisë kudo që punoi, si në Kastriot, Qafë-Murrë, Selishtë, Muhurr dhe Sinë. Për një kohë ai ishte drejtues i kulturës në divizionin “Korabi” në Shtëpinë e Kulturës së Ushtarakëve të qytetit të Peshkopisë. Më pas transferohet në qytetin e Burrelit ku punoi, fillimisht, si gazetar në gazetën lokale të rrethit të Matit, nëndrejtor në Shkollën e Mesme Profesionale dhe, më pas, Drejtor në Gjimnazin “28 Nëntori” deri në vitin 1997. Pastaj transferohet në Tiranë, ku punoi edhe si gazetar, edhe si mësues letërsie në disa gjimnaze të Tiranës. Vetëm për pak kohë punoi si drejtor në gjimnazin

“Eqerem Çabej” të kryeqytetit, pasi emigroi familjarisht për në Angli, ku, që në fillim të jetës së atjeshme, ka kryer disa kualifikime: në media, në muzikë, në kritikë letrare si dhe për letërsi angleze.

Naimi, tashmë, njihet jo vetem si poet dhe shkrimtar, por edhe si kantautor dhe përkthyes nga anglishtja. Ai numëron sot më se 35 libra, ndër të cilët gjashtë romane, pesëmbëdhjetë vëllime poetike, libra me tregime, libra me fabula, me hajke, me tekste këngësh, tre libra me të gjitha sonetet e përkthyer të Shekspir, etj. Tre albumet e tij me këngë popullore dhe të muzikës së lehtë, me tekste dhe muzikë të shkruara prej tij, më së shumti, dominohen nga këngët që ai ua ka kushtuar Muhurrit dhe Dibrës.

Ai ka botuar dhe një libër me këngë të tijat, të titulluar “Muhurri dhe Shqipëria në 100 këngët e mia”.

E veçanta e Naimit si autor tekstesh, kompozitor dhe si këngëtar është se ai nuk këndon tallava, nuk është kopjues i këngëve të huaja siç janë shumë të tjerë. Ai mbështetet fort në tabanin e popullit të vet, gjë që tregon se këngët e tij do të kenë të ardhme.

NGJITJE E RE NË SHKALLAREN E POEZISË

Naim Berisha nuk ka asnjë libër socrealist. Në diktaturë, krijimet e tij konsideroheshin të errëta, hermetike, dhe si të tilla, të pabotueshme. Krijimtaria e Naimit, gjithmonë, është vlerësuar nga autorë të vjetër e të rinj, të cilët janë të shquar në letrat shqipe, si: Dritëro Agolli, Teodor Laço, Bedri Dedja, Fatos Arapi, Odhise Grillo, Bardhyl Xhama, Miho Gjini dhe shumë të tjerë. Ja si shkruan Teodor Laço në parathënien e një libri të këtij autori: “Poeti Naim Berisha ndihet i mërguar vetëm fizikisht. Shpirti i tij i ndjeshëm poetik është këtu, në malet, fushat, luginat dhe lumenjtë e vendlindjes. Aty ku realisht dhe simbolikisht 522 Halil Rama mbeten vlerat e

mëdha njerëzore, që janë lënda e parë e qasjeve të tij ndaj poezisë...”. Dhe më pas, zoti Laço, një ndër personalitetet më në zë të letërsisë shqipe do të nënvizonte: “Naim Berisha nuk vjen nga librat, por nga nëna. Ai është një talent gjenuin, veprat më të mira të të cilit, bëjnë pjesë në fondin më të mirë të letërsisë sonë. Naimi ka mësuar nga letërsia, por nuk imiton letërsi. Për mua ai bën pjesë në grupin e vogël të poetëve më të mirë të kohëve të reja”. Ndërsa Dritëro Agolli, qysh në fillimet e krijimtarisë së Naimit, qe prononcuar me profecinë e tij se N. Berisha premtonte shumë për të ardhmen. Dhe tani që Naimi ka publikuar 35 libra, në pak më shumë se 20 vite, çuditërisht, shohim të realizuar profecinë e të madhit Dritëro.

<http://rrugaearberit.com/2017/07/01/berishet-e-muhurrit-si-rast-unikal-ne-historine-skenderbegiane/>

SHPENDI TOPOLLAJ, SHKRIMTARI PRODUKTIV ME KRIJIMTARI SHUMËPLANËSHE

*Krijimtaria produktive e cilësore e shkrimtarit, poetit,
publicistit, dramaturgut dhe kritiku letrar*



Shpendi Topollaj ka një kontribut të shquar si shkrimtar e publicist i cili në veprimtarinë e tij të gjerë ka pasqyruar më së miri historinë, kulturën, traditat e cilësitë identifikuese të shumë viseve shqiptare si dhe vlerat e shumë figurave të shquara të kombit shqiptar.

Lindi në ditën e të dashuruarve, 14 shkurtin e vitit 1947, për t'i dhuruar publikut bujarisht në 70 librat e tij (me prozë, poezi, drama, publicistikë, esse e kritikë letrare) dashuri të pamatë njerëzore.

Shpendi Topollaj njihet si shkrimtari, poeti, publicisti, dramaturgu dhe kritiku letrar, krijimtaria shumëplanëshe e të cilit ka qenë e pranishme sidomos në faqet e gazetave “Telegraf”, “Fjala”, “Nacional” e “Veterani”. Jeta e këtij oficeri dhe juristi, tashmë në pension, autor i rreth 70 librave të të gjitha gjinive

brenda harkut kohor prej vetëm njëzetepesë vitesh, njihet gjerësisht brenda dhe jashtë vendit. Dallgët e jetës i krijuan mundësinë që të shkruaj dhe të botojë vetëm pas ardhjes së demokracisë. Në të gjithë veprën e tij spikat si talenti dhe erudicioni i thellë, ashtu edhe guximi qytetar për demokimin e të keqes dhe domosdoshmërinë e bashkimit mes shqiptarëve. Kudo ai shfaqet si një intelektual i përgjegjshëm, predikues i vlerave tona kombëtare, i dashurisë për Atdhe dhe marrjen e fateve të tij në duart e vetë shqiptarëve. Aktiv edhe në jetën e përditëshme, ai drejton me sukses disa shoqata (nënkryetar i Shoq. Komb. “Skënderbegasi”, Nderi i Kombit dhe kryetar i degës Durrës etj.), dhe organizon veprimtari të shumta kushtuar figurave të shquara apo ngjarjeve të rëndësishme historike, si dhe promovimit të autorëve të ndryshëm, ç`ka duket qartë te 30 librat e tij vetëm me kritika. Për të dhe librat e dala nga pena e tij kanë shkruar me simpatinë më të madhe shumica e personaliteteve tona të artit dhe kulturës të cilat janë përmbledhur në pesë libra voluminozë. Për kontributet e tij, atij i janë akorduar disa tituj si “Ambasador për Paqen”, “Naim Frashëri i artë” nga Presidenti i Republikës, LSHA të Rusisë ku i janë botuar pesë romane, e ka shpallur fitues të çmimit “Pushkin” etj. Vetëm gjatë periudhës së pandemisë, ai ka botuar 15 libra të rëndësishëm si “Esse rreth shprehjeve mitologjike”, “Dantja e të tjerë”, “Shenjtorët e librave”, “Flas për ju”, “Çlirova shpirtin”, “Flisni miq”, “Përsiatje rreth pikturës”, “Pajtimi”, “Romancë me letra dashurie”, “E përdala”, “Ata ishin njerëz”, “E pabesueshmja”, “Kur qesh e qan Kadareja”, “Klithma nga burgu” dhe ky i tanishmi “Zë në shkretëtirë” me kritika letrare i cili u botua si dhuratë për ditëlindjen e tij nga Shtëpia Botuese 2MPrinting.

Në 70 librat e tij, Sh.Topollaj prezantohet si mjeshtër i profilit, duke krijuar personazhe si shembëlltura që të mbeten në kujtesë. Tërë krijimtaria e tij është në një linjë vetëpërmbushëse, ku autori me mjeshtëri di të përveçojë

protagonistë të veshur me detaje që vetëm syri i mprehtë dhe mendja pjellore i shpërfaq aq mjeshtërisht.


Në librat e tij depërton thellë në shpirt, në strukturën e personazheve si njerëz të matur që veprojnë në kontekst duke marrë prej tij, maksimalisht suksesin. Ashtu siç është edhe vetë në jetë autori Shpendi Topollaj, personazhet realë që përshkruan në librat dhe esetë e tij janë karaktere që bartin dashuri dhe buonsens, veti të qenësishme inteligjence.

Në fushën e të shkruarit dhe në disa institucione ku ka punuar evidentohet këmbëngulja dhe vullneti i tij për të studiuar, për të mbledhur burimet parësore, për të mësuar nga përvoja e tjerëve që është pjesë e stilit të punës kërkimore të Tij.

<https://www.fjalaelire.com/post/shpendi-topollaj-duarplot-në-75-vjetorin-e-lindjes>

ROMANI “POLAKJA” I XHEVAT MUSTAFËS, RADIOGRAFI E DIKTATURËS, PROGNOZË E SË ARDHMES

*Xhevat Mustafa gërsheton mjaft mirë
përvojën e tij diplomatike me formimin
e gjithanshëm letrar e gazetaresk*



Pas romaneve “Zë i prerë” (1993) dhe “Mëkatet e vetmisë” (2008) si dhe librit “Duke kërkuar Europën” (2012) (me analiza, komente dhe opinione), publicisti, prozatori dhe diplomati i njohur Xhevat Mustafa sjell për lexuesin romanin e tij të tretë “Polakja”. Kjo vepër letrare e këtij autori është e gjitha një performancë moderne, që të imponohet që në faqet e para dhe në vijim, deri në faqen 314, me subjektin dhe përmbajtjen e veçantë si dhe me formën e bukur artistike të rrëfimit, të ndërtimit, të gërshetimit të linjave e të kapërcimeve kohore.

Ngjarjet zënë fill në qytetin e Gdnaskut, në veriperëndim të Polonisë, vend ku më 1987, në Katovicë, një qytet jugor, ishte zhvilluar një mbledhje e shefave të partive komuniste të vendeve të kampit socialist, e cila ishte drejtuar nga lideri sovjetik Mikhail Gorbaçov.

Është shkruar e thënë se pjesëmarrësve u ishte shpërndarë një platformë veprimi në rast revoltash popullore politike e në periudhën e tranzicioneve politike, një kopje e së cilës i kishte rënë në dorë edhe Sekretarit të Parë të PPSH, Ramiz Alia.

Autori ka ekspozuar në këtë roman këndvështrimin e tij ndaj zhvillimeve të vrullshme në qytetin bregdetar të Gdnaskut, ku u diplomuan shumë studentë shqiptarë në Akademinë e Flotës Detare të këtij qyteti, gjatë viteve 1950-të deri në vitin 1961. Si publicist, si krijues e diplomat karriere, Xhevat Mustafa gërsheton mjaft mirë përvojën e tij diplomatike me formimin e gjithanshëm letrar e gazetaresk.

Kjo duket që në përshkrimin e ngjarjeve të vrullshme në kohën kur “Enver Hoxha po vraponte apo rrëshqiste pa u vetëpërmbajtur drejt plot-pushtetshmërisë së një diktatori, njëherazi klasik dhe unikal, në dukje partizan i një dogme dhe, thellë-thellë ideator dhe zbatues i një modeli sui-generis apo e një çorbe të shpikur prej tij”. Ishte koha, kur disa prej studentëve, në vetvete apo në biseda “sekrete” me njëritjetrin, nanuriseshin nga ideja dhe dëshira e qëndrimit në vendet ku po diplomoheshin, për të krijuar familje me vajzat që dashuronin, dhe njëkohësisht stepeshin, kur mendonin se moskthimi i tyre në Shqipëri mund të interpretohej si tradhti ndaj Atdheut e Partisë. Kjo akuzë nënkuptonte ndëshkime të rënda me burgosje, internime dhe ndëshkime të tjera politike për prindërit dhe pjestarët e tjerë të familjeve, praktikë që kishte vite që zbatoheshin”.

Për dy nga personazhet gjallues të romanit, studentët shqiptarë në Akademinë e Flotës Detare të Gdnaskut, Andon

Jaze dhe Jani Kruja, në këtë vorbull ishte e qartë se dilema do t'ia linte vendin përgatitjes së plaçkave dhe të valixheve për kthimin në atdhe.

Dhe ndërsa diktatori Hoxha prishej me Hrushovin e Bashkimit Sovjetik dhe aleatët e tij të bindur dhe po miqësohej me Kinën, Andoni, “edhe pse nuk ishte racist, personalisht mendonte se ndërrimi i “vëllezërve dhe motrave” nuk do të ishte njësoj si ndërrimi i kostumeve, fustaneve dhe ngjyrës së fytyrës apo të flokëve”.

E gjitha kjo përbën siparin e këtij romani, për të vazhduar më tej në retrospektivë, ku lëvrijnë marrëdhëniet dashurore të dy studentëve shqiptarë të Akademisë Detare të Gdnaskut me dy buroroshet polake. Mjaftojnë qoftë dhe trillet e përdorura në përshkrimin e këtyre marrëdhënieve për të kuptuar se Xhevat Mustafa e ka shkruajtur këtë roman më së pari me vizionin dhe ndjesitë e një artisti.

Krahas portretizimit artistik të dy polakeve, Anna dhe Jadëiga, si personazhet kryesore që përshkojnë romanin nga fillimi deri në mbarim të tij, autori përshkruan mjaft bukur qytetin e tyre të Gdnaskut në gjithë peisazhin socio-kulturor të tij. Ky qytet-port, me bukuritë natyrore, me historinë e pasur si mollë sherri dhe me luftra për të mes Polonisë dhe Gjermanisë, me inteligjencën e tij artikstike e shkollore, si edhe e gjithë Polonia, hyjnë natyrshëm në gjeografinë e përshkrimit. Kuptohet se përshkrimi i Durrësit është bërë edhe më me shumë detaje shprehëse dhe dashuri.

Të njohurit e miqtë e Janit dhe të Andonit, së toku me plot bashkëkohës, herë në Gdansk e herë në Durrës, popullojnë po natyrshëm lagjet e kujtesës dhe të fantazisë së autorit. Përditshmëria e aktivitetit brenda e jashtë qytetit të Durrësit, vështirsitë e një pune gjithsesi të pavlerësuar, vetë jeta e Andon Jazes dhe Jani Krujës, të kuadratuara në ecejaket rutinë, po edhe me fundin e tyre tragjik, lënë gjurmë emocionuese në kujtesën e lexuesit.

Ishte koha kur, si në gjithë kampin socialist të Lindjes edhe në Poloni, pas vrasjeve dhe zhdukjeve masive të burrave, mes tyre edhe të shumë hebrenjve, kishte superioritet të ndjeshëm të pjesës femërore të shoqërisë. Në këtë realitet studentët shqiptarë të Gdnaskut kishin shansin për të qenë të pëlqyer dhe të kërkuar nga plot vajza polake dhe për aventura kalimtare apo për lidhje serioze me ndonjëren prej tyre, por që, fatkeqësisht, fundin do ta kishin tragjik. Portretizimet e thjeshta dhe të ngrohta të Annës e Jadëigës, të shkurtëra dhe të qëlluara, me pamje nga larg apo në ambiente intime, fokusohen tërësisht në angazhimin njerzor për të mbajtur gjallë familjet e tyre. Po kështu edhe partnerët shqiptarë të tyre; Andoni që “bënte kujdes të fliste një polonishte korrekte gjuhësisht, përpiqet që me lakuriqësinë e shprehjes, të mendimit dhe të ndjenjës së tij, ta bindte Annën se jo të gjitha dashuritë janë të vërteta, dhe prandaj jo të gjitha martesat janë të forta dhe jetëgjata”. Kësisoj, përballë insistimit të Andonit, “Annës së martuar me dashuri me kitaristin polak, Marekun, po i shteroheshin me shpejtësi forcat për të mos u gremisur në krahët e studentit shqiptar nga Durrësi”, nga marrëdhënia jashtëmartesore me të cilin ngjizet dhe fëmija i tyre i vetëm, Feliksi.

Por pas izolimit total të Shqipërisë nga bota, pas viteve ‘60, kjo dashuri dhe ky fëmijë do të mbeteshin pengu i jetës së Andon Jazes, i cili gjatë jetës studentore “kishte mësuar shumë shpejt gjuhën e syve të vajzave polake” dhe kishte arritur ta bindte polaken Anna se “.pendesa është fare e papërfillshme përballë mëkatit”.

Linja tjetër e romanit janë marrëdhëniet dashurore dhe fundi tragjik nëpër burgjet e diktaturës i polakes Jadëiga, me trup e bukuri marramendëse, dhe bashkëshortit të saj, Janit, që e pësoi vetëm e vetëm pse “pranoi urdhërin e nomenklaturës për t’u divorcuar me polaken, mësuese muzike. Përballë kalvarit e genocidit të pashembullt, “ndoshta ajo vetë mund të

kishte dëshirë për të mos mbetur mollë përjetësisht e ndaluar për meshkujt e tjerë që e dëshironin”, por kurrësesi të mos binte viktimë e përdhunimit çnjerëzor të hetuesit famëkeq, Qemal Hanxhari.

“E gjithë qënia e tij mbarte dhe shprehte egërsi, ligësi, pabesi. Ai nuk dinte të qeshte dhe se zgërdhihej, vetëm kur i shihte viktimat e torturave të tij të mbuluara nga gjaku dhe të ulërinin deri në kupë të qiellit. Për të thonin se gjatë luftës partizane ishte përzgjedhur në skuadrën e pushkatimit të Brigadës për ekzekutimin e robërve të luftës Ngashërehej kur ua këpuste fare pa mëshirë kryet pëllumbave, lepujve të vegjël, këlyshëve të porsalindur apo pak ditësh të maceve e qenve Qemal Hanxhari i shërbente verbërisht dhe kafshërisht karrikeve që i dhuroheshin “.

NJOHËS I MIRË I LETËRSISË, MUZIKËS DHE KINEMATOGRAFISË BOTËRORE

Nëpërmjet përshkrimit të ngjarjeve dhe portretizimit të personazheve, Xhevat Mustafa evidentohet në këtë roman si njohës i letërsisë, kinematografisë dhe artit e muzikës botërore. Kështu, nuk është rastësi që ai perifrason romanin “Ana Karenina” të Tolstoit “me një kurbë në ngjitje zhvillimi dhe tensioni dhe një fund befasues, pa hapje and-in e zakonshëm në shumicën e romaneve të tjerë”. Dhe kështu ai shprehet për lidhjen jashtëmartesore të Andonit me Annën se “Ema Bovaritë dhe Anna Kareninat jetojnë edhe në këto kohë dhe se ia vlen të rrezikohet të dashurohesh me to”. Më tej, Viki, shoqja e saj e ngushtë që këmbëngulte që “Anna të ndjente keqardhje për Romeon e saj shqiptar të përtej gjysmës së shekullit të 20-të” Apo çasti kur panë në kinema filmin francez “E kuqja dhe e zeza”.. dhe kur “truri i punonte me tension të paprovuar, dhe zemra po i rrihte sikur donte t’i çante kraharorin “. Ndërkohë, bashkëshorti i saj Mareku, një

natë, pas një seksi të nxehtë, më shumë me shaka e kishte kërcënuar se mund të bëhej edhe Otello, po të dyshonte se ajo shkonte me një tjetër Gjithsesi, Mareku mund t'ia falte Annës, duke justifikuar vetveten se tradhtia bashkëshortore mund të kishte lindur bashkë me Evën dhe Adamin dhe se ai nuk ishte as i pari, as i vetmi dhe as i fundmi viktimë, jo në mbarë botën, por as në pallatin ku jetonin”.

Në këtë roman gjejmë edhe mjaftë referenca të tjera të autorit për letërsinë, muzikën, kinematografinë botërore, si “Frekuentimi i mbrëmjeve shthurëse ku kërcenin lirisht dhe me ritëm të shpejtuar valset dhe mazurkat si dhe meloditë e vallëzimeve të reja amerikane, të zhanrit “rock and roll”, apo “Kërkesa e mësueses së muzikës, Jadëiga për drejtorin e shkollës që t’i sillnin një piano, që informacionet për Bethovenin, Mozartin, Shopenin, Listin, Shtrausin, mund t’i ilustronte edhe me pjesë muzikore nga këto kolosë të muzikës botërore” ..(Por drejtori, që përballë kësaj zonje me trup e bukuri marramendëse ishte shprehur se “Për ty do të zbrisja edhe hënën në tokë!” .nuk nguron ta porosisë : “nxënësve tanë folu më pak për atë Shopenin tënd dhe mësoju më shumë këngë për Partinë tonë dhe për shokun Enver Hoxha!!! .E dyta, mos vish funde me gjatësi mbi gjunjë e fustane me dekolte shumë të hapur!!! ”.

Ndërsa si gazetar, autori i këtij romani, jo pa qëllim ka skalitur dhe portretin e ish kolegut të burgosur politik, Petritit, që kishte punuar në Radio Tirana dhe që një ditë ishte shprehur para bashkëvuajtësve në burg se “ndjej tmerr kur mendoj se paturpësisht dhe pashpirtmërisht na ka detyruar Enver Hoxha të gënjenim në reportazhet dhe emisionet tona për jetën e lumtur që bëjmë ne shqiptarët dhe për ferrin, ku jetojnë popujt në vendet kapitaliste”. Është koha kur regjimi po eliminonte pareshtur intelektualët më të shquar dhe po i mbushte zyrat me askushë apo me njerëz me formim të varfër .kur intelektualët burgoseshin se “ëndërronin për më

shumë orë pa zhurmues të stacioneve televizive italiane, për më shumë liri për puthje dashurie në rrugë, trotuare, barrestorante, në drama e filma dhe jo vetëm në stolat e parqeve e lulishteve, mes errësirës së natës dhe nën vështrimet masturbuese të disa pleqve maniakë , apo, jo rrallë, edhe nga ndonjë sy e vesh i spiunëve vullnetarë dhe me pagesë të Sigurimit të Shtetit, që gjendeshin edhe ku nuk i mendoje dhe prisje, në disa raste edhe në një krevat bashkëshortor, ku njëri nga partnerët tradhëtonte tjetrin në emër të besnikërisë dhe devotshmërisë ndaj Partisë dhe Pushtetit Popullor” Shembulli më sinjifikativ janë polakja Jadëiga dhe intelektualit shqiptar Jani Kruja.

KATOVICA NË ROMANIN E XHEVAT MUSTAFËS

Duke e marrë në tërësinë e tij, mund të konkludojmë se ky roman është radiografi e së shkuarës komuniste të Shqipërisë, por edhe prognozë e zhvillimeve të këtij çerekshekulli. Këtë e shpreh më së miri rrëfimi i polakes Jadëiga, e cila pas liritimit nga burgu dhe dëbimit në Poloni, u tregonte shoqeve se: “Atje në Shqipëri, në kushtet e ferrshme të burgut pësova një krizë nervore, por mendërisht isha krejt normale .Atje m’i kanë shkukur si me pinca të gjitha ndjenjat dhe instinktet e femrës . Ndërsa, im shoq, Jani Kruja, kishte marrë një tuberkuloz, që siç thoshte edhe vetë, nuk e luftojnë dot as antibiotikët më të fortë.”

Pas ‘90-tës, Jani Kruja do të shprehej se: “deformimi i demokracisë kishte nisur qysh në hapat e saj të parë. Edhe pse nuk gjendej një tekst origjinal, nga qytetarët bëhej çdo ditë e më e lexueshme apo e lakuriqsueshme se gjithshka në Shqipërinë e pas viteve 90, pak a shumë si në Rusi, Poloni, Rumani, Bullgari, Hungari, Çeki . “Katovica” zbatohet sipas një skenari largpamës për transferimin apo trashëgimin e pushteteve dhe të pasurive, nga baballarët tek bijtë e bijat,

nuset e dhëndurët, nipërit e mbesat “. Autori e paraqet këtë skenar qoftë dhe nëpërmjet portretizimit të personazhit negativ, hetuesit famëkeq Qemal Hanxhari, i cili në këto vite arrin të pasurohet marramendshëm, ndërsa djali i tij bëhet deputet i Kuvendit të Shqipërisë. Është vërtetë rrënjëthës takimi i Jadëigës pas shumë vitesh, kur vinte t’i bënte homazh tek varri bashkëshortit shqiptar Jani Kruja, me hetuesin Qemal Hanxhari ..që sipas saj “nuk ishte ndëshkuar as nga shteti mbi tokë dhe as nga Zoti në qiell”. Dhe pikërisht ky përdhunuesi i saj i dikurshëm në qelitë e burgut, tashmë pas 30 vitesh i pohon asaj krenarisht: “Ky është hoteli i tim biri, një nga biznesmenët e mëdhenj, deputet i partisë më të madhe opozitare, që së shpejti vjen në pushtet!”. Gjejmë kështu në romanin “Polakja” të Xhevat Mustafës rrëfime befasuese, që të prekin në shpirt dhe që të ngjallin ndjenja e mendime të thella.

Pa hyrë në detaje të subjektit, me qëllim që të mos zbehim kureshtjen e lexuesit, do të thoja se romani “Polakja” është një sprovë e forcës emotive të shprehjes, e një bukurie tërheqëse shkrimi, si dhe e një stili të krehur mirë, konçiz e kontemporan.

Romani në fjalë, më ka pëlqyer jo vetëm për gjuhën e zgjedhur, larg estetizimeve dhe përshkrimeve të zgjatura dhe pa vlerë, për stilin e bukur të rrëfimit, sintaksën poetike të përdorur me vend, metaforat e shumta dhe funksionale, për frazeologjinë e pasur e të larmishme, por edhe për mënyrën si është ndërtuar struktura dhe kompozicioni, për format si janë harmonizuar linjat kryesore me detajet dhe hollësitë dhe për digresionet e përdorura me mjeshtëri. Mjeshtria e autorit shprehet dukshëm sidomos në portretizimin plot ndjenja, lirizëm e poetizim të polakeve Anna e Jadëiga, duke të shtyrë të mendosh se i ka “dashuruar” nga larg, edhe pa i njohur dhe se synon që të mos i mbajë për vete, por me ato të dashurohen edhe lexuesit. Esenca e romanit “Polakja” është e lidhur me

ambicjet e autorit Xh.Mustafa për të shprehur artistikisht realitetin dhe natyrën në kuptimin më të gjërë si dhe vetë njeriun si pjesë e tyre. Mbi të gjitha ky roman mbart vlera për koherencën dhe mesazhet aktuale, që përçon artistikisht tek lexuesi.

*“Milosao 1 prill 2018”, “Gazeta Shqiptare”
by gazetashqiptare.al*

HYSNI BRUÇI, SI MODEL I POETIT KOMBËTAR

*Për librin e tij “Krojet e këtyre viseve thonë”,
me tetë cikle me poezi*



Libri “*Krojet e këtyre viseve thonë*”, me tetë cikle me poezi, i poetit Hysni Bruçi, është një prurje krejtësisht e veçantë dhe mjaftë cilësore në botimet me poezi të tri dekadave të fundit. Si njohës i thellë i historisë, kulturës dhe traditës dibrane, vlerat madhore të tyre i reflekton në poezinë e tij, të shkruar jo në një ditë, një vit apo një dekadë, por që në rininë e tij të herëshme të viteve ‘60-’70-të të shekullit të kaluar.

Vetë titulli i librit “*Krojet e këtyre viseve thonë*” është intrigues dhe të josh për ta lexuar. Po ashtu edhe titujt e cikleve: “*Si slynjare*”, “*Fshati rrëzë malit me pisha*”, “*Ankohen varret*”, “*Lisnaja përcjell mesazhe*”, “*Lulezodat e lirishtave të Runjës*”, “*Nëpër tërmete*”, “*Vite luftime*” e “*Dhe thonë rapsodite*”. Një lëndë aq e pasur dhe e larmishme si dhe vetë poezia e këtij liriku, që pas akumulimit të tij në pesë dekada sjell për lexuesin poezi që u shkrymbëzuan dhe u hirnosën, ndoshta

të ndryra në sirtaret e tavolinave të tij të punës si mësues, redaktor letrar në “Ushtima e Maleve” e inspektor i kulturës në ish-Komitetin Ekzekutiv të Dibrës...apo në sepetet e shtëpive të tij në Lukan, Muhurr e Peshkopi, dhe që dalin në dritë me një shkëlqim të rrallë.

Mjaftojnë qoftë dhe pak vargje nga poezia me titull “Bora e gjakut”: *“Ra bora e gjakut/ Dhe vatrën e prindërve/ E rralloi,/Berimin e vëllazërisë/ E përcolli/ E mpiksi/ Gjakun e probatinëve/Duarshërngimin/ E ngriu dhe krisi...”* për të konkluduar se si drithëron pena e këtij poeti, teksa percepton dhe fshikullon zakonet shfarosës.

Po ashtu tek cikli “Fshati rrëzë malit me pisha”, dallojmë poezinë lirike, si pjesë e rëndësishme e komunikimit dhe shprehje e botës së brendshme të autorit drejt lexuesit. Më e dukshme kjo tek poezia “Ngjyra, rreze, zëra”: *“Në livadhe kanë dalë luledet/ Ka filluar cijatja në zabele/ Në shtrunga sa s’derdhet kulloshtira/ Gjallojnë vathët prej shqerrave.../....Në dyqan të fshatit/ mbesën e vogël çova/ Fletorkë të re të më blejë/ Për vjersha...”*

Në tërësinë e këtij libri me 99 vjersha, Hysni Bruçi shfaqet si njohës perfekt i poezisë dhe veprave letrare në tërësi të Fishtës, Mjedës, Koliqit, Migjenit, Kutelit, Spasses, Kokonës, Dritëroit, Moikom Zeqos, Preç Zogajt, Shafki Karadakut, e tjerë, teksa na jep në këtë libër nuanca të dallueshme kulturore, në përputhje harmonike me zellin e tij studjues e krijues, me frymëzim nga “lulezojet e lirishtave të Runjës” apo dhe nga rapsoditë, që evokojnë dhe përcjellin ndër brza qëndresën e dibranëve në lufrat shekullore për liri e pavarësi kombëtare.

E pra, ndonëse shumë poezi i shkroi në vitet e sistemit të kaluar, Hysni Bruçi ka ditur t’i shmanget ndikimit të realizmit socialist, duke krijuar poezi me lëng e klorofilë, plot dritë e perspektivë në horizont. Le të ndalemi për ta konkretizuar këtë tek poezia “ATDHE” e ciklit “**Lisnaja përcjell mesazhe**”: *“Ushqyer këtë fjalë fëmijës/ Me ninullat e qumështin e gjirit;/*

Është zemra tek fjala Atdheu/ Fluturimi i dallëndyshes/ E foleja e skiferit.../ Është shamia e zezë e nënës/ E rrukullima e lotit të jetimit,/ Është çfarë ka sofrat/ E të zotit të konakut,/ Është edhe/ Pena e Dritëroit/ E huta e Dedë Gjo Lulit...”.

Nga tërësia e lëndës voluminoze, por edhe mjaftë cilësore e këtij libri, mund të konkludojmë pa asnjë mëdyshje se Hysni Bruçi është model i poetit kombëtar, ndaj duhet marrë si shembull që duhet ndjekur nga të rinjtë. Poezia e tij është e mbështetur në tabanin kombëtar dhe qëndron larg të ashtuquajturave skema të realizmit socialist.

Me këtë libër ai vjen si një xhevahir i ri, i rrallë, në gjerdanin e poezisë shqipe, të krijuar nga mijëra poetë shqiptarë ndër vite e shekuj.

Po kush është Hysni Bruçi (për ata që nuk e njohin nga afër)?

Në vitet ‘60-’70-të të shekullit të kaluar, në faqet e gazetave e revistave, të përditshme, javore e të përmuajshme periodike që botoheshin në Tiranë, do të tërhiqte vëmendjen firma e mësuesit Hysni Bruçi nga Muhurri i Dibrës. Publicistika e tij po zinte vend të rëndësishëm në gazetatat “Zëri i Popullit”, “Mësuesi”, “Bashkimi” etj. Po ashtu në rubrikat letrare-artistike të gazetave “Drita”, “Zëri i Rinisë” e “Puna” si dhe të revistave “Nëntori” e “Ylli” ai do të shfaqej, jo vetëm me reportazhe e skica letrare, por edhe me vjersha e poema.

Mësuesi i lëndëve gjuhë shqipe – histori në shkollën 8-vjeçare “Nexhat Agolli” Muhurr, në vitet 1960-1961, që kishte shërbyer edhe në shkollat e zonave Luzni e Kastriot si dhe me klasë kolektive në Rreth-Kale e Shqath (që kishte mbaruar me rezultate të shkëlqyera Shkollën e Mesme Pedagogjike “Ndrec Ndue Gjoka” në Tiranë e më pas edhe Shkollën e Lartë dy vjeçare pa shkëputje nga puna), do të shpërthente si një talent i rrallë në krijimtarinë poetike të asaj kohe.

Nërkohë, që nga të parët që u angazhua me Lëvizjen Amatore në fshat. Ai kishte lindur në Lukan, por u rrit e u

mirëformua në Muhurr, që ishte vendlindja e nënës së tij. Këtu mori arsimin fillestar dhe po nga Muhurri nisi rrugëtimin e tij të gjatë në fushën e mësuesisë, letërsisë, artit e kulturës. Pasi kishte spikatur për talentin e tij si poet me vjershat e poemat e botuara në shtypin qëndror, Hysni Bruçi mori pjesë edhe në përgaditjen e Almanakëve të parë letrarë “Dibra”.

Që me fillimin e botimit të gazetës lokale “Ushtima e Maleve” nisi të punojë aty, një vit si korrektor letrar e pastaj për disa vite si redaktor për kulturën e punën me talentet e reja letrare.

Në gjysmën e dytë të viteve ‘70-të, në Dibër po bëhej një hop përpara për gjallërimin e jetës artistike dhe kulturore dhe gazeta “Ushtima e Maleve”, sektorin e kulturës të së cilës e drejtonte Hysni Bruçi pati ndikim të dukshëm në nxitjen e promovimin e talenteve të reja. Madje, që këtu u evidentuan dhe u tërhoqën në institucione njerëz të pasionuar e të përkushtuar.

Në mars të vitit 1978 fillon punën në sektorin e kulturës të Komitetit Ekzekutiv, ku dha një kontribut të çmuar për organizimin dhe masivizimin e artit e kulturës në rrethin e Dibrës. Ishte koha kur u arrit që Estrada e Peshkopisë të klasifikohet “profesioniste” dhe të krahasohet me të Korçës, Sarandës dhe të Fierit. Ajo arriti të realizonte katër premiera në vit dhe të përfaqësohet denjësisht edhe në eventet kombëtare. Pasurimi i orkestrës së saj me instrumentistë të shkolluar të oboes, flautit, trombës, violinçelit etj, është padyshim edhe meritë e Hysni Bruçit që drejtonte sektorin e kulturës në Komitetin Ekzekutiv të rrethit. Ai inkurajoi dhe mbështeti muzikantë të talentuar që të krijonin e drejtonin grupe të ndryshme artistike. Në Lëvizjen Artistike u përfshinë këngëtarë që bënë emër brenda e jashtë vendit. U rrit profesionalizmi në trupën e aktorëve e të regjive të shfaqjeve; u rrit niveli artistik edhe me skenografinë e shfaqjeve. Gjatë kohës që Hysni Bruçi drejtonte Sektorin

e Kulturës në Komitetin Ekzekutiv të rrethit u krijua edhe Trupa e Teatrit Dramatik Amator që realizonte dy deri në tri premiera në vit. Vatër e argëtimit të fëmijëve u bë Teatri i Kukullave. Orkestra Frymore e qytetit të Peshkopisë arriti të marrë çmimin e dytë në takimin kombëtar të Korçës. Shtëpia e Pionierit po bëhej shkollë për përgatitjen e talenteve të reja. Dega e Librit, me çeljen e 16 librarive në fshat e në qytetet Peshkopi e Bulqizë përmirësoi dukshëm punën me librin. U krijua edhe Dega e Monumenteve të Kulturës. U ngrit edhe Ansambli Artistik “DIBRA” (që fatmirësisht e ruan edhe sot këtë emër), i cili arriti të japë shfaqje të suksesshme edhe jashtë vendit, si në Turqi, Prishtinë, Shkup etj. Hysni Bruçi pati rol parësor edhe në formimin e Shoqatës së Historianëve si dhe të Bërthamës Arkeologjike të rrethit të Dibrës. Puna studimore solli edhe riorganizimin e Muzeut Historik dhe ngritjen për herë të parë të Muzeut Etnografik të rrethit. Sipas një programi të posaçëm pune të Sektorit të Kulturës në Komitetin Ekzekutiv që drejtohej nga Hysni Bruçi, u ngritën Muzeu Tematikë në Dovalan, Sinjë, Okshtun, Bulqizë, Ostren, Lurë, Zerqan, Zogje e Kastriot. Po bëhej praktikë pune që çdo vit të organizoheshin sesione shkencore në zona.

Në tetor 1978, u zhvillua Konferenca e Parë Shkencore e rrethit për çështje të historisë e kulturës të Dibrës. Për herë të parë aty u paraqit projekt-ideja për Rugën e Arbërit, që po bëhet realitet në vitet e demokracisë, falë edhe rolit determinant të gazetës me të njejtin emër “Ruga e Arbërit” dhe Lidhjes së Intelektualëve Dibranë.

Në ato vite, Rrethi Letrar i Dibrës fitoi statusin e Degës së Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve të rrethit. Dhjetëra krijues dibranë që tanimë kanë botuar edhe librat e parë me poezi e tregime, debutimin e parë e patën në gazetën lokale “Ushtima e Maleve”, në kohën kur sektorin e artit, kulturës e letërsisë e drejtonte redaktori i talentuar Hysni Bruçi.

Për piktorët e skulptorët u dhanë 9 studio. Sektori i Artit Figurativ arriti që çdo vit të çelë ekspozitë. Punët e disa piktorëve dibranë zinin vend në ekspozitat vjetore kombëtare. Masivizimi solli që disa qendra pune e shkollat të ngrenë grupet artistike.

Të 26 shtëpitë e kulturës në zona arritën të ngrenë grupet folklorike me 50-60 pjesëmarrës. Në orkestrat e tyre hynë edhe instrumente të rrallë muzikorë si: gajdja e Klenjës, kavalli i Kastriotit, fyjet e Selishtës, lauria e Murrës, culet e Venishtit e Palamanit, sharkia e Çidhnës, pipzat e Lurës etj. Hysni Bruçi tregon se orkestra e grupit folklorik të Çidhnës kishte rreth 30 instrumentistë.

Po ashtu ai vlerëson krijimin dhe interpretimin e valleve si: vallja e brezave, vallet lirike të Grykës së Vogël e të Kalasë së Dodës, vallja e Xhafer Kabës, vallet dyshe të burrave të Zall Dardhës, Muhurrit e Maqellarës, vallja këmbë mbas këmbe e Katër Grykëve, Vallja “Hore” e Sllovës, vallja humoristike e Pollazhanit, etj.

Shpërthyen këngë brilante si: “Na knojnë pushkët nëpër kulla”, “Shtatë liqejt e Lurës”, “300 duvakët”, “Këngë për Mahmut Dacin”, këngët epike për Kosovën (“O prite Azem Galicën”, “Këngë për Jakup Ferrin”) etj. Emra këngëtarësh të tjerë dibranë u bënë të njohur e të dashur për artdashësit brenda dhe jashtë vendit Vlerësimi i mëtejshëm i punës me folklorin, për të cilin H.Bruçi tregoi përkushtim të rrallë, bëri që Dibra të marrë vendin e parë në Festivalin Folklorik kombëtar të vitit 1978.

Hysni Bruçi ka realizuar edhe kumtesa e studime për çështje të historisë e kulturës së kësaj treve. Ato janë referuar në Sesione Shkencore e disa janë botuar në revista e organe shtypi. Të tilla kanë qenë: “Tema e Qëndresës në krijimtarinë e popullit”, botuar në “Dibra e dibranët”, “Vlera pedagogjike në Abetaren e Kolë Gjumarit”, botuar në gazetën “Mësuesi”, “Disa të dhëna historike për lidhjet e Dibrës me Qeverinë e Vlorës

të 1912-tës”, mbajtur në Konferencën Shkencore të Kulturës të rrethit (1978); “Mbi disa shkaqe e koncepte të mënyrës së jetesës” si dhe “Shkaqe e pasoja të thashethemeve”, botuar në “Zëri i Popullit”. Gjithashtu Hysni Bruçi ka realizuar trajtesa me vlerë, si: “Ornamenistika në kostumet e shtatë zonave etnografike të Dibrës”, “Instrumentistë në kohë që bënë emër dhe Orkestra Folklorike e Dibrës”, “Figura mëmëdhetare të Dibrës dhe çështje të simboleve përkujtimore”, “Zall Dardha – një nga djepet e folklorit të Dibrës”, “Rapsodia Dibrane dhe profile rapsodësh” etj. Do të mjaftonte qoftë dhe botimi në një libër i këtyre kumtesave, studimeve e trajtesave, të realizuara, të mbajtura në sesione shkencore e të botuara me firmën e Hysni Bruçit, për të kuptuar kontributin e tij të veçantë për zhvillimin e letërsisë, artit e kulturës në Dibër.

“MARTESA E DYTË”, ROMANI I RIPËRTËRITJES SË FAMILJES

*Pas tri dramave për fëmijë e një studimi
për folklorin, Flamur Buçpapaj boton
romanin e mirëpritur nga lexuesi*



Në vlerësimin që para dy vitesh, shkrimtari i mirënjohur Teodor Laço i bënte gazetës kulturore-letrare “NACIONAL”, si promovuesja më e mirë e letrarëve të rinj, ndër të tjera do të shprehej për “një tufë poetësh, zëra të rinj poetik që derdhën frymëzimin e tyre, veçanërisht nga tre burime: Tropoja – farefisi Buçpapaj, Hamit Aliaj e të tjerë; Preç Zogaj, Ndoc Gjetja, Agim Isaku nga Lezha; Petrit Ruka, Ilirirjan Zhupa, Qazim Shemja nga Tepelena, ‘provincialë’, por që më vonë u bënë autorë të njohur të letërsisë dhe gazetarisë”. Dhe pikërisht nga “dinastia krijuese Buçpapaj”, po spikat një tjetër autor, që përveçse si themelues dhe drejtues i Radio “Nacional” po hedh hapa të sigurt edhe në prozën e gjatë. Kështu, Flamur Buçpapaj, pas tri dramave për fëmijë e një

studimi për folklorin në zonën e Tropojës, botoi më romanin “Martesa e dytë”, që është mirëpritur nga lexuesi. Ngjarjet në roman zhvillohen në një fshat të thellë malor, që autori e quan thjesht Bokë. Aty ku komunizmi bëri gjëmën duke synuar të zhdukë emrin e familjeve të mira. Në këtë vend, një rrafshnaltë poshtë një mali të lartë, rastësia apo fati, i bashkoi Jetonin me Borën që përpiqen të ringrenë emrin e familjes së tyre të nëpërkëmbur nga komunizmi. Galeria e personazheve në romanin e Flamur Buçpapës është e gjerë, por rreth këtyre dy të dashuruarve gjer në marrëzi ndërthuren jetë dhe realitete shqiptare që gjallojnë si të vërtetë.

PA DASHURI NUK KA RILINDJE TË JETËS

“Martesa e dytë” është padyshim një roman tërheqës, me ngjarje e personazhe të përshkruar mjeshtërisht. Autori, Flamur Buçpapaj ka skalitur veçanërisht portretet e Borës dhe Jetonit, por personazhe interesantë janë edhe nënë Ajshja, magjistarja Bukuriye, Naimi, shoku i ngushtë i jetonit murgeshat si dhe motra e vogël e Borës. Subjekti tepër interesant të bën të mos largohesh prej tij nga faqja e parë deri te e 218-ta. Jetoni dhe Bora, dy personazhet kryesorë, të lidhur që në gjimnaz, të dy nxënës shembullorë krijojnë një familje solide. Por Jetoni që rridhte nga familje bajraktarësh nuk lejohet të vazhdojë studimet e larta dhe sa vjen demokracia emigron në Gjermani, ku brenda një harku kohor pesë vjeçar merr shtetësinë gjermane, ndërkohë kryen dhe studimet e larta për jurisprudencë. Bora, nga ana e saj, ndonëse vajzë qyteti ruan nderin e burrit duke u kthyer në robinë e fatit të saj, si shërbëtore e vjehrrës e deri duke kryer punët më të rënda të bujqësisë e blegtorisë. Siç e përshkruan autori “Bora, një gërshetim i bukurisë me zgjuarsinë, me ndershmërinë dhe bujarinë...një gjë e bekuar që rrezaton hijeshi dhe paqe...”, do të bëhej më e respektuara në fshatin Bokë, jo vetëm për faktin

që ruajti nderin e burrit, por edhe pse shërbeu vullnetarisht si mësuese e fëmijëve të fshatit. Lajtmotivi i saj ishte “Pa dashuri nuk ka rilindje të jetës”. Dhe mbi të gjitha për të ishte dashuria për Jetonin që do të ringjallte shtëpinë e bajraktarit të zonës. “Bora kishte mbledhur folklorin e zonës dhe fjalët e urta popullore, duke bërë në mend që një ditë t’i botonte në një libër me folklorin e zonës dhe poezi...”. Ndërsa “Jetoni krenohej: E kam nusen poete, filozofe!...”

TRAGJEDIA E RIPËRTËRITJES SË FAMILJES

Fshati Bokë shtrihej më lart se Valbona, thuajse dy orë të mira më këmbë, ku siç shprehet autori F. Buçpapaj gjithë frymëzim: “në mëngjes me pi çaj mali, në darkë qumësht më mazë e të hash bukë çerepi, është jetë përrallore...ushqim bio...”. Pikërisht këtu po e rindëronte jetën Bora, vajza e kolme nga qyteti. “gjithë kjo femër, me gjithë këtë gjoks e gjithë këto këmbë që s’ka prekur njeri për pesë vjet..., e që siç meditonte herë pas here ajo vetë: “gati po bëhem e virgjër!”. Autori përshkruan aq bukur ndjenjën e dashurisë njerëzore, madje duke filozofuar për dashurinë. Nisur nga profili i personazhit kryesor t romanit të tij, Bora, autori jo më kot shprehet se “Femrat kanë nevojë për dashuri në radhë të parë...për ngrohtësi, mirësjellje, seksi është i fundit...Për Zotin e kam harruar fare seksin!!!!”. Edhe vjehrra Ajshja, mendonte si për çudi të njëjtat gjëra: “Është e re e shkreta dhe ia kërkon trupi, se rinia pa dashuri është si mali pa gjethe dhe ngjason me ndonjë zog të vetmuar”. Por fati i keq, edhe pas ekzaminimeve mjekësore kishte rezultuar se kjo krijesë hyjnore nuk mund të lindte fëmijë. E kjo sipas Kanunit do të shkaktonte gjëmën, sepse Jetonin do ta detyronin të kryente një martesë të dytë me një grua tjetër, vetëm për të lindur fëmijë e për të ripërtërirë familjen e bajraktarit... “Të gjithë uronin që Bora të qëndronte në atë shtëpi dhe në atë fshat

dhe se ajo të mos bënte zgjedhje radikale, të largohej..Kjo do të ishte një tragjedi, jo vetëm për familjen e tyre, por dhe për fshatin e tyre i cili jetonte me bëmat e saj dhe respekti i tyre për të është shumë i madh. Të gjithë e donin dhe krenoheshin me të. Ajo ishte bërë e famshme jo vetëm për ato që bëri, por dhe për kujdesin ndaj të varfërve dhe Zotit... Ndaj dhe Jetoni përulej para saj me admirim...”. Më tej autori shprehet se “Ankthi se nuk lindte fëmijë e kishte shoqëruar Borën gjatë gjithë kohës, edhe pse mjekët ia kishin thënë troç, se veçse një mrekulli do ta bënte të lindte fëmijë...Se Zoti, i kishte thënë magjistarja Bukuriye, e bën fëmijën nga toka dhe jo nga barku i Nanës...Zoti e bëri njeriun për ta bërë zot të këtij planeti. të gjithë ata që bëjnë kundër vullnetit të Zotit kanë për ta pësuar...”. Pikërisht në këtë vorbull gjykimesh edhe Jetoni do të lëkundej para presionit të farefisit, që i bindej përcaktimit të fatit të Borës nga magjistarja Bukuriye. Ndonëse investon në infrastrukturë e në përpunimin e produkteve bujqësore e blegtorale, si e si që ta lumturojë sa më shumë edhe nusen e tij të bukur Borën, edhe ai “pranon pa dashje” martesën e dytë. Dhe kur Bora viktimizohet pikërisht nga ky fakt, edhe Jetoni “harron martesën e dytë” dhe deshi të vetëvritej, duke pirë një kuti me ilaçe. Fati e deshi që ai, ndonëse rast i rrallë, të shpëtonte, pas gjëmës së madhe që shpoi qiellin pranveror të fshatin Bokë.

DASHURIA VAZHDON DHE NË BOTËN TJETËR

“Jetoni e rregullonte varrin e saj tek bliri, 100 metra afër shtëpisë, që e kishin mbjellë ditën e martesës së tyre. I vadiste lulet çdo mëngjes. ishte e njëjta dashuri si në jetë. Dashuria vazhdon dhe në botën tjetër. Gruan të cilën e dashuron me të vërtetë nuk mund ta duash vetëm në këtë botë. Ajo e meriton dhe në jetën tjetër...”. Dashuria e Jetonit për Borën është më e madhe se çdo rregull, Kanun....Megjithatë, nusja e dytë erdhi

sërish në këtë shtëpi, disa muaj pas vdekjes së Borës, e cila ishte larguar për të mos u kthyer kurrë, një orë pasi kishte ardhur për herë të parë nusja e dytë. “Ajo erdhi. ka fat!. E gjeti çdo gjë të ndërtuar, burrin, shtëpinë e të gjitha....Dridhem kur e kujtoj se ajo do të prekë burrin tim, shpresën time që mendoja se nuk do të ndahesha kurrë deri në vdekje...”, kishte shkruar në letrën e saj të lamtumirës, Bora, gruaja e bukur. Dhe kjo ndodhi, sepse siç shkruan autori në këtë roman “Humbja e dashurisë është njëlloj sikur të ndalojë dielli dhe të mos ketë më ditë... Dhe se dita është njësia themelore e jetës dhe se “jetë pa dashuri si duket nuk ka në qytetin verior”, ku personazhi kryesor i tyre po i lëkundte marrëdhëniet me jetën.”. Megjithatë, Jetoni që po ripërtërinte shtëpinë e të parëve, ishte ndër të parët që deklaronte dashurinë e tij për gruan e parë. “...Në zemrën time s’do të ketë më vend për dikë tjetër, vetëm ajo Bora, që s’do të shkrijë kurrë në jetën time sa të vdes. Ajo ishte dhe është ylli i jetës sime...” Si për të përligjur këtë filozofi të jetës në fshatin e largët malor, autori e përmbyll kësisoj romanin “Martesa e dytë”: “Pas një viti në shtëpinë e Jetonit, lindi një vajzë e vogël, e bukur, me emrin Bora. Të gjithë e pritën dimrin që të shikojnë çfarë bore ka rënë nga qielli...”

GËZOHU KUR E SOTMJA KA KËNAQËSI, TË NESËRMES NUK I DIHET

“Jeton, mos më merr për të çmendur dhe as për të fiksuar. Unë jam e vetmja femër që të dua me shpirt dhe se shpirti nuk vdes kurrë. Ai endet në ajër për jetë të jetëve..Një jetë në dy trupa!... Ika Jeton..të dua...të pres të vish të më marrësh”.. Mjafton qoftë edhe vetëm ky perifrazim për të kuptuar filozofinë e autorit Flamur Buçpapaj për jetën. Kjo del qartë edhe në dialogun e sipërmarrësit të ri të fshatit Bokë me shokun e tij të ngushtë, Naimin, teksa i thotë: “Gëzohu kur e sotmja ka lezet,


të nesërmes nuk i dihet”. Brenda kësaj filozofie janë edhe idetë e personazhit kryesor për shtetformimin e progresin. Me gjithë predikimet, trajtimi i një teme mjaftë delikate, si ajo e ruajtjes së traditës familjare, sidomos të një familje bajraktari të nëpërkëmbur nga komunizmi ia rrit vlerat autorit, i cili me një gjuhë të pasur ka përshkruar një histori rrëqethëse shumë afër reales. Por, Flamur Buçpapaj dëshmohej edhe si njohës e përcues i filozofisë së jetës dhe shtetformimit, duke sjellë fakte të reja edhe nga koha e sundimit të ideologjisë komuniste si dhe nga postdiktatura. Nga analiza e mirëfilltë e këtyre fakteve autori arrin në përfundimin se çdo gjë e re sjell dinamizëm, organizim të ri. Kjo edhe për faktin se shqiptarët kanë qenë gjithmonë në agresion.. Gjithsesi, autori me keqardhje konstaton se krahas sulmeve të jashtme kemi vrarë vazhdimisht njëri-tjetrin dhe se shumë pak njerëz kanë falur gjakun me njëri tjetrin. “Si nuk doli një burrë si Anton Çeta në Kosovë të ndalojë gjakmarrjen, sidomos në Veri?”, ngre pyetjen autori. Dhe duke perifrastuar intelektualin e mirëfilltë që ka qejf të ecë demokracia përpara e të kapim hapin e Evropës, sepse regjimi komunist na ka lanë shumë mbrapa (Komunistët janë të pandreqshëm si gungaçi, që vetëm vdekja ua shëron gungën, shprehet ai), “Elita që punon më mirë për popullin e vet qëndron më gjatë në pushtet. Ajo kujdeset për infrastrukturën, papunësinë, progresin shoqëror”.

Gazeta “TELEGRAF”, 28 gusht 2018

<https://telegraf.al/i-pakategorizuar/martesa-e-dyte-romani-i-riperteritjes-se-familjes/>

“NJERIU ME MASKË”, SI SKANER I NJË REALITETI TRONDITËS

Romani i parë i Agim Demirit, me një subjekt që mbush një zbrazëtirë të dukshme në analet e letërisë shqipe



Pas suksesit me disa studime për kuptimin e shprehjeve e fjalëve të rralla frazeologjike, për disa dukuri fonetike të të folmës së Bulqizës, për probleme të “analfabetizmit funksional”, sidhe me prozën e shkurtër, duke publikuar disa tregime që janë mirëpritur nga lexuesi e kritika letrare, shkrimtari Agim Demiri botoi më së fundmi romanin e tij të parë “Njeriu pa maskë”.

Për vetë tematikën nga një kohë jo shumë e largët, kur kuadrot mediokër e militant partiakë të tejskajshëm, të vënë padrejtësisht në drejtimin e punëve, përshpejtuan fundin fatal të sistemit komunist, ky roman mbush një zbrazëtirë të dukshme në analet e letërisë shqipe.

Portretizimi brilant i dy personazheve kryesorë: sekretarit të Byrosë të fshatit malor të Cakulit dhe përgjegjësës së kulturës të këtij fshati, e bën më tërheqës veprën letrare,

kompozicioni i së cilës i ngjan një ansambli ku interpretojnë mjeshtërisht artistë popullorë të disa gjinive e zhanreve.

Ngjarjet zhvillohen në mënyrë të atillë saqë të tërheqin për ta lexuar romanin me një frymë. Veprimi i personazheve mjaftë energjikisht në kahje të kundërta: nga njëra anë Zeneli – tornitori që kur u thirr për t’u bërë kandidat partie nuk dinte as kuptimin e fjalës “komunist”, por që më pas Partia e ngjiti në majë, dhe nga ana tjetër Ramia, përgjegjësja e kulturës që po materializonte dijet e marra në shkollë në këtë zonë të thellë malore, sjellin në vëmendjen e lexuesit kohën kur sundonte skamja e varfëria, por edhe mediokriteti e meskiniteti i drejtuesve partiakë.

I ndërtuar në dy pjesë, përkatësisht me 13 dhe 17 krerë, romani rrëfen ngjarje dhe episode vërtetë tronditëse të atij realiteti të hidhur. Vajza e re nga qyteti shkon për të përçuar kulturën e jetesës, por dhe atë të artit në një fshat ku pothuajse jetohej si në mesjetë dhe numri një i partisë, në vend që ta mbështesë e inkurajojë, përpiqet me të gjitha mënyrat e mjetet që ta nënshtrojë e poshtërojë atë dhe pasi nuk ia arrin kësisoj, i ngre akuza nga më absurdet.

Me një gjuhë të pasur artistike autori shtjellon këtë antagonizëm, ku padyshim triumfon me iokriteti që sundon deri në rangjet më të larta të partisë e pushtetit monist.... Mjafton për këtë qoftë dhe rrëfimi i skenarit të sekretar Ramizit, i cili ndonëse nuk ka haber nga problemet e arsimit, pasi vetë kishte mbaruar një të mesme natën, vë nën tutelë funksionarë të seksionit të arsimit të rrethit dhe “uzurpon” deri dhe analizat në këshillin pedagogjik.

Struktura dhe kompozicioni i romanit ku spikasin personazhe të ndryshëm nga struktura e një ish kooperative malore, sjellin një zhvillim real të personazheve dhe frymëmarrja e tyre shfaqet si një rrëfim duke ndriçuar historinë e secilit, pa rënë në një historizëm letrar. Kjo duket tek veprimi i personazheve të tillë si Deliu-kryetari i këshillit

të Bashkuar, drejtori i shkollës, Hamdiu, njëherësh dhe kryetar i këshillit Artistik, Sekretari i rinisë, Llani, shoferi i kooperativës që “theu” urdhërin e kryeagronomit për të mos marrë pjesë si këngëtar në grupin artistik të fshatit, etj. Ndërkohë risi e këtij romani janë pjesët “Kreu pa numër”, ku autori, me gjuhë të pasur letrare jep konkluzione pas rrëfimit të veprimtimit të një personazhi apo të një ngjarjeje.

Në tërësinë e tij, ky roman ka disa fakte “pikante” të asaj periudhe të çmendur. Sekretari i Byrosë që para se të bëhej kandidat partie kërkon nga e bija, Sofia, t’ia bëjë të qartë kuptimin e fjalës “komunist” dhe ajo e zënë ngushtë , s’di ç’ti thotë, veçse i reciton “...me 200 petrita, komunista lule...”, vite më vonë vë nën akuzë përgjegjësen e kulturës, pse ajo paska lejuar që në një festival folkorik të këndoheshin vargjet e këngës popullore me një tekst të tillë: “Tum tum lodra/ s’ka mish vorba/ ku ta gjejmë mishin/ veç të therim këlyshin....!!!!”...Këto vargje, ia shndrruan në akuzë ata të Degës së Punëve të Brendëshme me pretextin se aludohej për bagëtinë e fshatarit që ia kishte marrë tufëzimi...

Qoftë edhe episode të tilla të çojnë në konkluzionin e dy linjave kryesore mbi të cilat është ndërtuar romani “Njeriu me maskë”. Janë këto dy linja, njëra horizontale e tjetra vertikale që shkojnë e vijnë brenda një strukture të ndërlikuar me linjëza të tjera. Në veprimtarinë e Ramies zë e formësohet fati i ngrirë i një vaje të re të shkolluar, që do të përhapë të renë, progresisten, duke reaguar ashpër kundër realitetit tronditës kur sheh se “Gratë ishin ngarkuar me barrë në shpinë si mushka”. Në linjën tjetër rrjedhin intrigat e fuqishme të thurura nga kreu i partisë në ish kooperativën malore të Cakulit. Këto intriga konsistojnë në zhbirimin deri te enigma e shkuarjes padashur të përgjegjëses së kulturës tek shtëpia e “armikut të klasës”, e detyruar qoftë dhe për t’u larë, sepse që kur kishte ardhur në këtë fshat e kishin sistemuar në një dhomë të shkollës pa asnjë kusht...Po kësaj linje i përkasin

dhe mbushja e dosjes së Ramies me cikërrima të tilla, si, reagimi i saj për të mos lejuar shfaqje të filmave në natyrë nga kinooperatori, si në rastin e filmit “Ne dhe Lenini” që ai s’i dinte as titullin dhe ku dëgjohej vetëm “tovarish Lenin sllushajet !!!”. Si mund të lejohej që një film krejt i paqartë, në gjuhë të huaj, me përkthim që nuk dukej se si ishte shkruar, të shfaqej kështu me disa fëmijë dhe të regjistrohej: “ u shfaq për popullin!”... Por edhe ky reagim i Ramies u keqinterpretua nga sekretari byrosë...

Në romanin “Njeriu me maskë”, zëri i rrëfimitarit ndërkëmbehet me atë të personazhit. Ligjërimet e brendshme të personazhit, mendimet apo përjetimet e tij që ndërtojnë diskursin e personazhit, depërtojnë në ligjërimin e rrëfimitarit të jashtëm. Kjo duket qartazi tek rrëfimi i Ramizit, babai i Dritanit, recituesit më të mirë të shkollës. Ai ishte shpallur i deklasuar, pasi babai i tij që kishte patur shumë ndikim në fshat, kur kishin kaluar nëpër atë zonë forcat gjermane që vinin nga Struga u kishte nxjerrë flamurin e bardhë, që tregonte se jemi për paqe....” Atë e fajngjitën për tradhti ndaj atdheut dhe e pushkatojnë.....” Më pas kalvari i familjes për këtë shkak!!!... Por Ramizi ishte njeri i punës, me shtëpi moderne të kohës dhe me pasuri të vënë me mund e djersë, siç kishte edhe qindra koshere bletësh.... Ramia nuk e dinte këtë “sekret”, por e pësoi pse shkoi tek kjo familje e deklasuar?! Dikur ajo, në shkollën e mesme të Kulturës në Tiranë kishte interpretuar “Cucën” tek drama “Cuca e Maleve”, ndërsa tani do tëurvejohej nga agjentët e Degës së Punëve të Brendëshme, pse paska recituar gjatë një shfaqjeje një fragment që sikur thoshte partizani komunist: “ky xhelat me plumba më mbërtheu..ky xhelat ma griu shpirtin tim...”. Por nënteksti për sekretarin e Byrosë ishte i qartë, xhelati për të ishte vetë ai, Zeneli.... Ky xhelat...,-thoshte ajo, dhe njerëzit mbanin frymën....

Rastet e një përzierje të tillë të ligjërimin të rrëfimitarit me anë të personazhit nuk janë rastësore. Ato shtrihen përgjatë

gjithë veprës dhe i shërbejnë qëllimit final të ekzistencës së këtij romani. Ndërthurja e ligjërimeve në këtë roman është e dukshme dhe mjaft efikase në funksion të mesazhit që përcjell vepra: “Kur Ramia kishte gati programin artistik për festat e nëntorit për ta shfaqur para popullit dhe përrurimin me këtë rast të shtëpisë së kulturës, sekretari i Byrosë që s’kishte haber nga punët e kulturës vë veton: përrurimi nuk bëhet si e keni menduar ju! Do vemë rreth e rreth tavolina, stolat janë dhe do organizojmë një drekë këtu me pije etj...Do marrim një berr nga të kooperativës dhe do ta kuzhinojmë në mensë dhe më pas pjata e pije.....!!!”. Por Ramia, kurrësesi nuk mund të vepronte kështoj; koncertin e mirëpërgatitur do ta jepte për popullin dhe jo për zyrtarët e kooperativës....Dhe kjo do t’i kushtonte në përbaltjen e personalitetit të saj, qoftë dhe duke nënvizuar përpjekjet për të sjellë televizorin dhe librat për bibliotekën e shtëpisë së kulturës, që mund të përdreshin në funksion të armikut të klasës.


Njoftimet që i shkonin Degës së Punëve të Brendëshme ishin të tilla sikur kjo vajzë që kishte ardhur si përgjegjëse kulture në Cakul po bashkëpunonte me armiq të partisë dhe po bënte punë armiqsore...

Si e tillë, kjo vepër merr përmasa të gjera dramatike në brendinë e vet, si një strukturë që ngrihet mbi vetë zhanrin e dramës artistike dhe mbi vetë dramën reale që zhvillohet para syve të njeriut gjatë regjimit totalitar. Për ta kontretizuar këtë, mjafton të perifranojmë autorin në mbyllje të veprës: “Një gaz dege që erdhi natën kishte ndaluar si armike përgjegjësen e shtëpisë së kulturës, Ramie Lama.. Po atë natë bastisën dhe shtëpinë e kulturës duke grabitur gjithshka, librat.. stolat... Partia me syrin vigjilent kishte zbuluar një armike të rrezikshme...”!

Botuar në Gazetën lokale periodike “BULQIZA”

“E PUTHURA”, LIBRI QË E IDENTIFIKON ANDON ANDONIN SI NJË MJESHTËR TË PROZËS SË SHKURTËR

Tek tregimi me të njejtin titull autori e trajon temën e dashurisë përmes përdorimit të detajeve psikologjike të portreteve të personazheve.



Me njëzetëetë tregimet e zgjedhura, të përmbledhura në librin “E puthura”, Andon Andoni vjen sërish për lexuesin si një mjeshtër i prozës së shkurtër. Në gjurmët e xhaxhait të tij, tregimtarit të famshëm Sotir Andoni, por edhe si besnik i shkollës Kuteliane, ai vijon të shkruajë tregime, që pasi i ke lexuar të nxisin për të “rërmuar” më tej në botimet e mëparshme të këtij autori, siç janë: “Tek kilometri 39” (1987); “Guri në mes të lumit”(2002)’, “Nusja” (2005); “Kohë e çmendur për dashuri” (2007); “Dane Çiçua dhe rrëfenja të tjera”, si dhe “Fryma e bardhë”(2016).

Këto vëllime me tregime në shtatë libra, si dhe dy romanet e tij: “Gri” (2009; “Plaku në mes” (2011), dhe monografia

Kostë Çekrezi: i treti i munguari” (shumica botime të “M&B”, ndër botuesit më të suksesshëm të dy dekadave të fundit), janë tregues i një biografie mjaftë të pasur krijuese të Andon Andonit, të krijuar në harkun kohor të tridhjetëpesë viteve (1987-2022).

Por le të ndalemi më konkretisht tek libri i fundit i tij, “*E puthura*” (tregime-2021).

Ky vëllim nis me tregimin e titulluar “*Kisha*”, ku kemi të bëjmë me një ligjëratë të mirëfilltë artistike, pra me një prozë letrare. Aty rrëfihen ankthi, pasiguria por edhe vendosmëria e besimtarëve të krishterë të fshatit Guras për ringjalljen e Kishës së Fjetjes së Shënmërisë, që sipas autorit “s’mbahej mend që kur qe ndërtuar”. Këta besimtarë të devotshëm janë vështruar e trajtuar nga autori në planin njerëzor, në drama dhe situata psikologjike, ndërtuar me përshkrime, me dialogë e monologë, tipare këto të prozës artistike.

“Në të vërtetë, prej disa breza, gurasit patën kishë, por prift jo. Pasi qe vvarë papa Gjergua nga ajo cifël guri në Luftën e Madhe, as që donte të dorëzohej prift ndonjë prej burrave e djemve të katundit....Prifti i vdekur në oborr të kishës nuk kishte pasur ndonjë shenjë prej gjaku pas koke. Por ja që katundi ja kishte vënë fajin luftës dhe asaj cifle guri të qemerit, që bashkë me dy numrat 85 apo 58, pat marrë edhe jetën e vetë shërbetorit të perëndisë, papa Gjergos...”. Qoftë edhe ky perifrazim nga faqja 11, e këtij libri mjafton për të qëmtuar rrëfimin mjeshtëror të këtij autori, gjë që mund ta konstatojmë edhe më tej në vijim të këtij tregimi: “Por erdhi shumë shpejt koha, kur në tërë vendin, me demek rinia po i digjte e shkatërronte kishat e xhamitë, e ata në Guras kërkonin prift se kishën e kishin top e të palëkundur aty mbi kodrinën, në mes të katundit!?” (fq.18).

Dhe padyshim, pasi ke lexuar njëzetëetë tregimet e këtij vëllimi, vëmendja kryesore shkon tek *E puthura*”, titull ky intrigues i këtij tregimi që autori jo pa qëllim e ka vënë edhe

si titull të librit të tij të dymbëdhjetë. Është tema e dashurisë që përshkon thujse gjithë lëndën, të cilën A.Andoni e trajton përmes përdorimit të detajeve psikologjike të portreteve të personazheve.

Tek tregimi “*E puthura*” është dashuria e konsumuar nga zyshë Xhuli e anglishtes me maturantin rebel, Deni, të cilin pasi kishte dalë nga burgu të gjithë mësuesit nguronin ta kishin në klasën e tyre të kujdestarisë. Dhe kjo ndodhi një ditë, kur Deni erdhi në klasë i mbështjellë me një batanije, dhe kur Zyshë Xhuli e mbajti pas orës së mësimit për ta ndëshkuar.. Por “*sytë e tij blu ishin mishërues. Vështronte në bebëzat e saj plot sfidë... Zyshë Xhuli donte ta qëllonte, mbi faqe, siç bënte drejtor Rimi; frap-frap...Pastaj ta qëllonte mbi gjoks me grushtet e mbledhura sa që po i gjakosnin pëllëmbët...mund ta hante me dhëmbë mbi gjoks, mbi zverk, mbi krah...Kokat iu ishin afruar aq shumë sa hundët po ju tokeshin dhe frymët iu këmbeshin mbi fytyrë. Dhe...nuk bëri asnjëherë nga sa mendoj, por e puthi në buzë... Vetëm njëherë me buzët e saj të thara*”.

Nga ky perifrazim (fq.155-166) dallohet pastërtia e gjuhës, hijeshia e rrëfimit, përshtatësija e fjalëve

, ritmi e ndërtimi estetik i tyre në konsumimin e një ndjenje aq të pastër njerëzore.

Gjithsesi, në këtë libër si edhe në disa të tjerë të këtij autori sundon jeta e fshatarit devollj, kryesisht nga vendlindja e tij, Ziçishti, me të cilën autori është i lidhur ngushtësisht si askush tjetër. Nga atje ka marrë nektarin e luleve, bukurinë e hijeshinë e maleve, brengat e hallet e bashkëfshatarëve të cilat i kanë shërbyer si fabula të tregimeve me titull: “*Gratë e katundit*”, “*Ura e nuses*”, “*Java e dasmës*”, “*Kodrat e Ziçishtit*”, “*Ariu*”, “*Dylbitë*”, etj.

Po ashtu, plagët e kurbetit, tek tregimet e këtij libri, janë ndër më të spikaturat, si nga fabula e ngjeshur dhe dinamike, ashtu edhe nga lirizmi i gjuhës. Kështu, pasi ke lexuar tregimin “*Emigranti*”, e kupton fare qartë se autori ka të drejtë

kur shprehet se “Kurbeti i devollinjve është i dhimbsur, po të kesh parasysh se ikin dhe e mbajnë kokën gjithmonë pas, nga njerëzit që lënë këtu, gjë e mall. Ikin, dhe zemrën e shpirtin e lënë tek vendlindja”. Tregimi “Emigranti” është një apologji e kësaj dhimbjeje.

“Po mbusheshin tridhjetë vite që Ai ishte larguar nga shtëpia nëpër udhët e botës, por tani sa vinte dhe më shumë i dilte përpara syve dita e parë kur kishte ikur...Por ndodh që fati të të nëpërkëmbë dhe udha e jetës merr tjetër rrjedhë. Një mëngjes, teksa kryente punën në kuvertë mori lajmin se nënë Meni kishte vdekur. Ngarendi nëpër anijen që lëkundej si guaskë dhe gati u hodh në det të niste udhën e kthimit ta arrinte t’i hidhte një dorë dhe nënës plakë...”

Është kjo vërtetë një simbolikë therrëse, kur siç shprehet autori A. Andoni “...bija e bija ikën larg në mërgim, dhe vetëm tymi i bardhë i avionave në qiell i lidh me të afërmit, apo ndonjë telefon i varur në degët e gështenjës, që përdorte gjithë fshati në fillim të viteve 90, ua sillte pranë zërin e mallëngjimit”.

Për të mësuar se sa dhe si ta pëlqejnë letërsinë, lexuesit, Andon Andoni pohon se gjithmonë ka falur libra poshtë e përpjetë, miqve të tij, shkrimtarëve e ustallarëve të mirënjohur dhe deri tek ata që i ka miq e të njohur e më pak të njohur, me shpresën që t’ia lexojnë për çka është lodhur dhe ka paguar para për ti botuar. Dhe sigurisht, bashkëfshatarëve të tij ua dhuron me dëshirë dhe me autograf, i bindur se do gjejnë brënda tyre, jo vetëm rrugët dhe natyrën, çezmat e ujit me sylinarë të bronxët, dashuriçkat e rinisë nën shelgje, por të kuturitur tani nëpër udhët e botës dhe që kthehen në vendlindje më të rrallë si zogjtë shtegëtarë, për ditën e Pashkës a të Shënmarisë, do t’ua u ndizte mallin përmes leximesh... Është kjo një nga mënyrat e përhapjes dhe promovimit të librit, në kohën që nga egërsia e rrjeteve sociale, gjithnjë e më shumë po ushtrohet trysni mbi librin e printuar. Por Andoni Andoni, i njohur dhe vlerësuar nga elita krijuese e vendit, duhet ndjekur edhe kësajsoj.

VEPRA KRIJUESE E DR.HAJRI MANDRIT NË TRI DIMENSIONE

Për poetin, dramaturgun dhe studjuesin e shembëlltyrës në folklor dhe letërsi, me kontribute të çmuara në pedagogjinë speciale, ku më evident ky kontribut shfaqet te libri i tij shkencor “Tiflopedagogjia”



Para tre dekadash, në konkursin kombëtar të teatrove të njëjësive të ushtrisë, si metodist i punës kulturore në ish - shtëpinë e ushtarakëve të divizionit të Bulqizës, për t’iu përshtatur tematikës, zgjodha për të konkuruar me dramën “Bregdrinasit”. Autori, Hajri Mandri, ishte i njohur për kohën, pasi kishte botuar edhe drama të tjera. Madje, drama e tij “E fejuara”, e inskenuar nga trupa amatore e pallatit kulturës Bulqizë, pati një numër rekord shikuesish.

Për interpretimin e arrirë artistik dhe veçanërisht për faktin se drama “Bregdrinasit” kishte si subjekt historinë e “gjeneralit me shajak”, Elez Isuf Ndreu, trupa e shtëpisë së kulturës të divizionit të Bulqizës zuri vendin e parë në rang kombëtar.

E solla në vëmendje të lexuesit këtë fakt për të evidentuar një talent të “fshehur” të Dr.Hajri Mandrit, atë të dramaturgut. E dëshmon këtë talent qoftë edhe vetëm drama “Bregdrinasit”,

me paraqitjen imponante dhe burrërore të Elez Isufit, që rrezatonte ngjashmëri me heronjtë antikë.

Ngritja në art e aktivitetit të tij atdhetar, është një vlerë e shtuar për dramaturgun Mandri.

Nëpërmjet dialogimit të personazheve, heroit kryesor Elez Isufi dhe bashkëkohësve të tij, Sufë Xhelili, Osman Paci etj, vjen jehona e asaj kohe të largët kur kryengritësit dibranë mbrojtën me stoicizëm trojet e tyre kundër pushtuesit serb. Fjala artistike në dramën e Hajri Mandrit e sjell “gjeneralin e veshur me shajak” në të njëjtin nivel të atdhetarisë së gdhendur me gërma të arta në historinë tonë kombëtare. Mandri ka meritën e ngritjes në art të këtij biri besnik të atdheut, luftëtar i shquar për çlirimin dhe bashkimin e trojeve shqiptare. Kësisoj, dramaturgu H.Mandri që para tri dekadash, e shihte këtë përzgjedhje si një mundësi e mirë që drama e tij të mund të ndikonte në edukimin atdhetar të shoqërisë shqiptare, ndërkohë që krijoi dhe botoi në revistën “Teatër” edhe dramat “Mjeku i ri”, “Në rrjedhën e jetës” dhe “Joana”.

MODEL I RI VJERSHËRIMI DHE...

Hajri Mandri, fillimet e veta letrare i ka në poezi. Që kur ishte gjimnazist në Peshkopi dhe më vonë pas mbarimit të studimeve të larta, si mësues i letërsisë në shkollat e Bulqizës (dhe si drejtor i pallatit të kulturës të qytetit minator), ai do të ishte fitues i disa konkurseve letrare të degës së Lidhjes të Shkrimtarëve dhe Artistëve të Dibrës. Gjithsesi, poezia e tij do të bëhej e njohur pas viteve ‘90 kur ai do të botonte vëllimet poetike “Prag mijëvjeçari” e “Zjarret e ditëveves”. Në të dyja vëllimet dallohet poezia liriko-filozofike. Këto veçori të poezisë së tij i ndeshim qoftë dhe vetëm tek vjershërimi i porosisë së babait: “M’u zgjuan ca fjalë të kyçura në zemër/ M’i tha babai që nuk është më sot/ M’i tha e iku pa m’i ngopur sytë/ Duke më lënë një det me mall të ngrohtë....”

Në këto dy vëllime H.Mandri krijon një model të ri vjershërimi në problematikë dhe në mjeshtërinë letrare, gërsheton natyrshëm vlerat tradicionale të poezisë me mënyra të reja të shprehjes poetike. Në përgjithësi në poezinë e tij mbizotëron natyra lirike, si te *“Kroi i Verës”*: *“Mos ma prishni Kroin e Verës/ Kroi i Verës pikon mjaltë/ Tek ai krua, ajo hije/ Mrizon ëndërra prej fëmije/ Vijnë kujtimet më mbajnë gjallë,/ Kroi - leitmotiv i rrallë/ Mos ma prishni Kroin e Verës/ Musht e mjaltë në buzë e kam.....”*.

Lirika është mbizotëruese edhe në disa poezi të tjera të Mandrit, por më evidente ajo është tek ajo me titullin *“Lirike”*: *“I rashë hënës me një grusht/ Hëna shkau dhe ra n’humnerë/ Atë natë ishte gusht/ Binte shi dhe frynte erë.../ Desha, që veç unë e ti/ Ta sundojmë tërë errësirën/ Qënia jote qe magji,/ Lumi nishonte natyrën”*.

Ndërkohë konstatojmë se lirika në poezinë e këtij poeti shfaqet si vazhduese e vlerave më të mira të poezisë lirike shqipe, si psh tek poezia e titulluar *“Ti më pret...”*: *“Mos më ndal sonte në rrugë/ Eshtë e shtunë, ajo më pret/ Vijëzon në ballë një rrudhë/ Dhe nga sytë, loti i shket.../Nuk ka forcë që më ndal sonte/ Ti ditëlindjen ke në fshat/ Po t’mos vijë ai merak nëne,/ Të shqetëson, s’të lë rehat!”*. Dhe duke e vështruar në tërësi krijimtarinë poetike të H.Mandrit mund të konkludojmë se ajo është bartëse e tipareve moderne që shfaqen në sistemin letrar shqiptar, ndërkohë që thjeshtësia e komunikimit, mesazhet universale dhe shprehja e hapur e ndjeshmërisë janë shtyllat e forta ku mbështetet poezia e tij.

... SHEMBËLLTYRA NË FOLKLOR DHE NË LETËRSI

Në krijimtarinë e tij, Hajri Mandri është mbështetur thuajse tërësisht në traditën folklorike shqiptare. Librin *“Shembëlltyra në folklor dhe letërsi”* e ka shkruar fillimisht si tezë për shkallën *“Master”*, me titull pune *“Shembëlltyra në*

tregimet alegorike dibrane”. Por kësaj teze iu përkushtua për vite të tëra deri sa arriti të marrë titullin “Doktor i Shkencave” në Studime Letrare.

Siç është shprehur udhëheqësi i kësaj teme, Prof. Dr. Shaban Sinani: “Studimi i Hajri Mandrit, për qëllimin që u hartua, mund të mjaftohej edhe vetëm me një paraqitje panoramike anatomike të formave të ligjërimit me shembëlltura në tregimet alegorike dibrane, në të folurit me rrotulla të Kosovës, në kallëzimet popullore të viseve të tjera veriore të Shqipërisë, që përbëjnë dukuri folklorike me përhapje tejet të gjerë deri në ditët e sotme”.

Duke e rilexuar tashmë si një monografi që u drejtohet studiuesve, lexuesve me interesa në fushë të letërsisë, folklorit, etnografisë, ligjërimeve gjuhësore, jo thjesht për ta paraqitur me dinjitet para një komisioni specialistësh, vlerat e këtij libri mund të çmohen në një kontekst më të gjerë. Analiza gjuhësore e studimit “Shembëlltura në folklor dhe letërsi” hedh dritë jo vetën në pasqyrimin dhe dokumentimin e vlerave folklorike të Dibrës dhe krejt Verilindjes, por edhe për çështjet që lidhen me fushat e onomastikës, krijimtarinë popullore folklorike, dialektologjike etj.

Ky studim paraqet frymëzim shpirtëror jo vetëm për studiuesit e sotëm të folklorit shqiptar, por edhe për gjuhën shqipe dhe popullin shqiptar në përgjithësi, sepse aty pasqyrohet historia, mendësia popullore, doket, ritet, besimet etj. Përveç synimit për të qenë një ndihmesë në studimin e tipologjisë dhe karakteristikave të veçanta të mjeteve kohezive në gjuhën shqipe, punimi është motivuar dhe mbështetur edhe nga një qëllim tejpgjuhësor. Më shkoqur, autori synon për të vënë në qendër veprën e mbledhësve të folklorit, si përfaqësues të prirjes realiste kombëtare në letërsinë shqiptare, që bosht të krijimtarisë së vet pati vlerat dhe vrytytet njerëzore të njëmendëta dhe të përherëshme, që shqiptarin e djeshëm dhe të sotëm, pa se i lidh vazhdimësia

e traditës, e urtësisë, e virtytit moral, por edhe tragjiciteti, ky shoqërues i përhershëm i ekzistencës së tij, i cili ka përcaktuar edhe kalitjen e shpirtit të tij të qëndresës.


Mjafton që duke lexuar këtë botim shkencor, mund të arrijmë në përfundimin se Dr.Hajri Mandri është tashmë nga ata personalitete me kontribut të rëndësishëm që u ofron studentëve njohuri parësore për një dukuri të pastudiuar, vetë bartësve të fundmë të ligjërimit me shembëllyra një mënyrë të interpretuari të stilit të tyre të të folurit, specialistëve të letërsisë e të folklorit një varg problemesh të nevojshme për të gjykuar drejt për gjuhën, folklorin, letërsinë dhe marrëdhëniet midis tyre dhe mbi teoritë e evolucionit të zhanreve dhe të figuracionit; studiuesve të një niveli më të lartë formimi tema të hapura që presin njerëz të zellshëm dhe të formuar për t'u shpënë më tej. Punime dhe kërkime të tilla gjuhësore-folklorike, të bëjnë të besosh se potencialet intelektuale shqiptare, kanë një fuqi depërtuese dhe analizuese të trashëgimisë sonë kulturore, në baze të se cilës qëndron gjuha dhe folklori, këto vlera të thesarta të mbijetësës triumfale të kombit tonë.

Dr. Hajri Mandri me punën e vet konkrete, provon se është vërtet një potencial intelektual në botën akademike shqiptare.

<https://kohajone.com/vepra-krijuese-e-dr-hajri-mandrit-ne-tre-dimensione/>

PËR LIBRIN “MUSAI – PORTRET I NJERIUT FISNIK”

*Agron Tufa: Duke folur për Musain, në mendje më ulet
natyrshëm një krahasim me personazhet e suksesshëm të
romancierit amerikan Theodore Dreiser*



Rrallë ndodh që një njeri të përjetojë tri gëzime në një ditë, siç i përjetoj Musa Riçku në 60-vjetorin e ditëlindjes së tij, kur në një nga sallat kryesore të Hotel Tirana, u mbledhën qindra familjarë, të afërm e miq të shumtë. Një ditëlindje që është ngulitur thellë, jo vetëm në memorien e Musait, bashkëshortes, Hasijes, djemve e të afërmeve të tyre, por të të gjithë dibranëve e miqve të tij përtej Dibrës, gjer në Kosovë, Vlorë e Devoll... Një ditë vërtetë mbresëlënëse. Mbresa nga dokumentari kushtuar jetës dhe veprës së Musait, përgatitur me fantazi e profesionalizëm nga gazetari i talentuar, Defrim Methasani., vlerësime dhe fjalë zemre për Musain në promovimin e librit “MUSAI – Portret i njeriut fisnik” me autor Shaqir Skarrën, dhe si “qershia mbi tortë”, titulli “QYTETAR NDERI I DIBRËS” akorduar nga këshilli bashkiak i rrethit verilindor.

Fisnikëria e Musait është në një kuotë aq të lartë sa si rrallëkush arrin të bëjë bashkë krerët e politikës dibrane: deputetët e të gjitha partive, si dhe pothuajse të gjithë anëtarët e këshillit bashkiak të Dibrës, pa dallime partiake. Dhe në këtë ditë të shënuar për njeriun fisnik, që përveçse në Dibër e Tiranë ka shërbyer me devotshmëri edhe në Bulqizë, s’kishte si të mungonin edhe miqtë e tij bulqizakë.

Shkrimtari i mirënjohur Agron Tufa, jo pa qëllim u shpreh se: “duke folur për dajë Musain, në mendje më ulet natyrshëm një krahasim me personazhet e suksesshëm të romancierit amerikan Theodore Dreiser....Personazhet e Drajzerit e nisin karrierën e tyre nga hiri, për të mbërritur majat e suksesit në shoqërinë amerikane të fillimit të shekullit XX. Edhe Musai e nisi ngjitjen e tij nga pika më e ulët...Por sukseksi i dajë Musës është radikalisht i ndryshëm, sepse ai është i bazuar në themelet e etikës njerëzore, gjë tepër e rrallë kjo për parallinj të tanë “. Dhe vërtetë: Mjafton të lexosh ditarët e Musait ndër vite për t’u bindur në thelbin e argumentit moral të këtij sukseksi...

Një tjetër shkrimtar i suksesshëm dibran, Lutfi Hanku do të shprehej se: “Musa Riçku e çliroi shpirtin, duke e tjerre zgjuarsinë me fjalët e botës së dijes që mblodhi nga gjuha e mësuar e shkollës, në odat e kullave dibrane dhe nga valët e fjalës së Drinit, duke i shijuar këto fjalë nga shpirti i lirisë... Fryma e botës së vlerave të Musait nuk e shijon jetën përtej dëshirave të tij, sepse nuk është formuar si intelektual pa dritërimën e bindjes. Ndryshe nuk do t’i jepte emër jetës e të dritërohej në 36 shkronja nëpër libra”.

FAMILJAR I MIRË, MIK I VËRTETË, SHOK I PAPËRTUAR.....

Janë të shumtë personalitetet e botës së letrave, akademikë e profesorë që kanë dhënë vlerësime pozitive për Musa

Riçkun. Prof.Dr.Edlira Haxhiymeri – Kryetare e Shoqatës “Lidhja Intelektuale Dibrane”, duke u ndalur në dimensionin njerëzor të Musa Riçkut, e vlerëson atë si familjar të mirë, mik të vërtetë, shok të papërtuar, qytetar të ndërgjegjësuar dhe si dibranin me zemër të madhe. “Është fat, themi ne shpesh, të kesh një familje të mirë. Por është zotësi”. Ndaj, Znj.Haxhiymeri beson se Musai ia ka dalë, me ndihmën e bashkëshortes, të ngrejë një familje që reflekton të gjitha vlerat e tij. Në të njëjtën linjë, edhe Dr.Hajri Mandri shprehet se formacioni shpirtëror i Musait është përmirësuar dhe zhvilluar nën ndikimin e nxitësve dhe stimujve socialë, i cili, duke pasur një përthithje inteligjente dhe mishërim të vetive më të mira, zhvillon përgjigje të vlefshme ndaj indikatorëve socialë, si reagim estetik që i shkaktojnë ndjenjën e kënaqësisë e të përmbushjes morale. Madje, për Dr.Mandrin “Ajo që të lë mbresë të thellë në jetën, personalitetin dhe veprimtarinë e Musa Riçkut është vargu i gjatë i sponsorizimeve në fushën humane, dhuratë pa menduar këmbimin e tyre, kohëzgjatja në dekada e këtij inspirimi, sjellja ndaj vlerave dhe qasja ndaj njerëzve që përpiqen t’i përhapin ato”.

Këto anë të veçanta të karakterit të këtij dibrani të shquar, vepra e të cilit ka rrezatim mbarëkombëtar, i evidentuan më së miri në këtë aktivitet mbresëlënës, jo vetëm deputetët Sherefedin Shehu e Ulsi Manja, por dhe kreu i Komunes së Dibrës së Madhe, z.Rushdi Lata, vlonjati Vullnet Sina – President i “Big Market” si dhe dhjetra të tjerë që folën fjalë zemre për Musa Riçkun. Dhe vërtetë, siç përshkruhet në librin që u promovua në ditëlindjen e tij të 60-të: “Musai është përfaqësues i denjë i Limjanit, intelektual e punëtor i palodhur, familjar e bashkëshort i mirë.

Ai vazhdimisht ka pasur si qëllim evidentimin e vlerave humane e njerëzore të limjanasve dhe dibranëve. Musai është një gjysh i kujdesshëm, që nuk harron t’u përçojë nipave e mbesave dashurinë për vendin dhe origjinën. Ata janë

tashmë frymëzimi dhe optimizmi i tij për të punuar edhe më shumë....”.

MISIONARI QË MBAN GJALLË VLERAT E MËDHA TË ARTIT DHE KULTURËS POPULLORE DIBRANE

Si nënkryetar i Shoqatës “Lidhja e Intelektualëve Dibranë” Musai do të mbante ndër vite peshën kryesore, si një ndër kontribuesit kryesorë. Disa nga veprimtaritë e Shoqatës, ku kontributi financiar i Musait është i konsiderueshëm janë: Sesionit Shkencor për Rrugën e Arbërit (2007), “Dibra në sytë e të huajve” (2008), “Përkuajtimi i 100-vjetorit të Kongresit të Dibrës” (2009), “Kontributi i Dibrës në pavarësimin e Shqipërisë” (2012), si dhe mjaftë veprimtari të tjera që Shoqata ka organizuar gjatë këtyre 10 viteve të ekzistencës së saj.

Musa Riçku, edhe për shkak të një trashëgime familjare, ka pasur një vëmendje të shtuar ndaj objekteve të kultit. Që nga viti 1996 vazhdimisht ka ndihmuar në rikonstruksionin e xhamive të ndryshme në Dibër, por edhe me iniciativën e tij për të ndërtuar një xhami për komunitetin mysliman në Laprakë. Janë me qindra veprimtaritë e sponsorizuara prej tij, që nga botimi i librave të autorëve dibranë, e deri tek ato me karakter humanitar në ndihmë të të varfërve.

Musai ka qenë gjithmonë mbështetje edhe për vëllezërit boksierë nga Bulqiza, Ismail e Gjetan Keta, të cilët na kanë nderuar në arenën ndërkombëtare, duke ngritur lart emrin e Bulqizës, të Dibrës dhe Shqipërisë. Edhe në aktivitetin e organizuar më 19 shkurt 2016, ku Gjetan Keta u shpall nënkampion i botës, “Big Market Ken“ ishte një nga sponsorët, duke ndihmuar kështu një veprimtari sportive, e cila u transmetua drejtpërdrejtë në mbi 100 shtete të botës.

Nga libri “MUSAI – Portret i njeriut fisnik”, ndër të tjera mësojmë se ai është një nga misionarët e vetëm të Dibrës, që me kontributin e tij financiar ka bërë të mundur të mbajë



gjallë vlerat e mëdha të artit dhe kulturës popullore dibrane. Madje, “Oda Dibrane”, një ndër veprimtaritë mbarëkombëtare që zhvillohet çdo vit në Dibër, prej 21 vitesh ka patur si sponsor kryesor edhe Musa Riçkun. Për të gjitha këto, ky njeri që rrezaton mirësi në çdo aspekt të jetës së tij e meriton plotësisht titullin “Qytetar Nderi” i Dibrës dhe mirënjohjen e gjithë dibranëve.

Gazeta “BULQIZA” + http://www.veteraniobvl.org/html/botime/NE_PANTEONIN_E_VLERAVE.pdf

POEZIA E DHIMBJES NJERËZORE NË PESË LIBRA TË DEMIR RUSIT

Katër librat me poezi të Demir Rusit: “Ura e fjalës”; “Mos ik të lutem”; “Anja”; “Mos perëndo o dielli im” dhe libri me tregime e rrëfime “Djali që bleu vdekjen” janë promovuar bujshëm dhe mirëpritur nga lexuesi



Nga libri i parë “Djali që bleu vdekjen”, tek i dyti “Ura e fjalës”, si dhe në tre vëllime me poezi të botuara në harkun kohor të dhjetë viteve të fundit, poeti e publicisti Demir Rusi, identifikohet si poeti i dhimbjes njerëzore

Nëse në librin e parë me titullin sinjifikativ “Djali që bleu vdekjen”, sipas recensentit Namik Selmani, “Mbetet në gjithë sipërfaqen shkronjore dhimbja, mbetet drama, mbeten viktimat dhe fajtorët e një tragjedie që quhet kurbet i paligjshëm. Mbetet emocioni i rrëfimit...”, në vëllimet me poezi “Ura e fjalës”; “Mos ik të lutem”; “Anja”; “Mos perëndo o dielli im” është trashëgimia e bukur që mund të gjesh në gjuhën shqipe”. Duke lexuar poezitë e këtyre vçllimeve nuk është e vështirë të konstatosh krijimtarinë produktive

e cilësore të këtij autori, duke evidentuar kulturën e lartë gjuhësore, në ditaret, përshkrimet e poezitë e tij. Profilin e tij të e veçantë krijues D.Rusi e shpërfaq sidomos në poezitë që përçojnë plagët e rënda sociale që perjeton shoqëria e sotme.

Kështu nëse kriza globale e shkaktuar pas agresionit rus në Ukrainë reflektohet në vargjet e tij: *“Kriza tek ne, për fajin tonë/ Mirë ta ndreqim sa nuk është vonë/Kriza për naftën s’mund të besohet/Nëntoka jonë me naftë mbulohet...”*, kur vjen puna tek shkaktari i saj, vargjet e tij kanë nota të theksuara revolte: *Si nuk i mbaruam hallet njerzimit/ Mangut kishim dhe këto të Putin/ Fashist i ndyrë, xhelat i pashpirt/Vret e pret dhe gratë e fëmijët”*.

Po ashtu pas vëzhgimit e investigimit të realitetit të trishtë, të krijuar nga veprimtaria e krimin të organizuar, fjala poetike e D.Rusit është alarmuese: *“Paksa te SPAK-u njerzit shpresojnë/ Po të vakët duken e spo vepronë/Ata që ishin, po ato janë/ Veç po shtyjnë kohën e gjatë s’po bajnë..”*

Vargje revolte krijon poeti edhe në poezinë *“Mëkatarin, mëkati ndjek”*: *“ Dëgjuar e kam e s’ mbaj mend/ Madje dhe lexuar në ndonjë vend/ “Shemben malet ngritën halet”/ Ndaj e keqja nuk po ndalet.../ Se nga vijnë këto të këqija/Topi mbetet tek qeveria/Bëhen zgjedhje ndërron partia/ Hiqen të aftët vjen hajnia!!!”*

Poezia e Demir Rusit është poezi që recitohet, madje që interpretohet me ndjenjë, siç e ka inportretuar atë Artistja e Popullit dhe Nderi i Kombit Margarita Xhepa në promovimin e librave të tij. Nga katër vëllimet e tij të promovuara njëherazi mund të përzgjedhësh si të tilla poezitë e titulluara: *“Shteti vret”*, *“ Se ke hall askush s’ta var”*, *“Paraja dihet se të ngroh xhepin”*; *“ Helmi”*; *“Pse bën keq o njeri”*; *“Mos luaj me punën”*; *“Karrikja ime”*; *“Skizofrenia”* e *“Vitet nëpër libra”*.

Nëse lexon poezinë e autorit Demir Rusit nuk ke nevojë të vërtitësh rreth qëllimit për të cilin shkruan autori. Poezia e tij e nxjerr prej dhimbjes njerëzore është si mushti.

Por nga libri “*Mos Perendo o Dielli im*” mund të veçojmë edhe poezinë me titull: “*Epitaf për vehten*”, kur poeti shprehet në vargje se “*nuk do t’ia shkruajnë të tjerët epitafin e pasvdekjes...*”

Le të ndalemi së fundi tek libri i tij i parë me tregime e rrëfime “*Djali që bleu vdekjen*”, një botim produktiv dhe cilësor ku rrëfëhet intelektual i përjetoi strese të fuqishëm shkatërrues, por që nuk u tundua nga grishja për veprime aventurore në fushën e kontrabandës mafioze.... Në këtë libër rrëfëhet intelektual i mirëfilltë që kishte shërbyer me devotshmëri si oficer dhe si publicist ushtarak e si kryeredaktor i gazetës “*Minatori*”, të cilin koha e gjykoi së mbrapshti, duke e dëbuar nga puna me motive krejt absurde dhe pa asnjë mbështetje, as juridike dhe as logjike. Duke përshkruar si askush tjetër emigranët që i janë lënë rastësisë, të jetojnë ku të mundin e si të mundin, të fituar apo të humbur, të gjallë apo të vdekur, pa një mbrojtje juridike siç e kërkojnë Kartat Ndërkombëtare, D.Rusi shpreh njëherazi dhimbjen për djemtë e mbetur deteve, kufomëprishur, ushqim për peshqit!. Ndjeshmëria e mërgimtarit shprehet qartësisht sidomos në rrëfimin për hollësitë e asaj nate pus të zezë në Grykën e Otrantos. Në librin “*Djali që bleu vdekjen*”, (si edhe në vëllimin poetik) autori dallohet dhe për gjuhën e pasur në përshkrimin e personazheve dhe sidomos të miqësisë së tij me profesorin e nderuar italian, Xhovani Karbone. Pikërisht kur shpreh admirimin, respektin e mirënjohjen për këtë personalitet të shquar italian, teksa ai e takon me një nga miqtë e tij që kishte shërbyer në Shqipëri gjatë luftës së lavdishme nacionalçlirimtare, evidenton edhe kontributin e partizanëve të batalionit “*Antonio Gramshi*” dhe veçanërisht heroizmin e Tercilio Kardinalit. Dashuri të pakufishme shpreh autori sidomos për nënat që janë njësoj në gjithë botën, që një emër dhe një zemër kanë. Duke lexuar me vëmendje librin e D.Rusit “*Djali që bleu vdekjen*”, edhe më pesimisti gjen forca

për t'u bërë optimist, pasi përvoja e tij jetësore na mëson se “njeriu duhet të bëhet i fortë dhe t'u bëjë sfidë vështirësive që i dalin përpara; duhet të jetë optimist nëse dëshiron t'i mposhtë pengesat...Edhe kur është keq, njeriu nuk duhet t'i nënshtrohet së keqes...”. Ndërkohë autori është mjaftë bindës në konkluzionin për ekzistencën e të gjitha mundësive që Italia dhe Shqipëria të kthehen në simbole të vërteta miqësie e solidariteti. Kësisoj Demir Rusi prezantohet si vëzhgues i mprehtë i realitetit shqiptar dhe atij italian.

FATOS DACI, 51 LIBRA NË HARKUN KOHOR TË 20 VITEVE

Krijimtaria e tij letrare, publicistike, studimore e shkencore rrok një larmi temash, ku dominon historia



Me 51 libra të botuar në harkun kohor të 20 viteve, Fatos Daci është padyshim një prej autorëve më produktivë e cilësorë të këtij çerekshekulli.

Krijimtaria e tij letrare, publicistike, studimore e shkencore rrok një larmi temash, ku dominon historia... Historia, e shkruar me vërtetësi, bazuar në të dhëna arkivore, në një bibliografi tejet të pasur si dhe në dëshmi gojore nga personazhe realë bindës.

Mbi këtë bazë e ka shkruar autori veprën “DIBRA-HISTORIA E PLOTE”, ashtu siç ka shkruar edhe veprat tjera: “Enciklopedia e Dibrës”, “Kukësi”-Enciklopedi”, ”Nga lashtësia deri në vitin 1940”, “Skënderbeu i vërtetë”, “Të vërtetat për Skënderbeun”, “Kastriotët e Çidhnës së Dibrës”, “Peshkopia”, ”Çidhna dhe Kastriotët”, “Sllova përgjatë një shekulli”, “Histori e shkruar me pushkë e penë” , “Vendlindja ime (Dibra e

Bulqiza), “*Gryka e Vogël*”, “*Radomira*”, “*Shqiptonjat e kreshtave të Veriut*”, “*Të pavdekshmit*”, “*Burrat e Kullës së Canit*”, etj.

Krenar, si rrallëkush për historinë e lavdishme të Dibrës, Fatos Daci shkruan me kurajo e vërtetësi vepër në tij madhore “*Fitorja e Kosovës në duart e Dibrës*”, bazuar kjo në kontributin e shquar të personaliteve dibrane që nga epoka e lavdishme skënderbegiane e deri tek Lidhja Shqiptare e Prizrenit.

Dhe po si rrallëkush, Fatos Daci ka dhënë dhe jep një kontribut të veçantë në pasurimin e letërsisë sonë dokumentare. Këtë e dëshmojnë botimet e tij: “*Historia arsimit shqip në Dibër*”, “*Historia e mjekësisë dibrane*”, “*Historia e kulturës dibrane*”, “*Antologjia e poezisë dibrane*” (në dy vëllime) “*Dibra 07*” –antologji”, “*Shqiptonja fluturoi nga foleja*”, “*Një shekull poezi dibrane*”, “*Histori e shkruar me pushkë e penë*”, si dhe “*Në Amerikë flakëron atdhetaria dibrane*”.

Një ndër gjinitë më të lëvruara, ku spikat stili i tij original është monografia. Janë dhjetra monografi të këtij autori kushtuar figurave të ndritura të Dibrës, luftëtarë e patriotë të mëdhenj, artistë e mësues, ndër të cilat mund të përmendim ato me titull: “*Lirie Rasha-identiteti i vlerave*”, “*Burri i madh i Bulqizës*”, “*Mehmet Duriçi*”, “*Krushqit e lirisë*”, “*Mahmut Daci, princi i trimërisë*”, “*Rahman Doda i Reçit*”, “*Met Kaca dhe pasardhësit*”, “*Hysen Bara, pari e Dibrës*”, “*Pilket e Dibrës*”, “*Estref Gjoshi...*”, “*Dodajt e mëdhenj të Dibrës*”, “*Pasardhës të Dodajve të mëdhenj*”, “*Njeriu që di të bëjë gjera të mira*”, “*Miftar Fana, Nderi i Kombit*” si dhe “*Rahman Rasha*”..

Përveçse pasurimit të mendimit estetik nga vepra në vepër, F.Daci nuk lë pas dore edhe promovimin e vlerave më të mira të Dibrës e të gjithë Shqipërisë. Këtë e bën më së miri në botimet e tij: “*Pena e Dibrës*”, “*Vendi i artistëve*”, “*Shpërthime rinore*”, etj.

Po në këtë këndvështrim duhet parë edhe kontributi i këtij autori në fushën e së drejtës, i reflektuar më së miri në librin e tij “*Trajtime juridike*”.

Gjatë një studimi për veçoritë e LANÇ në Dibër, kolegu dhe bashkëautori im në disa botime, Sakip Cami, më tha se nga shfletimi i arkivës së gazetës “Ushtima e Maleve” të 30 viteve (1970-1990) kishte evidentuar Fatos Dacin si autorin me më shumë artikuj publicistikë, si reportazhe, skica, esse, fejtone.

Veprimtarinë e tij publicistike Fatos Daci, jo vetëm që nuk e ndërpreu në vitet ‘90, por e pasuroi dhe çoi edhe më tej gjatë këtij çerekshekulli, kur nga viti 1998 boton *gazetën e pavarur “Dibra”*, e cila nga numri i parë e deri më sot (edhe në versionin online) në qendër ka pasur Dibrën, dibranët dhe historinë e lavdishme, të djeshme e të sotme, të tyre

Ndërkohë, si kryeradektor ka drejtuar edhe gazetat “Zëri i Lirë” dhe “Trojet shqiptare”.

Ka realizuar dokumentarët televiziv: *“Sllava, mes heroizmit dhe ndryshimit”*, *“Dodajt e mëdhenj të Reçit të Dibrës”*, *“Kalisi”*, *“Mahmut Daci”*, *“Origjina e vërtetë e Atatürkut”*, *“Kalisi përkujton dëshmorët e tij”*, *“Kalisi në festë”*, *“70 vjet shkollë Pedagogjike”*, e *“Kuvendet e Dardhës së Dibrës”*.

Ka përgatitur për botim, redaktuar e botuar librat e dhjetëra autorëve dibranë e jo dibranë.

E gjithë kjo veprimtari letraro-publicistike e këtij autori, prej rreth 50 botimesh historiko-enciklopedike, është shprehur në rreth 15 mijë faqe libri, ku janë pasqyruar mbi 35 mijë dibranë e dibrane, kuksianë dhe kuksiane, sipas profesioneve të fushave të tyre, nga të cilat mbi 2500 janë pasqyruar hollësisht, me portrete-fotografi dhe jetëshkrim, dhe janë ilustruar me mbi 3 mijë fotografi.

Disa nga veprimtaritë e zhvilluara nga Fatos DACI, janë:

Në vazhdim të krijimtarisë së tij, autori Fatos Daci ka organizuar shumë veprimtari publike e sesione shkencore, si:

-100-vjetori i shkollës shqipe në Dibër, 100-vjetori i shkollës shqipe në Grykë të Vogël, Bllacë; organizuar te Muzeu Historik Kombëtar, në Tiranë;

-100-vjetori i Kryengritjes së Përgjithshme të Dibrës dhe eksodi i parë masiv dibran, zhvilluar po te Muzeu Historik Kombëtar në Tiranë;

-100 vjetori i masakrës austriake në Lurë, zhvilluar te Akademia e arteve;

-100-vjetori i Poezisë dhe Krijimtarisë dibrane, zhvilluar në Pallatin e Kulturës në Peshkopi,

- Ditëlindjen e Skënderbeut te Muzeu i Kastriotëve, tre vjet radhazi, në Sinë të Çidhnës, në Dibër;

- Ditën e Poezisë dhe të Krijimtarisë Dibrane, tre vjet radhazi, në Pallatin e Kulturës së qytetit të Peshkopisë,

-Kthimi i Skënderbeut nga Nishi në Dibër,

-Qindra veprimtari të tjera përkujtimore e promovuese në Tiranë, Bulqizë, Peshkopi, Dibër e Madhe, Shupenzë, Lurë, Sllovë, Arras, Zall-Dardhë, Kalis etj., me pjesëmarrje të gjerë, të cilat janë ideuar dhe organizuar nga z.Fatos Daci.

Në TVSH (Televizionin Publik Shqiptar), në Channel One, Ora Neës, Top –Channel, UTV Neës, TV “Dibra”-Peshkopi, TV “Dibra-Dibër e Madhe, TV “Zhupa” dhe Radio “Tirana”, ka promovuar vlerat atdhetare, patriotike, kulturore, krijuese e historike të Dibrës dhe të dibranëve, si i ftuar në këto medie.

Sistematikisht, prej 50 vitesh, ka shkruar e ka botuar artikuj të ndryshëm problemor, historik, përkujtimor, reportazhe etj. në gazetata: “Ushtima e Maleve”, “Dibra”, “Zëri i Popullit”, “Zëri i Rinisë”, “Bashkimi”, “10 Korriku”, “Shqiptarja e Re”, “Luftëtari”, “RD”, “55”, “Ndryshe”, “Shekulli”, “Telegraf”, “Tirana Observer”, “Trojet Shqiptare”, “Bulqiza”, “Pensionisti”, “Veterani”, “Zëri i Arbrit” etj.

Ka mbajtur dy kumtesa në Akademinë Shqiptaro-Amerikane të Shkencave (Një për raportet e komuniteteve fetare në Shqipëri dhe kontributin e tyre për shpalljen e pavarësisë dhe tjetrën për Heroin tonë Kombëtar -Skënderbeun.



Një kumtesë tjetër kushtuar figurës madhore të për Skënderbeut e ka mbajtur vitin që shkoi në komunën e Kasalvekios në Pulia, Itali.

“DIBRA-HISTORIA E PLOTE” dhe “Personalitetet e Dibrës” janë dy vepra voluminoze dhe para së gjithash cilësore që meritojnë të lexohen e studjohen nga lexuesi i gjerë, për të cilat shpreh bindjen se zënë vend nderi në historinë e letrave shqipe.

<https://vizion.com.al/veprimtaria-studimore-botuese-e-promovuese-e-fatos-dacit-nga-halil-rama/>

MIRËNJOHJE ÇAMËRIE PËR DIBRËN E DIBRANËT

*Libri i Namik Selmanit, një model i bukur gjuhësor,
i shkrimit të gjuhës amtare*



Pena e artë e poetit, studiuesit, eseistit e publicistit të mirënjohur Namik Selmani “shtegton” kësaj radhe në Dibrën e “Nëntë Maleve” kreshnike, duke sjellë prej andej vlera të rralla natyrore e njerëzore, ende të panjohura për lexuesin në një libër mjaft të veçantë. Një libër për mirënjohjen, në hyrje të cilit autori shpreh “Një falënderim Çamërie e mbarëkombëtare për atë që krahina e Dibrës i ka dhënë kombit”.

I ndërtuar mbi një treshe magjike, ky libër sjell për lexuesin recensionë, portrete njerëzore, poezi dhe ese poetike, të frymëzuara nga Dibra dhe dibranët.

“Kur hyra në shkollën dibrane, isha nxënës dhe dola prapë nxënës”, shprehet autori Selmani, i cili më tej vlerëson pa asnjë mëdyshje se DIBRANIZMI është një portë rrezatuese të cilën, të gjithë në Shqipëri e në diasporë, duhet ta bëjnë atë

pjesë të kulturës së tyre. “E dibranizmi na jep mjaft zemër e shpirt, themi se ai jeton e do të jetojë tashmë edhe në urtinë e tij. Mbase nuk është e rastësishme që nga kjo krahinë kanë dalë mjaft ushtarakë e intelektualë të fushave të ndryshme të jetës...

Nuk është e rastësishme që dhe boksierët më të mirë të kombit e me kurora bote (Ismail, Gjetan e Ferit Keta), të kenë lindur në këto troje. Është emocion të dëgjosh këngët, elegjitë dibrane si perla të muzikës së kombit tonë, të interpretuara mjeshtërisht nga Arif Vladi, Hazis Ndreu, Liri Rasha, Qerim Sula, Vera Laçi, Sherif Dervishi e Dritan Jashari...

Nuk është e rastësishme që lojërat e fëmijërisë i burrëronin më shpejt se mosha fëmijët e saj siç ishte “kalaja dibrançe”. Mbase edhe manushaqet, ashtu si dardhat, kumbullat, mollët kanë atje një aromë që nuk e shijon në ndonjë vend tjetër... Nëse diku keni dëgjuar e keni përsëritur shprehjen “Mat shtatë herë e prit një herë!” për Dibrën bashkë me këtë urtësi popullore, duhet të keni kaluar Shkollën e Dashurisë për Shkronjën. Madje dhe mirë. Duhet të keni kaluar e të jeni përballur me një ujëvarë mentarie. Nëse nuk je i stërkaluar i tëri me atë ujëvarë, duhet me e pasë njomur me të penën tuaj, sytë tuaj!”, - shprehet ndër të tjera autori i këtij libri.

DHURATË PËR DIBRËN E DIBRANËT NGA BOSTONI

Në këto 30 vitet e fundit, po edhe më herët janë shkruar me qindra e qindra libra për Dibrën. Kjo temë dhe liria e fjalës ka nxitur mjaft shkrimtarë, historianë, poetë. Ky libër, i botuar nga shtëpia botuese prestigjioze “M&B”, i shkruar për Dibrën, është krejt i veçantë. Është shkruar nga një njeri i mirë i Çamërisë që quhet Namik Selmani. Më shumë se fjala e tij është një mirënjohje që një krahinë plot tradita e plot dhimbje si Çamëria, duket se ia bën Dibrës, por edhe vetë

këtij shkrimtari. Ai jeton prej disa vitesh në Boston e, siç e thotë dhe ai vetë, e ka shumë të dashur këtë libër për të cilin ka punuar gati 20 vite. Është një dhuratë që ai ia bën Dibrës në një përvjetor të veçantë siç është 70-vjetori i lindjes, ndërkohë që vetë Dibra, miqtë e tij dibranë dhe unë personalisht e uroj nga zemra për shëndet e për vepra sa më të arrira. Edhe për faktin se ky libër i tij vjen si një “dhuratë” nga Bostoni për Dibrën e dibranët. Para një të vërtete të prekur, unë do të thosha se libra të tillë janë të rrallë e për këtë, mirënjohja e lexuesve dibranë e më gjerë është e madhe. Kam pasur disa raste të bashkëpunimit konkret me Namikun, si në librat për Rrahman Parllakun, për Skënder Calën, etj. Madje nuk duhet të çuditëni se në gazetën dibrane si “Rruga e Arbërit” e “Bulqiza” ai boton herë pas here poezi dhe ese që pëlqehen nga lexuesit.

Në katër kapitujt e këtij libri ka recensionë (parathënie librash), portrete, ese poetike dhe poezi të autorit Namik Selmani. Kështu në kapitullin e parë gjejmë recensionë për librin tim “Në panteonin e vlerave”; Refleksione mbi librin e dr. Islam Canit “Rrënjët historike të Kastriotëve të Çidhnës”; Mendime për librin e Abdurahim Ashikut “Rrëfimet e Komshiut”; Mendime për librin me poezi “Ura e Fjalës” të poetit Demir Rusi....

VLERAT INTELEKTUALE, MORALE E MATERIALE

H.Rama shkruan për Shuaip Methasanin, intelektualin dibran që rrezaton mirësi dhe vlera, duke vlerësuar dy librat e tij - testament për brezat ku përshkruhen më së miri vendlindja, historia e lavdishme, personazhe e personalitete që kanë bërë historinë e traditat më të mira.

Po në kapitullin “Portrete”, autori shkruan për Muharrem Gjokën, si mishërues dhe përcues të fjalës së mençur dibrane. Shkruan për këtë dibran të shquar që u “diplomua” në

kantieret e ndërtimit e asfaltimit të rrugëve në gjithë vendin, ku implementoi suksesshëm dijet e marra në “Universitetin e Dibrës”, leksionet e të cilit i përvetësoi nëpër odat e kuvendet dibrane...., shkruan për vitet e jetën e Doktores së Shkencave Mjekësore Suzana Zhuka - Nuellari që si okuliste e talentuar e sheh jetën me sytë e dashurisë për profesionin e njerëzit... ..shkruan për intelektualin dhe biznesmenin e suksesshëm Latif Miha, i cili ka përvojën, moshën, fuqinë intelektuale, morale e materiale që t’i përkushtohet sipërmarrjes....

Në këtë libër autori “rrugëton” në gjurmët e jetës dhe veprës së Shemsi Prençit - muhurrakut që ka qenë dhe mbetet në garën e madhe dhe të ndershme me forcën dhe motivin për t’i shërbyer kombit...Më tej ai shpreh fjalë zemre për gazetarin Defrim Methasani , që si ikonë e gazetarisë sportive dhe e dokumentarit televiziv jeton dhe punon brenda mençurisë dhe humanizmit dibran. Nën titullin “Lum kush njeh vëllezërit Rusi”, autori shkruan për Demir e Baftjtar Rusin, duke ua “peshuar” fjalën ndershmërisht! I gdhendur mjeshtërisht është në këtë libër edhe portreti i Prof. Dr. Bujar Kapexhiut, Mjeshtër i Mjeshtrove - “Nderi i Kombit”. “Mirënjohje për mirënjohjen” është titulli i profilit të artistit Skender Cala, ikonë e artit dhe kulturës kombëtare.

Në këtë kapitull, autori shkruan edhe për urtakun e përjetshëm Azis Keta, për të cilin shprehet se ka të paktën rreth 30 vite që e njeh nga afër....

Kështu, nëse Bujar Kapexhiu - “Nderi i Kombit” është pasqyra më e bukur e shpirtërave njerëzorë, të asaj që e duam si fabul, si gjendje shpirtërore, të punëdashjes e artdashjes, “Nderi i Kombit” Hazis Ndreu vjen si një shpirt lirie i derdhur në një këngë -simfoni. Referuar vargjeve të kësaj kënge (kënga e “Hajredin Pashës”), autori pohon se që prej gati 300 a 400 vitesh ka ardhur në ditët tona ajo urti dibrane që e sollti koha, që e vulosi koha atëherë dhe sot: “Nëse do të humbë Stambolli, Dibra do ta ndërtojë atë e nëse humbet

Dibra, Stambolli nuk mund ta ndërtojë më atë"... Dhe e dini se cili është gjoksi që mban këtë vrundullimë të egër? Janë vetë malet. Jo male të zakonshëm, se kudo në botë ka male, ka lumenj, ka gryka, ka kroje dhe dete, po këtu malet kanë shpirt qëndrese që dinë të bëjnë edhe BESË. E pas besës vjen BELAJA. Nuk e dimë se sa e njeh fjalorin e ushtrive këngëtari popullor, apo ai rapsod që ka bërë vargjet e saj. Po fjala BELA është më e mira që e tregon humbjen, disfatën, sfidën e fituar. Përballë BESËS është vdekja. Këtu nuk ka diplomaci sallash të fshehta, nuk ka traktate, nuk ka marrëveshje të firmosura me një lloj ceremoniali të rrallë. Këtu flet vetëm pushka. Jeta dhe vdekja për liri nuk rrinë në asnjë vend të Ballkanit më afër se në këtë grykë të Radikës....

NJË MODEL I BUKUR GJUHËSOR I SHKRIMIT TË GJUHËS AMTARE

Në kapitullin e tretë "Ese të zgjedhura", si redaktor i librit do të veçoja esetë poetike me tituj:

- "Amaneti i këngës" (Në kujtim të këngëtarit dibran Qerim Sula - "Mjeshtër i Madh" dhe "Kalorës i Urdhërit të Skënderbeut);

- "Simfonia" për Çamërinë" (Në gjurmët e këngës së Arif Vladit - "Mjeshtër i Madh" dhe "Kalorës i Urdhërit të Skënderbeut);

- "Një shpirt lirie i derdhur në një këngë" - simfoni duke ndjekur këngën "Kënga e Hajredin Pashës";

- "Moj Fusha e Korabit, o e mjera unë-oooo" (Në vend të një mirënjohjeje publike për këngëtarët e shquara dibrane Liri Rasha dhe Vera Laçi - Meditim për këngën "Oj Fusha e Korabit");


- "Ylberi nuk shuhet, edhe pse shekujt ecin me revan të pandalur" (Për këngën "Kur e përcolla ylberin").

Libri “Jehona e urtësisë dibrane” mbyllet me kapitullin me një tufë poezi të frymëzuara nga Dibra. Me një gjuhë letrare dhe rrëfim të admirueshëm ato të emocionojnë për detajet e stilin që ai ka zgjedhur dhe që e bën origjinal. Ky libër është një vlerë për historinë e Dibrës që mund të ushqente mjaft muze të saj, atë të luftës, të arsimit, të teatrit, të ushtrisë, të shkencës, etj. Është një model i bukur gjuhësor, para të cilit mësuesit e gjuhës amtare do të shihnin modelin e mirë të shkrimit të gjuhës amtare. Dhe këto nuk janë pak që edhe vetë libri, ashtu si personazhet e tij, të vihet në “vitrinën” e kulturë së shkruar shqiptare të viteve të fundit.

<http://rrugaearberit.com/2021/02/04/jehona-e-urtësisë-dibrane-ne-librin-e-ri-te-poetit-namik-selmani/>

MEVLUD BUCI - MËSUES, PUBLICIST DHE POET I TALENTUAR

*Për autorin e 27 librave me poezi epiko-lirike, fabula,
epigrame, fjalë të urta e shprehje frazeologjike,
monografi e publicistikë letrare*



Dyzetegjasthtë vjet mësuës, drejtor e zëvendës drejtor në disa shkolla të Dibrës e Tiranës, si dhe 27 librat e tij me poezi, epigrame, fabula e monografi, e kanë bërë Mevlud Bucin një emër të spikatur të elitës intelektuale dibrane e asaj kombëtare.

Plot shtatë dekada jetë, ndër të cilat, pothuajse gjashtë të tilla janë të mbushura me ngjarje që kanë lënë gjurmë në personalitetin e tij krijues. Sepse Mevlud Buci nisi të shkruajë e të botojë që në moshën 15 - vjeçare, kur ishte nxënës i shkollës 7-vjeçare në Lunarë të Katër Grykëve, të cilën e kreu me rezultate të shkëlqyera. Më pas do ngjiste shkallët e dijes si nxënës shembullor në shkollën pedagogjike “Luigj Gurakuqi” në Elbasan, në fakultetin e Gjuhë - Letërsisë dhe specializimin për stilistikë dhe letërsi me rezultate të larta, po ashtu të gjitha kategoritë e kualifikimit të mësuesisë.

Nga CV e tij mësojmë se në vitet 2011-2013, Mevlud Buci përfundon studimet pasuniversitare në fakultetin e shkencave Humane të Zbatuara të Edukimit dhe mori gradën për Drejtim dhe Administrim në Arsim.

KARRIERË E SHKËLQYER PROFESIONALE SI MËSIMDHËNËS E DREJTUES I TALENTUAR SHKOLLASH

Mevlud Buci ka një karrierë të shkëlqyer profesionale si mësimdhënës e drejtues i talentuar i disa shkollave. Plot 46 vite ka shërbyer si mësues i gjuhës dhe letërsisë, si drejtor e nëndrejtor në shkollave 9-vjeçare e të mesme: “Kadri Abdihoxha”, Qafë Murrë, Selishtë, “Kolë Jakova” në Laknas, “Ataturk” e “Sandër Prosi”, “Sadi Nuri”, Yrshek, e “Murat Toptani” në Tiranë, ku ai ka përhapur dritën e diturisë. shkollat, ndër më të mëdhatë e të vështira, në Dibër e Tiranë. Breza të tërë nxënësish e mësuesish e vlerësojnë Mevludin si mësuesin e zellshëm e me talent, për përkushtimin e rrallë dhe profesionalizmin e lartë, si organizator dhe drejtues vizionar. Ai është vlerësuar nga institucione, gazeta, revista, fondacione e shoqata me tituj nderi, medalje e mirënjohje. Mban titullin: “Mësues i dalluar”, dhënë nga Ministria e Arsimit dhe “Anëtar Nderi i Diasporës” dhënë nga gazeta “Emigranti”.

Më 26 nëntor 2016, mori “Mirënjohje” nga shkolla e Sohodollit të Dibrës, ku dhuroi 700 libra dhe 128 revista shkencore.

Më 28 shkurt 2018, u nderua me “Mirënjohje” nga Komuniteti Mysliman për ndihmën në shtypin e vëllazërimin fetar.

Mevlud Buci mban çimimin “Pena Budi”, 2014, akorduar nga revista “Emathia”, Burrel. Më 30 tetor 2019, nderohet me “Mirënjohje” nga shkolla 9- vjeçare Vranjt e Kastriotit të

Dibrës për arritje në mësimdhënie dhe për botimin e librave të tij.

Më 12 shtator 2020, ka marrë “Çmimin e Karrierës” në konkursin “Muza Budiane 5” (organizuar në shkallë mbarëkombëtare).

PRODUKTI LETRAR I MEVLUD BUCIT, I PASUR E CILËSOR

Si rrallë kush në Dibër, Tiranë e gjetkë, Mevlud Buci njihet për produktin e tij publicistik e letrar, të konkretizuar në 27 libra me poezi epiko-lirike, fabula, epigrame, fjalë të urta e shprehje frazeologjike, monografi e publicistikë letrare.

Mbi 50 vite, ka shkruar në mjaft organe shtypi, lokale dhe qendrore, mban vlerësime në shtypin publik, ushtarak dhe nga revista shkencore. Ka shkruar me qindra artikuj në revistën “Hosteni” me pseudonimin “Runja”; në revistën “Obelisk”, “Humor shkodran”, “Kunji”, “Mësuesi”, “Humor e satirë”, “Urtësia”, “Gjuha jonë”, “Emathia”, “Arsimi sot dhe nesër”, “Rreth e rrotull” etj.

Për shumë vite ka qenë bashkëpunëtor i Radio “Kukësi” e Radio “Tirana”, si dhe bashkëpunëtor shkencor i Akademisë së Shkencave (Instituti i Folklorit). Mjaft produktiv e me krijime cilësore shfaqet Mevlud Buci sidomos në librat “Alegoria e Dibrës-filozofia e shekujve”, “Dritë jete, dritë vlerash” libër publicistik-letrar me shkrime, skica, krijime për vlerat njerëzore; “Qesh e qaj me lot”, libër me poezi satirike, fabula, tregime, aforizma; “Shenjtëria”, libër liriko-epik, poezi me krijimtarinë e 50 viteve të botuara në shtypin letrar; “Udha e mirësive”, libër me poezi lirike - filozofike, “Metafora e Shpirtit”, libër me një mijë aforizma të krijuara si dhe me disa libra tjerë të tij. Ndërkohë ai ka në proces botimi librat: “Molla Bajram Buci (Hoxhë Buci i Dibrës, dritëshenjtori për atdhe e flamur”, (monografi); “I përfalem mirënjohjes”,

libër monografik; “Përvojë dhe tradita nga mësimdhënia, veprimtaritë dhe arti i drejtimit të shkollës në demokraci”; “Testamenti i përjetësisë”, libër me poema; “Ndrin Kaftalli në at’ Kashnjet” (Libër publicistik-letrar për kullën e Gjokës, fisin Gjoka dhe traditat e brezave, atdhetarët Ndue Mark Gjoka dhe Llesh Ndue Gjoka).

KRENAR PËR TRADITAT DHE ORIGINËN E TIJ

Mësuesi, poeti, publicisti e radiokronisti i talentuar Mevlud Buci ka të drejtë legjitime të krenohet me origjinën dhe traditat e vendlindjes së tij. Ai është stërnip i Hoxhë Bucit (Molla Bajram Bucit) i cili njihet në histori si sekretar i Lidhjes së Prizrenit, shok i Iliaz Pashë Dibrës, zotërues i shtatë gjuhëve të huaja. Me babanë e me të birin, Hoxhë Buci u vra për atdhe në shtator 1913, me të birin Mustafanë e Hoxhë Bodinin, në malin e Petralës (Petrino) në mësymjen e dytë kundër serbëve.

Kulla e Bucit, historikisht, ishte bazë e patriotëve të Dibrës e më gjerë. Xhaxhai, Bajram Buci (I riu) ishte luftëtar i lirisë qysh në njësitin e parë të çetës së Dibrës; shtëpia ishte bazë e luftëtarëve të lirisë të Dibrës, Matit, e më gjerë. Mevlud Buci është nip i kullës atdhetare të Manukëve të Luznisë: Hazi e Demir Manuka, burrave të shquar e mentarë: Rrem, Destan, Naim, Sakip, Fetah, Maliq, Seit e Veli Manuka. Më 1920, dajat qëndrestarë e shndrruan kullën në kala qëndrese ku, në rrethim, u vra edhe komandanti serb, gjeneral, - thotë muza popullore.

Besnik i origjinës dhe traditës, Mevlud Buci, ndoshta si rast unikal në historinë e lëvizjeve masive të tri dekadave të fundit, pasi jetoi e shërbeu për afro 25 vite në shkolla të ndryshme të Tiranës, si drejtor e zëvendësdrejtor, rikthehet për të banuar e jetuar në kullën e tij të vendlindjes në Lukanin malor të Katër Grykëve të Dibrës, fshati që ka si mburojë Runjën hijerëndë e kreshnikë 2048 metra mbi nivelin e detit.

Me bashkëshorten e tij shembullore, Shahen, këtu i gëzohen gjithshkaje, ajrit të pastër që rigjeneron mushkëritë e tyre, freskisë së maleve, zërit të bilbilave dhe unitetit të atyre pak banorëve që kanë vendosur ta vazhdojnë jetën në këtë fshat me histori të lavdishme, në zemër të maleve. Këtu frymëzimi i tij është i pashtershëm. Në atë votër të ngrohtë familjare ia merr këngës me çifteli dhe valles, si dikur kur debutonte shkëlqyer në festivalet folklorike lokale e kombëtare. Pëlqimet e tij mbeten: Dashuria për njeriun, traditat, folklorin, misteret e psikikës e të pedagogjisë, mjeshtëria dhe takti në mësimdhënie dhe drejtimin arsimor. Këto pasione të tij i gjejmë të shprehura edhe në vëllimin e tij më të fundit poetik “Shenjtëria”, në parathënien e të cilit, poeti dhe kritiku i mirënjohur letrar, Qazim Shehu, duke e vlerësuar Mevlud Bucin si poetin e ngjyrave të vendlindjes, të dashurisë dhe patriotizmit brilant, ndër të tjera shprehet se: “Vëllimi poetik më i ri i Mevlud Bucit shenjtëron, përmes një verbi të sinqertë e plot ndjenjë vendlindjen; vendlindjen si natyrë me male, gryka, përrenj, shkëmbenj, thepa, kreshta, lëndina, lule; vendlindjen përmes një zëri epik, me traditat, luftërat për liri, kullat, qëndresën dhe mbijetesën, për të ngritur lart virtytet e malësorit, të cilat u shenjtëruan nëpër shekuj dhe mbajtën gjallë karakterin e etnisë; poeti shenjtëron e shpalos dashuri, mall, përkushtim dhe mirënjohje edhe për sa e sa njerëz të cilët i ka njohur, njerëz të thjeshtë po edhe të përmendur”.

Mevlud Buci, mbetet pjesë e spikatur e plejadës së mësuesve shqiptarë, që për vite të tëra i shërbyen ndriçimit të mendjes së brezave që përtërinë Shqipërinë. Ai kujton se të qëniti mësues, ishte nderi dhe shërbimi më i madh që mund të bënte duke njohur nga afër sa e sa botë njomëzakësh, që etja për dije i mblidhte në shkolla rreth mësuesve. Mevlud Buci i shërbeu dijes, edukimit qytetar dhe të mirës shoqërore. Duke qënë përherë mes njerëzve dhe sidomos midis brezit


që rritet dhe sjell shpresë e vijimësi, mësues Buci kurrë nuk harroi penën si një “urë” pavdekësie që përcjell mendimet dhe ndjenjat në letër, duke radhitur fjalën e shpirtin e vet krijues si një “testament” që nuk ka nevojë të noterizohet në zyrat e shumta të avokatësisë shqiptare. Emri i tij është “avokati” falas për Mevlud Bucin që sapo shënoi shtatë dekadat e para të jetës së vet...

Gazeta “NACIONAL” + <http://rrugaearbetit.com/2021/03/05/70-vjetori-i-lindjes-publicistika-dhe-produkti-letrar-i-mevlud-bucit/>

II.
NGA LETËRSIA
DOKUMENTARE

LIBRI I GJENERAL PARLLAKUT “NJË SHEKULL NË MEMORIE”

UET PREES do të botonte në vigjilje të 100 vjetorit të ditëlindjes së gjeneral Rrahman Parllakut – Hero i Popullit dhe Nderi i Kombit, librin e tij me kujtime “Një shekull në memorie”



Një fletore me shënime për 96 librat që ka lexuar gjatë 17 viteve të burgut, dëshmi e aftësisë së tij për të mos prishur miqësinë me librin edhe në kushtet e inkuizicionit më të egër.

Pas dy librave të mëparshëm të tij: “Mirënjohje familjeve vlonjate që më mbajtën si birin e tyre” dhe “Kosova e lirë, ëndrra e jetës sime”, libri “Një shekull në memorie” është një testament fjale që generali legjendë i lë lexuesit.

Ndër të tjera, nga ky libër mësojmë se si librat do të ktheheshin në të vetmin ngushëllim për të, gjatë 16 viteve e tre muajve burg. Gjeneral Parllaku, do të kalonte 11 muaj në hetuesi, bashkë me të tjerë, të konsideruar “puçistë të ushtrisë”, si Beqir Balluku, Petrit Dume e Hito Çako. Më tej qelia. Pikërisht aty gjenerali do të mbahej më këmbë përmes leximeve.

NJË FLETORË SHËNIMESH, SI PASURI E RRALLË E GJENERAL PARLLAKUT

Gjatë viteve të vuajtjes së dënimit, Parllaku ka mbajtur një fletore shënimesh për 96 librat që ka lexuar në burg. Letërsi botërore dhe shqiptare, për të cilën mbante shënime të shkurtëra. Edhe pse sot vlerësimet e tij mund të duken pak skematike e të ndikuara edhe nga metoda e kritikës së kohës, ato janë një lëndë interesante për një studim mbi letërsinë e lexuar në burgjet e diktaturës. Përmes këtij shënimi po sjellim jo vetëm përmbajtjen e ditarit të librave, mbajtur në qeli, por edhe copëza kujtimesh nga ajo periudhë tmerri: cilët ishin hetuesit e oficerët, ata “të vijës së partisë” dhe ata njerëzorët, që thyenin rregullat me një gjest sado të vogël humanizmi. Si iu vu leximit dhe ku i siguronte librat ?!

* * *

Gjatë 17 viteve të vuajtjes së dënimit në burgjet e diktaturës, njeriu-legjendë në kufirin e dy kohëve, lexoi dhe konspektoi 96 vepra të autorëve më të njohur të letërsisë botërore dhe asaj shqiptare. Brenda kalvarit të vuajtjeve në 16 vite, 3 muaj e një ditë, të kaluara në burgjet e diktaturës, bën pjesë dhe një fletore shënimesh, si “pasuri e rrallë” e Heroit të Popullit dhe Nderit të Kombit, gjeneral-lejtënant Rrahman Parllaku. Një fletore aritmetike e kohës së largët, e zverdhur nga pesha e viteve, e kodifikuar “Shënime nga librat e lexuara në vitet e vuajtjes të dënimit në burg, 16 Dhjetor 1974 – 17 mars 1991”, brenda 32 faqeve të shfrytëzuara maksimalisht, rresht për rresht, bart vlera të veçanta, të lidhura pazgjidhshmërisht me formimin e Heroit – legjendë, në kufirin e dy kohëve. Është kjo fletore dëshmi e aftësisë së tij për të mos prishur miqësinë me librin edhe në kushtet e inkuizicionit më të egër. Njëherazi dhe e njeriut, që dhe në ato kushte ka ditur të përveçojë për të lexuar ato libra që mund të ndikonin në formimin dhe

forcimin e karakterit dhe të identitetit të tij. Duket qartazi kjo, tek “ditari i mbajtur”, për çdo libër të lexuar, ku në pak rreshta ka shënuar: autorin, temën, idenë dhe veprimet e personazheve.

Gjejmë në këto shënime, jo vetëm një lexues të thjeshtë, por intelektualin erudit që arrin të konkludojë për vlerat dhe mangësitë e çdo vepre. E bën këtë, jo vetëm për autorë shqiptarë, por dhe për kolosë të letërsisë botërore.

Le të fillojmë me “Ne Zheliani” të autorit Saverino Strati, ndër librat e parë që Parllaku ka lexuar në burg, në përfundim të të cilit ka shënuar se: “Autori përshkruan në roman, gjendjen e rëndë të popullit në Italinë e Jugut, shtypjen, shfrytëzimin që u bëhet masave punonjëse. Këtë gjendje e rëndon shumë mërgimi, që i detyron njerëzit të shpërndahen në vende të ndryshme të botës, të ndarë nga familja dhe që bëjnë punët më të rënda, përveçse ndjejnë edhe përbuzjen e padronëve e vendasve”. Është kështu, në pak rreshta një roman i tërë, i një prej autorëve më të zëshëm... Kësisoj, Rr.Parllaku i përmbahet besnikërisht filozofisë së Platonit, sipas të cilit “Ngadhënjimi i parë dhe i madh është ngadhënjimi i vetvetes. Të jesh i mposhtur nga ana e vetvetes është gjëja më e turpshme dhe më e mjerueshme”. Ai nuk u mposht nga torturat më mizore...

TË LEXOSH LIBRA PASI KE PROVUAR TORTURAT MË MIZORE TË HETUESISË SPECIALE

Libri ia mbajti të gjallë kujtesën dhe e ndihmoi të ruante freskinë e mendimit e veprimit edhe pasi kishte provuar torturat më mizore të hetuesisë Speciale. Në formimin e Rr.Parllakut, që kishte marrë shkëlqyeshëm dy klasë të fillores brenda një viti shkollor dhe që po me atë zell për dijen e arsimimin kishte mbaruar më pas edhe Akademinë Ushtarake në Moskë, libri do të kishte ndikim të veçantë.

Për Beqir Ballukun, Petrit Dumen, Hito Çakon dhe Rrahman Parllakun u përdor kriter i paparë deri në atë kohë. U arrestuan në sallë, me hekura në duar dhe helmata në kokë dhe me makina BÇ u transportuan menjëherë në burgun e sigurisë së lartë. Hetimi zgjati 11 muaj. Përveç futjes në qeli, i futën në kafaze hekuri brenda qelisë. Në kafaz flinin, hanin dhe hetoheshin. Për ruajtjen e tyre ishte caktuar një komandë dhe një trupë e veçantë gardianësh që komandohej nga Idriz Seiti (ish-shef sigurimi), i cili kishte dalë në pension, por ishte thirrur për këtë detyrë. Për ironi të fatit edhe Idrizin, pas vdekjes së Mehmet Shehut, e dënuan me burg.

Ishin 4 oficerë sigurimi në 24 orë që i ruanin, i përgjonin, dhe që e kishin të ndaluar të flisnin sepse kontrolloheshin edhe ata nga frëngjitë e dyerve të qelive. Edhe kur i nxirrnin për nevoja vetjake, nuk ua hiqnin hekurat nga duart dhe helmetën nga koka. Policët u rrinin mbi kokë. Por kjo ishte e vështirë edhe për ta. Pas dënimit me vdekje, Beqir Ballukun, Petrit Dumen dhe Hito Çakon i pushkatuan në Lanabregas të Tiranës dhe i varrosën në Vranisht të Vlorës, natën, pa dijeninë e askujt... Pa varr, pa nam, pa nishan... A ishte i nevojshëm ky hetim, kur dënimin e kishte përcaktuar kryeprokurori Hoxha që në mbledhjen e Pleniumit të KQ të PPSH?! Por ja që edhe shteti komunist ka ligje, ka formalizëm, ka shtet!!!. Këtë e vërtetojnë edhe prokurori i çështjes, Murat Kamani dhe hetuesi Piro Dautaj. Në një çast hetimi, Piro Dautaj e pyeti Parllakun: “akoma beson se do të mbrohesh kur akuzën dhe dënimin e ka përcaktuar ai lart?”. “Përse të mos besoj tek drejtësia?!” - iu përgjigj Parllaku. “Sepse ata që të përjashtuan nga partia, të dhanë edhe dënimin që në atë çast, - vazhdoi Piro. - Dënimin tënd e kanë vendosur ata 100 burrat e pleniumit të KQ të PPSH. Ne po bëjmë një formalitet këtu”. Po kështu deklaroi edhe Murat Kamani, prokurori i çështjes.

GREVA E URISË DHE VIZITA MJEKËSORE

Në ditët e vuajtjes, ndodhi që Rrahmani u fut në grevë urie, sepse komanda e burgut nuk ia pranonte kërkesën për t'u trajtuar si diabetik dhe ta lejonte për të bërë lëvizje apo për të lexuar ndonjë libër. Erdhi për ta vizituar Dr. Hektor Peçi. Ai kishte marrë me vete edhe kartelën mjekësore që vërtetonte faktin se Parllaku vuante në fakt nga diabeti dhe ishte mjekuar deri në momentin e futjes në burg. Pas vizitës së mjekut u trajtua si diabetik dhe u lejua të bënte lëvizje për rreth 15 minuta, sigurisht me 2 roje anash. Dieta në burg, sidomos gjatë hetuesisë, u zbatua fare pak. Mbas dënimit, me ndihmën e familjarëve, Parllaku e respektoi këtë dietë, gjë që bëri të mundur të mbijetojë pas 16 vjet e 3 muaj burgu.

NJË PORTOKALL NË QELI NË NATËN E VITIT TË RI

Ishte nata e ndërrimit të viteve 1974-1975. Rrahmani kishte 15 ditë brenda kafazit të hekurt, brenda qelisë. Në mesnatë u bë ndërresa e shërbimit të oficerit që bënte roje në qelinë e tij. Oficeri që mori shërbimin, siç do ta mësonte më vonë Parllaku, quhej Dilaver Muhametaj nga fshati Kajcë i Dishnicës. U sigurua se frëngjia e qelisë që kontrollonte edhe rojen brenda ishte e mbyllur. U ul në karriken e fiksuar të tij dhe filloi të qëronte një portokall. Parllaku u ndje i ofenduar nga ai veprim dhe mendja i shkoi te njerëzit e dashur të tij. Çfarë bëhej me ta vallë në këtë natë të ndërrimit të viteve? Parllaku tregon: “Dilaveri qëroi portokallin dhe ma drejtoi mua. Mos lë asnjë gjurmë apo ndonjë bërthamë në shtresa që t'i shohin ata të mëngjezit, më porositi ai.” Iu mbush zemra dhe bindi veten se kishte njerëz të mirë akoma, madje edhe në atë vend ferri.

Kujtimet i vijnë radhazi. Ai tregon edhe për një rast tjetër humanizmi nga rojet që shërbenin në burg: “Kisha 10 ditë në

kafaz brenda qelisë. Më nxorën në banjo për nevoja vetjake. I kërkova oficerit shoqërues që të më lejonte të laja këmbët. Ishte dhjetor. Ai më lejoi. Uji ishte i ftohtë akull, por unë kisha nevojë për të, sepse po më kalbeshin këmbët. U futa në qeli me këmbët akull.

Oficeri më afroi furnelën e tij për të tharë këmbët. Në këtë moment hyri komandanti i tyre, Idriz Seiti, që i bërtiti: “Ç’bën more, ruan apo ngroh të burgosurit që kanë tradhëtuar partinë dhe Enver Hoxhën?!”. Oficeri iu përgjigj: “Bëj detyrën, por jam edhe njeri”. Këtij oficeri nuk ia mësova dot emrin dhe nuk e kam takuar më që ta falenderoj thellë nga zemra. Me siguri ky veprim duhet t’i kishte kushtuar shumë, sepse të nesërmen nuk e pashë më”.

Mirënjohje, Rahman Parllaku ka edhe për oficerin Hiqmet Meçe. “Hiqmeti më trajtonte mjaft mirë. Sa herë merrte shërbimin në mesnatë, më sillte një kaush me kafe dhe sheqer, që të mos ia harroja shijen kafesë. Kur merrte shërbimin gjatë ditës, bënte pastrimin e qelisë. Një herë kur e gjeti duke pastruar komandanti Idriz Seiti dhe e qortoi, ai iu përgjigj se e pastronte për vete, për të mbajtur pastërti në vendin e shërbimit. Hiqmet Meçen dhe Dilaver Muhametin, Rahmani i ka takuar edhe tani pas liritimit nga burgu, duke u shprehur falenderime.

SI I GJENTE LIBRAT NË BURG

Faktet e mësipëme janë pjesë e kalvarit në ato vite të tmerrshme të hetuesisë speciale. Rahman Parllaku, që nuk u mposht para hetuesve specialë të diktaturës, pas “daljes” nga inkuizicioni, një ditë i thotë intendentit të burgut:

- A mund të gjejë ndonjë libër me të cilin të kaloj kohën?
- Janë ca libra në një magazinë, por duhen sistemuar më parë, i thotë zyrtari i burgut.
- Nëse më lejoni, këtë mund ta bëj unë,-vijon gjenerali

që për afro 30 vjet kishte drejtuar ushtrinë shqiptare, si ish zëvendësministër i Mbrojtjes, zëvendëschef i Shtabit të Përgjithshëm e disa herë drejtor i drejtorive të rëndësishme në dikasterin e Mbrojtjes, tashmë i dënuar me 25 vjet heqje lirie. Dhe falë “zemërgjerësisë” së intendentit, gjenerali, i cili që në fëmijërinë e tij kishte mësuar “Lahutën e malcisë” të Fishtës, (edhe sot në moshën 98-vjeçare e di atë përmendësh), iu përvesh punës për të përzgjedhur librat e lënë në mëshirë të fatit në një nga skuta e errëta të burgut. Nga ajo kohë e largët, në Fletoren e tij të rrallë gjejmë shënime për romanin “Shembja e idhujve” të Skënder Drinit, “Jongbllandët të Xhon O Kilens, Përmbledhjen me libra të Çajupit, “Lidhja Shqiptare e Prizrenit” të Koli Xoxit”, “Tokë e papushtueshme” të Skënder Jasës”, “Kikoja” (tregim autobiografik) të Franko Piros, “Prova e zjarrit” të Sabri Godos”, e dhjetra romane të tjerë të asaj periudhe.

Me vizionin e largpamësinë e intelektualit të formuar në zjarrin e luftës për liri dhe të mirëarsimuar deri në Akademitë ushtarake në ish-Bashkimin Sovjetik, pa e ditur se një ditë kjo fletore do të shërbente si ekzemplar i rrallë për studjuesit e letërsisë, do të hidhte në të deri edhe elementë të spikatur të kritikës letrare.

Kështu, nëse tregimin autobiografik “Kikoja” e konsideron realist, pasi “në të përshkruhet jeta e shtresave të varfëra, të cilat në kushtet e shtypjes kanë filluar të zgjohen, kërkojnë të organizohen e të luftojnë, ata mashtrohen nga socialistët e revizionistët, që janë në shërbim të borgjezisë”, për romanin “Prova e zjarrit” të Sabri Godos”, lexuesi Parllaku, në kushtet e burgut, shprehet se “ky roman nuk e ka nivelin e veprave të tjera të këtij shkrimtari!”

Më tej në këtë fletore shënimesh të mbajtura nga gjeneral Parllaku gjatë viteve të burgut (shënime këto që përbëjnë një thesar të rrallë) gjejmë vlerësime objektive për kryevepra të letërsisë botërore, si për romanin “Te shpella prapa palmave”

të Anh Duk; “Beteja vazhdon” të Stiv Nelson; “Shoqja Anjezë” të Renato Vigano; “E kuqja dhe e zeza” të Stendal; “Dita, bijë njeriu” të Martin Andersen Nikse; “Shigjetat e zeza” të Robert Lui Stivenson; “Evgjeni Grande” e “Fshatarët” të Honore de Balzak, si dhe për dhjetra kryevepra të tjera botërore... Por, gjenerali, ish-deputet i tetë legjislativave të Kuvendit Popullor të Republikës së Shqipërisë, ku që në të parën pati fatin të ulej në një tavolinë me Sejfulla Malëshovën e Aleksandër Xhuvanin dhe që kishte përfituar nga përvoja e tyre edhe për punën me librin, kurrësesi nuk mund të anashkalonte autorët shqiptarë. Kështu gjatë viteve të ferrit në burgun famëkeq të Burrelit, ai lexoi me interes të jashtëzakonshëm dhe konspektoi romanet: “Belxhiku që këndonte vençë” të Shefqet Musarajt, “Njeriu me top” të Dritëro Agollit; “Lulja e kripës” të Jakov Xoxes, “Zëri i largët i kasolles” të Frederik Reshpes, “Do të jetojmë ndryshe” të Dhimitër Xhuvanit, “Përballimi” të Teodor Laços, “Ditë me furtunë” të Resul Bedos, “Dueli i madh” të Ali Abdihoxhës, e disa romane të tjerë. Si një nga komandantët legjendarë të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare, që drejtoi me talent e trimëri të rrallë, që nga njësitet guerrile të Vlorës deri Divizionin e V-të Sulmues që luftoi heroikisht për çlirimin e tokave të ish-Jugosllavisë, në Kosovë e deri në Sanxhak, gjeneral Parllakun padyshim që do ta tërheqë letërsia që i kushtohet pikërisht LANÇ-it. Në fletorën e tij interesante, përveç konspekteve të dhjetra romaneve gjejmë edhe atë të veprës “Nëpër analet e diplomacisë angleze” të Arben Putos, për të cilën ka shënuar: “Në bazë të dokumentave të Foren Ofisit, autori përshkruan planet e qeverisë angleze në politikën e saj ndaj luftës Nacionalçlirimtare të popullit tonë, me anë të të cilave ajo kërkonte të rriste ndikimin e saj dhe ta çonte në hullitë që desh ajo. Edhe me vendosjen e pushtetit popullor, në vitet e para pas çlirimit, ajo me anën e njerëzve të saj bëri presione të vazhdueshme, deri në provokacione, që qeveria jonë t’i nënshtrohej diktatit të saj ?!”. Duke e

konsideruar gjeneral Parllakun si strateg të formuar në udhëheqje të luftës antifashiste dhe në drejtimin për 30 vjet të ushtrisë Shqiptare, nga kjo fletore e tij, nuk është e vështirë të konstatojmë se atë e tërhiqte letërsia që iu kushtojë betejave historike të popullit tonë për liri e pavarësi kombëtare. Ndaj nuk është rastësi që shënimi më i gjatë në këtë fletore i përket librit të Fan S. Nolit “Historia e Skënderbeut”, ku gjejmë të renditura në mënyrë kronologjike pothuajse të gjitha betejat, kuvendet dhe ngjarjet më kulmore të jetës dhe veprës të Heroit tonë Kombëtar Gjergj Kastrioti Skënderbeu. Për këto, si dhe për dhjetra kryevepra të letërsisë botërore, pati “fatin” të diskutonte edhe me përfaqësues të elitës intelektuale shqiptare, si: Fadil Paçrami, Todi Lubonja, Vaskë Gjino, Gjergj Titani, Lipe Nashi, Agron Çomo, Nevruz Demiri, Maqo Çomo, Bardhyl Belishova, Xhavit Qesja, Gjin Marku, Sadik Bekteshi, Arif Hasko, Muhamet Prodani, Abaz Fejzo, Halim Ramohito, Spartak Ngjela, si dhe me dhjetra bashkëvuajtës të tjerë në burgun e Burrelit. Për brezin e sotëm dhe brezat që do vijjnë, kjo fletore, me vlera të rralla arkivore dhe muzeale është një testament fjale.

RRËFIMI I GJENERALIT PËR SPECIFIKËN E LEXIMEVE NË BURGJET E DIKTATURËS

Për specifikën e leximeve në kohën e burgut, por edhe tani në moshën 98-vjeçare, gjeneral Parllaku ka një rrëfim befasues. Befasues për mënyrën e gjetjes së librave por edhe për kohën e kushtet në të cilat lexonte. Pa u zgjatur, ja dhe rrëfimi i tij për këtë specifikë të veçantë: “Kohën në burg e kaloja kryesisht me lexim. Lexoja çfarë mund të gjeja në bibliotekë. Kam lexuar vepra të shkrimtarëve tanë, nga më të dëgjuarit e më të rëndomtut, romane, tregime, poezi, libra historikë; doja që vetëm të kisha diçka në dorë. Kur ishim në Tiranë nuk kishte bibliotekë. Kishte një dhomë, depo me

libra. Kërkova të më lejonin t'i sistemoja në rafte, sipas gjinisë së shkrimit, që ta kisha më të lehtë të gjeja atë libër që doja të lexoja. Më lejuan dhe bëra një farë ndarjeje që më lejonte të lija librin e lexuar e të merrja atë që dëshiroja. Në qeli ishim dy veta. Llafet na mbaroheshin, gjatë izolimit në burgun e Tiranës na jepej për lexim vetem “Zëri i Popullit”. E lexonim atë dhe bënim ndonjë koment. Por koha tjetër duhej kaluar, se edhe meditimet ishin të kufizuara. Vetëm leximi e mbushte kohën. Në burgun e Burrelit gjendja ndryshonte. Aty vinte gjithë shtypi, gazeta e revista; kishte një bibliotekë, megjithëse edhe aty librat ishin të kufizuara, kryesisht të shkrimtarëve tanë. Por mund të gjendeshin edhe libra të përkthyer nga shkrimtarë të huaj. Aty kish mundësi për të porositur e blerë libra, po të ta mbante xhepi. Sigurisht lejoheshin ato libra të çensuruara. Në qeli që leximi, kurse gjatë dy orëve të ajrosjes, unë nuk qëndroja një minutë në vend. Vetëm do të lëvizja me hap të shpejtë. Edhe kur binte shi e borë, nuk e ndërprisja lëvizjen. Gjithë të tjerët futeshin brenda e polici roje mbetej vetëm me mua në oborr. Për ta përballuar borën, shiun e llocën që krijoheshin aty, familjarët më kishin sjellë xhup, çizme llastiku; kunata më kishte qepur një pelerinë me material plasmasi si ato ushtaraket me jakë. I pajisur me këto veshëmbathje e vazhdoja lëvizjen në çdo kohë të motit, duke mos u ndarë asnjëherë nga leximi i librave. Por edhe brenda qelisë mbi dërrasat e shtratit, disa herë në ditë shkrijoja gjymtyrët me ushtrime gjimnastikore dhe më pas vijoja të lexoja librin e radhës. Leximi ka qenë dhe mbetet rregull i jetës sime. Edhe tani në moshën 98 vjeçare lexoj të paktën një libër në javë. Po ashtu edhe lëvizja, ku edhe tani kur po i afrohem një shekulli jetë, bëj të paktën një orë ecje me këmbë në ditë”. Ndaj nuk është rastësi, që pikërisht Ai, mjeshtri i të lexuarit dhe të përfutuarit prej librit, por dhe autori i dy librave mbresëlënës tek mijëra lexues, të marrë pjesë në mënyrë aktive në disa promovime librash të autorëve të ndryshëm....

madje dhe të flasë me kompetencë e profesionalizëm për vlerat e tyre.

JO VETËM LEXUES, POR EDHE KRIJUES PRODUKTIV

Rrëfimin e mësipërm si dhe pothuajse gjithë aktivitetin e tij ushtarak dhe civil, gjeneral- Rrahman Parllaku e ka përfshirë në librin e tij “Memoria historike e kombit”. Si një enciklopedi e gjallë ai sjell ngjarje dhe fakte të paevidentuara më parë, që mund të shërbejnë si burim për historiografinë shqiptare. E dëshmojnë këtë dhe dy librat e botuar prej tij: “MIRËNJOHJE PËR FAMILJET VLONJATE QË MË MBAJTËN SI BIRIN E TYRE” dhe “KOSOVA E LIRË, ËNDRRA E JETËS SIME”, botime këto të vlerësuara edhe nga akademikë të njohur, si Prof.Dr.Paskal Milo, Prof. Dr.Pëllumb Xhufi, Prof.Dr.Ana Lalaj, Dr.Bujar Leskaj, Dr.Auron Tare etj. Përfundimi që del nga këto botime dinjitoze të Gjeneral Parllakut është se “populli ynë prej 1 milion banorësh, në kuadër të Aleancës Antifashiste të popujve të botës që udhëhiqej nga Anglia, nga ish Bashkimi Sovjetik dhe nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, dha një kontribut të çmuar në Luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare”. Kjo sipas tij, për faktin se Ushtria Nacionalçlirimtare Shqiptare, me luftën për çlirimin e vendit, mbajti të angazhuara në luftë forca të shumta nazifashiste, që llogariteshin gjithsej deri 10 divizione dhe u shkaktoi atyre dhjetra mijë të vrarë, të plagosur e robër luftime. “Po të mos ishin të angazhuara në frontin shqiptar, këto forca do të luftonin diku tjetër kundër ushtrive aleate.

Me Luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare për çlirimin e atdheut, me luftën për çlirimin e Kosovës, me luftën e dy divizioneve shqiptare në territorin e ish-Jugosllavisë për çlirimin e Malit të Zi, të Sanxhakut e të Bosnjes dhe me goditjet kundër forcave të Gruparmatës E-RE në tërheqje nga



Ballkani Jugor, ushtria shqiptare në Luftën e Dytë Botërore e radhiti me dinjitet Shqipërinë krahas shteteve më të fuqishme të botës që luftuan kundër nazifashizmit. Ditën e fitores mbi nazifashizmin, shqiptarët u ndjenë krenarë, kur flamuri kombëtar u valëvit krenar krahas flamujve të shteteve fitimtarë”, shprehet gjeneral Parllaku.

Ndërkohë, për vlerat e librit të tij, mjaftojnë qoftë edhe kujtimet për kohën kur ka qenë i zgjedhur deputet i Lumës që në legjislaturën e parë të parlamentit të parë pluralist. “Parlamenti ishte i përbërë nga intelektualë, njerëz të feve e shtresave të ndryshme dhe në përgjithësi ishin pjesëmarrës të luftës çlirimtare, por edhe figura të pa kompromentuara me armikun gjatë luftës. Parlamenti vazhdonte punën intensivisht, pasi po punoheshin ligjet bazë të shtetit. Zhvilloheshin debate të zjarra mbi përmbajtjen e ligjeve, që lidheshin me reformat e ndërmarra në të gjitha drejtimet, veçanërisht në ekonomi”, nënvizon gjeneral Parllaku. Më tej ai vijon se zërat që dëgjoheshin më shumë në parlament, nga udhëheqja e Partisë ishin Sejfulla Malëshova, Nako Spiru, Ymer Dishnica, Shefqet Beja, Riza Dani, Gjergj Kokoshi, Andrea Sahatçi, etj.

RRAHMAN PARLLAKU: PRAPASKENAT E PARLAMENTIT TË PARË PLURALIST MË 1945

Të lexuarit ka qenë “matematika” e tij e mendjes edhe në kohët më të vështira, atëherë kur vuante dënimin në burg. Plot 16 vjet e tre muaj, të cilët i mbushi me lexime të atyre librave që lejoheshin brenda qelisë, më së shumti shqiptarë, por edhe të huaj. Çdo gjë që lexonte ai e mbante shënim në një fletore, e cila del në dritë në këtë libër.

Një dokument interesant, që mund të jetë një temë më vete studimi. Kështu, gjenerali i shquar, ish-pjesëmarrës në Luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare, ndan me lexuesin mendimin e tij për rolin e LANÇ.

Interesant është rrëfimi i tij për parlamentin e parë pluralist, për kolegët e tij Riza Dani e Sejfulla Malëshova, mendimet e tyre pro pluralizmit apo për reformat ekonomike. Ai tregon për një nga momentet më të vështira për të, përjetuar në këtë legjislaturë, që lidhet me dënimin e Riza Danit, për akuzat që iu bënë në sallën e gjyqit dhe përgjigjen e Danit, që ai e kujton edhe sot. Për më tepër ai po përgatit një libër voluminoz, ku dëshmon edhe krimet e diktaturës.

* * *

Gjeneral Rr.Parllaku, si memoria historike e kombit, përshkruan realisht në këtë libër edhe mënyrën e funksionimit të legjislativit shqiptar të vitit 1945.

“Diskutime kishte edhe për formën e ligjeve. Aleksandër Xhuvani kërkonte formulimin e çdo ligji në gjuhën shqipe dhe kur gjente gabime debatonte me profesor Kostaq Cipon për rishikimin e ligjit nga ana gjuhësore. Siç theksonte vazhdimisht profesor Xhuvani, ligjet duhet të ishin të sakta si nga ana juridike ashtu edhe nga ana gjuhësore, pra të ishin shqiptare nga përmbajtja dhe nga forma e tyre”.

Në librin “Memoria historike e kombit” të gjeneral Parllakut gjejmë qëndrimin liberal të Sejfulla Malëshovës në parlament ndaj forcave të tjera politike, siç kishte vepruar gjatë luftës, për t’i afruar ato me frontin nacionalçlirimtar dhe për ti përfshirë në luftë kundër okupatorit. Ai dënoi me tone të ashpra si ekstremizmin, ashtu edhe terrorizmin në Pleniumin e Partisë Komuniste, mbledhur në Berat në nëntor 1944. Edhe në parlament Sejfullahu nuk ishte për reforma ekonomike radikale. Këtë e tregoi që në hartimin e ligjit të parë për reformën agrare, ku ai u shpreh kundër kërkesave të partisë për reforma ekstreme. Fatkeqësisht një pjesë e mirë e këtyre reformave u rishikuan e u ndryshuan pas dënimit të Sejfullahut në pleniumin e shkurtit të Komitetit Qëndror të Partisë. Pas dënimit të vijës (oportuniste e liberale) të Sejfullahut, gjeneral Parllaku pohon se u godit edhe opozita në parlament. Opozitarët u quajtën përfaqësues të reaksionit në parlamentin shqiptar.

“Isha i ulur në sallën e parlamentit mes miqve të mi, Riza Danit dhe Zija Dibrës, të cilët i kisha propozuar vetë si kandidatë për deputet të Shkodrës, dhe shtanga kur nga tribuna e parlamentit Riza Dani u akuzua direkt se përfaqësonte reaksionin në parlament. Rizai brofi në këmbë dhe u përgjigj vrullshëm: Unë Riza Dani përfaqësokam këtu reaksionin?!. Riza Dani, përfaqësues i lëvizjes demokratike në Shqipëri, anëtar i KONARE-së në emigracion, pjesëmarrës i Luftës Antifashiste dhe Kryetar i Frontit Nacionalçlirimtar në Prefekturën e Shkodrës, po mbron në këtë parlament të drejtat demokratike dhe jo ato të reaksionit!”. Edhe pse kanë kaluar 62-vjet, gjeneral Parllakut ende i ushtojnë në vesh fjalët e Riza Danit. E sjell të freskët në kujtesë atë moment fatal, pasi në momentin, kur ai erdhi e u ul mes tyre, gjenerali si dhe Zija Dibra janë ndjerë shumë keq dhe kanë mbetur pa fjalë. Kjo për faktin se po akuzohej Riza Dani, një nga përfaqësuesit më të mirë të elitës intelektuale të asaj kohe,

dhe më pas do të vinte më e keqja, dënimet dhe pushkatimet e grupit të deputetëve”,-shkruan general parllaku.

Duke i parë nga distanca kohore krimet e kryera nga diktatura, autori i këtyre kujtimeve, shpreh bindjen se ato janë një akt i krenarisë së tij kombëtare, pasi jo vetëm hedhin dritë mbi krimet më monstruoze por janë edhe një distancim e dënim kurajoz i tyre.

DASHURIA PËR ATDHEUN E TIJ, SI LAJTMOTIV VIJUES MBIKOHOR I GJENERAL PARLLAKUT

Retrospektiva dhe perspektiva kanë një prerje të artë në personalitetin e gjeneral Parllakut. Qoftë edhe nga ato që shkruan në këtë libër, nuk e kemi të vështirë të konkludojmë se atë e përshkon frymëzimi dhe dashuria për atdheun e tij, si lajtmotiv vijues mbikohor, që çliron në rrethana tipike energji shpirtërore pozitive në luftën e jetës. Jeta e tij është një shëmbëlltyrë e rrallë që na fton të kuptojmë se jeta meriton të jetohet kur luftohet fort dhe fitohet. Si një ushtarak, korrekt, i shquar, ai mbështetej në skrupuj të fortë të moralit kombëtar, me pikëvështrim të qartë dhe të kthjellët, duke ngjitur një nga një shkallët e karrierës ushtarake, si një gjigant hijerëndë që ngjitet i sigurt në bedenat e kalasë. Kalaja e pushteteve në kohë të ndryshme dhe situata të ndryshme, pati edhe shembje morale e politike, por këto nuk e dobësuan dhe përulën gjeneral Rrahman Parllakun, këtë soj të fortë shqiptari, që me mençuri diti të manovrojë në spiralet e rrezikshme të historisë shqiptare.

Siç shkruan dr.Hajri Mandri në parathënien e këtij libri: “Heroi i luftës në terren, i luftës dhe përballjes në gjyqe ushtarake, përballoi burgje e privime dhe fitoi duke merituar lavdinë dhe pavdekësinë. Jeta iu afrua heroit herë me tufa me lule, herë duke u derdhur mbi të me tërë egërsinë e saj. Rrallë gjen shembuj të tillë të personalitetit, ku të jenë ngjizur

e plazmuar në mënyrë aq mjeshtërore vetitë e karakterit të një intelektualit patriot, të një drejtuesi e komanduesi të aftë ushtarak, të zgjuar dhe trim, të thjeshtë dhe të ndershëm, të bukur në trup, shpirt dhe mendime. Ai është një model i ardhur nga gjenocidi komunist si dëshmitar i gjallë për të kuptuar dhe vërtetuar peripecitë dhe traumat që kaloi ky popull i orientuar dhe i ideologjizuar gabimisht nga rryma dhe korrente të huaja.

Mbi 20 vjet në krye të Organizatës të Bashkuar të Veteranëve të Luftës (OBVL), me ndershmëri dhe principe të larta morale, ka kontribuar në ndriçimin e mjaft skenave dhe protagonistëve, të vërtetave dhe kërkimeve historike, duke dhënë një ndihmesë të vyer në emancipimin politiko-shoqëror e demokratik të shoqërisë. Si një lundërtar i shquar, ai e drejtoi varkën e shpëtimit duke kapërcyer me sukses tallazet e historisë deri në brigjet e paqta të demokracisë që po jetojmë. Jo vetëm gjatësia kohore e jetës, por dendësia dhe përmbushja e saj me veprime, qëndrime dhe vlera në përmbajtjen e saj, e bënë këtë figurë të lartësohet në nderimin tonë shoqëror, ku zëri dhe mesazhet e tij dëgjohen deri në organizata famoze ndërkombëtare. Në këtë vështrim, gjeneral Rrahman Parllaku përbën një shembull frymëzimi për atdhedashurinë dhe përkushtimin qytetar”.

<https://www.balkanweb.com/ditari-i-gjeneral-parllakut-ne-burg-pucistet-e-ushtrise-ruheshin-ne-kafaze/>

FADIL HOXHA - ARKITEKT I KOSOVËS SË LIRË

Misionari historik që vjen e na zgjon për motivime të mëdha kombëtare. Ai mbushi me frymë krijuese një shekull, për t'i dhënë dinjitet njerëzor popullit shqiptar



Me një vështrim realist të kushteve dhe rrethanave historike nëpër të cilat kaloi Kosova, në vitet e thyerjeve të mëdha dhe krizës së pushtetit, janë të rrallë personalitete që u kundërqëndruan sfidave, provokimeve, përndjekjeve, hileve dhe dredhive politike të panumërta, në mënyrë aq stoike, si Fadil Hoxha. Ai pati vizionin e një politikani patriot e modern, i cili projektoi dhe sendërtoi të ardhmen e atdheut të tij.

Në dy libra të botuar në Prishtinë: “*Fadil Hoxha siç e njoha unë*” i akademik Ekrem Myrtezai dhe “*Fadil Hoxha në veten e parë*”, me parathënie nga publicisti Veton Surroi, personaliteti më emblematik i Kosovës së periudhës së Luftës së Dytë Botërore dhe i pasluftës, kur Kosova qe e okupuar nën pushtetin serb, paraqitet si udhëheqës dhe pushtetar i thjeshtë, pa ekstravagancë apo kryelartësi.

Në këto botime, si dhe në filmin dokumentar televiziv “*Fadil Hoxha-arkitekt i Kosovës së lirë*” - prodhim i Radiotelevizionit Publik Shqiptar (ku jam bashkëskënarist me Dr.Hajri Mandrin), Fadil Hoxha evidentohet si misionari historik që vjen e na zgjon për motivime të mëdha kombëtare,

si personaliteti që mbushi me frymë krijuese një shekull, për t'i dhënë dinjitet njerëzor popullit shqiptar.

Në çaste kritike, i urtë e racional, koloz i luftës, sa romantik në ëndërrime aq realist në veprime, e lindi vuajtja e popullit të tij për t'u ngritur mbi dallgët e shantazhet politike si feniksi nga hiri.

Ai lindi në Gjakovë, por njerëzit e mëdhenj nuk i nxë qyteti, ai u bë bir i tërë Kosovës dhe Shqipërisë që e ëndërroi tërë jetën si komb të bashkuar. Fadili nuk krijoi pasuri por la veprën e Tij: Kosovën e lirë me vështrimin drejt demokracive të përparuara e të qytetëruara, ai sot është Kosova në ecje, jeta në prosperitet dhe liria e demokracia në hapësira të reja! Fadil Hoxha bashkë me shokët e tij Xhavit Nimanin, Xhevdet Hamza, Veli Dema, Xhafer Vokshi etj. i qëndrojnë historisë Kosovës si kostelacion yjesh në qiellin e demokracisë.

Personalitete kosovare të botës akademike e të letrave e personifikojnë Fadil Hoxhën si intelektualin e udhëheqësin komunikues, të hapur, të çiltër dhe të ngrohtë me të gjithë, si burrështetasin që ngrihet në lartësitë morale të burrave të rrallë të kombit shqiptar që ende na fton e na thërret, për më shumë dashuri amtare për më shumë dinjitet!

Sipas **Akademikut Ekrem Murtezai**, Fadil Hoxha ka bërë për Kosovën optimumin e asaj që ka qenë e mundur në kushtet, rrethanat dhe në situatën e atëhershme brendapërbrenda sistemit socialist e monist”.

Ekrem Murtezai që nga viti 1969 e deri në vitin 1973 ka qenë shef i Kabinetit dhe këshilltar i pavarur i Fadil Hoxhës, i cili në Kongresin e IX, u zgjodh anëta i Byros Ekzekutive të Kryesisë së LKJ që ka qenë maja e piramidës në hijerharhinë partiake jugosllavë.

Në librin e tij *“Fadil Hoxha siç e njoha unë”* Akademik Ekrem Murtezai veç tjerash shkruan:

“Fadil Hoxha për shqiptarët ka bërë tërë atë që ka qenë e mundur në kushtet mjaft të pavolitshme ekonomike, politike, kulturore dhe ndërkombëtare, duke dhënë optimumin e mundshëm brendapërbrenda sistemit. Në bazë të angazhimit

të tij si politikan numër një i Kosovës, si tribun, mund të them se Fadil Hoxha ka meritën më të madhe se kushdo tjetër nga drejtuesit e tjerë kosovarë jo vetëm për arritjet e shqiptarëve në federatën jugosllave, por, më tepër, edhe për atë që kemi sot – shtetin e ri të pavarur dhe sovran të Kosovës, sepse pa Kushtetutën e vitit 1974, do të kishte shumë vështirësi juridike ndërkombëtare në përkrahjen e UÇK.

REXHEP QOSJA: FADIL HOXHA MË MBRONTE MUA DHE KONCEPTIN E SHQIPËRISË ETNIKE

Akademik Rexhep Qosja, për Fadil Hoxhën, në Klan Kosova në vitin 2015, thotë: “Unë e di një gjë, Fadil Hoxha ka thënë të mbrojmë intelgjencën, sepse e ka ditur se tehu i sulmeve të Serbisë ishte drejtuar kundër intelektualëve të Kosovës. Në takimet që kam pasur me Fadil Hoxhën, Mahmut Bakallin dhe Xhavit Nimanin, ata i kam perceptuar duke bërë sjellje në pjesën më të madhe të dinjitetshme. Ata flijonin interesat e veta të ngushta dhe mendonin për interesat e Kosovës. Serbia ka bërë çmos që në vitin 1981 dhe 1982 të vëjë administratë ushtarake në Kosovë. Këtë tragjedi e ka parandaluar Fadil Hoxha”. Më tej akademiku I mirënjohur kosovar shprehet se: “Prej rreziqeve që më janë kanosur, jo vetëm për dënim politik, por edhe për pushim nga puna, edhe për burgosje, më ka shpëtuar një njeri që është figura më e shquar politike e Kosovës dhe quhet Fadil Hoxha. Ai në mënyrë të hapur u ka thënë zyrtarëve që vendosnin për fatin e intelektualëve, mbani duart larg prej Rexhep Qosjes. Më kanë shkarkuar nga detyra e drejtorit, më kanë dënuar edhe partiakisht, por nuk më kanë burgosur. I kam një borxh moral e njerëzor Fadil Hoxhës dhe këtë e kam thënë hapur dhe shpjeguar në ditar. Të mos harrojmë se Fadil Hoxha ka qenë nxënës i Normales së Elbasanit dhe sado që ka qenë zyrtar i lartë në Jugosllavi, që zbatonte politikën e atij shteti, ishte atdhetar gjithëkombëtar. Kam pasur tri a katër biseda me të, në katër sy, dhe e kam

ndjerë, e kam parë, dhe e kam përjetuar nostalgjinë që kishte Fadil Hoxha për Shqipërinë”.

Një tjetër personalitet i mirënjohur kosovar, **Akademik Pajazit Nushi** në një intervistë dhënë RTK-së në vitin 2015 shprehet se: Fadil Hoxha ka vdekur si thotë populli me “zhigun” e bashkimit të Kosovës me Shqipërinë. Kjo ka qenë vija konstante e politikës së tij. Jam i sigurt që ka shku me brengën që Kosova (ende) nuk është bashkuar me Shqipërinë. Për aq sa e kam njohur Fadil Hoxhën, për këtë jam i sigurt.

Po ashtu **akademiku i shquar i Kosovës**, **JUSUF BAJRAKTARI**, vlerëson se: Fadil Hoxha është njeriu, luftëtari, komandanti, politikani dhe burrshtetasi që me përkushtim, vuri emrin e Tij, në altarin e personaliteteve që personifikojnë historinë Kosovare si një nga figurat e mëdha shqiptare të shekullit që lamë pas. Intervista...

Prof.Dr. **Hakif Bajrami**, historian dhe publicist i njohur shqiptar shkruan se: Fadil Hoxha e përkushtoi jetën dhe veprimtarinë e tij në shërbim të pandërprerë të atdheut, aktiviteti i tij shumëdimensional nga komandant i talentuar i shtabit të përgjithshëm të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, burrshtetasi dhe patriot i flaktë, u bë symbol përkushtimit atdhetar. Idhulli i partizanëve të Kosovës, Udhëheqësi i shquar i shtetndërtimit në gjysmëshekullin e pasluftës, kurrë nuk iu nda epiteti “separatist” nga Beogradi. Historia e luftës dhe pasluftës ka emrin mendjen dhe veprën e babait separatist, Fadil Hoxha. Nga llogoret e Luftës deri te piramida e pushtetit, nga akuzat dhe burgjet, deri te mirënjohja e heroit të Kosovës, me adhurimin më madhor publik, shtrihet jeta dhe vepra e këtij vigani liberator!

Prof. Dr. Masar Rizvanolli – Kryetar i Shoqatës së Intelektualëve “Jakova”, ndër të tjera vlerëson se “Fadil Hoxha ishte ndër themeluesit e parë të Ushtrisë Nacionalçlirimtare dhe arradhave partizane, në krye të së cilës ishte vetë ai... gati në të gjitha betejat ishte luftëtar me armë në dorë, duke u treguar strateg i niveleve të larta ushtarake.

Po ashtu **gjeneral Rrahman Parllaku** – Hero i Popullit dhe “Nderi i Kombit”, në librin e tij testament “*Memoria historike e Kombit*” shkruan se: “Për mua, Fadil Hoxha është më i madhi i të gjithë shqiptarëve, qofshin në Shqipëri apo në Kosovë. Më i madhi duhet të ishte Enveri, po të mos kishte pushkatuar të vetët si Pol Poti.

Fadil Hoxha, si burrë shteti, me aftësi e dinjitet, me zgjuarsri e largpamësi të jashtëzakonshme, duke shfrytëzuar më së miri konjunkturat e brendshme politike në ish-Federatën Jugosllave, arriti ta bëjë Kosovën pjesë kushtetuese të Federatës”.

PAK RADHË PËR FILMIN DOKUMENTAR KUSHTUAR FADIL HOXHËS

Filmi dokumentar “Fadil Hoxha-arkitekt i Kosovës së lirë” që u promovua më 15 shkurt 2022 në sallën e Akademisë së Shkencave në Tiranë, në praninë e më shumë se 100 personaliteteve akademike e publike nga Tirana e Prishtina, (ku unë jam bashkëskënarist me dr. Hajri Mandrin dhe me regjisor të mirënjohurin Llesh Nikolla – “Mjeshtër i Madh”, e konsulent z. Bashkim Hisari), është një prodhim me metrazh të gjatë, 47 minuta, i cili i kushtohet veprimtarisë së Fadil Hoxhës, për periudhën 1932 deri 2001, si lideri kryesor në historinë e Kosovës.

Filmi jep një përmbledhje të zhvillimeve politike, historike dhe kulturore në Kosovë, duke u fokusuar te kontributi politik dhe patriotik i Fadil Hoxhës në zhvillimin dhe konsolidimin e Pavarësisë së Kosovës. Diskursi politik e patriotik i Fadil Hoxhës, në mbrojtje të të drejtave dhe lirive të popullit shqiptar në Kosovë Në përshëndetjen për të pranishmit, pas shfaqjes së filmit dokumentar, ish-Presidenti i Republikës, Alfred Moisiu, ndër të tjera veçoi formimin, frymën, qëndrimet, vlerat dhe arritjet e Fadil Hoxhës si udhëheqësi më jetëgjatë i Kosovës, duke dhënë në gjuhë filmike, momentet dhe pasazhet më domethënëse që shërbejnë për plotësimin e shëmbëlltyrës së Fadil Hoxhës, si protagonist kryesor.



Po ashtu, prof. dr. Bujar Kapexhiu – “Nderi i Kombit” e vlerësoi filmin si një narrativë dokumentare me efekte letrarizuese ku dimensionin e liderit kosovar Fadil Hoxha jepet në diskursin e tij politik e patriotik, në mbrojtje të të drejtave dhe lirive të popullit shqiptar në Kosovë. Rëndësi ka materiali i pasur arkivor e fotografik dhe intervistat që japin rolin bashkëpunues të F.Hoxhës në politikëbërje në mbrojtje të kauzës shqiptare. Skenari dhe materialet filmike, intervistat me

personalitetet më të shquara akademike në Shqipëri dhe Kosovë jepen në film në mënyrë estetiko-profesionale me një nivel të lartë, duke përcjellë vlera dhe mesazhe aktuale në dobi të përparimit të shqiptarëve.

Në vlerësimet që bëjnë figurat më të shquara kombëtare akademike, historike dhe publicistike si akademik Rexhep Qosja, Jusuf Bajraktari, Paskal Milo, Nevila Nika, publicistët Veton Surroi, Akif Bajrami etj., përcaktojnë dhe ridimensionojnë figurën dhe rolin e Fadil Hoxhës në historinë e Kosovës gjatë Luftës së Dytë Botërore deri në Luftën e UÇK-së, sidomos rolin e tij vendimtar për Kushtetutën e vitit 1974, që e përcaktoi Kosovën krahinë autonome, kufijtë e së cilës shërbyen për shtetin e sotëm të pavarur të Republikës së Kosovës.

Akademik Pëllumb Xhufi evidentoi rolin e rëndësishëm të Fadil Hoxhës në tejkalimin e prapambetjes kulturoro-arsimore të shqiptarëve në ish-Jugosllavi, arritjet në fushën e të drejtave politike në kuadrin e autonomisë, lirisë dhe të drejtave politike e kombëtare dhe arritjet në Kushtetutën e

1974, përpjekjet në Konferencën e Bujanit për bashkimin kombëtar të shqiptarëve etj. Filmi dokumentar “Fadil Hoxha, arkitekti i Kosovës së lirë” ruan koherencën kontekstuale, mbështetet në inserte ndëraktive që ndërthuren në formë kujtimesth dhënë në mënyrë estetike.

Me një vështrim realist të kushteve dhe rrethanave historike, nëpër të cilat kaloi Kosova, në vitet e thyerjeve të mëdha dhe krizës së pushtetit, janë të rrallë personalitete që u kundërqëndruan sfidave, provokimeve, përndjekjeve, hileve dhe dredhive politike të panumërta, në mënyrë aq stoike si Fadil Hoxha.

FADIL HOXHA ISHTE IDEALIST, BESONTE TE LIRIA DHE PROSPERITETI I POPULLIT TË TIJ

Fadili, si shumë djem kosovarë që shkolloheshin në Shqipëri, ishte ndër të parët që përqafoi idetë përparimtare e liridashëse të kohës, pasi kishte ndjerë shtypjen e lirive nacionale, nën sundimin e regjimit të egër serb.

Fadil Hoxha, si burrë shteti, me aftësi e dinjitet, me zgjuarsiri e largpamësi të jashtëzakonshme, duke shfrytëzuar më së miri konjunkturën e brendshme politike në ish-Federatën Jugosllave, arriti ta bëjë Kosovën pjesë kushtetuese të Federatës.”

Një ndër gratë më të njohura në kohën e saj, Vahide Hoxha, reformatore e Edukimit dhe aktiviste e shquar, jo vetëm pse ishte bashkëshorte e Fadil Hoxhës, por sepse kreu funksione të shumta, që nga profesoresha e Normales në Prishtinë deri te kryetarja e Bashkësisë së Kulturës. “Sinqerisht them se kam kaluar një jetë të lumtur. Jemi marrë vesh për çdo gjë, kemi qenë si shokë. Prandaj, nuk e kam pasur lehtë që pas 56 vjetësh të ndahem prej tij. Ishte vështirë. Por, jam munduar të mbahem. Në cdo skutë të shtëpisë sime janë kujtimet, që më lidhin me të.”

Pa u zgjatur, në vlerësimet që bëjnë figurat më të shquara kombëtare akademike, historike dhe publicistike si Akademik Rexhep Qosja, Jusuf Bajraktari, Paskal Milo,

Nevila Nika, publicistët Veton Surroi, Akif Bajrami etj, pëcaktajnë dhe ridimensionojnë figurën dhe rolin e Fadil Hoxhës në historinë e Kosovës gjatë Luftës së Dytë botërore deri në Luftën e UÇK-së, sidomos rolin e tij vendimtar për Kushtetutën e vitit 1974 që përcaktoi Kosovën krahinë autonome, kufijte e së cilës shërbyen për shtetin e sotëm të pavarur të Republikës së Kosovës. Akademik Pëllumb Xhufi evidentoi rolin e rëndësishëm të Fadil Hoxhës në tejkalimin e prapambetjes kulturoro-arsimore të shqiptarëve në ish-Jugosllavi, arritjet në fushën e të drejtave politike në kuadrin e autonomisë, lirisë dhe të drejtave politike e kombëtare, dhe arritjet në Kushtetutën e 1974, përpjekjet në Konferencën e Bujanit për bashkimin kombëtar të shqiptarëve etj. Filmi dokumentar “Fadil Hoxha, arkitekti i Kosovës së lirë” ruan koherencën kontekstuale, mbështetet në inserte ndëraktive që ndërthuren në formë kujtimesh dhënë në mënyrë estetike.

Me një vështrim realist të kushteve dhe rrethanave historike nëpër të cilat kaloi Kosova, në vitet e thyerjeve të mëdha dhe krizës së pushtetit, janë të rrallë personalitete që u kundërqëndruan sfidave, provokimeve, përndjekjeve, hileve dhe dredhive politike të panumërta, në mënyrë aq stoike, si Fadil Hoxha. Ai ishte idealist, besonte te liria dhe prosperiteti i popullit të tij, shpresonte dhe ishte i bindur se nëpërmjet Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare, si pjesë e Koalicionit Ndërkombëtar Antifashist, do t’i shërbente idealit të kahershëm të popullit të Kosovës - bashkimit me Shqipërinë. Ai ishte iniciatori kryesor edhe për aktivitetin e 500-Vjetorit të vdekjes së Heroit Kombëtar – Skënderbeut (1968); 100-vjetorin të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit (1978), si dy nga ngjarjet kulmore të jetës kulturore e shkencore në Kosovë. Fadil Hoxha pati vizionin e një politikani patriot e modern, i cili projektoi dhe sendërtoi të ardhmen e atdheut të tij.

LIGJËRIMI DIPLOMATIK I SHABAN MURATIT

*Shënime për librin
“Vetëvrasja diplomatike e Kosovës dhe e Shqipërisë”*



Pasi ka ndjerë mungesën e mendimit diplomatik shqiptar për çerek shekulli, si ish-funksionar në Ministrinë e Jashtme dhe dy herë ambasador, diplomati i mirënjohur Shaban Murati po e plotëson këtë vakuum me analizat e tija të mirëfillta, të përmbledhura në 17 vepra të botuara në harkun kohor të 17 viteve të fundit. Është ky padyshim një kontribut mjaftë i qënësishëm në pasurimin e historikut të diplomacisë shqiptare. Në analet e kësaj diplomacie, vepra më e fundit e ambasador Muratit “Vetëvrasja diplomatike e Kosovës dhe e Shqipërisë” që u promovua para pak ditësh në praninë e dhjetra personaliteteve shqiptare të politikës, diplomacisë e letrave, zë vend të rëndësishëm, pasi në të shpaloset përvoja 50-vjeçare e një analisti të politikës së jashtme.

Në 75 artikujt e kësaj vepre, të shkruara në harkun kohor të tri viteve të fundit (2018-2021) Shaban Murati, “Mjeshtër

i Madh” në diplomaci, sjell mendimin e tij të avancuar si studjues i marrëdhënieve ndërkombëtare dhe analist diplomatik.

Kështu, nëse në artikullin “Në Bruksel po vërtitet Konferenca e Londrës. Pse nuk ndodhet Shqipëria?” (të datës 30 korrik 2018) shpreh shqetësimin e ligjshëm të një situate alarmante, ku përfaqësues të veçantë të diplomacisë europiane tentonin devijimin e objektit kryesor të bisedimeve përfundimtare midis Kosovës dhe Serbisë në Bruksel, tre vjet më vonë, ai denoncon me kurajo pabesinë diplomatike të Zoran Zaevit ndaj Kosovës. Thelbin e kësaj pabesie, Murati e sheh në parashtrimin zyrtar që kryeministri i Maqedonisë së Veriut Zoran Zaev, bëri në një intervistë në datën 1 gusht 2021 me Agjencinë Shtetërore Serbe “Tanjug”, ku për herë të parë zbuloi se “Ballkani i hapur” serb do të angazhohet në një platformë dhe betejë diplomatike kundër Kosovës. Do të mjaftonte qoftë edhe mosreagimi i duhur i Ministrive të Jashtme të dy qeverive shqiptare (të Shqipërisë dhe Kosovës) për të përligjur titullin sinjifikativ të veprës së ambasador Muratit “Vetëvrasja diplomatike e Kosovës dhe e Shqipërisë”. Parë nga ky këndvështrim, në ligjërimin diplomatik të tij gjejmë fakte dhe argumenta që rrëzojnë tezën e ndryshimit të kufijve midis Kosovës dhe Serbisë.

Referuar zhvillimeve historike, Sh.Murati konkludon se “Për sa i përket Kosovës, ndryshimi i kufijve të saj, nëpërmjet ndarjes, ka qenë një kërkesë konstante prej vitesh, e deri sot, e diplomacisë serbe, që nga Millosheviçi e Koshtunica, e deri te Daçiçi e Vuçiçi. Deri para bisedimeve ndërkombëtare për statusin e Kosovës, edhe disa qarqe të diplomacisë europiane e kishin konsideruar tezën e ndarjes së Kosovës si alternativë me interes” (fq.13).

Vetëm një analist diplomatik i vëmendshëm si Shaban Murati do të mund t’iu kundërvihej hapur tezave të lidërshipeve zyrtare të Kosovës dhe Shqipërisë në mbështetje

të propozimit të Presidentit Serb Vuçiç për ndarjen e mundshme të Kosovës. Pikërisht ky qëndrim i eksponentëve më të lartë të dy shteteve të Shqipërisë dhe Kosovës dëshmon vetëvrasjen diplomatike të Shqipërisë dhe Kosovës.

Ndaj dhe analisti diplomatik Murati, që para tri vitesh, ndër 14 pyetjeve të ditës që shtroi për Prishtinën dhe Tiranën zyrtare, iu drejtohet atyre publikisht se: “Me çfarë të drejte dhe norme ndërkombëtare juridike i kërkohet Kosovës t’i japë pjesë nga sovraniteti dhe integriteti i vet Serbisë, shtetit që humbi luftën më 1999? A i kanë lexuar Tirana dhe Prishtina traktatet e paqes dhe marrëveshjet e paqes midis shteteve fituese dhe shteteve të mundura në luftë?...A duhet të lejohet që Kosova të humbë në paqe atë liri e sovranitet, që fitoi në luftë me gjak dhe me ndihmën e NATO-s në vitin 1999?”.

Në trajtimin e marrëdhënieve dypalëshe Shqipëri – Kosovë të tre viteve të fundit, si dhe të raporteve të tyre me Serbinë, SHBA-të dhe BE-në, Sh.Murati arrin në konkluzionin se marrëdhëniet mes Kosovës dhe Shqipërisë janë në pikën e tyre më të ulët. Këtë e argumenton edhe me mosdakortësinë për idenë e rrezikshme të partneritetit strategjik me Serbinë. Referuar deklaratës së kryeministrit Rama në mbledhjen e përbashkët të dy qeverive më 26 Nëntor 2018 në Pejë se “Marrëdhënia jonë me Serbinë është strategjike për afat të gjatë. Shqipëria është e vendosur të ndërtojë një partneritet strategjik me Serbinë”, ambasador Murati e konsideron këtë kaq jonormale, duke menduar se do ngrejë stuhi reagimesh mbarëshqiptare, njësoj si për idenë tjetër të ndryshimit të kufijve apo shkëmbimit të territoreve midis Kosovës dhe Serbisë.

Ambasadori Murati argumenton se ky nivel i ulët marrëdhëniesh midis Shqipërisë dhe Kosovës kryesisht vjen nga presioni i fortë i Serbisë, e cila, gjatë mandatit të dytë të qeverisë së Shqipërisë ka gjetur një terren tepër të përshtatshëm për një ofensivë dhe për një imponim të ideve, tezave dhe

qëndrimeve jopozitive të qeverisë dhe të diplomacisë serbe. Kjo sipas tij edhe për faktin se pas mikrosamitit të Shkupit të 29 korrikut 2021 të krerëve të tri shteteve anëtare, përkrahëse të projektit serb me emrin “mini Shengen” apo “Ballkan i hapur” konstatohet një ngutje diplomatike dhe politike e sforcuar për të ecur sa më shpejt drejt integritit serb të grupimit të ri subrajonat. Për të argumentuar lëvizjen e “Ballkanit të hapur” në skemat ruse, analisti diplomatik Sh.Murati sjell në vëmendjen e opinionit publik deklaratën e zëvendësministrit të jashtëm rus, Aleksandër Grushko në Beograd më 18 qershor 2021 se “vendet e Ballkanit duhet të zgjedhin modelin e Federatës ruse, pra të bëhen si një shtet federativ që të ketë qendër drejtuese Beogradin, siç është Moska për Federatën Ruse”. Në këtë kontekst, mbështetjen zyrtarisht dhe publikisht të qëndrimeve të Serbisë nga Tirana zyrtare, ambasador Murati e konsideron si qëndrim që solli një çarje midis publikut shqiptar si dhe midis qeverisë së Shqipërisë dhe qeverisë së Kosovës. Madje me të drejtë Sh.Murati shprehet për defekte të patriotizmit tonë, të cilin e kemi parcial.

Ndoshta edhe për këtë mendim e ligjërimit diplomatik të avancuar, Prof.dr.Enver Hoxhaj, ish-zëvendëskryeministër dhe Ministër i Jashtëm i Republikës së Kosovës (2016-2020) e konsideron ambasador Muratin njohësin më të mirë të Kosovës dhe të raporteve të saj me botën e jashtme që nënkupton: rajonin, Europën Juglindore, raportet me BE-në, por edhe kontekstin global të asaj se çfarë raportesh ka Kosova. “Mund të them që është prej njohësve më të mirë, ndoshta prej Vjenës deri në Athinë.. Sa herë shkruhet, flitet për Kosovën: mendimi i tij lexohet në Prishtinë, jo vetëm në mesin e vendimmarrësve politikë, por edhe në mesin e shumë të tjerëve, të cilët e krijojnë, e fuqizojnë kulturën e re politike në Republikën e Kosovës”, vlerëson z.Hoxhaj.

Nisur edhe nga ky vlerësim shpreh bindjen në domosdoshmërinë e pasurimit të bibliotekave institucionale dhe vetjake të çdo shqiptari me librat e ambasador Muratit.

Veçanërisht në veprën e tij të fundit madhore “Vetëvrasje diplomatike e Kosovës dhe e Shqipërisë”, analisti diplomatik Sh.Murati argumenton edhe dështimin e madh të BE me Kosovën. Referuar dështimit të tryezave të njëpasnjëshme të bisedimeve Prishtinë-Beograd, autori i kësaj vepre e sheh dështimin e BE-më Kosovën në paaftësinë e saj për të arritur një zgjidhje përfundimtare në bisedimet tëtëvjeçare Serbi Kosovë, gjë që imponoi nevojën e angazhimit të drejtpërdrejtë të SHBA në ato bisedime.

Të mirëargumentuara janë në këtë vepër, “Dalldia filoserbe në dëm të rajonit dhe pozicioni që duhet të mbajë Shqipëria”, “Idea e rrezikshme ruse për Kosovën në Këshillin e Sigurimit” dhe veçanërisht “Doktrina ‘Bajden’, si zgjidhje për Kosovën dhe Ballkanin”.

Ajo që autori e quan Doktrina e Presidentit amerikan Bajden për Ballkanin, me pak fjalë përmbledhet në luftën kundër korrupsionit si interes strategjik dhe kundër atyre politikanëve që destabilizojnë rajonin, si dhe qendërimi i dialogut Kosovë – Serbi. Autori thekson se modeli i Ballkanit me standarte perëndimore kërkon një forcë bindëse teorike, por kërkon edhe një forcë praktike, të cilën e përfaqësojnë vetëm Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Gazeta “NACIONAL”, 4 dhjetor 2021


Gazeta “Fjala”, 11 dhjetor 2021

- <https://alb-spirit.com/.../halil-rama-ligjerimi.../>

“KOHA KUR PO SHKRIHESHIN AKUJT” NË LIBRIN E KAMBER FARUKUT

*Krimet e komunizmit meritojnë
një monument kujtëse që të mos na përsëritet kurrë
më e kaluara e Tonton-Makutëve enverianë*

*“Jemi një shoqëri në zgjim. Ta bëjmë përtëritjen nga
pesha e diktaturës me guxim. Misioni për të demaskuar
deri në fund, me fakte diktaturën u takon trimave,
atyre që nuk kanë frikë nga varret dhe hijet e së
kaluarës. Të shërojmë njerëzit e gjymtuar, të shërojmë
plagët. Të gjallët meritojnë respekt. Na takon ne që
e nisëm, ta çojmë deri në fund demokratizimin dhe
dekomunistizimin e vendit”*



Nëse do t'i përmbahemi vlerësimit që Kamber Faruku i bën gazetarit dhe shkrimtarit sovjetik Ilia Ehremburg, duke evidentuar gjuhën, stilin dhe përmbajtjen e reportazhit të tij “Si e njoha unë Amerikën”, botuar në 1947, një lexues i vëmendshëm, në të njejtin vlerësim do të arrinte edhe për librin e tij “Kur po shkriheshin akujt”.

Por, nëse Ehremburgu lejohej ta krahasonte SHBA-në me një njeri me trup gjigand, por me kokë të vogël, dhe të botonte një reportazh aq të drejtpërdrejtë dhe realist, Kamber Faruku, ndër gazetarët më kurajozë të kohës, do të haste vështirësi të panumërta në ushtrimin e profesionit, i ndodhur nën trysninë e pothuajse gjithë nomenklaturës komuniste, përfshirë edhe ish-sekretarët e parë të komitetit të PPSH-së së Dibrës. Por gjithsesi, i vënë në sprovën e së vërtetës ai, falë inteligjencës së spikatur dhe penës së tij të mprehtë arriti t’iu bëjë ball me dinjitet sfidave të asaj kohe skëterrë.

Libri i tij “Kur po shkriheshin akujt” në pjesën e parë “Shënime dollapi”, përmbledh përjetime dhe asosacione të ngjarjeve më kryesore që rrodhën vrullshëm gjatë vitit 1990, si pararendëse të legjitimitit të pluralizmit politik në Shqipëri.

Në këto ditare, përveç analizave të mirëargumentuara të zhvillimeve aktuale, ai bën retrospektivë nga e kaluara e largët për të sjellë në vëmendjen e lexuesit ato kohë kur në vendin tonë kishte pllakosuar skamja e varfëria e tejskajshme. Kështu ai e josh lexuesin të mësojë për ngjarje të kohës së luftës kundër nazifashizmit, kur “Kishte raste që në të njejtën shtëpi rrinin në kate të ndryshme armiqtë e njëri-tjetrit”. Në të njejtën linjë i trajton edhe ngjarjet e mëvonshme autori, kur sjell një rast nga Prodani, kur “vogëlushët nuk donin që ne të shihnim mjerimin që i kishte pllakosur”, ndërsa xha Ibrahimit, vëllait të Aliut që kishte shoqëruar E.Hoxhën në Prodan më 1943, i dukeshin brekushet e zeza, që kur hapeshin ishin të shpuara vrima-vrime. Në fokus të gazetarit të mirënjohur

janë zhvillimet kobndjellëse të kohës së kolektivizimit të bujqësisë, kur fshatarët, pasi dorëzuan “vullnetarisht” tokën, sistemi i detyroi të dilnin ciplak në shi e në borë. Por dhe ajo e tufëzimit të bagëtive që e la fshatarin edhe pa një lugë shëllirë. Ka edhe mjaftë raste ku autori sjell shembuj konkretë se si organizatat bazë të partisë ishin shndërruar në fole të sundimit, thashethemeve, misticizmit dhe “paragjyqeve” politike..

Në këtë libër gjejmë sarkazmën e thellë të autorit për fshatarët që do t’u kërciste luga në sahan, si në rastin, kur ai i detyruar do të shkruante e botonte kronikën “Drejt Prrenjasit” (me shënimin e tij në ditar) “me t’u dhimsë vetja!”. Dhe po me këtë kurajë K.Faruku evidenton në librin e tij edhe gazetarë, të cilët iu drejtuan natyrës së llustrës për të marrë rrogën, duke sjellë shembullin e reportazhit “Qumështi i tufëzave”, botuar në “Zëri i Popullit” më 28 qershor 1986, ku gjenden përshkrime si te përralla e Andersenit “rrobat e reja të mbretit”. K. Faruku konkludon dhe argumenton se me shkrime të tilla gazetarja jonë e zhvilloi publicistikën me gjini të reja si “Kur e zeza bëhet e bardhë” , “Lexo e ngopu” apo “Hi syve”. Këto përfundime të publicistit, diplomatit e politikanit Kamber Faruku janë në koherencë me realitetin e sotëm, kur edhe 30 vjet pas këtij tranzicioni të tejzgatur, ka kalemxhinj që iu bëjnë llustra pushtetarëve më të korruptuar e më të inkriminuar të rajonit të Ballkanit. K.Faruku, pasi analizon shkaqet që çuan në kolaps të plotë ekonominë shqiptare, ndër të tjera konkludon edhe për faktin se mendja e njerëzve, prej varfërisë së tejskajshme, ishte bërë si eshkë dhe merrte flakë urrejtje.

PORTRETIZIMET, TESTI I SAKTË I PROFESIONALIZMIT TË GAZETARIT

Libri “Kur po shkriheshin akujt”, ka ngjarje e fakte interesante nga pothuajse të gjitha zonat e Dibrës: Muhurri, Luznia,

Katër Grykët, Lura, Reçi e Dardha, Kalaja e Dodës, Çidhna e Kastrioti, Sllova e Shumbati, Shupenza e Golloborda, Bulqiza etj. Përshkrimet brilante të bukurive natyrore, si dhe portretizimi gjer në detaje i ish - zyrtarëve të nomenklaturës komuniste, sidomos i ish- sekretarëve të komitetit të PPSH të rrethit Dibër, e bëjnë mjaftë tërheqës këtë libër. Pjesa e portretizimit të një gazetari natyrisht është testi i saktë i profesionalizmit të tij. Këtë ai e jep në mjaft personazhe të spikatur, të njohur e të panjohur shumë për publikun e gjërë dibran e jodibran. Është gjë e bukur se optika e tyre përfshin personalitete të kohrave, moshave e profesioneve të ndryshme si: Dine Hoxha, Tafe Kaziu, Ali Lika, Murat Kaloshi, Halit e Haxhi Lleshi, Sali Berisha, Azem Hajdari, Anton Çeta, Safet Zhulali, Mirush Mati, Arif Mata, Adrian Skuka, Besa Mera, Rexhep Hoxha, Lavdrim Shehu, Astrit Kuka e dhjetra të tjerë që të mbeten në mendje me detajet që ai ka dhënë për jetën dhe veprën e tyre (qofshin këta personazhë negativë apo pozitivë).

I drejtëprdrejtë është K.Faruku edhe në pjesën e dytë të librit, kur nuk nguron që nëpërmjet portretizimit të fytyrave të disa ish - eksponentëve të PD-së (viti 1991) bën profetin për ardhmërinë e tyre politike. Ja çfarë shkruan autori Faruku për një rast takimi me lidërsipin demokrat në vitin 1991: “-Prisni te kjo zyra, do ta njoftoj Doktorin,-na tha një sekretare. Kur u futëm te zyra, aty ulur në një kënd, qëndronte Aleksandër Meksi....Pasi e mësoi se kemi ardhur nga Dibra dhe duam të takojmë Doktorin, shkëmbeu dy-tri fjalë me Mirushin (Mati) dhe heshti, sikur nuk kishim se çfarë të flisnim më. Me një kostum të thjeshtë ngjyrë hiri të errët dhe me jelek klasik me cepa, me një kapele me strehë të rrasur në kokën e tij tullace me flokë të rrallë anash, me mustaqet si furçe teli dhe fytyrën shumë të zeshkët, me trupin e shkurtër dhe të mbushur e rondokop, nuk e di pse, Meksi më ngjante me kallajxhinjtë, të cilët vinin në anët tona nga Përmeti dhe thërrisnin:

Kallaisim bakra! Bakra për të kallaisur!” Portretizime të tilla “të kripura”, K.Faruku bën edhe për të ndjerin Gramoz Pashko në rastin kur e kishin thirrur në një mbledhje qeverie si zëvendëskryetar i komitetit ekzekutiv pluralist të rrethit, për të dhënë llogari se pse Dibra nuk pranonte të zbatohet ligji famëkeq 7501 i ndarjes së tokës për frymë!

KUR GAZETARI VESH MANTELIN E HISTORIANIT

Sa shumë emra, sa shumë vende dhe histori, sa shumë negativitet dhe pozitivitet, dashuri dhe mirënjohje për to, ka derdhur autori, gazetari i mirënjohur, Kamber Faruku, brenda faqeve të këtij libri. Në një topografi dhe gjeografi që nga Bulqiza, Okshtuni, Klenja, Gjorica, dhe pse jo, gjer në Lurë e Kala të Dodës, Tiranë, Prrenjas e Laç.... Të rrethuar me trimëri nga jehona e kohërave, por të thjeshtë, të thjeshtë deri në madhështi vijnë e ulen pranë nesh, me fakte, me ngjarje, me jetët e tyre përmes faqeve të këtij libri.

Autori K.Faruku që provoi të jetë një publicist i sukseshshëm dhe tejet kompetent si redaktor i gazetës lokale “Ushtima e maleve” për gati 15 vjet, me shkrime nëpër gazetatat e ndryshme të vendit, me këtë libër, ai pa frikë ka veshur edhe mantelin e historianit. Vetë libri, në pjesën më të madhe të tij të sugjeron, data, ngjarje, personazhe dhe histori që do të jenë burim referencash për të ardhmen. Leksiku i pasur, fjalët e shprehjet frazeologjike të rralla dibrane e bëjnë këtë libër edhe një pasuri gjuhësore e mjaft tërheqës për lexuesin. Mjaftë interesante janë përshkrimet që K.Faruku u bën takimeve të tij elektorale të kohës kur ishte kandidat i Partisë Demokratike për deputet në zgjedhjet e para pluraliste të 31 Marsit 1991. Janë përshkrime brilante që ekzaminojnë saktë gjendjen e rëndë ku e kishte katandisur sistemi socialist fshatin shqiptar dhe ndikimin e politikës mashtruese në indoktrinimin e thellë të malësorëve të varfër.

ANALIZA TË MIRËFILLTA NË SENSIN DIPLOMATIK

Si diplomat (K.Faruku në vitin 1994 filloi punë në MPJ në Tiranë, si sekretar i parë i ambasadës shqiptare në Maqedoninë e Veriut - në atë kohë FYROM, ish- Republika Jugosllave e Maqedonisë, dhe nga shtatori deri në dhjetor 1997, me largimin e ambasadorit, u caktua i ngarkuar me punë (a.i.), bën analiza dhe arrin në konkluzione të drejta, si për kohën pas çlirimit, kur përplaseshin superfuqitë SHBA dhe BS për hegjemoni e kur “Shqipëria mbeti si gomari mes dy atllarëve dhe hëngri aq shumë shkelma, sa vetëm më 14 dhjetor 1955, mundi të ulet në kuvendin e kombeve”, ashtu edhe për vitet e mëvonshme kur “zgjodhëm disa teza ‘të mira’ nga klasikët e M-L dhe pastaj bëmë një zhvillim krijues të marksizmit”, ekperimente bajate këto që e çuan Shqipërinë në buzë të greminës më 1990.

Dhe po në sensin diplomatik gjejmë në këtë libër analiza të mirëfillta për kohën kur “Shqipëria, si subjekt demokratik në Europë, duket se u prish punë forcave shoviniste në Ballkan”, ndërkohë që sipas tij, diplomacia shqiptare rrinte si një iriq i mbledhur në kundërshtimin e saj apokaliptik. Janë analiza të kohës kur “Sllobodan Millosheviçi është bërë një politikan i errët, një nacionalist histerik, që po luan me popullin e vet si buburreci me bajgën”...dhe kur “Jugosllavia i ngjan një laraske, që kakaris si e bardhë, por ngjyrën e ka të zezë”..

Pasi analizon edhe zhvillimet në botën arabe, kur në ringun e përbaljes kishte dalë diktatori Sadam Hyseini, diplomati dhe publicisti i mirënjohur K.Faruku arrin në përfundimin se “Një popull bie në mjerim, kur u beson verbërisht udhëheqësve, vetëm se ata e trazojnë në ndjenjat dhe emocionet nacionaliste”. (A nuk është ky përfudim në koherencë edhe me zhvillimet aktuale në vendin tonë, kur ekranet e televizioneve janë tejmbushur me kronika e debate për influenza të tilla?!)

DIMENSIONI INTELEKTUAL E NJERËZOR I K.FARUKUT


Ajo që jep më së miri dimensionin intelektual e njerëzor të K.Farukut është fjala e tij (që nuk u lejua ta mbante të plotë në një takim të datës 29.06.1991 në sallën e kinemasë Peshkopi, kur kishin ardhur të deleguar Azem Hajdari e Napolon Roshi. Publicisti e politikani kurajoz, këtu, midis të tjerash do të shprehej: “Jemi një shoqëri në zgjim. Ta bëjmë përtëritjen nga peshja e diktaturës me guxim. Misioni për të demaskuar deri në fund, me fakte diktaturën u takon trimave, atyre që nuk kanë frikë nga varret dhe hijet e së kaluarës. Të shërojmë njerëzit e gjymtuar, të shërojmë plagët. Krimet e komunizmit meritojnë një monument kujtese që të mos na përsëritet kurrë më e kaluara e TontonMakutëve enverianë. Të gjallët meritojnë respekt. Na takon ne që e nisëm, ta çojmë deri në fund demokratizimin dhe dekomunistizimin e vendit. Siç thotë dijetari i shquar Visental: Liria nuk vjen nga qielli, për të luftohet çdo ditë”. E perifrashtrava këtë pjesë nga libri “Kur po shkriheshin akujt” për të sjellë në vëmendjen e lexuesit mesazhet aktuale që përcjell kjo vepër shumëdimensionale e Kamber Farukut për kohët që jetojmë.

“Kur po shkriheshin akujt” është një libër racional, emocional, dokumentar, arkivor që të bën ta marrësh diku një laps nga ato që shumë herë i kemi harruar përballë dehjes që na kanë bërë tastierat e kompjuterave dhe të celularëve dhe të shkruash diçka, mbase edhe shumë. Të shkruash për t’u bërë më tej një urë modeste e dobishme dhe e bukur mes kësaj veprë dhe publikut që e ndjek me shumë respekt, padurim dhe kureshtje çdo vepër që ai bën. Të bën që para se t’ia japësh mesazhin atyre që do e lexojnë këtë vepër të Kamber Farukut, të marrësh shumë për vete, bash si ata çirakët që kanë një kod të përbotshëm të marrjes së zanatit nga ustallarët.

Gazeta “NACIONAL” - http://www.veteraniobvl.org/html/botime/Fluturon_shqipja.pdf

SHATKU - PLEJADA E BURRAVE TË SHQUAR DIBRANË NË HISTORINË E TIRANËS

*Sagë e lavdishme sfidash të atdhetarëve Shatku. -
Ndjesia që përjeton pasi lexon librin historiko-biografik
të bashkëautorëve Dr.Saimir Shatku dhe Qatip Mara*



Plejadës së burrave të shquar që bënë emër në historinë e kryeqytetit shqiptar të gjysmës së parë të shekullit të kaluar i përkasin edhe patriotët nga Dibra e Madhe: Izet Shatku-Dibra (ish prefekt i Tiranës 1927-1928), Faik Shtaku, ish - Ministër i Drejtësisë në Qeverinë e fundit Mbretërore të kryesuar nga Koço Kotta, Shefki Shatku, ish - komandat i Përgjithshëm i Xhandarmërisë Mbretërore nga tetori 1931, si dhe disa emra të shquar të këtij fisi me histori të lavdishme.

Pikërisht, për kontributin e këtyre burrave të shquar, bashkëautorët: Dr.Saimir Shatku dhe Qatip Mara, pas një punë të mirëfilltë studimore dhe mbi burime arkivore shumë bindëse shkruan dhe botuan librin historiko-biografik “Atdhetarët Shatku”.

Procesi i hartimit, përgatitjes, sistemit dhe botimit të një libri, nuk është një punë e lehtë dhe aq më tepër e kuptueshme për këdo, por në këtë libër, katalizatori kryesor u bë rëndësia ndihmëse dhe historike e vlerave dhe figurave kombëtare, në krijimin, zhvillimin dhe konsolidimin e shtetit Shqiptar dhe institucioneve tona.

Konkretisht, libri është i ndarë në pesë kapituj, tema dhe nënkaptuj, i paisur me një bibliografi të pasur botimesh të cilat fillojnë nga periodikët e kohës, antikuarët dhe revistat e viteve 1919-1944; Dokumente arkivorë nga fondi i arkivit të shtetit me nr. 803, 804 dhe nga fondi jetëshkrimor i disa personaliteteve në këtë botim, si dhe qindra e mijëra dokumente të tjera shteruese e bibliografike retrospektive të kohës, janë një burim i rëndësishëm për këtë libër.

BURIME TË FONDIT ARKIVOR E ATIJ FAMILJAR

I një rëndësie të veçantë është përdorimi gjithashtu si pjesë e studimit i materialeve dhe dorëshkrimeve të fondit të arkivit familjar si dhe ditaret e tyre. Një kontribut të veçantë në lidhje me pasurimin e informacionit në botim, kanë dhe fondet e fotografive nga fonoteka Marubi, Shkodër, arkivi fotografik, Insituti Luce, Romë, foto-studio Ristani, Tiranë, foto Dajti si dhe foto Sport.

Periudha e studimit mbi trungun genetik të familjes Shatku, fillon që me datimin e tyre në qytetin e Dibrës së Madhe në vitin 1671, pra para 350 vitesh, si pjesë e Sanxhakut të Manastirit e duke përfshirë rrugëtimin historik të rrjedhës së kohës, dhe depërtimin e tyre në Tiranë pas eksodit masiv të shtatorit të 1913. Në libër përshkruhet me vlerësime dhe mirënjohje roli dhe kontributi i kryetarit të Bashkisë së Tiranës, Zyber Hallulli, i cili sëbashku me familjet e tjera të pasura të Tiranës si, Bargjini, Kërçiku, Vorpsi, Karapici,

Bakalli, Fagu, dolën dhe pritën kolonat e para të eksodit masiv të genocidit sllavo-serb të 1913.

Më pas, në libër, bëhet një detajim më i gjerë i fëmijërisë, arsimimit, edukimit kulturor e shoqëror, studimeve shkencore dhe deri në funksionet dhe detyrat politiko-juridike, të disa prej figurave më eminente të kësaj familje.

Pjesë e rëndësishme e librit, janë veprimtaritë dhe kompetencat që ato kanë ushtruar nga periudha 1916-1939, si guvernator rajoni në, Çall, Allasonjë, Manastir e Gramsh, prefekt i qyteteve, Durrës, Berat, Elbasan, Tiranë, Deputet i Dibrës, Tiranës dhe Elbasanit, Ministër i Punëve Botore, i Ekonomisë Kombëtare, si dhe Drejtor i Përgjithshëm i Reformës Agrare dhe Zyrës së Emigracionit, Ministër i Arsmi Kombëtar dhe i Drejtësisë dhe Komandant i Përgjithshëm i Xhandarmërisë, ndërsa periudha më me trysni e kohës, ishte ajo e dëbimit dhe urbanizimit të tyre, pas vitit 1947.

LIBËR QË PASURON LETËRSINË TONË DOKUMENTARE

Padyshim që botimi i këtij libri që pasuron dukshëm letërsinë tonë dokumentare është meritë e shtëpisë botuese “M&B me administrator Bujar Karoshi. Gjithsesi në promovimin që iu bë këtij libri në sallën e madhe të Presidentit të Republikës në kuadrin e 101 - vjetorit të Tiranës kryeqytet, autori Saimir Shatku vlerësoi rolin e redaktorit shkencor Remzi Zeqja, dhe redaktorin letrar, Lumturi Prizreni, recezentin e librit, Tofik Jegeni, si dhe Gazmend Bakiu për parathënien e librit dhe pasthënien nga prof.dr. Bujar Kapexhiu- Nderi i Kombit.

Falenderimi dhe mirënjohja shkojnë gjithashtu për Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivit, Bibliotekën Kombëtare, Institutin e Historisë, Institutin e Monumenteve të Kulturës, Fonotekën “Marubi”, si dhe Arkivin Historik të Institutit Luce, Romë për fotografitë e tyre.

NGAZËLLIM DHE NGUTJE E BRENDSHME PËR TË HEDHUR DRITË MBI AKTIVITETIN PATRIOTIK TË PERSONALITETEVE TË TILLA

Duke lexuar këtë libër, përjetimet janë të shumta dhe historia e dyerve dhe fiseve më në zë, që e kanë mbartur atdheun si një peng dashurie të përjetshme, në udhëkryqe kohësh dhe epokash, duket se konvergjon në një pikë: në shpirtin e sakrificës, që i ka udhëhequr dhe motivuar në shekuj këto familje të mëdha fisnikësh, për të bërë shumë më tepër se detyra ndaj familjarëve, derës, fisit, farefisit dhe trevës së tyre. Duke u bërë modele të sjelljes atdhetare e dinjitozë të kohës që i lindi dhe i ushquu me pasionin e etshëm të lirisë...

Madje siç shkruan Gazmend Bakiu “Mjeshtër i Madh” në parathënien “...kur merr në dorë një libër si ky, që autorët Dr. Saimir Shatku dhe Qatip Mara po i japin lexuesit, ndjen një ngazëllim të brendshëm dhe një ngutje të brendshme e të beftë, për të hedhur diçka në letër.

Impresioni i parë, kur kthen faqen e fundit të librit, është ballafaqimi me njohuritë tona, për kohën kur bëhet fjalë në këtë histori dhe përtej kësaj, fakti kokëfortë se sa të vërteta kanë mbetur në hije për dyert dhe familjet më fisnike të kombit, në një kohë të pakohë”.

“Atdhetarët Shatku” i autorëve, Saimir Shatku dhe historianit Qatip Mara, është një libër i shkruar me përgjegjësi krijuese dhe realizëm, për njërën nga familjet më me kontribut në historinë e Dibrës së Madhe.

Libri paraqet një sagë të lavdishme përpjekjesh dhe sfidash atdhetare, të burrave më në zë të fisit Shatku, që në përballje me vetveten, për të tejkaluar unin e tyre dhe rrethin e interesave të ngushta, ngrihen në lartësinë e vizioneve kombëtare. Bëhen pjesë e udhës së vështirë, plot kthesa të rrezikshme dhe honesh, ku është vërtitur koha e shqiptarëve,

në një nga periudhat më dramatike të historisë sonë, kur kërcënoheshim nga lakmia shovene, nga njëra anë, dhe nga dritëshkurtësia e orekseve të kolltukofagëve, nga ana tjetër.

Evidentimi i vlerave morale, njerëzore, diturore të pinjollëve të derës Shatku, Izet Shatkut, Faik Shatkut, Shefki Shatkut etj, nxjerrja në pah e qëndresës së tyre përballë lakmisë, dredhisë dhe korrupsionit administrativ, që edhe atëherë, si dhe sot, ka qenë më se i pranishëm në jetën politike dhe administrative shqiptare, jepet nga autorët me një kolorit të gjerë dhe të detajuar ngjyrash emocionale.

Ky libër është një ftesë për të reflektuar mbi ndalesat dhe vakumet historike. Për të parë përtej fasadave të servitura nga kohë dhe shoqëri të devijuara qëllimshëm në udhëkryqe epokash të trishta, siç ishte epoka ku ne kaluam në gjysmëshekullin absurd.

<https://www.fjalaelire.com/post/sagë-e-lavdishme-sfidash-të-atdhetarëve-shatku-që-bënë-emër-në-historinë-e-tiranës>

FISI BRUÇI I LUKANIT TË DIBRËS

*Një monografi shumëvlerëshe e autorit Faik Bruçi,
për historinë e fisit e të fshatit që pati dhjetra luftëtarë
në luftën për çlirimin e Shkodrës*



Në historinë e zhvillimeve epokale botërore dhe lokale, fiset e mëdha identifikohen me emrat e personaliteteve që ata kanë nxjerrë në kohëra e rrethana të ndryshme. Kështu ka ndodhur edhe me fisin Bruçi të Lukanit të Dibrës, për historinë e lavdishme të të cilit është shkruar dhe botuar një monografi interesante nga studiuesi dhe sipërmarrësi i mirënjohur Faik Bruçi.

Nëse Muhurri, njëri nga Nandë Malet e Dibrës identifikohet me emrin e filozofit popullor Dine Hoxha, një nga këshilltarët më të afërt të Mbretit Zog i I-rë, emër ky i përjetësuar në xhaminë e Rugës së Kavajës në Tiranë, (financuar prej tij në vitin 1930), Lukani i Katër Grykëve të Dibrës, i njohur për prijësit e mendimtarët Hoxhë Buci e Lam Tahiri (Bruçi), në kohët e sotme moderne identifikohet edhe me një emër mjaft

të njohur në metropolin shqiptar. Ky është Faik Bruçi, ndër sipërmërrësit më të suksesshëm (pronar i “Capital Tirana Hotel” tek Pazari i ri i Tiranës, fare pranë selisë së Prokurorisë së Përgjithshme), promovues i vlerave atdhetare, historike dhe kombëtare. Në këtë kontekst, treguesi më i qartë është botimi me autorësinë e tij i librit “Fisi Bruçi i Lukanit të Dibrës”, (monografi) një botim special me 230 faqe.

Ky botim shkencor i Faik Bruçit dëshmon për arritjen e një niveli të lartë në artin e të shkruarit.

Kjo për faktin se Faiku, ashtu si në çështje të sipërmarrjes, edhe në këtë libër dëshmon se din të përveçojë me inteligjencë, fakte dhe ngjarje, si pjesë substanciale e karakterit të personazheve, duke e bërë librin e tij me vlera njohëse, edukuese dhe estetike.

PAK NGA VËSHTRIMI GJEOGRAFIK E HISTORIK I LUKANIT ME HISTORI TË LAVDISHME

Në morinë e detajeve dhe fakteve interesante nga historia e vendlindjes së tij, F. Bruçi e bën ndalesën e parë tek vështrimi gjeografik e historik i Lukanit me histori të lavdishme.

Kështu, nëse përcakton saktë pozicionin gjeografik të fshatit në zemër të maleve që kufizohet: në veri me Lurën, në lindje me Muhurrin, në jug me Selishtën dhe Kacninë, në Perëndim me Qafë Murrën, (ndërsa ka si mburojë Runjën hijerëndë e kreshnike, 2048 metra mbi nivelin e detit), po aq bindës është edhe në vështrimin etimologjik për emërtimin e fshatit Lukan, që vjen nga fjala “lug” - luginë, dhe që në gjuhën dibrane shqiptohet “luk”. Pra, nga fjala “luk” erdhi emri i fshatit Lukan. Për këtë autori i kësaj monografie i referohet periudhës historike të shekullit XV. Por kjo sipas tij nuk do të thotë se Lukani nuk ka prejardhje më të herëshme, siç kanë shkruar dhe lënë dorëshkrime historianët Hysen Lala e Bajram Totraku.

Parë nga ky këndvështrim, Faik Bruçi argumenton se edhe në aspektin ushtarak Lukani është katundi më strategjik i Katër Grykëve - një nga Nandë Malet e Dibrës që luftoi dhe nuk u mposht në lufta me pushtuesit turq, serbë, austriakë etj (Mal në Dibër dhe bajrak në Mat).

Në këtë mori faktesh, meritë e autorit është përshkrimi në pak rreshta i prejardhjes së herëshme të fisit BRUÇI, nga Dardania-Kosova e sotme.

“Kjo prejardhje është treguar gojarisht brez pas brezi deri në ditët e sotme. Përmes faktesh bindëse për ekzistencën prej 250 vjetësh të fisit Bruçi në Lukan të Katër Grykëve të Dibrës, Faik Bruçi ndër të tjera shkruan se: “Burime të herëshme gojore tregojnë se fisi Bruçi ka ardhur nga Kosova, është vendosur në Shkodër, nga Shkodra në Domgjon e Fan të Mirditës. Stacioni i parafundit ka qenë Fushë Lura”. (fq.14).

KUVENDI I KULLAVE

Mjaft bukur shkruan autori i kësaj monografie për institucionin e kuvendit të kullave. Në Lukan nuk ka shtëpi, por kulla. Çdo shtëpi është një kullë, është një kala trimërie që ka brenda saj burra të mençur dhe trima të vendosur.

Në këto kulla të bekuara nga Zoti dhe të uruara nga Dede Bruçi, Hoxhë Bushi, Hoxhë Buci e Dede Ndrejoni kanë lindur, janë rritur e burrëruar qindra e mijëra djem petrita. (Djemtë dhe vajzat e tyre gjenden sot në disa vende të Europës, Amerikës, Kanadasë e Australisë, si sipërmarrës, mjekë e artistë me emër). “Në muret e këtyre kullave u varën qindra armë miqsh e trimash, bujtës nga Katër Grykët, Muhurri, Luznia, Lura, Dibra e Madhe, Mati, Kruja etj. Nga krismat e pushkëve të këtyre kullave u bekuan qindra dasma dhe lindje djemsh. Njerëzit ndër vite u dhanë jetë kullave dhe kullat ndër vite mbrojtën njerëzit. Në kullat e Katër Grykëve bujtën Abdyl Frashëri, Iljaz Pashë Dibra dhe udhëheqësit e Lidhjes

Shqiptare të Prizrenit. Këtu mori jetë jeta jonë, rruga jonë”, - shkruan F.Bruçi në monografinë “FISI BRUÇI I LUKANIT”.

Në këtë libër, faqe pas faqeje hidhet dritë mbi luftimet e trimave të Lukanit e të krejt Katër Grykëve në betejat kundër turqve e serbëve, ndërkohë që mjaftë bukur autori e përshkruan Lukanin si strehë të njerëzve të shpërngulur nga raprezaljet serbe.

Kësisoj karakteret humanë shfaqen si shëmbëlltyra të përzgjedhura nga dora e një studjuesi të zellshëm dhe me talent, duke të bërë për vete me stilin e të shkruarit.

Dhe ajo që e bën të veçantë librin “FISI BRUÇI I LUKANIT, në raport me disa botime tjera në formë monografie apo enciklopedie për fshatra tjerë të Dibrës, është fakti se ai rrok brenda tij një periudhë të gjatë, gati një shekullore, duke derdhur dashuri dhe mirënjohje për personazhe dominantë të historisë sonë kombëtare.

Kështu ai sjell për lexuesin profilin e Bajram Bucit, i njohur ndryshe si Hoxhë Buci, i cili si njeri i zgjuar, i arsimuar dhe atdhetar ishte i pranishëm në të gjitha ngjarjet e mëdha historike që kaloi vendi ynë në vitet 1860-1913, veçanërisht si përfaqësues i Lukanit në Lidhjen Shqiptare të Prizrenit më 10 qershor 1878. “Veprimtaria e Hoxhë Bucit është shumë e gjerë. Për të kanë shkruar historianët Kristo Frashëri, Kristaq Prifti, Selami Pulaha, Stefanaq Pollo, Bajram Xhafa etj. Për veprimtarinë e tij, përveçse në Arkivin Qëndror të Shtetit Shqiptar ka të dhëna e dokumenta edhe në arkivat e Turqisë, Austrisë etj”,-nënvizon autori F.Bruçi në këtë monografi kushtuar fisit të tij emërndritur në historinë tonë kombëtare.

Një tjetër personazh interesant i këtij libri është Islam Tahiri (Bruçi), simbol i zgjuarsisë dhe trimërisë dibrane. Duke e profilizuar si një njeri bashkëkohor, autori shkruan se: “Lami njihet si njeri i kohës, i muhabetit, me zgjuarsi natyrale dhe i zoti. Jetoj në periudhën e sundimit otoman, kohën e pushtimit serb, Luftën e Parë dhe të Dytë Botërore,

në periudhën e regjimit komunist, dhe kurdoherë diti të orientohej drejt dhe të mbijetonte”. Më tej autori i kësaj monografie shkruan për Tofik Xhafer Bruçin që ishte lezeti i odës së burrave, i odës dibrane por dhe arkitekti i unitetit të fshatit, si dhe për Bajram Totrakun që ia ngiti lart emrin Lukanit dhe Katër Grykëve të Dibrës.

LAVDI BURRAVE TË LUKANIT QË LUFTUAN PËR ÇLIRIMIN E SHKODRËS

Një shembull frymëzues atdhedashurie janë 14 burrat e Lukanit, nga të cilët katër të fisit Bruçi, që shkruan faqe heroizmi në luftën legjendare për çlirimin e Shkodrës.

Gjatë rrethimit që iu bë nga 28 tetori 1912 deri më 23 prill 1913, në kuadrin e Luftës së Parë Ballkanike, prej forcave aleate të Malit të Zi dhe Serbisë kundër forcave të Perandorisë Osmane, Shkodra qëndroi e pamposhtur, falë edhe mbështetjes prej forcave rezerviste dibrane.


Studiuesi F.Bruçi, referuar dokumentave arkivore shkruan në këtë monografi se në luftën për çlirimin e Shkodrës, ndër 17 batalionet rezerviste të rezistencës, njëri ishte Batalioni i Dibrës. “Udhëheqësit kryesorë të forcave vullnetare të Katër Grykëve kanë qenë Hoxhë Buci dhe Smajl Nika. Lufta zgjati 6 muaj. Në këto luftime dhanë jetën 114 dibranë, midis tyre edhe disa luftëtarë nga Lukani dhe Katër Grykët”, shkruan F.Bruçi në këtë monografi (fq.38). Madje sipas tij, Smajl Nika prej Qafë Murre, shpëtoi përveç flamurit (bajrakut) të Katër Grykëve edhe bajrakun e Lurës dhe të Matit. Gjithashtu në respekt të kontributit të të parëve të fisit e fshatit të tij të lindjes, ai rendit emrat e disa burrave të Lukanit që luftuan për çlirimin e Shkodrës, si: Hoxhë Buci; Islam Tahir Bruçi, Shaban Ali Bruçi; Xhafer Can Bruçi, Shaban Xhafer Dervishi; Ali Lik Dervishi; Selman Dervishi; Mustafa Buci; Sali Totraku; Llan Koka; Ibrahim Ndregjoni, Destan Ndregjoni,


Zeqir Ndreka etj. Pjesë e kësaj monografie shumëvlerëshe është edhe kontributi i Dine Hoxhës e Llan Destan Ndrejonit në mobilizimin e trimave të Lukanit përballë qëllimeve shoviniste të Serbisë, si dhe mbështetja që Katërgrykasit i dhanë qeverisë së Arrasit më 1920. Këtë monografi e bëjnë tërheqëse kapitujt “Njerëz të thjeshtë që ja kushtuan jetën Lukanit”, “Nderim dhe respekt për luftëtarët dhe veteranët e Luftës së Dytë Botërore”, “Fisi Bruçi, fis me tradita të shquara bujarie”, sidhe artikujt: “Lukani, fshat arsimdashës”; “Përkras të kulturës dhe qytetërimit”, “Intelektualët e rinj”, “Plejadë burrash që siguruan mbijetesën e fshatit”, dhe “Bijtë e Lukanit, biznesmenë të fuqishëm në shkallë vendi”.

Brenda faqeve të kësaj monografie gjen plot emra të spikatur të fisit Bruçi e të gjithë fshatit Lukan të Dibrës që qëndrojnë me dinjitet në panteonin e vlerave.

FAIK BRUÇI, “MJESHTËR I MADH” DHE “NDERI I QARKU DIBËR”

Autori i kësaj monografie, Faik Bruçi është dekoruar nga Presidenti i Republikës me titullin e lartë “Mjeshtër i Madh” me motivacionin “Në vlerësim të kontributit të çmuar në ndërtimin e veprave hidroteknike në mbarë vendin. I dalluar si humanist dhe kontribues në dobi të bashkësisë dibrane





dhe promovues i vlerave atdhetare, historike dhe kombëtare.” (Dekret Nr.11272, datë 12.09.2019). Po ashtu, Këshilli i Qarkut Dibër, me vendim Nr.5, datë 13 mars 2018, e ka nderuar Faik Bruçin me titullin më të lartë “Nderi i Qarkut Dibër”, me motivacionin: “Në vlerësim të veprimtarisë së tij, për mbështetjen financiare, në ruajtjen dhe promovimin e vlerave për historinë, artin, sportin dhe kulturën dibrane”. Këto tituj të lartë nderi janë vlerësim i kontributit të tij të dukshëm si një nga sipërmarrësit shqiptarë më të suksesshëm. Për shumë vite ai ka themeluar dhe drejtuar Kompaninë “Bruçi” shpk, Kompaninë “Jon 2002” si dhe ka qenë aksioner i rëndësishëm dhe i suksesshëm në “Bankën Popullore”, Kompaninë e Sigurimeve “Albsig”, Hidrocentralin e Gjançit, Korçë dhe njëkohësisht sot është pronar i vetëm i “Capital Tirana Hotel”. Biznesi dhe aktiviteti i tij çdo vit ka njohur vetëm ngritje dhe suksese. Për këtë, kompanisë që ai drejton dhe personalitetit të tij angazhues, me aftësi të mira menaxhuese, i janë akorduar tituj dhe simbole vlerësuese nga institucione brenda dhe jashtë vendit tonë.

III.
PËR DISA LIBRA
STUDIMORË-SHKENCORË

PROF. DR. ESHREF YMERI, SHTIGJEVE TË FJALËS ARTISTIKE

Në librin e ri të profesor Ymerit gjejmë modelin më të mirë se si duhet shkruar recensionin i një veprë letrare



Ndonëse shpreh me tepri modestinë e tij në analizën e veprave letrare të më shumë se 70 autorëve (që sërish, me modesti prof. Ymeri i quan “SHKRIME”), ato në vetvete janë recensa të mirëfillta, ku jepen detaje për tematikën, figuracionin, përmbajtjen e mesazhet që përcjellin...

Mirënjohja si shprehja më e bukur e karakterit të njeriut gjen mishërim të plotë në librin e ri të prof.dr.Eshref Ymerit, Shtigjeve të fjalës artistike. Që në hyrje të librit, me titullin “Dy fjalë”, ky personalitet i shquar i letrave dhe i kulturës kombëtare, falenderon të gjitha ato pena të talentuara shqiptare që ia kanë dhuruar librat e tyre me aq bujari. Dhe profesori ua shpërblen po me aq bujari, me mbresat e renditura me modesti në faqet e këtij libri. Në librin e ri të profesor Eshref Ymerit Shtigjeve të fjalës artistike gjejmë modelin më të mirë se si duhet shkruar recensionin i një veprë letrare. Prandaj edhe prof.dr.Fatmir Terziu e konsideron veprën studimore të

prof.dr.Eshref Ymerit “Shtigjeve të fjalës artistike”, një analizë tekstuale brenda zbërthimit kontekstual. “Kjo vepër,-thotë ai,- është një ndalesë e gjatë e autorit, ku në thelbin e ndërmarrjes së tij u jep përgjigje të thellë e kuptimplote mjaftë enigmave ku rreken burimet e frymëzimeve të autorëve të ndryshëm, në atë pikë ku shkrimet e para janë të lidhura me faktet dhe me prototipat dhe në pikën ku krijimtaria e vëzhguar thellë e në detaje, merr një zhvillim më të madh”.

“PËR TË QENË KRITIK I SHKËLQYER, DUHEN AFTËSI PËR TË QENË NJË SHKRIMTAR I MIRË”

Jo pa qëllim prof.Ymeri citon shkrimtarin dhe personalitetin shtetëror frances Fransua Vilmenit (Abel-François Villemain – 1790-1890), kritik dhe historian i letërsisë: “Për të qenë kritik i shkëlqyer, duhen aftësi për të qenë një shkrimtar i mirë. Vetëm talenti është në gjendje t’i zgjerojë hapësirat e dijes”. Në këtë qasje, prof.Ymeri rendit mbresa që ka përjetuar nga leximi i veprave artistike që ia kanë dhuruar mikësja apo miq të tij, pena të talentuara në botën e letrave shqipe. Dhe kështu, prof.Ymeri vlerëson strukturën e librit “Vikama e tingullit” të Vera Ibrahimit, kushtuar Artistit të Popullit, Feim Ibrahimit, shkruar në trajtë ditari, por me përthyerje kronologjike e me fluturime lirike e që të pushton qenien sapo ke lexuar rreshtat e parë. Ndonëse shpreh me tepri modestinë e tij në analizën e veprave letrare të më shumë se 70 autorëve (që sërish, me modesti i quan “SHKRIME”), ato në vetvete janë recensa të mirëfillta, ku jepen detaje për tematikën, figuracionin, përmbajtjen e mesazhet që përcjellin.

Prof.Ymeri i evidenton fare qartë këto elementë, kur ndalet te “Shtegtimet lirike në poezinë e Elida Buçpapajt.” Në analizën e vëllimit poetik me titull “Ujshëm”, prof. Eshref Ymeri evidenton, ndër të tjera lirizmin që përbën njërin nga karakteristikat e të menduarit artistikisht të poetes, publicistes

dhe përkthyeses së talentuar Elida Buçpapaj, që mbështetet në përjetimet vetjake gjatë perceptimit të ngjarjeve në morinë e realiteteve shqiptare, çka gjen pasqyrim në gjendjen e saj shpirtërore.

Po ashtu, në analizën e romanit “Çatia e gjarpërinjve” (Misteret e çatisë së gjarpërinjve” – fq.339), prof.Dr.Eshref Ymeri (të cilin me të drejtë prof.dr.Fatmir Terziu e konsideron “Filozofi modern mes dy kohëve”), shkruan: “...Poet-shkrimtari Eqerem Canaj e ka lidhur vërtetësinë e realitetit që përcjell në krijimtarinë e vet me shtresëzimet e një stili të papërsëritshëm që e shpërfaq me një shpirt krijues të jashtëzakonshëm”. Thjeshtësinë deri në madhështinë e tij, prof.Ymeri e tregon edhe në analizën e poezisë së Qazim D.Shehut, të cilin e konsideron një zë origjinal që ndjek shtigjet e veta të krijimtarisë, duke iu shmangur me elegancë përditshmërisë.

Për prof.Ymerin, “Ligjërimi poetik i Qazim D.Shehut të bën përshtypje për forcën shprehëse, të cilën ia japin mjetet artistike, figurat që ai di t’i organizojë me art”.

Në koherencë me realitetin objektiv prof.Ymeri analizon lirizmin emocionues të shkrimtares Mira Meksi, prozën tregimtare të Sotir Athanasit e Vilheme Vrana Haxhirajt, fushëbetejën e fjalës artistike të Uran Butkës, “potpurinë” letrare të Flori Bruqit, fabulën në penën e Nimfa Hakanit, si dhe poezinë e poetëve Daniel Gazulli, Artur Shemaj e Arqile Gjata.

FRYMA POLEMIZUESE....

Duke rrugëtuar nëpër këto shtigje, prof Ymeri, nuk ngurron të bëjë një “pushim të shkurtër” edhe te poezia elegjiake e Dritëroit me titull “Më fal Enver”, kur shkruan se “..dikatura e egër e kriminelit Enver Hoxha e kishte bërë punën e vet: Njerëzit i kishte zhveshur tërësisht nga dinjiteti personal”. Por vetëm një faqe më pas të kësaj vepre shumëpërmasore, me

gjykim racional gjegjë një tjetër përfundim të prof.Ymerit për poezinë e Dritëroit me titull “Sikur s’jetoj në vendin tim”. Pasi pohon se e ka lexuar këtë poezi në faqen internetike VOAL të datës 19 shtator 2016, me moderatorë dy publicistë me emër të kombit shqiptar – Elida Buçpapaj dhe Skënder Buçpapaj, prof. Ymeri shkruan: “Poezia është mjaft prekëse dhe dëshmon për një zhgënjim tepër të madh të Dritëroit në këtë moshë të nderuar”. Do të mjaftonin për të arritur në këtë përfundim qoftë edhe vargjet e të Madhit Dritëro: “Ky vend më duket do helmohet krejt/ Nga helmi rrjedhur vrimash në themelet, /Pastaj do tundet toka në tërmet/ Dhe djalli i Madh do qeshë e do zgërdheshet”.

I drejtpërdrejtë, objektiv dhe konciz është prof.Eshref Ymeri kur shkruan se “Nuk mbrohet Kadarea me të pavërteta”. Pasi ka lexuar artikullin e botuar nga Poli Hoxha me titull “Kadarea, Enveri dhe ata që s’kanë ‘jetuar’ atëherë” (Gazeta “Ballkan”, 02 korrik 2004), prof.Ymeri ndër të tjera shkruan: “Sigurisht, nga kujtimet e Kadaresë për Enver Hoxhën nuk del askund se ai ka qenë beniamin i diktaturës. Por halli është se ‘beniaminizmin’ e vet ndaj diktaturës Kadarea e ka vulosur me krijimtarinë e vet poetike, e cila është e shkruar e zezë mbi të bardhë dhe sot është pronë e mbarë lexuesve shqiptarë”.

PËRSËRI PËR MIRËNJOHJEN

Mirënjohja, ky virtyt që e fisnikëron njeriun përshkon pothuajse tërë librin “Shtigjeve të fjalës artistike” me 543 faqe të prof.dr.Eshref Ymerit. Ashtu si modestinë, edhe mirënjohjen, prof. Ymeri e shfaq me tepri, jo vetëm në përditshmërinë e tij, në takimet me miq e shokë, por edhe në analizën e veprave të autorëve të ndryshëm (pa i diferencuar ato) .

Ndoshta, nisur edhe nga kjo anë e profilit të tij, miku im, publicisti dhe prozatori i njohur Shefqet Meko, shkruan: “Prof. dr.Eshref Ymeri është nga ata burra, që i peshon fjala dhe i

ndrit karakteri. Ai, me gjithë aftësitë e shquara si përkthyes dhe intelektual, nuk u bë kurrë vegël e politikës jargavitëse të kohës që jetojmë, por duket se ka nënshkruar vetëm një ‘kontratë’ me të vërtetën dhe Shqipërinë”.

Po. Prof. Eshref Ymeri ka qenë dhe është i drejtpërdrejtë ndaj kalemxhinjve, që tentuan dhe tentojnë të shtrembërojnë historinë e kombit tonë. Ai i tillë është edhe në shprehjen e mirënjohjes për ata dhjetëra krijues të talentuar që veprat e tyre i bazojnë tek e vërteta. Prandaj jam i një mendjeje me Skënder Sadri Kapitin, i cili, i nxitur nga shkrimi i prof. dr. Eshref Ymerit, me titull “Mirënjohja është pasuri shumë e çmuar shpirtërore” (faqja e internetit “Fjala e lirë”, 11 janar 2021) shkruan: “Te profesor Eshref Ymeri, mbi gjithçka konstatojmë shpirtgjerësinë, modestinë dhe respektin e mirënjohjen që e karakterizon”. Këto veti të karakterit të tij i gjejmë pothuajse në të gjitha vlerësimet e librave, të përmbledhura në veprën “Shtigjeve të fjalës artistike”.

Po ashtu edhe Vilheme Vranari-Haxhiraj - akademike, Mjeshtre e Madhe, në librin e saj “Elitat e mohuara Krenari kombëtare” (Shtëpia Botuese “Nacional” - Tiranë 2019, fq 404-411), ndër të tjera shkruan: “Eshref Ymeri është një personalitet dhe individualitet i veçantë i kulturës sonë kombëtare, një erudit që ka dhënë vlera të pallogaritshme në fushën e gjuhësisë, të përkthimit dhe të publicistikës”.

Dhe së fundmi, dua të përshtaq edhe mirënjohjen që prof. dr. Eshref Ymeri shpreh për shoqen e shtrenjtë të jetës së tij, Havanë. Jo vetëm për mirërritjen e miredukimin e dy fëmijëve të tyre, Plarentit dhe Kesianës, të cilët tashmë kanë hyrë me dinjitet në indin e jetës amerikane, por edhe për ndihmën e çmuar në redaktimin dhe korrektimin e artikujve publicistikë dhe të librave të botuar.

<https://fjala.al/2021/10/09/eshref-ymeri-shtigjeve-te-fjales-artistike/>

NJË LIBËR, SA INTRIGUES AQ EDHE MBRESËLËNËS

Shaqir Rexhvelaj sjell për lexuesin librin e tij të parë, me titullin mjaftë sinjifikativ “ARTI I TINGUJVE”



Pas një përvoje, të vyer, prej pesë dekadash, si gazetar e drejtues programesh në Televizionin Publik Shqiptar dhe si Drejtor i Përgjithshëm i Kulturës në Bashkinë e Tiranës dhe në MTKRS, Shaqir Rexhvelaj solli për lexuesin librin e tij të parë, me titullin mjaftë sinjifikativ “ARTI I TINGUJVE”.

Më shumë se sa për titullin intrigues, ky libër të tërheq që në fillim dhe të mbërthen pas asaj që shkruhet në të, faqe pas faqeje, në katër kapitujt e tij, deri te “Impresione nga Festivale dhe Koncerte”, jo vetëm për larminë e personazheve, por parasëgjithash për stilistikën e përdorur në përshkrimin e tyre.

I konceptuar si ansambël unik vlerash, për t'i dhënë publikut atë që i mungonte nga “Të mëdhenjtë e muzikës dhe muzikologjisë”, ky libër bart vlera shumëdimensionale, për kohën që jetojmë dhe për brezat e ardhshëm.

Me një filozofi të qartë dhe mesazhe të përbotshme, studjuesi i mirëfilltë Rexhvelaj, tashmë edhe si një kritik arti, që në fillim të librit sjell risi në përshkrimin plot finesë të të papërsëritshmit e të paarrtshmit Ludvig Van Beethoven. Këtë e bën jo rastësisht, por duke evidentuar disi ndryshe stilin, format dhe gjinitë muzikore që krijoi kompozitori i fashmëm.

Në të njejtën linjë ecën autori edhe me profilin e themeluesit të etnomuzikologjisë shqiptare, Ramadan Sokoli. “Arti i tingujve” të këtij kolosi na jepet nëpërmjet studimeve e krijimtarisë brilante që ai la pas si trashëgimia më e vyer për nxënësit e studentët e Shkollave e Universiteteve të Artit, brenda e jashtë vendit. Nëpërmjet portetizimit brilant dhe intervistave të një rëndësie të veçantë studimore, Sh.Rexhvelaj, ka ditur të përveçojë “nektarin” e veprës së Prof.R.Sokolit - një prej figurave më të spikatura të muzikës sonë; studjuesit, kompozitorit, etnomuzikologut, albanologut, filozofit dhe analistit më të ndjeshëm, të asaj që quhet “amë e shpirt” e krijimtarisë popullore folklorike prej një harku kohor shumë “shekullor”, që përfshin historia krijuese e jetës së një kombi, e “genit” shqiptar.

Duke vijuar me personazhet tjera, si Nikolla Zoraqi, Muharrem Xhediku, Kozma Lara, Aleksandër Peçi, Mihal Ciko, Vaso Tole, etj, autori na jep portrete artistësh nga këndvështrime të freskëta origjinale. Jeta dhe vepra e tyre na jepet artistikisht përmes tablove e detajeve të zgjedhura me kujdes nga autori.

Në kritikën letrare të veprave të disa prej autorëve, ku ka qenë prezent e ka folur, si dhe në esetë, profilet, intervistat e reçensionet e përfshira në librin “Arti i tingujve”, autori Rexhvelaj arrin të japë me mjeshtri krijuese thelbin e këtyre veprave madhështore, në një kontekst si historik, ashtu dhe bashkëkohor. Në katër kapitujt e librit dallohet fare qartë fryma e analizë-sintezës si konfirmuese, ashtu dhe kritike konstruktive e polemizuese që jep mesazhe civilizuese.

Në tërësinë e tij, “Arti i tingujve” jeton si një simbiozë e sinqertë midis emocionit dhe ideve krijuese të gazetarit dhe studiuesit, Shaqir Rexhvelaj. Me këtë libër ai prezantohet si përfaqësues tipik që siguron kohezion midis breza artistësh. Këtë e dallojmë në resurset kulturore e artistike, në vlerat rrëfimore për festivale kombëtare e ndërkombëtare, ku gjejmë mjaftë skena mbresëlënëse, por dhe në profilet e kompozitorëve, këngëtarëve, koreografëve e studjuesve të artit që përbëjnë sfondin e librit.

Parë nga ky këndvështrim, libri “Arti i tingujve” është trashëgimia e bukur kulturoreartistike që mund të gesh në gjuhën shqipe. Lënda e këtij libri bart gjithashtu kulturën e lartë gjuhësore, të cilën autori e zotëron deri në perfeksion, e sintetizuar kjo në gjuhën e pasur gjatë përshkrimit të personazheve. “Arti i tingujve”, na evidenton gjithashtu autorin Rexhvelaj, si një zë i spikatur i kulturës sonë kombëtare. Ai del para lexuesit me një karrierë të pasur artistike e shkencore.


Rexhvelaj, që e mbylli karrierën e tij si Drejtor i Përgjithshëm i Kulturës, Rinisë dhe Sporteve në MTKRS para pesë vitesh, krahas Konservatorit Shtetëror të Tiranës (Sot Akademia e Arteve) është diplomuar edhe për gazetari në Universitetin e Tiranës, Fakulteti i Shkencave Politike e Juridike. Ai ka një përvojë të gjatë profesionale si flautist në Orkestrën Simfonike të Radios dhe Kinematografisë dhe në Televizionin Shqiptar si Redaktor Përgjegjës në Redaksinë e Muzikës. Në vitet 1977 – 1989 si Përgjegjës i Redaksisë së Programeve Artistike në RTV dhe Udhëheqës Artistik është ideues dhe bashkerealizues i shumë emisioneve, programeve, dhe spektakleve televizive. Po ashtu si Drejtor i Krijimitarisë Muzikore në Radiotelevizion dhe Udhëheqës Artistik i Orkestrës Simfonike të Radiotelevizionit ka realizuar: Festivalin e 28 – të të Këngës në RTV (1989) si Udhëheqës Artistik i Festivalit ; Koncertet e Pranverës në RTV (1989 dhe 1990) dhe Festivalin e Parë të Interpretuesve të Këngës

Popullore (1989) po si Udhëheqës Artistik. Në harkun kohor të 10 viteve (1990-2000) Shaqir Rexhvelaj kryen me kompetencë e profesionalizëm funksionet: Shef i Seksionit të Kulturës në ish -Komitetin Ekzekutiv të KP të Rrethit të Tiranës dhe Sekretar i Përgjithshëm i Komitetit Ekzekutiv Pluralist të Rrethit të Tiranës; Shef i Arteve dhe Drejtor i Drejtorisë së Kulturës, Rinisë e Sporteve në Bashkinë e Tiranës. Kariera e tij artistike pasurohet me aktivitet intensiv si Laurat i Festivalit të Parë Folklorik Kombëtar organizuar në Tiranë, si instrumentist popullor, pjesëmarrës interpretues në Festivalin e 6 – të Botëror të Rinisë e Studentëve në Moskë; pjesëmarrës interpretues në Festivalin Folklorik të Vendeve të Ballkanit dhe Zonës së Adriatikut, me Ansamblin Shtetëror të Këngëve dhe Valleve Popullore në Bukuresht, Rumani dhe si pjesëmarrës interpretues në Festivalin Folklorik Botëror, me Ansamblin Shtetëror të Këngëve dhe Valleve Popullore, në Kajro – Egjipt. Veprimtaria krijuese e Shaqir Rexhvelajt i përket kryesisht gjinive televizive dhe gjendet e regjistruar pranë Arkivit të Radiotelevizionit Shqiptar, bashkë me fillimet e tij si televizion profesional me programe të rregullta në vitin 1971. Ka realizuar kryesisht emisione muzikore artistike, programe, spektakle si “Bashkë me Ju”, “Fituesja e Fitueseve», “Këndon për Ju” “Portrete Artistësh”, “Koncrete Varjete” e Filma muzikorë, etj. Në 2010, me propozim të Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Presidenti i Republikës i akordoi Urdhërin “Naim Frashëri i Artë”. Shaqir Rexhvelaj është një emër i spikatur edhe në politikën shqiptare të këtyre 20 viteve të fundit, si sekretar i Përgjithshëm dhe nënkryetar i Bashkimit Socialdemokrat dhe Bashkimit Liberal Shqiptar.

http://www.veteraniobvl.org/html/botime/NE_PANTEONIN_E_VLERAVE.pdf

VEPËR SHKENCORE ME VLERA TË JASHTËZAKONSHME ETNOKULTURORE

*Për librin studimor të Prof.dr.Fatmir Terziut
“Toponimia e Gollobordës: Diskursi i dygjuhësisë
dhe derivati i origjinës*



Sfidë e hapur ndaj Akademisë Shqiptare, që në monotoninë e vet përgjumëse ende nuk është kthyer në “gardën kombëtare” të mbrojtjes me “zjarr akademik” të të vërtetave gjithëshqiptare që shpesh mbulohen me mashtrime ulëritëse nga fqinjët tanë.

PARARENDJA E SHKRIMIT

E lexova me shumë vemendje dhe interes të veçantë librin studimor të Prof. Dr. Fatmir Terziut “Toponimia e Gollobordës: Diskursi i dygjuhësisë dhe derivati i origjinës”. Një analizë të mirëfilltë mjaft të detajuar i ka bërë këtij botimi Prof. Dr. Eshref Imeraj, i cili që në krye të pasthënies nxit

lexuesin, kur shprehet: “Lexohet me shumë kënaqësi. Kjo është një vepër me vlera të jashtëzakonshme etnokulturore”. Por unë do të veçoja vlerat studimore, duke e konsideruar këtë një vepër të rëndësishme shkencore.

TRI DALLESAT TIPOLOGJIKE

Së pari: Që në fillim, autori trajton bindshëm dhe me finesë marrëdhënien mes gurit dhe zjarrit duke pëshkruar “...prodhimin e produktit të lindur prej gurit dhe zjarrit me produktin që në fakt kishte përdorim të dyfishtë, shëndetësor dhe estetik, të katër faktorët janë të pranishëm: toka, riprodhimi primitiv, puna dhe paraja, kombinimet e ndryshme të të cilave përbëjnë historinë e këtij produkti, që u ngjiz si gëlqere, një nga elementët më të rëndësishëm, pas vetë grurit, baltës, rërës dhe drurit në një proces të ngritjes estetike të një banese. Por që nga momenti i shkulljes së tyre nga toka, deri në formëzimin e fundit të gurit e produktit të fundit të vënies në shërbim të obligimit njerëzor, si produkt i tij pas zjarrit, gëlqerja, vetvetiu sillen në mënyra gati se gjithmonë kundërshtojnë rrënjësisht lidhjen me zjarrin.

Shtëpitë janë të tilla pas së gjithave, por kur zjarri dhe zjarrvënësi nuk kanë arsyen e dhimbjes, natyrisht kundërshtia shkon përtej dhimbjes në të gjitha rrëfenjat, këngët e rrjedhat. Në këtë kornizë të ardhur nga rrëfenjat guri i skalitur në duart e ustait e mbajti zjarrin në shpirt, në zemër e në tërë udhën e tij të ecjes jetike. Sakaq ustai forcoi dashurinë me gurin. ”Për analogji, sipas një legjende: kur dibranët e Dibrës së Madhe u vendosën në Tiranë, pas eksodit të 1913- tës, lyen muret e shtëpive dhe të avllive me gëlqere dhe tiranasit u çuditën dhe kujtuan se po i lyenin me qumësht... Jo, ajo ishte gëlqerja që Prof. Terziu e sjell me rëndësinë që ka si element i pazëvendësueshëm në ndërtimtarinë shqiptare, ku gollobërdasit dhe dibranët kanë në histori unike si njerëzit

që sikur kanë ndërnuat cepe më cep të Shqipërisë duke vënë “vulën” e qëndresës kombëtare edhe pse gjithmonë nën sulm dhe drejt “detdhedhjes” nga fqinjët e pangopur.

Së dyti: Gjatë vitit që punoja në ish-këshillin e rrethit Bulqizë për 7 vjet (1991-1997) kam shkelur pothuajse në shumicën e fshatrave të ish-komunave Ostren e Trebisht, ndërsa më parë, në shtëpinë e oficerëve Bulqizë (1997- 1991), edhe në disa fshata të Steblevës, madje deri na Draganin majë maleve. Por veçanërisht, në gazetën “Bulqiza” që themelova dhe nxora rreth 90 numëra të saj (1992-1996 në Bulqizë dhe 1015-2020 në Tiranë) kam botuar disa artikuj studimorë të autorëve të njohur nga Golloborda: Hilmi Sadikaj, Velo Cfarku, Agim Bekteshit, Besnik Rama etj, të cilët përveç pozitës gjeografike, pavarësisht dygjuhësisë argumentojnë se shumica e banorëve të kësaj zone janë shqiptarë autoktonas dhe kjo “dygjuhësi” shpjegohet me tregun dhe etjen për punë të burrave të Gollobërdës historike.

Pa marrë parasysh vëshirësitë e ndërmarrjes së një studimi të tillë në një kohë kur parlamenti i Shqipërisë ka miratuar tashmë ligjin “Për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare”, në të cilin ka përcaktuar se minoritetet në Shqipëri janë nëntë, përfshirë dhe pakicën bullgare, të cilësuar si të tillë popullsinë e fshatrave të zonës së Gollobordës, Prof. Dr. Fatmir Terziu, nëpërmjet referencave të shumta, ku unë veçoj prof. Kristo Frashëri, prof. Eqerem Çabej, Marin Barleti, Hilmi Sadikaj, arkivat britanike (sidomos mendimtarët e shquar si bizantologu francez Alen Dykelie (Allain Ducellier), dhe historiani anglez Noel Malkolm, etj, është më bindës në këtë kontekst.

Kjo sepse argumenton bindshëm se si lëvizjet dhe pushtimet kanë sjellë ndryshime, jo vetëm në konstrukt, por dhe në ADN-në e popujve, krahinave e njëzëve veçmas në Ballkanin që duke qënë “shesh lufte” shpesh ka përzjerë keqas gjuhëtdhe etnitë origjinale.

Mjafton të perifrazojmë atë që shkruan në fq. 7: “Se kush janë banorët e një zone të tillë në derivatin e originës dhe në diskursin e gjuhës, apo dhe të dygjuhësisë, gjithashtu dhe përsëri për mendimin tim, mund dhe s’mund të përcaktohet nga gjuha që flet dhe shkruan, ndërtimet dhe shenjat e lashta që e rrethojnë aty ku jeton dhe gurët e shkruar nëntokë e mbi tokë.

Këta komponentë popullit të kësaj zone, nuk i mungojnë, kur vjen fjala e këngëve të mbetura që edhe në gjuhën e grave dygjuhëfolëse këndohet dhe faktohet se “Rosa rosit vo arbanoshka zemja “ (vesa veson në tokën arbërore) por i mungon dëshmia e shkruar, i mungon madje mjaft arsyeja e gjuhëve të shumta mbi këta gurë, i mungon, ajo që të tjerët në shekuj e bënë sipas rrethanave të tyre për të nxjerrë në pah “orrigjinën” dhe mbi të gjitha dhe “dominimin” e dëshirave të hershme të shtrirjes masive territoriale”.

Së treti: Këto teza autori i shtjellon duke sjellë fakte dhe argumenta në tre pjesët e para të kësaj vepre. Në pjesën e parë “Golloborda nga memorja”, nga artikulli “Emri, rrjedhat dhe gjuhët”, prof. Terziu ka si referencë “Defteri Osman” i vitit 1467, të cilin e sollti në vëmendje për herë të parë në këtë drejtim historiani Hilmi Sadikaj (1999), duke theksuar se “kjo krahinë ka qenë e regjistruar me emrin “Dullgoberda ose Dollgoberda”. Pra, emri i kësaj krahine vjen nga bullgarishtja e vjetër dhe do të thotë në shqip “kodër (bordo) e gjatë (dollgo). Ky toponim gjendet i pranishëm pjesërisht në emërtime lokale vendesh, si në Trebisht (kodra përballë lagjes Kasaj të fshatit, që quhet “Borda” nga banorët vendas), në Steblevë (në formën Vetarno Bordo), në Rekë (Velebordo) dhe në Vollnisht (Ternino Nebordo) (fq.22). Gjithashtu autori, në pjesën e parë të kësaj vepre na njeh me traditat e shkëmbimit dhe mjeshtëritë, me mjeshtrit duarartë të Gollobordës, me kostumet tradicionale të grave të kësaj krahine si dhe me ritet në dasmat, gëzimet dhe përcjelljet njerëzore.

STUDIMI ME BAZA SHKENCORE

Pjesa e dytë e librit si zanafilla e studimit na sjell në vëmendjen e lexuesit e sidomos të studjuesve “Vajtimet e Gollobordës”, ndërkohë që më pas në artikullin “Trazim kulturash” nguron ta japë përgjigjen shpejt dhe përciptazi. Kjo sipas tij për faktin se, studimi duhet të kalojë së pari në të gjitha pikat ku ravijëzohen ritet familjare, lindja, dasma, lamtumira, mbyllja e rrethit të jetës njerëzore, të gjitha ato që bëhen momentet më të rëndësishme në tërësinë e një treve, ato që shënojnë tranzicionet e saj kulturore më të rëndësishme.

Interes paraqesin për lexuesin edhe ato çfarë shkruan autori për vllhët dhe “jevgit” e Gollobordës. Mendoj se impresionuese është pjesa e tretë dhe më e rëndësishme e veprës mbi “Toponimet si qasje Etimologjike”. Bazuar në toponiminë si kërkim shkencor të emrave të vendeve, origjinës së tyre, kuptimeve, përdorimeve dhe tipifikimeve, prof. Terziu sjell fakte se si mjaft vende të krahinës së Gollobordës kanë marë emërtimet e tyre nga toponimet. Pa u zgatur, për këtë mjafton të lexojmë artikujt e kësaj pjese të veprës me tituj mjaft intrigues: “Vajtimi i kukuvajkave”; “Guri i lotit”; “Tre lisat”; “Dardha e bekuar”; “Zogu i jargavanit”; “Guri i Xhemos”; “Qershitë e Lamos”; “Raven” u ngjiz nga i Huaji”; “Radec, toponimi që flet qartë”; “Kodra e Shutecit”; “Krasta’ emri që rrëfen”; “Arra budallaqë”; “Rebori”; “Smilen”; “Kallogjeri”; “Presllop”; “Dragalicë”; “Truku i Bellavodas”; “ etj. Ndërsa për Kështjellën e Trebishtit, ndër më të njohura e kësaj zone autori shkruan se: “Një nga emrat më të lakuar prej kohësh, që ka ngjizur toponimin më befasues dhe më tipologjik të kësaj treve lidhet me toponimin ‘Gradishtë, që do thotë qytezë. ‘Gradishtë’ quhet vendi në fshatin Trebisht Çelebi, për të cilin hamendësohet se kohë më herët e kanë cekur në shkrimet e tyre Dhimitër Frangu dhe Marin Barleti”.

Vështrimin etnokulturor të autorit për zonën e Gollobordës e ndeshim në pjesën e 4-t të këtij libri “Ballkani

përtej “njëjësit”. Këtu, veç të tjerash prof. Terziu na njih me vallen pa ‘njëjës’ “Pajrushka”, me origjinën e këngës “72 ditë”, ku e gjithë kënga interpretohet kështu: “Shtatëdhjetë e dy ditë/ Ka një plagë në zemrën time/Nuk është plagë nga sëmundja/ Tashmë është plagë dhe pikëllimi./Merre pushkën dhe më vrit mua/pastaj më thuaj se s’ të dua”.

Në këtë vepër të rëndësishme shumëdimensionale (studimore, etnokulturore) autori argumenton edhe “Këngët si mesazh unik” si dhe Gollobordën si zonë shumëgjuhëshe.

Ndërkohë, duke u ndalur tek “Rregjistrimi i Tetorit 2020” lehtësisht evidentojmë shqetësimin e autorit për kushtin bullgar në lidhje me marrjen e një date për negociatat nga Tirana që ka të bëjë plotësisht me të drejtat reale të pakicës kombëtare bullgare. Prof. Terziu, jo më kot sjell për lexuesin një artikull të plotë dhe të pandryshuar nga origjinali, thujse jashtë procedurës së referencimit, të shkruar nga Prof. Dr. Spasse Tashev, me qëllim mosndërhyrjen në disa pika që mund të quhen të plotëkuptueshme në një situatë të tillë.

Është fjala për problemin e mosgjetjes së “origjinës bullgare” për mjaft nga ata që aplikojnë për pasaportën e këtij shteti, në kushtet e sotme të komplikuar ekonomike, por që vetëm me këtë mundësi ata mund të lëvizin e të punësohen diku në vendet europiane. Dhe konkluzioni i autorit: “Përgjigjja është mjaft kuptimplote, nëse nuk do të ishte kjo pasaportë, ata nuk do të kërkonin të ishin ndonjë lloj minoriteti”. Siç shkrova në fillim, mjaft bindëse e bëjnë veprën e Terziut referencat nga arkivat britanike, të sintetsizuara në pjesën e 5-të “Arkivat Britanike për Gollobordën”.

TJETRI NË KËTË VEPËR TEJET DINJITOZE

Kjo vepër tejet dinjitoze, me interes të veçantë për lexuesin, mbyllet me pjesën e 6-të “Figurat dhe vlerat”. Këtu autori na njih me personalitete emërdritur në histori të kësaj zone.

Ndërsa evidenton origjinën shqiptare të Qemal Ataturkut, Terziu shkruan për Kapitenin e Parë Qazim Kasa - Drejtuesi ushtarak i Prishtinës, për “Piktorin e Popullit” Nexhmedin Zajmin, sidhe piktorët tjerë si, Bajram Mata, Tahir Zeneli, Duro Ibrahimit etj. “... Lexoja kujtimet e Hasan Shahinajt, Dail Halilajt, Ibrahim Allës, Islam Ramës, Fatmir Selimit, Velo Cfarkut, Fidan Markut, Halil Hoxhës etj., dhe ndjehesha kryelartë, komentoja poezitë e dhjetra poetëve të Gollobordës dhe bëhesha letrar ndryshe, shikoja skulpturat e Hamza Halilit, Fitim Sulës, Bashkim Sadikut dhe përhumbesha në to, shikoja filmat dhe skenaret e Esat Musliut dhe s’kisha të ngopur, pastaj shkrimet e studimet e Hilmi Sadikut, Myqerem Tafaj, Ramazan Hoxhës, Besnik Ramës, Cfetan Maznikut, Kujtim Boriçit, Mehmet Hasanit, Kristaq Trajës..”, shkruan autori (fq.145). Prof Terziu vlerëson gjithashtu veprën e Doktor Arif Hasanit - “Qytetar Nderi i Dibrës”, të këtij kirurgu duarartë që shpëtoi qindra jetë njerëzish.

KONKLUZIONI I KONKLuzionIT

Në pjesën e 7-të të librit janë konkluzionet e autorit. “Të dhënat e mbledhura në punën në terren gjatë viteve dëshmojnë se njerëzit e kësaj treve shprehin lidhjen e tyre të origjinës në mënyra të ndryshme. Disa e sqarojnë me një fjali që përcaktohet sipas tyre me shprehjen “mije zborime bugarsko”, dhe disa të tjerë me një tjetër që bazohet tek “mije zborime nashincki, nashki”. E para shkon ndoshta më larg në vitet kur sundonte dhe dominonte kultura dhe gjuha bullgare në rajon, duke lënë kështu kuptimin e fjalisë së parë “ne flasim bullgarisht” dhe kuptimin e shprehjes së dytë “ne flasim gjuhën tonë, tonën”. Dhe kështu kur mbetet zgjidhja nga toponimet kjo e fundit flet më së miri në këtë pikë, po aq sa e para. Pra, hipoteza jonë se toponimet ndikuan në këtë bashkësi në mënyrë të ngjashme në përvojën e identitetit

të tij të pakicës është vërtetuar e gabuar. Për të forcuar këtë përfundim, komuniteti i Gollobordës që nuk kanë të njëjtën fe si bullgarët dhe maqedonasit duhet të ekzaminohet”, shkruan prof. Terziu.

Ndërkohë ai sqaron lexuesin se puna kërkuese e këtij studimi është e një natyre skematike. Ai nuk pretendon se botimi është një përpjekje për të shterruar këtë temë, as nuk mendon “se kontrastet kulturore, sociale dhe historike të theksuara midis efektivitetit tjetër të madh kulturor të traditës Gollobordës janë të gjitha aq sa absolutja e dukurive kulturo-sociale është ekstremisht komplekse, dhe larmia e faktorëve që i përcaktojnë ato shkaktajnë që ato të ndryshojnë shumë gjatë zhvillimit të tyre, nganjëherë ndryshimet i bëjnë ato të duken plotësisht të kundërta. Sidoqoftë, në thelb kontrastet që kam theksuar ekzistojnë. Idetë e përshkruara në këtë punë dhe faktet mbi të cilat ato bazohen mund të mbështeten nga një dokumentim i plotë dhe sistematik në shënimet e mbajtura nga rrëfimet, por duke pasur parasysh natyrën e punës kam preferuar të shtoj disa elementë plotësues. Ata merren me një temë themelore të tyre, por mbajnë disa aspekte themelore të pikës së parë të Gollobordës dhe do t’u interesojnë lexuesve që kujdesen të hyjnë më thellë në këtë temë”. Parë në një këndvështrim të përgjithshëm, Prof. Dr. Fatmir Terziu trajton gjerësisht në këtë vepër madhore fenomenin shoqëror të transkulturimit dhe rëndësinë e tij në Gollobordë.

Të “ripërtypësh” qetësisht tezat e guximshme që hedh Fatmir Terziu në librin e vet mbi Gollobordën, këtë krahinë me tradita historike në vetë ekzistencën kombëtare shqiptare, duhet që librin to lexosh dhe rilexosh, sepse ka shumë kuptime mes rreshtave. Sikurse thamë më sipër pa marrë të mirëqënë faktin që Terziu i thotë të gjitha në këtë vepër studimore me “tezat e një doktoreture” universitare, autori hap për diskutim akademik një çështje të mprehtë shqiptare: kush jemi dhe cila është pjesa jonë më ekzistenciale. Shqipëria duke qënë

“kërthizë” e gadishullit më të trazuar të kontinentit europian, natyrisht ka shumë për të thënë dhe sqaruar duke konfirmuar devizën se autoktonia shqiptare jo vetëm që nuk diskutohet, por studime të mëtejshme do të kristalizojnë të vërtetën e “turbulluar nga koha”. Studimi i Fatmir Terziut nga Londra është një sfidë e hapur ndaj vetë Akademisë Shqiptare, që në monotoninë e vet përgjumëse ende nuk është kthyer në “gardën kombëtare” të mbrojtjes me “zjarr akademik” të të vërtetave gjithëshqiptare që shpesh mbulohen nga mashtrime ulëritëse nga fqinjët tanë. Autori meriton përgëzime jo vetëm për guximin hulumtues, por edhe për dritën që hedh mbi një krahinë të harruar dhe nënvleftësuar nga regjimet dhe administratat qëndrore shqiptare. Në fund të fundit Shqipëria është një dhe mbetet një unison ballkanik me vitalitet që po testohet sërish në kohë lirie.

<https://rd.al/2021/03/03/veper-shkencore-me-vlera-te-jashtezakonshme-etnokulturore/>

“NGA ISHIN KASTRIOTËT” KU LINDI SKËNDERBEU?”

*Për librin “Origjina dibrane e Skënderbeut”
të studjuesit Besnik S.Kebej*

“Panorama” - Jan 17, 2022



Gjon Muzaka që në shekullin e 16-të ka lënë si testament: “Ta dini se gjyshi i Zotit Skënderbe quhet Pal Kastrioti dhe nuk pati më shumë se dy fshatra në zotërim, të quajtura Sinë dhe Gardh i Poshtëm “ (Gardhi i Poshtëm ndodhet në Muhurr)

Dyzetetë vjet më parë (janar 1974), çështja e origjinës krahinore të Kastriotëve u bë objekt i një studimi të veçantë të profesor Kristo Frashërit, i cili për herë të parë trajton shkencërisht edhe çështjen e vendit ku lindi Skënderbeu. Në artikullin e tij me titull “Nga ishin Kastriotët? Ku lindi Skënderbeu?”, ai shtroi për diskutim dhe ballafaqim të gjitha burimet arkivore dhe letrare, të cilave u shtoi edhe të dhënat toponimike që mbledhi në terren.

Nga analiza e këtyre të dhënave, profesor Frashëri del në përfundimin se, me emrin Has, kronika raguziane e Lukarit dhe koleksioni boshnjak i Fermexhinit, nuk kanë pasur parasysh krahinën e sotme të Kukësit, pasi kjo krahinë, deri në fund të shek. XVI quhej Pashtrik. Ata, sipas Profesor Frashërit, kanë pasur parasysh një nga krahinat e rrethit të Dibrës, qendra e së cilës është Çidhna, e masakruar barbarisht nga Sulltan Mehmeti II më 1466, në gjirin e së cilës ndodhen fshatrat Kastriot, Sinë dhe Gardhi i Poshtëm, që lidhen historikisht me familjen e Skënderbeut.

Tetë vjet më vonë, historianët e mirënjohur, prof. Stafanaq Pollo e prof. Kristo Frashëri, pasi vizituan muzeun e Kastriotëve në Sinë të Dibrës lanë këtë shënim në fletoren e përshtypjeve të vizitorëve të këtij muzeu: “Sinë, 12 shtator 1982. Vizituam muzeun e vogël të fshatit Sinë, vendi i origjinës së Kastriotëve dhe Heroit tonë Kombëtar, Skënderbeut. Përshëndesim nismën e banorëve të Sinës dhe atyre që e përkrahën ngritjen e këtij Muzeu. Urojmë që ai (muzeu) të pasurohet sa më shumë e më shpejt dhe të kthehet në një objekt historik të vizitueshëm për edukimin e brezit të ri.

Urojmë që së shpejti në Sinë të ngrihet muzeu kombëtar kushtuar familjes së Kastriotëve e bijve e bijave që nxori kjo derë e shkëlqyer, veçanërisht heroin e pavdekshëm, Skënderbeun”. Kristo Frashëri, Hysen Lala, Stafanaq Pollo, Hazis Ndreu – Firmat (libri “Origjina dibrane e Skënderbeut”, faqe 218- botimet M&B). Pikërisht kjo referencë nga historianët e mirënjohur, prof. Stafanaq Pollo e prof. Kristo Frashëri e bën më të besueshëm librin “Origjina dibrane e Skënderbeut” (Historia e ngritjes së Muzeut të Kastriotëve në Sinë) të autorit Besnik Selman Kebej, që është një studim vërtet shkencor. Kjo fletore që ruhet me fanatizëm nga arkitekti i këtij muzeu, Besnik S. Kebej, ish-drejtor i shkollës 8-vjeçare Sinë, përbën bazën e këtij studimi që botohet në kuadrin e 554-vjetorit të vdekjes së Heroit Kombëtar, Gjergj Kastriot Skënderbeu.

Tridhjetepesë vjet pas inaugurimit të Muzeut të Kastriotëve në Sinë të Dibrës (18 shtator 2020), një vizitë impresionuese këtu në vend originën e Heroit tonë Kombëtar, Gjergj Kastrioti Skënderbeu, e kreut të shtetit shqiptar, Ilir Meta, do të shërbente për ripërtëritjen e traditës së kësaj zone. Një ditë historike kjo, pasi referuar pikërisht veprës madhore të prof. Kristo Frashërit, “Historia e Dibrës”, që qëndron hijerëndë përkrah busteve të Gjon, Pal e Gjergj Kastriotit në hyrje të Muzeut, Presidenti Meta, ashtu si edhe elita historike e kombit (prof. Paskal Milo, prof. Bernard Zoto, prof. Adem Bunguri etj.) që vizituan këtë muze para tre vitesh, do të “legjitimonte” këtë fshat si vend originë të Kastriotëve.

Por ai që i ka paraprirë kësaj ngjarrjeje madhore është pikërisht, mësuesi i apasionuar pas historisë Besnik S. Kebej, i cili pas një pune studimore 30 vjeçare na dhuron veprën e tij monumentale “Origjina dibrane e Skënderbeut – Historia e ngritjes së Muzeut të Kastriotëve në Sinë”, me 255 faqe, plot referenca, burime arkivore e bibliografike. Redaktori i librit, dr. Fejzulla Gjabri, ndër të tjera e vlerëson atë për një mënyrë ndryshe të trajtimit të origjinës së Kastriotëve.

Kjo, sipas tij, për faktin se Besnik S.Kebej, “duke qenë punonjës për disa kohë në Muzeun e Skënderbeut në Sinë, ka fituar përvojën e trajtesave historike, duke përfituar edhe nga debatet e shumta rreth origjinës së Kastriotëve, të parëve të Skënderbeut. Në këtë libër është puna e tij më se 30-vjeçare, duke mbledhur e sistemuar të dhëna për vendin e origjinës së Heroit”.

Bazuar në referenca të shumta nga studiues të njohur vendas e të huaj që janë marrë me këtë temë, autori i këtij libri trajton shkencërisht tema të tilla si “Kastriotët dhe Skënderbeu”, “Cilët janë dibranët”, “Kastriotët, trashëgimia dhe territoret”, “Kastriotët, etimologjia, flamuri dhe stema” etj. Ndërsa në kapitullin e 7-të, “Disa toponime që formojnë një territor unik”, ai jep të dhëna për disa fshatra sipas

defterit turk, për të vijuar më pas në kapitullin e 8-të me “Pak arkeologji në trojet e Kastriotit”.

PAK HISTORI....

Muzeu i Kastriotëve në Sinë qe gati që më 28 nëntor 1979, por për arsye subjektive dhe pengesa të qëllimshme nga ndonjë autoritet vendor i rrethit Dibër, përrurimi i tij u bë pas gjashtë vitesh, më 2 nëntor 1985. Gjithsesi, edhe gjatë këtyre viteve vijoi intensivisht puna për pasurimin e tij. Që në gusht 1978 kur filloi punën drejtor në shkollën 8-vjeçare “Nimete Progonati” në Sinë, B. S. Kebej ra në kontakt më gojëdhëna e emra vendesh për Skënderbeun, njëlloj si në Muhurr. Më pas vijoi për disa kohë me toponiminë dhe intervistat me të moshuarit për Skënderbeun.

Ndërkohë, u ishte dhënë detyrë nxënësve që të vazhdonin me gjetje arkeologjike të rastit, Deri në vitin 1982 organizuan dy sesione shkencore për Skënderbeun, duke pasuruar materialet dhe shtuar njohuritë për Heroin. Gjithashtu, në librin e tij (fq.213) mësojmë se më 29 maj 1982, kooperativisti Isa Kadriu kishte sjellë në Drejtorinë e Shkollës një medaljon prej bronzi me portretin e Skënderbeut. Madje, ky objekt medaljon vuri në lëvizje deri autoritete shkencore të Akademisë së Shkencave në Tiranë.

Gjatë vizitës në Sinë në vjeshtën e vitit 1982, akademikëve të mirënjohur, prof. Stafanaq Pollo dhe prof. Kristo Farshëri u tërhoqën vëmendjen tri objekte arkeologjike, të gjetura në Sinë të Poshtme: një unazë floriri me portretin e Skënderbeut, që kishte përfunduar në pronësi të Ahmet Zogut; një vulë e thatë me trup guri, pjesa me shkronja e së cilës kishte stemë metalike (kjo vulë është gjetur rreth viteve 1967-1968, kur është hapur kanali vaditës që del në anën e përtejme të Drinit), si dhe një pllakë metalike me stemë, e gjetur rreth vitit 1940, e cila, siç tregojnë, kur fërkohej, ndriçonte derisa të vriteshin sytë deri në verbim.

Asokohe, studiuesi i zellshëm B. S. Kebej u ka folur profesorëve të nderuar Pollo e Frashëri edhe varrin e Ballaban Pashës në Sinë të Epërme, me “kryqet në gur”, për Kllezin e Poshtëm (ku një përrua e ka zanafillën në Këllezin e Epër dhe ky përrua njihet me emërtimin “përroi i qytetit”), për Trojën e Mzeze, ku ka shumë toponime e mikrotoponime me objekt pazaret dhe dyqanet. Mbështetur mbi këtë toponimi mjaftë të pasur, studiuesi Kebej argumenton vendndodhjen e Gardhit të Poshtëm (Zhgjerdhi) në Muhurr.

Ai pohon se këtu ka gjurmë banimi, të cilat janë dëmtuar gjatë viteve të ishkooperativës bujqësore e më vonë u vendos edhe një repart ushtarak, që e dëmtuan edhe më shumë. Gjithsesi, studiuesi Kebej nuk i rreshti kërkimet. Pas intervistave me disa pleq mendjehollë nga Muhurri e Sina, u fokusua në tri legjenda:

“Kepi i Skënderbeut sepse ka pasur gjurmë kali”; “Tre gjurmë të kalit të Skënderbeut janë edhe sot në Hurdha të Mshela; “Skënderbeu në Sheh të Thatë ka pas ndërtuar një kala dhe që edhe sot njihet si Kalaja e Skënderbeut”. Me këto e shumë të dhëna të tjera burimore e arkivore u pasurua më tej Muzeu i Kastriotëve në Sinë, që u përrua zyrtarisht më 2 nëntor 1985. Ky muze i vogël, me një ndërtesë njëkatëshe, me gur të gdhendur nga mjeshtrit e Sinës dëshmon një fakt të madh historik për atë kohë dhe për brezat që do vijnë se origjina e Kastriotëve është Sina e Dibrës.

Jo më kot, historiani i njohur dibran, Haki Përnezha, në rolin e ciceronit, ndër të tjera do t'i bënte të njohur një vit më parë vizitorit më të rëndësishëm të këtij muzeu, Presidentit Meta, atë që ka lënë si testament Gjon Muzaka që në shekullin e 16-të: “Ta dini se gjyshi i Zotit Skënderbe quhet Pal Kastrioti dhe nuk pati më shumë se dy fshatra në zotërim, të quajtura Sinë dhe Gardh i Poshtëm...” (Gardhi i Poshtëm ndodhet në Muhurr).

KONKLUZIONE

Studimin e tij të mirëfilltë për origjinën dibrane të Skënderbeut, Besnik S. Kebej e mbyll me konkluzionin se “Territori MuhurrSinë është ai që plotëson dhe përputhet me dokumente, me pozicionin gjeostrategjik, me toponiminë, me arkeologjinë, se ky është pikërisht territori më minimal që përmend Gj. Muzaka për gjyshin e Skënderbeut”. Në këtë konkluzion ai arrin pasi ka sjellë dokumente dhe argumente se gjyshi i Skënderbeut quhej Kostandin Mazrek Kastrioti dhe se ai ishte nga Mazreka e Epër në Muhurr.


Në këto përfundime ai arrin edhe nga fakti se nëpër Muhurr kalonte rruga kalorësiakë me emrin Rruga Dibrane, ndërsa nëpër Sinë kalonte Rruga Plakë. Po ashtu edhe për faktin se në Muhurr ndodhet Qyteza e shekullit V-VI pas Krishtit, në Sinjë ndodhet Kllezi dhe mes Sinës e Muhurrit qyteti i Trojës, që ka varre të shumta, ka ujin, ka dyqanet dhe pazaret, ka vendet fetare me emërtimet Popteshja e Madhe dhe Popteshja e Vogël. Sipas tij, Kastriotët kanë lëvizur për jetë më të mirë nga Mazrekat në Sinë dhe nga Sina dolën në fshatin që formuan vetë në krahun e djathtë të Drinit të Zi, me emrin e tyre, Kastriot.

<http://www.panorama.com.al/nga-ishin-kastriotet-ku-lindi.../>

42 KRYETARËT E TIRANËS NË NJË ALBUM FOTOGRAFIK DHE BIOGRAFIK

*Pas 79 vitesh, rivjen një botim i dytë
për historinë e qytetit dhe të Bashkisë së Tiranës
në një hark kohor prej 103 vitesh*

Gazeta “Koha jonë”, April 26, 2016



Pas tetë botimeve tematike për vlerat historike, kulturore dhe njerëzore, kryesisht për metropolin shqiptar, studiuesi dhe analisti i mirënjohur Valter Gjoni sjell për lexuesin 42 kryetarët e Tiranës, në një album fotografik dhe historik.

Pasi jep detaje dhe fakte interesante nga historia administrative e Tiranës, deri në shpalljen e pavarësisë, Gjoni e bën ndalesën e parë tek i pari ligj që rregulloi organizimin dhe funksionimin e qeverisjes lokale, i qeverisë së dalë nga Kongresi i Lushnjës. Është pikërisht Ligji “Qytetet dhe Bashkitë më 25 XII – 1921”, që mund të konsiderohet si ligji I parë për zgjedhjet e drejtuesve lokalë.

Për gati një shekull Tirana është drejtuar nga 42 kryetarë bashkie. Në fakt, sipas autorit V.Gjoni, ky term përdoret në ditët e sotme, por në periudha e sisteme të ndryshme, qytetari i parë i Tiranës ka pasur emërtime të ndryshme.

Duke iu referuar faqes zyrtare të Bashkisë së Tiranës, Kryetari i Parë ka qenë Zyber Halluli në 1913, që ishte ndërkohë shefi i komunitetit fetar dominues. Pikërisht nga ky personalitet i shquar i kohës, e nis autori renditjen në mënyrë kronologjike të kryetarëve të Tiranës, duke vijuar me Servet Libohovën (1915-1916), Ismail Ndroqin (1917-1922) dhe me z.Ali Begeja i periudhës 1922-1923, i cili u zgjodh kryetar, si këshilltari që mori më shumë vota.

Pesë kryetarët e mëvonshëm të periudhës 1923-1928, pikërisht: Ali Derhemi, Beqir Rusi, Xhemal Kondi, Fuat Toptani dhe Izet Dibra e kanë qeverisur Tiranën për një afat kohor një vjeçar, të zgjedhur pothuajse sejcili si këshilltari me më shumë vota. Por gjithsesi meritë e autorit është përshkrimi në pak rreshta i biografisë së tyre lidhur me arsimimin, pasionet, dimensionin e tyre njerëzor dhe se çfarë ata i lanë Tiranës në ato vite.

Në këtë mënyrë vijohet edhe me Rexhep Jellën (1930-1933), Abedin Nepravishtën (1933-1935 dhe 1937-1939), me Qemal Butkën (1935-1936) dhe me Qazim Mulletin (1939-1940).

NIVEL I LARTË NË ARTIN E TË SHKRUARIT

Jo pa qëllim evidentuam 14 kryetarët e parë, si pjesë të këtij libri të një rëndësie të veçantë për vlerat historike që bart, por sepse publiku i njeh ato përciptazi, për të mos thënë fare pak.

Më pas, duke vijuar me 28 kryetarët e tjerë të Tiranës (1940-2016) autori bëhet i besueshëm, jo vetëm për vërtetësinë e viteve që ata kanë qeverisur kryeqytetin shqiptar, por për mënyrën dhe përshkrimin e anëve të veçanta të biografisë së

secilit në 5-6 rreshta. Ndërkohë ilustrimi fotografik është bërë në mënyrë të përkryer.

Parë nga ky këndvështrim ky botim shkencor i Valter Gjonit dëshmon për arritjen e një niveli të lartë në artin e të shkruarit. Kjo për faktin se Valteri di të përveçojë me inteligjencë, fakte dhe ngjarje, si pjesë substanciale e karakterit të personazheve, duke e bërë librin e tij me vlera njohëse, edukuese dhe estetike. Ndërkohë që karakteret humanë shfaqen si shëmbëlltyra të përzgjedhura nga dora e një shkrimtari dhe publicisti me përvojë dhe talent, duke të bërë për vete me stilin e të shkruarit. Dhe ajo që e bën të veçantë librin “42 kryetarët e Tiranës”, në raport me krijimtarinë e mëparshme të Valter Gjonit është fakti se ai rrok brenda tij një periudhe të gjatë, gati njëshekullore, duke derdhur dashuri dhe mirënjohje për 42 personazhe dominantë të historisë sonë kombëtare. Duke gërshtuar përvojën e tij administrative, gazetareske dhe artistike

jashtë funksioneve zyrtare, autori ka realizuar gjithashtu 20 ekspozita, të mirëpritura nga vizitorë të shumtë, brenda e jashtë vendit. Pikërisht për këto merita Valter Gjoni mban disa tituj nderi, kombëtarë dhe ndërkombëtarë, ku titujt më të lartë janë: “Kalorës i Urdhrit të Meritës” i Republikës Franceze, “Bene Merit” - titull nderi i Republikës së Polonisë, Urdhrit “Naim Frashëri” të Republikës së Shqipërisë dhe titullin bashkiak “Mirënjohja e Qytetit të Tiranës”.

GJURMË QË I PËRKASIN HISTORISË SË TIRANËS


Këtij botimi ia shton rëndësinë edhe parathënia e kryetarit aktual të bashkisë Tiranë, Erion Veliaj. Kjo për faktin se “nëse botimi i vitit 1937 trajtonte me kujdesin e kohës vetëm figurat e 9 kryetarëve të Tiranës, vitet në vijim deri në ditët e sotme kanë njohur vetëm listim emrash dhe periudhash, në shumë raste me gabime dhe mangësi, pa as më të voglin informacion

për 33 drejtuesit e tjerë të qytetit, si në botime specifike, ashtu edhe në informacionin e rrjeteve sociale”. Kryebashkiaku Veliaj vlerëson gjurmimet historike që janë bërë në këtë botim për 41 paraardhësit e tij dhe gjurmët e lëna prej tyre, në mbi një shekull që janë tashmë gjurmë që i përkasin historisë së Tiranës dhe përvojës së bashkisë së saj. Sipas kreut aktual të bashkisë së Tiranës “kemi të bëjmë me një botim që na shuan kuriozitetin, por dhe që na sjell informacion të bollshëm, që mund të shërbejë në të ardhmen qoftë si vlerë historike, ashtu dhe si informacion mbi administratën lokale shqiptare qysh prej themelimit të saj deri në ditët e sotme”. Kryebashkiaku Veliaj argumenton gjithashtu më së miri se, këto vlera që i kanë rezistuar kohës dhe rrethanave të ndryshme në të cilën janë zhvilluar, janë mbledhur me kujdes nga autori, ndaj ato e bëjnë këtë botim të larmishëm, si për anën historike, ashtu dhe atë dokumentare. Kësisoj, me botimin e albumit biografiko-historik kushtuar 42 kryetarëve të qytetit të Tiranës, pas 79 vitesh, rivjen një botim i dytë për historinë e qytetit dhe të Bashkisë së Tiranës në një hark kohor prej 103 vitesh.

<https://kohajone.com/42-kryetaret-e-tiranes-ne-nje-album-fotografik-dhe-biografik/>

“TOPONIMIA E ÇIDHNËS”, NJË BOTIM MË VLERA TË RRALLA SHKENCORE

Vepra e Haki Përnezha e Ruzhdi Bitrit ka një mënyrë të konceptuari e shtjelluari mjaft të rrallë, brilante



Botimet “M&B”, pas suksesit të padiskutueshëm në Panairin e Librit 2016, prezantuan më 25 Nëntor 2016, në sallën e Akademisë së Shkencave në Tiranë librin “Toponimia e Çidhnës” (me 110 ilustrime fotografike dhe me një fjalës të leksikut të rrallë), të bashkëautorëve Haki Përnezha e Ruzhdi Bitri.

Për vlerat e rralla shkencore të këtij botimi folën: poeti dhe prozatori i mirënjohur Agron Tufa, Prof. Gjovalin Shkurtaj, Prof.Dr. Shaban Sinani, si dhe studjuesit Ali Hoxha, Besim Cengu e Mustafa Tola. Përveç studimit të thelluar e skurpuloz, për besueshmërinë e këtij botimi flasin qoftë dhe 328 referencat e përdorura nga bashkautorët, ku spikasin ato të Prof.E.Çabej, Mjeshtrit të Madh, Hazis Ndreu, studiuesit Iljaz

Kaca, apo dhe të Giuseppe Valentini (E Drejta e komuniteteve në traditën juridike shqiptare).

Në përpjekjet për të sjellë aromën e vendlindjes së tyre, H.Përnezha dhe Rr.Bitri hyjnë në analet e historisë së letrave me një botim të rrallë. Pa hyrë në një analizë të thellë të këtij botimi tejet dinjitoz, në këto pak radhë unë dua të shpreh vlerësimin për kontributin e tyre në kërkimet shkencore. Një sipërmarrje të tillë të vështirë mund ta quajmë pa mëdyshje të suksesshme dhe merita për këtë u takon dy bashkautorëve, por edhe redaktorit potencial, akademik Shaban Sinanit, si dhe botuesit M&B (Miranda e Bujar Karoshi).

Larmia e studimeve të paraqitura në këtë libër janë dhe një nga arsyet e suksesit të botimit, i cili është i një cilësie shumë të mirë, i denjë për të nderuar dy studiues të shquar, botuesin dhe redaktorin. Në këto studime, pa mëdyshje shquhen ato mbi fshtarat Sinë e Epër e Sinë e Poshtme, Çidhën e Poshtme, Grykë Nokë, Mustafe, Zall dhe Kodër Leshe, Fushë Alie, Laçes, Çelias, Blliçe, Rrenx, Kastriot, Brest i Epër e Brest i Poshtëm. Natyrisht, lexuesi shqiptar, bazuar në këto studime merr një informacion relativisht të pasur për këtë trevë të njohur që nga lashtësia. Vepra e H.Përnezhës e Rr.Bitrit ndërkaq ka një mënyrë të konceptuari e shtjelluari mjaft të rrallë, brilante.

Meritë e padiskutueshme e këtyre autorëve, krahas njohurive që zotërojnë për vendlindjen e tyre, është padyshim shfletimi dhe studimi në origjinal i një bibliografie mjaft të pasur. Më së miri e vlerëson librin e tyre redaktori Sh.Sinani, i cili evidenton 100 fotot ilustruese dhe një burim të fjalës së rrallë e në zhdukje, që së bashku me frazeologjinë që lidhet me to, është një provë burimore dhe shkencore e rëndësisë kulturore e historike të emërtimeve vendore.

“I shkruar pas një vëzhgimi kërkimor prej shumë vitesh, prej dy njerëzish që janë edhe vetë subjekt i kërkimit; me një vëmendje diturore të kthyer në qëllim prej dekadash më


parë, “Toponimia e Çidhnës”, – thekson akademiku Sinani – është një regestum i emërtimeve të përveçme të kësaj krahine etnografike, një hipotekë e kësaj pasurie shpirtërore, e cila për fat tashmë ka zot, dhe ky zot është folësi shqiptar i atyre anëve, bartës brez pas brezi i saj, një bartës sa krijues aq dhe ruajtës, sa pragmatik, aq dhe sintagmatik, sa figurativ aq dhe përdorues”.

Sipas Prof.Sh.Sinanit “Në librin e këtyre dy autorëve janë ndërthurur meritat e mbledhësit, tejskruesit dhe të studiuesit. Aty janë bashkë edhe filologu, edhe dialektologu, edhe antropologu e historiani. Libri i tyre është një arritje etnoghësore, në të cilën fjala dhe bartësi i saj nuk ndahen”. Madje sipas akademikut të mirënjohur “Toponimia e Çidhnës” dëshmon mbi të gjitha se populli i këtyre anëve nuk ka jetuar si popull malesh, si barinj shtegtarë, sikurse shkruhet edhe sot në disa botime enciklopedike, por ka ditur të jetojë dhe madje ka jetuar mirë.”

Gazeta “BULQIZA”

PEDAGOGJIKJA E PESHKOPISË, TEMPULL I DIJES

*Studjuesi Xhavit Lashi, monografi interesante
për historinë e arsimit në Dibër*



Më 27 shtator 1948, në qytetin verilindor të Peshkopisë u hap e para shkollë pedagogjike, e cila për vetë “produktin” e saj (qindra personalitete, deri ministra, gjuhëtarë e profesorë, poetë e shkrimtarë, artistë, diplomatë e gazetarë), me të drejtë njihet si “Universiteti i Dibrës”. Një bilanc mbresëlënës për faktin se ajo nxori rreth 2200 kuadro, djem e vajza, që çuan dritën e diturisë dhe kulturën në gjithë krahinat e fshatrat e zonës verilindore të Shqipërisë.

Pikërisht në vigjilje të 70-vjetorit të krijimit, njëri nga ish-nxënësit e shkëlqyer të saj, historiani Xhavit Lashi botoi monografinë “*Shkolla Pedagogjike e Peshkopisë*”. Kjo është dhurata më e mirë që studjuesi kukësiyan u bëri në këtë ditë feste jubilarë ishmësuesve e nxënësve të kësaj shkolle. Autori sjell fakte interesante që plotësojnë historikun e zhvillimit të arsimit: Nga shkolla e parë shqipe në qytetin e Dibrës më

1888; Internati i Dibrës më 1923 dhe i Kastriotit më 1925, Unikja më 1945, Pedagogjika më 27 shtator 1948 e deri tek filiali i Universitetit të Durrësit në qytetin e Peshkopisë.

PAK HISTORI

Mësojmë nga kjo monografi hapjen e të parës shkollë shqipe në qytetin e Dibrës më 1888 nga patrioti Said Najdeni, vetëm një vit pas hapjes së shkollës së parë shqipe në Korçë. Më tej, mbështetur në burime arkivore në libër gjejmë ngritjen e dy Internateve në Dibër e Kosovë, sipas Shkresës së Ministrisë së Arsimit nr.366, datë 8 shkurt 1923.

Internati “Dibra” u vendeos së pari në shtëpinë e Shehat Shehut në Qafë të Pazarit, të marrë me qera dhe në vitin 1925, ky Interant kaloi në Kastriot të Dibrës. Meritë për këtë kanë drejtorët e nderuar: Haki Sharofi, Ferid Jegeni, Sali Morina, Ahmet Imami, Ferid Imami, Ramadan Sejдини e Rifat Spahiu, si dhe mësuesit: Qemal Drita, Zejnel Zajmi, Ramazan Sefedini, Hafuz Fetah Ajdini, Abdulla Çanga, Muharrem Musa, Refik Shpuza, Fehti Dizdari, Faik Pajuni, Beqir Spahiu, Hydajet Ceka, Shyqyri Daiu, etj.

Jo pa qëllim, autori sjell një listë me emra personalitetesh të përmasave kombëtare që kontribuan në drejtim e në mësimdhënie, për të vijuar me nxënësit që kanë mësuar në Internatin “Dibra”, ndër të cilët dëshmorët e atdheut Nazmi Rushiti, Demir Gashi e Tufik Çanga, si dhe personalitetet e mëvonshme të arsimit në Dibër: Selim Alliu, Adem Shehu, Xhavit Hysa, Fehmi Plaku, Haki Alush Kumanova, Munir Shehu etj. Është pikërisht kjo plejadë që do kontribuonte më vonë, pas çlirimit në hapjen e shkollës Unike të Peshkopisë më 1945 dhe tre vjet më vonë edhe të Pedagogjikes, më 28 shtator 1948.

Shkolla Pedagogjike e nisi rrugën e saj më 21 nxënës: 13 nga rrethi i Dibrës, 5 nga rrethi i Kukësit dhe 2 nga rrethi i

Elbasanit. Në vitet në vazhdim u rrit numri i nxënësve, duke u pranuar në të me bursë si konviktorë ata që vinin nga rrethet e Verilindjes. Asnjë mësues nuk ishte vendas. Mësuesit u emëruan nga Ministria e Arsimit. Studjuesi Xhavit Lashi, në librin e tij, ndër të tjera nënvizon se “Prej Shkollës Pedagogjike Peshkopi, kanë dalë kuadro që kanë bërë emër të mirë në shkallë rrethesh e në shkallë vendi. Nga bankat e shkollës janë përgatitur jo vetëm mësues e pedagogë të aftë, por dhe kuadro të tjerë që kanë punuar me përkushtim e kompetencë në sektorë të ndryshëm të ekonomisë, shkencës e politikës. Prej tyre ka shkencëtarë, profesorë, diplomatë, juristë, artistë, sportistë, gazetarë, drejtues të organeve të pushtetit, të partisë dhe të ekonomisë”.

PEDAGOGJIKJA E PESHKOPIË NXORI PERSONALITETE NË RANG KOMBËTAR

Në këtë mori emrash autori ndër të tjerë evidenton ish pedagogjikasit e Peshkopisë (deputetë, diplomatë, profesorë e doktorë shkencash, gjuhëtarë, fizikantë, biologë, shkrimtarë, ushtarakë, artistë, sportistë etj)si: Xhelil Gjoni, Tefta Cami, Lumturie Rexha, Femi Abdiu, Safet Zhulali, Shefqet Hoxha, Sulejman Tomçini, Abdi Baleta, Maxhun Peka, Kamber Faruku, Nuri Abdiu, Shaban Sinani, Muharrem Dezhgiu, Xhafer Martini, Lutfi Hanku, Naim Plaku, Sali Onuzi, Musa Riçku, Liri Rasha. ...Këta, si dhe dhjetra emra të tjerë të spikatur që u përgatitën nga ky tempull i dijes vijnë të profilizuar në opinionet, kujtimet essetë e disa bashkëpunëtorëve të autorit Lashi, i cili ka spikatur në përzgjedhjen, redaktimin dhe përfshirjen e tyre në këtë monografi dinjitoze, duke plotësuar kështu historikun e Shkollës Pedagogjike të Peshkopisë si vatër e ndritur e dijes për gjithë zonën verilindore të vendit. Libri ka shumë personazhe, që gjithsesi redaktori i tij, prof. dr.Hajri Shehu nuk i konsideron si personazhe të një libri

letraro-artistikë, por më shumë se kaq, pasi sjellin kujtime dhe vlerësime për shkollën e për mësuesit. Kjo edhe për faktin se ato janë tubuar sipas një tematike të caktuar. “Kujtimet vijnë nga autorë të ndryshëm e prandaj krijojnë një mozaik, një thyezim. Dhe është një thyezim shumëngjyrësh. Kësisoj, shumë i këndshëm”, nënvizon prof.dr.Hajri Shehu. Autori i kësaj monografie Xhavit Lashi që mban diplomën “shkëlqyer” nga Pedagogjika e Peshkopisë, më 1975 përfundoi studimet e larta për histori-gjeografi dhe filozofi dhe më pas për dekada të tëra punoi si mësues e në detyra e funksione të rëndësishme në rrethin e Kukësit. Ka botuar dhjetra artikuj studimorë e problemorë si dhe librin “Qarku i Kukësit në rrjedhën historike – ndarja administrative dhe qeverisja vendore”. Në librin e ri “Shkolla Pedagogjike e Peshkopisë”, që u botua pikërisht në vigjilje të 70 vjetorit të krijimit të saj, Xh.Lashi sjell në kujtesën e armatës së mësuesve e nxënësve të saj rrethanat historike në të cilat u ngrit kjo shkollë e konsideruar si “Universiteti i Dibrës”, si dhe një varg ngjarjesh e personalitetesh që kanë lënë gjurmë në historinë e arsimit tonë kombëtar. Kjo monografi është produkt i hulumtimeve, evidentimit dhe pasqyrimin të ngjarjeve që lidhen me rritjen ndër vite të këtij tempulli arsimor. Studimet e autorit si dhe rrëfimet e bashkëpunëtorëve të tij flasin për një histori përpjekjesh për të përgatitur kuadrot që do përhapnin dritën e diturisë në zonën verilindore të vendit me një popull të vogël në numër, por të madh në botën e tij shpirtërore, në vullnetin e tij për të qenë i arsimuar e i kulturuar. Botimi i kësaj monografie paraqet rëndësi të veçantë sidomos për më shumë se 2200 kuadrot që u përgatitën nëpër dyert e këtij tempulli të diturisë, por edhe për vetë qytetarët e Dibrës, Kukësit, Matit, Tropojës e Krujës, pasi në këtë historik të Pedagogjikes së Peshkopisë ata gjejnë edhe një pjesë të historisë së tyre.

Ky libër që duhet konsideruar si kontribut i çmuar i autorit Xhavit Lashi në letërsinë dokumentare, në pesë kapitujt e tij



sjell një lëndë të pasur me të dhëna për Dibrën e Peshkopinë, Shkollën Pedagogjike dhe rrethanat e hapjes së saj, drejtorët e stafin pedagogjik ndër vite, kujtime nga shkolla, ku një vend të veçantë zënë ish-pedagogjikasit kukësiyanë në Peshkopi si dhe takimet me rastin e përvjetorëve të shkollës. Monografia për historikune saj përbën një ngjarje të madhe për historinë e arsimit dhe të kulturës shqiptare.

<https://telegraf.al/kulture/70-vjetori-i-tempull-i-dijes-pedagogjika-e-peshkopise/>

FILOZOFIA POPULLORE DIBRANE NË RRËFIMET E SAKIP CAMIT

*Dy libra interesantë që përcjellin
tek lexuesi visare të Dibrës*



Në harkun kohor të tri dekadave të fundit, përveç dhjetra veprave me poezi, publicistikë e monografi letrare, publicisti dhe poeti i njohur Sakip Cami, ka botuar edhe dy libra të të njejtit profil, në të cilët rrëfëhet mjeshtërisht filozofia popullore dibrane. “Rrëfime popullore dibrane” (2006) dhe “Dibra nëpërmjet këngëve dhe tregimeve të popullit” (2010) janë dy libra të vyer që përcjellin tek lexuesi visare të Dibrës. Në këto dy libra gjen mishërim sentenca “Atdheu nis nga familja”. Mjafton për këtë qoftë dhe kushtimi i dy vëllimeve prindërve të tij, Ukë A.Cami dhe Razie Cami (Hasa), nga goja e të cilëve (siç shprehet vetë autori) ka dëgjuar shumicën e këtyre rrëfimeve.

Në këto rrëfime, ndonëse përçohen nga alegoria therëse, sështë e vështirë të dallosh mirëbërësinë e bujarinë e dibranëve, autoritetin moral e shpirtëror, traditën e

mikëpritjes, por dhe zgjuarsinë, inteligjencën dhe mençurinë e dibranëve nëpër shekuj. Këto cilësi, më mirë se askush tjetër i ka mbledhur, perceptuar dhe pasqyruar realisht në këto dy libra, dibrani i mirë dhe i talentuar Sakip Cami, autor i disa librave me poezi, monografi, publicistikë, fabula e satira. E ka bërë këtë, duke qëmtuar e hulumtuar nëpër dasma e morte, në kuvende, në ceremoni fejesash e lindjesh, ku shpaloset mençuria e famshme, po dhe ajo që quhet “alegoria dibrane”. Dallohen fare qartë këto, qoftë dhe vetëm në rrëfimin me titull “Gjëmon Korabi or babë”, ku përçohet ideja se mali më i lartë i atdheut tonë gjëmon vetëm kur ka luftë të madhe me shumë kraja!.. Më tej, rrëfimi me titull: “O Muharrem Aga, shyqyr që të vdiq baba”, në pak rreshta sinteizon ligjin e jetës, barazinë e gjallesave para Zotit, si në fragmentin: “...jetën e ka në dorë Zoti, por po të kishte shpëtue baba i Bajraktarit, na të tjerët nuk kishim ma vend prej baballarëve tanë. “E patë, Muharrem Aga e shnoshi babën në Austri, ndërsa ju na leni me vdekë”, do na thoshin...”

Gjymë në këto rrëfime gjithashtu ballafaqimin me vështirësitë e jetës, por dhe guximin e trimërinë për përballimin e tyre. Kjo më së miri konstatohet në rrëfimet me titull: “Me këto para që punoj e fitoj unë ushqehem, laj borxhet e jap pare me fajde”; “Asgjë nuk vjen nga oxhaku”, “Kush ka kohë të pijë kafen time” etj.

Një vend të veçantë në këto dy vëllime zë filozofia popullore e përçarur nga goja e burrave të mençur e të urtë dibranë. Mund të veçojmë filozofin popullor Dine Hoxha, të cilin e kanë quajtur Dekan i “Universitetit të Dibrës”, “Sokrati i Dibrës”, “Profesori i alegorisë dibrane”, sepse atë e njihje mbarë Shqipëria.

Vetë mbreti Zog e kishte këshilltarin e vet. Ai ishte nga Muhurri, i konsideruar si “Djepi i urtësisë së Nëntë maleve të Dibrës”, pikërisht pse lindi e rriti burra të tillë të shquar si Dine Hoxha e paraardhësit e tij Kurt, Nel e Hazis Hoxha.

Filozofia e këtij mëndje kandarfloriri jepet qoftë dhe në rrëfimin me titull “Dine Hoxha dhe latifondisti francez”. Është koha kur një pronar i madh tokash nga Franca vjen në Shqipëri për të takuar Dine Hoxhën që ta pyeste për mend lidhur me shqetësimin e tij që konsistonte në sekuestrimin e qindra hektarëve tokë pronë e tij, nga qeveria franceze. Dhe përgjigja e Dine Hoxhës ishte: “Dëgjo or mik, mos u ngatërro me qeverinë për punën e tokës. As me qeverinë dhe me asnjë njeri. Sakllam, sakllam, çdo njeri ka të vetat vetëm dy metra katror tokë, ndërsa ti ai i ke, apo s’i ke nuk e di!”.

Sipas etnologut të njohur Mark Tirta, është mjaft domethënëse formula e mirënjohur e proverbiale që thotë se “Mendja”, “Urtia” ka le në Dibër... Fjala dhe kuvendi i dibranit shquhet për mendjemprehtësi e lakonizëm, për peshë mendimi, për sinqeritet e dashamirësi, por dhe për këmbëngulje e qëndresë imponuese, bindëse. Më mirë se kudo tjetër këtë e ndeshim tek libri i S.Camit “Dibra nëpërmjet këngeve dhe tregimeve të popullit”. Aty gjejmë “Mesele dibrane”, “Histori”, “Rite, zakone dhe traditë”. “Tregime brenda dhomës dibrane”...gjejmë historinë e Dibrës nëpërmjet këngëve të vjetra popullore, por dhe nëpërmjet dokumentave.

I kompozuar kësisoj “*Dibra nëpërmjet këngeve dhe tregimeve të popullit*” është një sintezë e mençurisë, urtësisë dhe filozofisë dibrane. Ai është i mbushur plot me visare të çmuara. Me mjeshtri të rrallë, Sakip Cami ka ngritur në art odën dibrane që është quajtur “Universiteti i Dibrës”, atëhere kur në Shqipëri nuk kishte as shkolla fillore.

Madje siç shprehet recensenti, Hajri Mandri në parathënjen e këtij libri: “Mendimi filozofik dhe mendimi estetik, në odat e Dibrës, transmentonin që nga e kaluara e herëshme, mesazhet përmes një forme origjinale. Këto janë rrëfenjat (tregime), ose siç u thotë populli “meseletë”, të cilat, për nga gjuha, kompozicioni, simboli dhe alegoria,

humori dhe ironia, hiperbolat dhe litotat, u shndrruan në një platformë komunikimi për dibranët ose në një “shkollë” ku shpaloseshin idealet socialestetike, qëndrimet moralizuese e didaktike, rreth jetës e vdekjes, rreth familjes e integritetit të saj”.

Pikërisht mbi këtë shtrat ndërtohen dhe librat e S.Camit “Rrëfime popullore dibrane” dhe “Dibra nëpërmjet këngëve dhe tregimeve të popullit”, ku brenda një tematike shumë të gjerë dhe të larmishme rrëfëhet tradita, historia dhe heronjtë e Dibrës, por dhe ngjarje të ditës, të lidhura ngushtë me politikën, ekonominë e sjelljen e njerëzve në rrethana të caktuara. Në këto rrëfenja gjejmë fjalën dhe kuvendin e dibranit të shquara për mendjemprehtësi e lakonizëm, për peshë mendimi, për sinqeritet e dashamirësi, por dhe për këmbëngulje e qëndresë imponuese, bindëse.

Si askush tjetër, Sakip Cami në këto dy libra reflekton zgjuarsinë dibrane, maturinë e burrave të mençur te Dibrës, dashurinë për njerëzit, sakrificat, patriotizmin e shumë veti të tjera të çmuara.

Gazeta “Metropol”

<https://www.dibraon.com/filozofia-popullore-dibrane-ne-rrrefimet-e-sakip-camit/konaku/>

“LASERI NË OFTALMOLOGJI”, VEPËR ME VLERA SHKENCORE

*Prof.Asoc.Dr. Ali Tonuzi - kirurgu vitreoretinal
që kryen ndërhyrjet më të ndërlikuara në sy*

*-Gazeta “NACIONAL ...- 6 Nëntor 2021
& Gazeta “Rruga e Arbërit”, dhjetor 2021*



“Libri “Lasери në Oftalmologji” i Prof.asoc.dr.Ali Tonuzi është konceptuar të shërbejë si një bashkudhëtar i fuqishëm për oftalmologjistët klinikë dhe siguron një ilustrim të mirë të koncepteve bazë të terapisë së laserit për shoqërime okulare të ndryshme të lidhur me kapakët, kornën, kristalinin dhe retinën”,-shprehet ndër të tjera prof.Zhugli

Pas tri dekadash pa ndërprerje në gazetari, me sytë mbërthyer nga ekrani i kompjuterit, konstatova dëmtimin e perdes së syrit, një patologji kjo problematike që konsiston në zvogëlimin e imazhit të gjërave të largëta dhe të larta. Në këtë gjendje, si çdokush tjetër i prekur nga kjo patologji, iu drejtova mjekut okulist. Dhe ai që bëri mrekullinë, duke më

rikthyer dritën e syrit qe Prof.asoc.dr.Ali Tonuzi – Kirurg Vitreoretinal në Departamentin e Okulistikës të Spitalit Francez në QSUT (Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”). Për t’i shprehur mirënjohjen si shprehja më e bukur e karakterit të njeriut, hodha disa rreshta për profilin e tij në websitin e një portali të njohur, pa e ditur që pas atij statusi do të vërshonin mijëra falenderime për të. Janë këto vlerësimet më objektive nga “foltorja” më e besueshme, jo vetëm e pacientëve të operuar prej tij, por edhe e përfaqësuesve të elitës mjeksore. Njëri prej tyre, Dr.Nexhat Kala,- otorinologu i njohur, ish-nëndrejtor i QSUT dhe deputet i Kuvendit të Shqipërisë, këtë “dyndje” mirënjohjeje të pacientëve e shpjegon me nivelin e lartë profesional të okulistit të talentuar Ali Tonuzi, shpirtin human dhe reputacionin që ai e ka fituar me punën e përkushtimin qytetar, me sjelljen dhe shërbimin shembullor, pa i diferencuar në asnjë rast pacientët.

**PROF. ZHUGLI: LIBRI I DR. ALI TONUZIT
“LASERI NË OFTALMOLOGJI”, VEPËR
ME VLERA SHKENCORE**

Prof.asc.dr.Ali Tonuzi, në mesin e moshës së tij ka arritur një karrierë të shkëlqyer akademike dhe profesionale. Jo vetëm si një okulist famoz (ndër të vetmit në rang vendi e rajoni që kryen operacione të shkallës së lartë), por prej dy dekash edhe si një ndër pedagogët më të mirë në Departamentin ORL-Okulistikë të Fakultetit të Mjeksisë në Universitetin e Mjeksisë Tiranë. Ai është përfshirë intensivisht në botën akademike pasi fitoi titullin “Doktor i Shkencave Mjeksore” (Maj 2002) dhe Prof. Asc në Tetor 2012. Produkt i punës së thelluar studimore shkencore është edhe libri i tij “Lasери në Oftalmologji” për të cilin prof.Sulejman Zhugli pohon se është teksti i parë që botohet në fushën e Oftalmologjisë në vendin tonë, llojet dhe përdorimet e shumta të tij në këtë fushë. Libri

është shkruar thjeshtë, i ilustruar me shumë figura, duke e bërë tekstin shumë të kuptueshëm për të gjithë gjeneratën e oftalmologjistëve dhe më gjerë. “Ky libër është konceptuar të shërbejë si një bashkudhëtar i fuqishëm për oftalmologjistët klinikë dhe siguron një ilustrim të mirë të koncepteve bazë të terapisë së laserit për shoqërime okulare të ndryshme të lidhur me kapakët, kornën, kristalinin dhe retinën”,-shprehet ndër të tjera prof.Zhugli në paraathënien e këtij libri.

Padyshim që kjo karrierë e shkëlqyer profesionale dhe akademike e prof.asoc.dr.Ali Tonuzit ka patur si bazë studimet universitare me rezultate të shkëlqyera në Fakultetin e Mjeksisë, Tiranë, dega Mjeksi e Përgjithshme (1986-1991), për të vijuar me “Diplomë Kualifikimi”, Specializim në Departamentin e Okulistikës, Tiranë (1992-1996) dhe në vitin 1997, ndoqi dhe përfundoi Shkollën Pasuniversitare (SHPU). Për të arritur në këtë stad kualitativ dhe akademik, prof.as.dr. Ali Tonuzi ka kryer disa trajnime dhe kualifikime, si: Kirurgji Okulare (Syrin) në Malaga – Spanjë; Specializim në Okulistikë (ORBIS) në Varna – Bullgari; për Kirurgjinë e Kataraktit pranë Universitetit Charles – Pragë, Republika Çeke; Program trainimi në Phacoemulsification, në Aravind Eye Hospital Coimbatore – Shteti, Tamilnadu, INDIA si dhe Felloëship në Menaxhimin Medikal & Kirurgjikal në Semundjet e retines dhe Vitrosit, në Aravind Eye Hospitals & Postgraduate Institute of Ophthalmology. India.

Si njohës perfekt i anglishtes e frëngjishtes në të lexuar, shkruar e folur, Prof.asc.dr. Ali Tonuzi, njëherësh ndër anëtarët më aktiv të Shoqatës së kirurgëve vitreoretinal të Indisë dhe Shoqatave Shkencore të Okulistëve të Shqipërisë e asaj të Kosovës, është pjesëmarrës dhe referues dinjtoz në disa kongrese e konferenca Shkencore, kombëtare, rajonale e ndërkombëtare, si në Bern e San Galen – Zvicër, Romë – Itali, , Prague – Czech Republik, Morfild – Londër, Dubrovnik-Kroaci, Sarajevë – Bosnje Hercegovinë, Kerala – Shteti

Tamilnadu India, Ljubljana – Slloveni, Thessaloniki – Greqi , Helsinki – Finland , në Prishtinë, Stugë. Etj.

Prof.asc.dr.Ali Tonuzi është autor i dhjetra artikujve dhe botimeve shkencore në revista e buletine shkencore të vendit e ato ndërkombëtare.

AKTIVITETI PROFESIONAL

Aktiviteti profesional I Prof.asc.dr.Ali Tonuzit konsiston në zbulimin për të parën herë të sëmurëve me retinitis nekrotizant nga CMV dhe të sëmurëve me endoftalmit endogen nga HIV. Po ashtu, në trajtimin e endoftalmitit me vitrektomi dhe injeksione intravitreale; përdorimin e triamcinolonit në edemën makulare diabetike; përdorimin e avastines në edemën makulare cystoide; trajtimin bashkohor të degeneracionit makular senile të njome me Anti-VEGEF, Lucentes dhe TPP, PDT; përdorimin e laserit në edemën makulare diabetike (Fokal laser); përdorimin e laserit për fotokoagulacionin panretinal ne retinopatin diabetike proliferative si dhe trajtimin e okluzioneve venoze retinale me laser.

Specialistët e fushës i njohin prof,asc,dr.Ali Tonuzit meritën e trajtimit për herë të parë të sëmurëve me dislokim të lensit në trupin vitroz me vitrektomi anteriore dhe fiksion skleral në dhomen e pasme; aplikimin e Barage laser për degeneracionet dhe çarjet retinale periferike për parandalimin e shkolitjes retinale, përdorimin për herë të parë të Ganciklovirit intravitreal dhe cor vitrectomi në endoftalmitin nga HIV- i dhe CMV; trajtimin kirurgjikal në sindromë Marfan dhe riaftesim të plote të sëmurit me anë të fiksimit të inplantit në sklere dhe vitrektomi anteriore si dhe të Trans plana vitrektomi në hemoragjitë masive vitreale dhe rrethim me buckel në shkolitjet retinale dhe injeksion i vajit të silikonit.

Me këto ndërhyrje kirurgjikale të sukseshme ai është bërë nga kirurgët vitreoretinal më të njohur e preferuar nga pacientët, jo vetëm vendas por edhe nga shtetet e rajonit.

KIRURGU VITREORETINAL QË KRYEN NDËRHRYJET MË TË NDËRLIKUARA NË SY

Prof, asc. Dr. Ali Tonuzi – oftalmolog, kirurg i vitreoretinës, që e ushtron profesionin prej afro tri dekadash, si dhe një nga pedagogët e mirënjohur të Univeritetit të Mjeksisë (udhëheqës shkencor i temave të disa doktorantëve) është ndër të rrallët që ka realizuar me sukses mijëra operacione të ndërlikuara.

Ai bën të ditur se prej vitesh Sherbimi i Okulistikës ofron me sukses një gamë të gjërë të ndërhyrjeve kirurgjikale në sy me teknika bashkëkohore dhe se prej vitit 2019 e në vazhdim është siguruar nga spitali e gjithë paketa e kataraktës që vazhdon të aplikohet me sukses në këtë shërbim. Ndërkohë, Qendra Shqiptare e Syve, drejtuar nga Prof.asc.dr.Ali Tonuzi, është ndër më profesionale, ku përveçse vizitave të përgjithshme okulistike janë kryer dhe kryhen me sukses ndërhyrje të ndërlikuara, si kirurgji strabizmi; pterigium; kirurgji katarakte; kirurgji glaukome; lazer për retinë; kirurgji vitreoretinale; trajtim i syrit të verbër të dhimbshëm; proteza okulare; plastikë e syrit si dhe hapje e kanalit të lotit endoskopike (pa qepje).

Dr.Tonuzi gjatë karrierës së tij profesionale dhe akademike ka marrë disa vlerësime nga institucione e agjenci të specializuara, për nivelin e lartë profesional, përkushtimin dhe cilësitë njerëzore dhe si hartues i suksesshëm i një sërë leksionesh universitare në fushën e mjekësisë.

Përkushtimi, profesionalizmi dhe talenti i Dr.Ali Tonuzit është vlerësuar edhe nga shoqata Shqipëri-Itali. Kjo shoqatë i akordoi atij para disa ditësh një Mirënjohje në vlerësim të



kontributit të shquar në fushën e mjekësisë dhe në atë të jetës akademike e universitare.

Dr.Tonuzi, 54 vjeç, ka tashmë më se çerek shekulli në shëndetësi. Në duart e tij kanë kaluar me dhjetra e dhjetra mijëra pacientë të cilët i kanë besuar dritën e syve këtij mjeku okulist të talentuar, ku prej shërbimit të marrë kanë qenë mjaft të kënaqur.

Për tri dekada këtu në Shërbimin e Okulistikës të Spitalit Francez në QSUT ai ka dhënë provat e një mjeku mjaft të aftë dhe ambicioz në profesion.

Në kohët që jetojmë kemi nevojë për njerëz të mirë të mençur, vizionarë që të nderojnë jo vetëm një punë ku marrin një rrogë mujore, po shumë më tepër. Kohët që po jetojmë na bëjnë që ta kthejmë dhe më shumë syrin nga mjeku, nga humanizmi i tij.

*<https://rd.al> 2021/11/20 › [prof-asoc-dr-ali-tonuzi-me-...](https://dritare.info/libri-laseri-ne-oftalmologji-i-prof-.../)
<http://dritare.info/libri-laseri-ne-oftalmologji-i-prof-.../>
<http://rrugaearberit.com> 2021/12/11 › [prof-asoc-dr.al](https://rd.al)*

KUR ADEM KORMAKU DEBATONTE ME MANUSH MYFTIUN PËR 15 – KATËSHIN

*Për librin enciklopedi, me 400 faqe
“U rrita me lotët e nënës”*



“Konstruksioni dhe arkitektura e hotelit 15 katësh janë bërë nga konstruktori me përvojë Ferit Stërmasi dhe arkitektja Valentina Pistoli. Nuk ka asnjë dyshim për konstruksionin e zbatuar që nga themelet, katet teknike, kolona, trarë, ndërsa pjesa e betonimit të hotelit, janë mure betoni me dopjo zgarë me betonime cilësore, me marka të larta betoni. Kështu, ka garanci të plotë e sikur të bjerë hoteli, do të mbetet si shkrepëse pa prishur!”

Në artin e ndërtimitarisë shqiptare, Hotel “Tirana Interanational”, ose 15 katëshi i para “90-tës në qendër të Tiranës, sot mund të konsiderohet edhe si “embrioni” i kullave shumëkatëshe që janë ngritur e po ngrihen thuajse në çdo rrugë të kryeqytetit. Kjo, edhe për peripecitë që përjetoi stafi inxhiniero-teknik që projektoi dhe ndoqi zbatimin e

punimeve të 15-katëshit. Më së miri këto i shpjegon Ing.Adem Kormaku, ish-drejtori i kantierit të “21 Dhjetorit”. Në librin e tij enciklopedi, me 400 faqe “U rrita me lotët e nënës,” ndër të tjera ai shkruan: “Nga fundi i vitit 1972 u bë një analizë në organet e larta qeverisëse në Tiranë ku doli se në stadin aktual, ishte e nevojshme ndërtimi i disa objekteve të rëndësishme për Tiranën. Këto objekte ishin: Një hotel 15 katësh në qendër të Tiranës, Hotel ‘Arbëria’ ku është sot Ministria e Drejtësisë; Galeria e Arteve; Shkolla përballë Arkivit të Shtetit; godina e banimit shtatë katëshe para Ministrisë së Drejtësisë, Rezidenca e Ambasadës së Kinës, ndërtimi i hotelit të kinezëve-sot Policia e Shtetit; ndërtimi i Antibiotikut etj”. Ing.Kormakut i cili ka gjurmët e tij në pothuajse të gjitha këto vepra, pasi kishte udhëhequr punimet në ndërtimin e metalurgjikut të Elbasanit, me kantierin e “21 Dhjetorit”, iu besua detyra e vështirë për zbatimin e projektit të 15 katëshit, një objekt me përmasa e vështirësi specifike që realizohej për herë të parë në vendin tonë. Si një nga mjeshtrit e njohur të artit të ndërtimtarisë në vendin tonë, Ing.Kormaku thekson se në ndërtimin e këtij objekti unikal në Shqipëri për kohën dhe më vonë, ishin përqëndruar e thirrur specialistët më të mirë, grupuar në një brigadë prej 300 vetësh, mjeshtrë në profesionet e karpentierit, hekurit, suvatimeve, patinimeve, sistemet hidraulike, hekurkthyes, marangozë, elektrikist...

DEBATI ME MANUSH MYFTIUN PËR KATET E LARTA TË HOTELIT 15 KATËSH

Në kohën kur ishin kapërcyer momentet më të vështira, zbatuesit e projektit u gjendën para të papriturës sepse vinçi i blerë për këtë qëllim nuk mund të realizonte ndërtimin e kateve të larta. Ky qe edhe shkaku që Adem Kormakun e thirri me urgjencë në ballafaqim Manush Myftiu, duke i kërkuar të jepte garanci për konstruksionin e 15 katëshit.

“Konstrukzioni dhe arkitektura e hotelit 15 katësh është bërë nga inxhinieri dhe arkitekti me përvojë, siç janë konstruktori me përvojë Ferit Stërmasi dhe arkitektja Valentina Pistoli. Nuk ka asnjë dyshim për konstrukcionin e zbatuar që nga themelet, katet teknike, kolona, trarë, ndërsa pjesa e betonimit të hotelit, janë mure betoni me dopjo zgarë me betonime cilësore, me marka të larta betoni. Kështu, ka garanci të plotë e sikur të bjerë hoteli, do të mbetet si shkrepëse pa prishur!”, ka qenë garancia që i ka dhënë ish byroistit Myftiu, inxhinieri i talentuar me origjinë nga Stebleva. Kështu, Adem Kormaku, ka lënë gjurmë me artin e ndërtuesit, jo vetëm tek Hotel “Tirana Interanational”, ose 15 katëshi i para ‘90-tës në qendër të Tiranës, por edhe në ngritjen e bazamentit të monumentit të Luftëtarëve të Lirisë në Mat’hauzen; në ngritjen e Pallatit të Madh të Kulturës në Tiranë, në Galerinë e Arteve, në ndërtimin e kompleksit të ambasadës kineze, sot Ministria e Jashtme e Shqipërisë, duke fituar mirënjohje e vlerësim nga qindra punëtorë, teknikë, inxhinier, nga drejtues e institucionet më të larta shoqërore e shtetërore.

Mjafton të lexosh librin e tij “U rrita me lotët e nënës,” për të kuptuar se me sa dashuri shkruan ai për plejadën e madhe të ndërtuesve, për ata që sakrifkuan në rindërtimin e vendit për pesë dekada. Ashtu si artin e ndërtimarisë në këtë libër ai ka derdhur edhe artin e të shkruarit me cilësi dhe me ndjenjë.

INXHINERËT SHQIPTARË QË ZBATUAN PUNIMETE MEMORIALIT TË MAT’HAUZENIT

Në mars të vitit 1968, Adem Kormaku, kur sapo kishte fituar titullin inxhinier-asistent, ngarkohet me një grup pune për të përgatitur bazën materiale për zbatimin e punimeve në monumentin kushtuar të rënëve në kampin famëkeq të Mat’hauzenit në Austri. Në këtë detyrë me shumë përgjegjësi

inxhinieri nga Stebleva ishte së bashku me Taqo Mihon dhe Llazar Maznikun.

Ishte vërtetë një nga momentet më të lumtura të jetës së tij, pasi djali që ishte rritur jetim (pa baba që në fëmijërinë e tij të herëshme) me vështirësi të panumërta në një zonë mjaftë të varfër, ishte përzgjedhur të përfaqësonte shtetin shqiptar në një vepër monumentale në një nga shtetet kryesore të Europës. I ndërgjegjshëm se do të linte gjurmë në një vepër që do përjetësonte martirët e lirisë të rënë në kampin famëkeq të shfarosjes në Mat'huazen, iu përkushtua detyrës me përgjegjësi maksimale.

“Pasi u përgatit gjithçka, më 23 shtator u nisëm për në Austri dhe në dhjetor të vitit 1968 kthehemi nga Austria me detyrë tëvrealizuar”, shkruan ai në faqen 155 të librit të tij “ U rrita me lotët e nënës”. Mbresëlënëse janë kujtimet e tij të hedhura me dashuri në faqet e këtij libri, për kohën kur në Tiranë nisi dhe u realizua ndërtimi i banesave me punë vullnetare. Shkruan ai për vitet 1966-1970 kur nga organet vendimmarrëse të kohës u pa e nevojshme që ndërtimet me kontribut vullnetar të ishin të përqëndruara. Dhe pikërisht për këtë qëllim u krijua Drejtoria e Objekteve me Kontribut vullnetar, nga e cila vetëm në vitin 1970 do të ndërtoheshin 2000 apartamente. Më pas Adem Kormaku do të ishte i pranishëm në ndërtimin e veprave të rëndësishme në Tiranë, ku do të spikasnin përkushtimi dhe sakrifica e tij në përmbushjen e detyrave.

Në korrik të vitit 1976 inxhinieri i talentuar Adem Kormaku emërohet Drejtor në Ndërmarrjen e Ndërtimit Nr.10 në Tiranë. “Që të jem i sigurtë, me shpirt nuk e prita mirë këtë ngritje në përgjegjësi. Kjo pasi me vrull të madh u kthyem nga Elbasani ku punuam e sakrifikuanm aq shumë për të përfaqësuar denjësisht Tiranën në ndërtimin e Kombinatit Metalurgjik, e për aq kohë sa punuam atje, patëm rezultate shumë të mira, Edhe ndërtimin e objekteve kapitale në Tiranë,

e filluam nga zero dhe ia dolëm me sukses falë një pune të vështirë, lodhëse, por dhe që na dha kënaqësi”,-shkruan ai me modesti në librin e tij, (fq.173-175). Në këtë libër ai shkruan edhe për ndërtimin e objekteve të rëndësishë së veçantë, ku ndër të tjera rendit repartin 101-K për Rezervat e Shtetit, Ministrinë e Rendit si dhe Godinën e Radio Televizionit...

DASHURIA E ZJARRTË PËR VENDLINDJEN DHE NJERËZIT E SAJ

Jo më kot, kapitullin e parë të këtij libri ai ua kushton vendlindjes dhe personaliteteve të Steblevës. Referuar librave të autorëve vendas e të huaj që ofrojnë shkaqe të ndryshme për emërtimin e vendlindjes së tij, si Vahid Kormaku, Ramazan Hoxha, Ilmi Sadiku, Kujtim Boriçi, Velo Cfaruku, Mehmet Hasani, Artan Lila, Agim Çadri etj, ai me kompetencë jep etimologjinë e saktë, sipas të cilit mbizotëron varianti i prejardhjes nga “s’të bleva”, (pra “nuk të bleva”), nga u përshtat emri- Stebleva.

Biri i denjë i kësaj krahine të Gollobordës, i rritur jetim me përkujdesjen dhe dashurinë e nënës së tij (të cilën e ka patur dhe e ka idhull dhe kështu e përshkruan me madhësi edhe në këtë libër), referuar Barletit shpreh krenarinë për faktin se Oraniku (Stebleva e sotme) ka qenë një nga vendqëndrimet dhe baza e Skënderbeut në luftimet me hordhitë e ushtrisë turke.

Krenari të ligjshme shpreh auutori i kësaj vepre edhe për origjinën e Mustafa Qemal Ataturkut nga Stebleva e Shqipërisë.

Ashtu siç përshkruan mjaftë bukur bukuritë natyrore të kësaj zone të stolisur me male të larta e pllaja të bukura mes pyjeve shekullore që i ngjajnë një amfiteatri të mrekullueshëm, Adem Kormaku shprehet për njerëzit e kësaj zone, natyra e virgjër e së cilës i ka edukuar ta duan punën dhe dijen e kudo

ku kanë punuar e jetuar, kanë lënë mbresa dhe një emër të mirë.

“Në këtë fshat të virgjër me tradita patriotike, që është i dëgjuar për vlerat historike në shekuj, steblevasit me virtyte të larta njerëzore janë njerëz të ndershëm, të siqertë, të dashur, për t’u pasur zili që kanë krijuar harmoni brez pas brezi”. Si të tillë ai i profilizon me mjeshtri artistike tribunët popullorë dhe personalitetet e zonës Hazis Lila e Islam Hoxha, Adem Bojaxhiun që për 30 vjet me radhë ishte kryeplaku i Steblevës, sidhe mësuesin e dashur e të paharruar Gani Vaid Kormaku.

Ndonëse i ka kaluar 80 vite jetë, me ndjenjë njerëzore ai sjell edhe kujtimet e babait të tij Hamit Musa Kormaku (Terziu), rrëfimet e nënës dhe të të tjerëve.

Në këtë libër mbresëlënës mëson për kalvarin e njeriut të punës, me virtyte të rralla njerëzore e intelektuale, që nga një fëmijë i rritur jetim, më 1959 do të përzgjidhej si pjestar i bandës së ushtrisë për të mbrritur më 5 korrik 1970 tek diploma e kursit të lartë (Pasuniversitar) dy vjeçar të Inxhinisrisë së Ndërtimit, që mban numrin 96 të regjistrit zyrtar.

Në këtë libër mësojmë gjithashu se si intelektual i me kontribute kombëtare në artin e ndërtrimtarisë, Adem Kormaku do të arrinte të krijonte një familje solide dhe sot ju gëzohet dy djemve e vajzës së vetme si dhe nipërve e mbesave.

Shkrimtari dhe publicisti i mirënjohur Kujtim Boriçi, në parathënie të kësaj vepre enciklopedike, ndër të tjere evidenton modestinë e autorit Kormaku, i cili edhe kësisoj ngre në pedestal njeriun e punës e të veprave të mëdha. “Mendoj se duhet evidentuar dhe modestia e autorit për këtë produkt (librin), e cila theksohet që në faqen e parë e deri në mbyllje. Ai, ndonëse thotë se kujtimet, dokumentet e përmbledhura në këtë libër i ka shkruar për tu lënë fëmijëve, të afërmve e të njohurve, copëza jete të dekadave që ai ka mbi supe, në fakt, libri në tërësi është shumë më tepër se kaq”,-

shkruan redaktori Boriçi. Kjo sipas tij edhe për faktin se lexuesi i këtij libri do të shikoj se Ademi ka qenë specialist apo drejtues në disa vepra shumë të rëndësishme, që nuk janë pak, por krenaria e ndërtimitarisë në Shqipëri, e si të tilla, për ta edhe rreth tyre, ne sot, por dhe brezat që vijnë, duhet të dinë apo të kenë të dokumentuar jo vetëm projektet, por dhe punën e gjallë që është bërë për materializimin e tyre, sakrificat e mijëra njerëzve që bënë gjithçka për ti ngritur ata në këmbë. Edhe me këtë vepër enciklopedike Adem Kormaku ka dhënë diçka me vlerë për shoqërinë.

*Gazeta "FJALA", 21 Dhjetor 2021 - [https://alb-spirit.com/.../
kur-adem-kormaku-debatonte.../
\[https://fjala.al/2021/12/21/kur-adem-kormaku-debatonte-
me-manush-myftiun-per-15-kateshin/\]\(https://fjala.al/2021/12/21/kur-adem-kormaku-debatonte-me-manush-myftiun-per-15-kateshin/\)](https://alb-spirit.com/.../kur-adem-kormaku-debatonte.../)*

DR. HAJRI MANDRI: HALIL RAMA – PROFILI I PUBLICISTIT DHE SHKRIMTARIT TË MIRËNJOHUR

*Në 20 librat e tij sjell artistikisht
ngjarje e personazhe që të lënë mbresa*




Krijimtaria e Halil Ramës është vlerësuar nga personalitete të shquara të letrave si: Prof.dr.Shaban Sinani, Prof.Bujar Kapexhiu-]”Nderi i Kombit”, Prof.Dr.Fatmir Terziu - “Mjeshtë i Madh” (dekoruar edhe me dekoratën e lartë “Gjergj Kastrioti Skënderbeu”, si dhe nga shkrimtarët e mirënjohur: Shpendi Topollaj, Dr.Hajri Mandri, Andon Andoni, Shefqet Meko, Sakip Cami, Dr.Fejzulla Gjabri, Naim Berisha, Namik Selmani, Dr.Selman Mëziu etj.

Nga viti 2000 boton në vijimësi opinione, dossier, kritikë letrare, poezi dhe reportazhe në të përditshmet: “Panorama”, “Gazeta Shqiptare”, “Telegraf”, “Koha jonë”, “Dita”, “Bota Sot” dhe “Standard”; në të përjavshmen kulturore-artistike “NACIONAL”, si dhe në portalet e mirënjohura: “Fjala e lirë”, “alb-spirit”, “start-news”, “dritare.info”, “vizion.com.al”, “Zani i Malsisë”, etj.

Publicisti dhe shkrimtari i talentuar, mjaft produktiv e cilësor dhe me një përvojë të gjatë, Halil Rama, në 60-vjetorin e ditëlindjes (28 tetor 2020), është dekoruar nga Presidenti i Republikës Ilir Meta, me titullin “Mjeshtër i Madh” . Ky titull i lartë iu dha autorit të 20 librave monografikë (H.Rama), në një manifestim festiv të komunitetit artistik të Zall Dardhës, më 19 shtator 2020, me prezencën

e autoriteve vendore dhe elitës intelektuale dibrane: *“Për kontributin e shquar si shkrimtar, skenarist e publicist i cili në veprimtarinë e tij të gjerë ka pasyqruar më së miri historinë, kulturën, traditat e cilësitë identifikuese të shumë viseve shqiptare, veçanërisht të trevës së Dibrës, si dhe vlerat e shumë figurave të shquara të kombit shqiptar”* (motivacioni i dekoratës).

Jo pa qëllim ishte përzgjedhur Zall Dardha për të vlerësuar shkrimtarin dhe publicistin Halil Rama, si dhe artistët më në zë të kësaj treve Liri Rasha, Qerim Sula, Sherif Dervishi,






Sahje Poleshi, Xhelail Imeraj, Neshat Ndreu, etj. Kjo për faktin se Halir Rama ka shkruar dhe promovuar monografi e dokumentarë për artistë të përmasave kombëtare të kësaj treve, si për kompozitorin e tangos shqiptare Muharrem Xhediku, ikonën e artit e kulturës kombëtare Hazis Ndreu, regjisorin dhe aktorin e shquar Skënder Cala, për Lutfi Ndreun – mësues dhe artist, etj, të botuara këto edhe në prestigjiozet e përditshme: “Panorama”, “Gazeta Shqiptare”, “Telegraf”, “Koha jonë”, “Dita”, “Bota Sot” dhe “Standard” e në të përjavshmen kulturore-artistike “NACIONAL”, si dhe në portalet e mirënjohura: “Fjala e lirë”, “alb-spirit”, “start-news”, “dritare.info”, “vizion.com.al”, “Zani i Malsisë”, etj.

Veçanërisht në tri monografitë e botuara dy vitet e fundit: “*Muhurri, histori dhe personalitete*”, (me 712 faqe në 17 kapituj), “*Fluturon shqipja mbi Korab*” dhe “*Zall Dardha në ditarin e Isuf Rashës*”, si dhe në librat e shkruara dekadën





Zija Cela

Halil Rama, miku im i dashtun, ti ke botuar nje shkrim me shume miredashje per librin “Thika pa gjak”, ku eshte perfshire edhe ky tregim. Mbaresesi e perqafime.

Autograf

e fundit nga ky autor, zbulohet thelbi i marrëdhënieve njerëzore. Jetët e personazheve realë, janë të mbushura me pasione dhe emocione të pandalshme, drejt sfidës së jetës, drejt suksesit. Shkrimi i tij depërton thellë në shpirt dhe zbulon botën delikate të intelektualëve dibranë, kukësi, durrsakë, shkodranë etj, në strukturën e tyre si njerëz të matur që veprojnë në kontekst duke marrë prej tij, maksimalisht suksesin.

Halili e formoi personalitetin e tij, jo vetëm në praktikën krijuese voluminoze por edhe me studime të integruara formale universitare për drejtësi, (duke fituar edhe titullin “Avokat”) çka i ka dhënë një surplus në interpretimin e dukurive shoqërore dhe ngjarjeve pikante të historisë. Ai i vendos intelektualët që nuk jetojnë dhe ata që jetojnë dhe kontribuojnë ende, secilin në vendin dhe piedestalin e merituar. Dashuria dhe ngrohtësia me të cilat i mbështjell ata, janë shprehje e humanizmit dhe shpirtit patriot, demokrat e liridashës të autorit.

Lexuesi mund të shijojë drejtpërdrejtë noktturnet dhe romantikën që shpërfaqen në librat e H.Ramës (për gjeneral Rrahman Parllakun, Liri Belishovën, Muharrem Xhedikun,



Skënder Calën etj) shkruar me një stil të rrjedhshëm, që ngjajnë me një ese të gjatë liriko-epike, si një databazë e plotë e vlerave të tyre, duke plotësuar harmonishëm tablonë gjigande të njerëzve të ditur, të urtë e patriotë. Veçanërisht librat e fundit “Muhurri, histori dhe personalitete” dhe “Fluturon shqipja mbi Korab”, lexohen këndshëm nga përdorimi me mjeshtëri i mjeteve gjuhësore dhe stilistike, ngjytimeve emocionale që fitojnë ngjarjet dhe personazhet, nën talentin dhe profesionalizmin e Halil Ramës. Madje siç shprehet shkrimtari dhe publicisti i njohur Shefqet Meko: “Halil Rama shkruan thjesht, pa bujë dhe bërtitje, me gjuhë të thjeshtë, të kuptueshme qartë dhe rrejdshëm. Ai e përdor fuqinë shprehëse të shqipes si ‘antikorp’ gjuhësor ndaj çdo huazimi të huaj, që ka çibanuizuar lemeritshëm shtypin, rrjetet sociale, median dhe ekranet shqitare.

Krijimtaria e Halil Ramës është vlerësuar nga personalitete të shquara të letrave si: Prof.dr.Shaban Sinani, Prof.Bujar Kapexhiu-“Nderi i Kombit”, Prof.Dr.Fatmir Terziu - “Mjeshtëri i Madh” (dekoruar edhe me dekoratën e lartë “Gjergj Kastrioti Skënderbeu”, si dhe nga shkrimtarët e mirënjohur: Shpendi Topollaj, Dr.Hajri Mandri, Andon Andoni, Shefqet Meko, Sakip Cami, Dr.Fejzulla Gjabri, Naim Berisha, Namik Selmani, Dr.Selman Mëziu etj.



Në 20 librat e tij ai sjell artistikisht ngjarje e personazhe që të lënë mbresa, por dhe jehonën e vendlindjes së tij të bukur dhe të dashur, si shembëlltyrë e jehonës që vjen nga e shkuara tek e sotmja dhe na zgjon të gjithëve e na thërret, për më shumë humanizëm, dashuri e dinjitet.

KUSH ËSHTË HALIL RAMA

Ka lindur në Muhurr, Dibër më 28 Tetor 1960.

Nga 1996 jeton dhe punon në Tiranë.

Është diplomuar në Jurisprudencë (Bachelor dhe Master Shkencor) dhe pasi ka kryer edhe Shkollën Kombëtare të Avokatisë me rezultate shumë të mira, ka fitur titullin “Avokat” me Nr.Liçense 7979, datë 31.10.2014.

Ka punuar: Përgjegjës i Shtëpisë së Kulturës Muhurr (1980-1981) pasi kreu Kursin e Regjistrës pranë Shtëpisë Qëndrore të Krijimtarisë Popullore, Tiranë (1979); Punonjës Socialkulturor në Minierën e Mermerit Muhurr (1985-1988); Metodist kulture në Shtëpinë e Oficerëve Bulqizë (1989-1991); Shef i Administratës në Këshillin e Rrethit Bulqizë (1992-1997); Shef i Organizimit dhe Nënkyetar i BSD e Bashkimit Liberal Demokrat (1997-2015) dhe njëherësh: Reporter dhe Redaktor i Politikës e Kulturës në gazetat e

përditshme: “Bulevard”, “Albania” dhe “Rilindja Demokratike (1999-2013); Shef i Sektorit të Marrëdhënive me Publikun të Bashkisë Kamëz dhe Kryeredaktor i gazetës “Kamza” (2010-2012); Specialist në Sektorin e Koordinimit të Marrëdhënive me Njësitë Administrative të Bashkisë Tiranë, ku ka fituar Statusin e Nëpunësit Civil (2012-2020 e në vazhdim).

Fillimet në gazetarinë e shkruar i ka që nga viti 1977 si bashkëpunëtor i gazetës lokale “Ushtima e Maleve” dhe i gazetave qendrore “Bashkimi”, “Zëri i Rinisë”, “Puna” dhe “Luftëtari”.

Është kryeredaktor i gazetave periodike: “BULQIZA” (1992-1996 dhe nga 2014 e në vazhdim); “Bota SD” (1998-2003); “Vizioni Liberal” (2003-2009) dhe “VETERANI” (nga 2003 e në vazhdim).

Nga viti 2000 boton në vijimësi opinione, dossier, kritikë letrare, poezi dhe reportazhe në të përditshmet: “Panorama”, “Gazeta Shqiptare”, “Telegraf”, “Koha jonë”, “Dita”, “Bota Sot” dhe “Standard”; në të përjavshmen kulturore-artistike “NACIONAL”, si dhe në portalet e mirënjohura: “Fjala e lirë”, “alb-spirit”, “start-news”, “dritare.info”, “vizion.com.al”, “Zani i Malsisë”, etj.

Është autor i 20 librave (monografi&refleksione&reportazhe&poezi&kritikë letrare).

Halil Rama është i martuar me Znj.Kimete Rama(Berisha) dhe ka dy djem, Bledarin dhe Arlindin.

Me Dekret Nr.11724, datë 17.09.2020, Z.Halil Rama është dekoruar nga Presidenti i Republikës SHT Z.Illir Meta me titullin “MJESHTËR I MADH” me motivacionin: *“Për kontributin e shquar si shkrimtar, skenarist e publicist i cili në veprimtarinë e tij të gjerë ka pasyqruar më së miri historinë, kulturën, traditat e cilësitë identifikuese të shumë viseve shqiptare, veçanërisht të trevës së Dibrës, si dhe vlerat e shumë figurave të shquara të kombit shqiptar”*

DISA BOTIME TË AUTORIT HALIL RAMA NË VITE:

- Dine Hoxha-Një filozof popullor në Oborrrin Mbtretëror (monografi me b/autor, 2006)
- Muharrem Xhediku – Kompozitori i tangos shqiptare (monografi me b/autor, 2008)
- Fundi i Rrugës së vetme (refleksione&kritikë letare, 2011)
- Testamenti i atdhedashurisë (Reportazhe, portrete, kritike letare, 2012)
- Memoria historike e kombit Reportazhe, portrete, kritike letare, 2013)
- Rrahman Parllaku-Një legjendë ne kufirine dy koheve (monografi me b/autor, 2014)
- 20 VJET OBVL (Histori, portrete, me b/autor – 2014)
- Histori brezazh te familjes së shquar Kazazi të Durrësit (monografi me b/autor, 2015)
- LIRI BELISHOVA – Gruaja që sfidoi diktaturën (Monografi – 2016)
- Në panteonin e vlerave (refleksione&profile&kritikë letare ,2016
- Bajram Ndreu i Zall Dardhës (monografi me b/autor, 2017)
- AGJENDA E NJE MINISTRI (kushtuar Safet Zhulalit - monografi me b/autor, 2017)
- Lutfi Ndreu, mësues dhe artist (Monografi – 2019)
- Rizgjime meteorësh (refleksione & profile & kritikë letare & Poezi,-2019)
- Skënder Cala në gjerdanin e artë të kulturës shqiptare (Monografi letare ,2019)
- Gjenerali që sfidoi kohërat (monografi me b/autor, 2019)

- MUHURRI - Histori dhe personalitete (Monografi - 2020)
- Fluturon shqipja mbi Korab (Reportazhe, portrete, kritikë letare, 2021)
- Zall Dardha në ditarin e Isuf Rashës (monografi me b/ autor -2021)
- Magjia e fjalës..(profile krijuesish, kritikë letrare, analiza të veprave shkencore – 2022)

<https://www.fjalaelire.com/post/halil-rama-profil-i-publicistit-dhe-shkrimtarit-të-mirënjohur>

CIP Katalogimi në botim BK Tiranë

Rama, Halil

Magjia e fjalës : një libër për librat... : profile krijuesish,
kritikë letrare, analiza të veprave studimore / Halil Rama ;

rec. Hajri Mandri ; red. Aristir Lumezi. – Tiranë :

UET Press, 2022

290 f. ; 135. x 20.7 cm. – (ESSE / ide & debate; 63)

Me parath. nga Preç Zogaj

ISBN 978-9928-320-88-9

1.Letërsia shqipe 2.Autorë shqiptarë 3.Kritika, interpretimi
4.Njerëz të shquar dhe kultura 5.Historia 6.Shqipëri

821.18 .09

929(496.5)



"Magjia e fjalës", përveçse një adresar titujsh për t'u lexuar dhe një koleksion citimesh që në lidhjen e tyre krijojnë një buqetë perlesh për njohjen dhe kujtesën, është një shërbesë e madhe letrare dhe intelektuale në këto kohë të vështira për artin dhe kulturën. Nëse do të përfytyronim një "Urdhër" për mbrojtjen dhe promovimin e kulturës si pasuri e shoqërisë dhe njerëzimit, Halil Rama është aty, në shërbim të librit në gjithë shqipe.

Preç ZOGAJ

Përkushtim, seriozitet, dinjitet, dashuri, mall, respekt, mburrje, nostalgji, krenari – të gjitha së bashku këto ndjesi, si një gjerdan gurësh të çmuar në gjoksin e Halil Ramës, japin shkëlqimin dhe meritën e të suksesshmit, që çdokush e çmon dhe e vlerëson, pasi me 20 librat e tij ka ngritur me pasion këtë kështjellë të pakrahasueshme.

Prof. Bujar KAPEXHIU – Nderi i Kombit

Krijimtaria e Halil Ramës është vlerësuar nga personalitete të shquara të letrave si: Prof. dr. Shaban Sinani, Prof. Bujar Kapexhiu, Prof. Dr. Fatmir Terziu, si dhe nga shkrimtarët e mirënjohur: Shpendi Topollaj, Ahmet Prençi, Andon Anđoni, Shefqet Meko, Sakip Cami, Dr.Fejzulla Gjabri, Naim Berisha, Namik Selmani, Dr.Selman Mëziu etj. Në librat e shkruara dekadën e fundit nga ky autor, zbulohet thelbi i marrëdhënieve njerëzore. Jetët e personazheve realë, janë të mbushura me pasione dhe emocione të pandalshme, drejt sfidës së jetës, drejt suksesit. Shkrimi i tij depërton thellë në shpirt dhe zbulon botën delikate të elitës krijuese, në strukturën e tyre si njerëz të matur që veprojnë në kontekst duke marrë prej tij, maksimalisht suksesin.

Dr. Hajri MANDRI



UETPRESS

